



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 15

Tiranë – E mërkurë, 21 janar 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 94/2025, datë 18.12.2025	Për vullnetarizmin..... 1407
Dekret i Presidentit nr. 23, datë 15.1.2026	Për shpallje ligji..... 1420
Ligj nr. 96/2025, datë 18.12.2025	Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve..... 1420
Dekret i Presidentit nr. 24, datë 15.1.2026	Për shpallje ligji..... 1434
Dekret i Presidentit nr. 25, datë 16.1.2026	Për lirim nga detyra të Komandantit të Forcës Detare..... 1434
Dekret i Presidentit nr. 26, datë 16.1.2026	Për emërimin në detyrë të Komandantit të Forcës Detare..... 1434
Dekret i Presidentit nr. 27, datë 16.1.2026	Për dhënie grade madhore..... 1434
Dekret i Presidentit nr. 28, datë 16.1.2026	Për dhënie grade madhore..... 1435
Dekret i Presidentit nr. 29, datë 16.1.2026	Për dhënie grade madhore..... 1435
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 15.1.2026	Për disa ndryshime në vendimin nr. 250, datë 24.4.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme”, të ndryshuar..... 1435
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 9, datë 15.1.2026	Për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2027–2029..... 1471

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 12, datë 15.1.2026	Për disa ndryshime në vendimin nr. 1039, datë 4.12.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Punës dhe për caktimin e përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave në këtë këshill”, të ndryshuar.....	1484
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 15, datë 15.1.2026	Për transferimin e kuotave të kapitalit, që zotërohen nga shoqëria “ <i>Albcontrol</i> ” sh.a., në shoqërinë “ <i>Air Albania</i> ” sh.p.k., tek Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit.....	1485
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 16, datë 15.1.2026	Për miratimin e listës së mallrave të përjashtuara nga taksat doganore, të cilat shërbejnë drejtpërdrejt për prodhimin e armatimit ushtarak.....	1485
Udhëzim i ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit nr. 1, datë 9.1.2026	Për përcaktimin e rregullave të brendshme mbi ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë me debitor ministrinë përgjegjëse për turizmin, kulturën dhe sportin.....	1494
Urdhër i ministrit të Financave nr. 2, datë 7.1.2026	Për delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor.....	1496
Urdhër i drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit nr. 12, datë 8.1.2026	Për delegim kompetence.....	1496
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 47, datë 14.1.2026	Për delegim kompetence.....	1497
Urdhër i ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit nr. 213, datë 19.11.2025	Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret, afatet, si dhe procedurën për kategorizimin e strukturave akomoduese”.....	1497
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 44, datë 29.7.2025	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 93 (87-2024-134), datë 17.5.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-1272, datë 11.7.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.	1529
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 345, datë 29.12.2025	Mbi kërkesën e shoqërisë “Volton” sh.p.k. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë OSSH sh.a., lidhur me pikën e matjes “Tona ALB/6390”.....	1563
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 346, datë 29.12.2025	Mbi fillimin e procedurës për disa ndryshime në treguesit e kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike.....	1565
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 1, datë 8.1.2026	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Tirana International Development” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	1567
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 2, datë 8.1.2026	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Favina.1.” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	1568



LIGJ
Nr. 94/2025

PËR VULLNETARIZMIN

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton parimet bazë, rregullat për kryerjen e vullnetarizmit, të drejtat dhe detyrimet e vullnetarëve e të ofruesve të vullnetarizmit, kontratën e vullnetarizmit, organet shtetërore përgjegjëse dhe mekanizmat për nxitjen, mbështetjen e mbikëqyrjen e vullnetarizmit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 2
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim krijimin e një kuadri rregullator e institucional të favorshëm për kryerjen e vullnetarizmit dhe nxitjen e pjesëmarrjes së individëve në vullnetarizëm, zhvillimin e vlerave njerëzore dhe solidaritetin shoqëror.

Neni 3
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për:

- të gjitha subjektet që kryejnë, ofrojnë ose përfitojnë vullnetarizëm në Republikën e Shqipërisë;
- vullnetarizmin afatgjatë dhe afatshkurtër.

2. Ky ligj nuk zbatohet për:

- kryerjen e punëve ose të shërbimeve, që janë të zakonshme në familje, shoqëri apo në marrëdhëniet e fqinjësisë;
- dhurimin e gjakut;

c) realizimin e detyrimeve të caktuara me vendim gjykatë të formës së prerë;

ç) angazhimin në një program trajnimi apo formimi profesional përpara lidhjes së kontratës së punës;

d) përcaktimin e metodologjisë së prodhimit të statistikave zyrtare mbi vullnetarizmin;

dh) partitë politike;

e) kryerjen e punëve ose të shërbimeve nga sindikatat apo shoqatat e tjera ekonomike, profesionale dhe tregtare, që synojnë realizimin e objektivave dhe të veprimtarive në interes të anëtarësisë së tyre, në bazë të parashikimeve të statutit;

ë) angazhimin dhe trajtimin e vullnetarëve në fushën e mbrojtjes civile, që kryhet sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë ligj, termit e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Grupe të veçanta” janë vullnetarë apo përfitues të vullnetarizmit, si:

a) nëna nën moshën 18 vjeç;

b) persona me aftësi të kufizuara, sipas parashikimeve të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara;

c) persona nga komuniteti rom dhe egjiptian;

ç) persona që i nënshtrohen trajtimit apo kujdesit shëndetësor;

d) të mitur, sipas parashikimeve të Kodit Civil;

dh) të mitur e të rinj në konflikt me ligjin, sipas parashikimeve të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur;

e) të moshuar;

ë) viktimat të dhunës në familje dhe viktimat të dhunës me bazë gjinore;

f) viktimat të trafikimit apo viktimat të mundshme të trafikimit;

g) viktimat të diskriminimit.

2. “Kohëzgjatje e vullnetarizmit” është koha në të cilën vullnetari vihet në dispozicion të ofruesit të vullnetarizmit, duke përfshirë edhe kohën e trajnimit të nevojshëm për të kryer vullnetarizmin.

3. “Ministri”/“Ministria” është ministri/ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit.

4. “Organizatë jofitimprurëse” është shoqata, fondacioni dhe qendra, që zhvillon veprimtarinë në



mënyrë të pavarur e të pandikuar nga shteti, në përputhje me parashikimet e legjislacionit për organizatat jofitimprurëse dhe të ligjeve të veçanta.

5. “Person” është personi fizik sipas parashikimeve të Kodit Civil.

6. “Program vullnetarizmi” është një grup veprimtarish apo shërbimesh, që organizohen nga ofrues të vullnetarizmit, zbatohen plotësisht apo pjesërisht nga vullnetarë dhe mbështesin realizimin e objektivave, që janë në të mirë dhe në interes të publikut apo në dobi të personave të tjerë.

7. “Veprimtari në të mirë dhe në interes të publikut” është çdo veprimtari që mbështet e zhvillon tek individit dhe shoqëria vlera shpirtërore e vlera të tjera humanitare, mbron jetën e njeriut, shëndetin e tij, siguron e realizon shërbime publike dhe sociale, ndihma dhe mbështetje në raste fatkeqësish, mbron mjedisin e zhvillon kulturën dhe edukatën ndaj tij, mbështet e zhvillon vlerat dhe traditat kulturore e historike, shkencën, arsimimin, edukimin fizik e shpirtëror, jep ndihmesë në zhvillimin e zakoneve të mira dhe të vlerave demokratike, si dhe çdo drejtim tjetër në të mirë dhe në interes të publikut.

8. “Vullnetarizëm i drejtpërdrejtë” është kryerja nga vullnetari, me iniciativën personale dhe pa organizimin e ofruesit të vullnetarizmit, të punëve ose shërbimeve vullnetare, në të mirë dhe në interes të publikut apo në dobi të personave të tjerë.

9. “Vullnetarizëm i organizuar” është kryerja nga vullnetari, përmes organizimit të ofruesit të vullnetarizmit, të punëve ose shërbimeve vullnetare në të mirë dhe interes të publikut apo në dobi të personave të tjerë.

10. “Shqetësim” është çdo sjellje e padëshiruar kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 9 të këtij ligji, që ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues ose ofendues për atë person, si dhe trajtimin më pak të favorshëm, të kryer si rezultat i kundërshtimit ose mosnënshtrimit nga ana e personit të cenuar ndaj një sjelljeje të tillë.

11. “Shqetësim seksual” është çdo sjellje e padëshiruar verbale ose joverbale, e natyrës seksuale, e cila ka për qëllim ose sjell si pasojë cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi kërcënues, armiqësor, përçmues, poshtërues ose ofendues për të.

Neni 5

Vullnetarizmi

1. Vullnetarizëm është investimi me vullnet të lirë i kohës, i njohurive dhe i aftësive vetjake në kryerjen pa kundërshtpërblim, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të organizuar, të punëve ose shërbimeve në të mirë dhe në interes të publikut apo në dobi të personave të tjerë.

2. Vullnetarizmi organizohet në formën e vullnetarizmit afatgjatë dhe të vullnetarizmit afatshkurtër.

3. Vullnetarizmi afatgjatë organizohet nga një ofrues vullnetarizmi me kohëzgjatje të paktën 20 (njëzet) orë në javë dhe zbatim të rregullt për të paktën tre muaj të njëpasnjëshëm.

4. Vullnetarizmi afatshkurtër organizohet nga një ofrues vullnetarizmi me kohëzgjatje më të kufizuar se vullnetarizmi afatgjatë, por, në çdo rast, jo më të shkurtër se 1 (një) orë në javë.

5. Çdo shtetas shqiptar dhe i huaj ka të drejtë kryejë vullnetarizëm e të japë kontribut në të mirë dhe në interes të publikut apo në dobi të personave të tjerë pa pasur nevojë të organizohet pranë ose nëpërmjet një ofruesi vullnetarizmi.

Neni 6

Vullnetari

1. Vullnetar është çdo person, vendas ose i huaj, që me vullnet të lirë kryen vullnetarizëm.

2. Vullnetar është i mituri apo një person me aftësi të kufizuara të shëndetit mendor, që kryen vullnetarizëm sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 7

Ofruesi dhe përfituesi i vullnetarizmit

1. Ofruesi i vullnetarizmit organizon vullnetarizmin.

2. Ofruesi i vullnetarizmit është një institucion publik, një bashkësi fetare ose një organizatë jofitimprurëse.

3. Institucioni publik ofron vullnetarizëm në përputhje me këtë ligj, ligje të veçanta apo në bazë të detyrimeve të përcaktuara në akte ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

4. Ofruesi i vullnetarizmit është edhe një person juridik, vendas ose i huaj, që kryen veprimtari fitimprurëse, i cili, në ofrimin e vullnetarizmit, nuk



synon fitimin dhe plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 24 të këtij ligji.

5. Ofruesi i vullnetarizmit, i përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, i angazhon vullnetarët vetëm në veprimtari që janë në të mirë dhe në interes të publikut ose në dobi të personave të tjerë.

6. Ofruesi i vullnetarizmit përcakton nevojën për angazhimin e vullnetarëve, natyrën dhe sasinë e punëve apo shërbimeve vullnetare të kërkuara, si dhe mënyrën e kryerjes së vullnetarizmit, bazuar në programin e vullnetarizmit.

7. Ofruesi i vullnetarizmit në programet e Bashkimit Evropian apo në programet e tjera ndërkombëtare në fushën vullnetarizmit përcaktohet në bazë të rregullimeve të këtyre programeve.

8. Përfituesi i vullnetarizmit është një person, një institucion publik, një bashkësi fetare ose një organizatë jofitimprurëse.

KREU II PARIMET BAZË

Neni 8

Parimi i njohjes dhe i mbështetjes së vullnetarizmit

1. Vullnetarizmi njihet dhe mbështetet në Republikën e Shqipërisë si një veprimtari me vlerë të lartë shoqërore, që kontribuon në përmirësimin e cilësisë së jetesës, zhvillimin e personalitetit njerëzor dhe përfshirjen e individëve në ndërtimin e një shoqërie demokratike, të drejtë dhe solidare.

2. Fëmijët dhe të rinjtë, që janë pjesë e sistemit arsimor në Republikën e Shqipërisë dhe që marrin pjesë në programet e edukimit joformal të mbështetur nga shteti, mbështeten që të fitojnë njohuri për konceptet, vlerat dhe rëndësinë e vullnetarizmit, të kryejnë vullnetarizëm dhe të fitojnë përvojën vullnetare, si dhe të përfitojnë kualifikime të përshtatshme për vullnetarizmin, solidaritetin shoqëror dhe qytetarinë aktive.

Neni 9

Parimi i trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit të vullnetarit dhe përfituesit të vullnetarizmit

1. Ofruesi i vullnetarizmit trajton çdo vullnetar në bazë të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit

në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë ose me çdo shkak tjetër.

2. Trajtimi i ndryshëm i vullnetarëve nuk përbën diskriminim kur parashikohet shprehimisht në këtë ligj apo ligje të tjera të posaçme.

3. Ofruesi i vullnetarizmit dhe vullnetari trajtojnë çdo person, që është përfitues i vullnetarizmit, në bazë të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë ose me çdo shkak tjetër.

4. Kur një person pretendon se është cenuar nga moszbatimi i parimit të trajtimit të barabartë në ushtrimin e së drejtës për kryerjen ose përfitimin e vullnetarizmit, sipas këtij ligji, ndjek procedurën e ankimit, të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

Neni 10

Parimi i mbrojtjes së personalitetit të vullnetarit dhe përfituesit të vullnetarizmit

Ndalohet çdo lloj shqetësimi, përfshirë edhe shqetësimin seksual, i kryer nga ofruesi i vullnetarizmit kundrejt vullnetarit ose përfituesit të vullnetarizmit, ndërmjet vullnetarëve apo ndërmjet vullnetarit e përfituesit të vullnetarizmit.

Neni 11

Parimi i mbrojtjes së të dhënave personale

Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale të vullnetarëve dhe përfituesve të vullnetarizmit bëhet



duke respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore të tyre, sipas parashikimeve të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 12

Parimi i ndalimit të shfrytëzimit të vullnetarit

1. Ndalohet vullnetarizmi që synon zëvendësimin e punëve ose të shërbimeve, të cilat kryhen në mënyrë të zakonshme nga punëmarrësit apo që kontraktohen rregullisht si shërbime të jashtme nga ofruesi i vullnetarizmit.

2. Ndalohet përdorimi dhe shfrytëzimi i vullnetarëve për qëllime fitimi.

3. Ndalohet vullnetarizmi me kohëzgjatje më të madhe se 40 (dyzet) orë në javë.

4. Ndalohet vullnetarizmi me kohëzgjatje 40 (dyzet) orë në javë dhe zbatim të rregullt për tre muaj të njëpasnjëshëm nëse nuk shoqërohet në vijim nga një pushim për të paktën dy muaj të njëpasnjëshëm.

5. Ndalohet vullnetarizmi me kohëzgjatje më të madhe se 10 (dhjetë) orë në ditë dhe zbatim për tre ditë të njëpasnjëshme nëse nuk shoqërohet në vijim nga një pushim për të paktën tre ditë të njëpasnjëshme.

Neni 13

Parimi i mbështetjes mbi vullnetin e lirë dhe ndjenjën solidare

1. Vullnetarizmi nënkupton kryerjen e punëve apo të shërbimeve vullnetare, mbështetur mbi vullnetin e lirë dhe ndjenjën solidare të vullnetarit.

2. Vullnetarizmi që nuk mbështetet mbi vullnetin e lirë dhe të plotë të vullnetarit, nuk konsiderohet vullnetarizëm sipas përcaktimeve të këtij ligji.

Neni 14

Parimi i vullnetarizmit pa përfitim material

1. Vullnetarizmi kryhet pa shpërblim monetar, pa shpërblim në natyrë apo një formë tjetër përfitimi material, përgjatë kohëzgjatjes së vullnetarizmit ose me përfundimin e tij, përveçse kur ky ligj parashikon ndryshe.

2. Vullnetarizmi që kryhet bazuar mbi premtimin ose dhënien, drejtpërdrejt ose tërthorazi, e çdo lloji forme përfitimi material, nuk konsiderohet vullnetarizëm sipas përcaktimeve të këtij ligji.

3. Nuk konsiderohet përfitim material kompensimi i vullnetarit për shpenzimet e kryera dhe të dokumentuara gjatë vullnetarizmit sipas rasteve të mëposhtme:

a) shpenzime për sigurimin e veshjeve, mjeteve ose pajisjeve të nevojshme për ruajtjen e shëndetit të vullnetarit apo për kryerjen e vullnetarizmit;

b) shpenzime për udhëtimin, akomodimin, ushqimin ose çdo shpenzim tjetër, të përballuar nga vullnetari gjatë kryerjes së vullnetarizmit;

c) shpenzime për ushqimin, kujdesin dhe trajnimin e kafshëve në pronësi të vullnetarit dhe që përdoren për kryerjen e vullnetarizmit;

ç) shpenzime për kontrollet mjekësore dhe shërbimet spitalore, kur nevojiten për kryerjen e vullnetarizmit;

d) shpenzime për pjesëmarrjen në një program trajnimi apo edukimi të ofruar jashtë sistemit arsimor kur lidhet me kryerjen e vullnetarizmit;

dh) shpenzime për sigurimin e jetës e të shëndetit të vullnetarit, si dhe për sigurimin për shpërblim dëmi të shkaktuar ndaj ofruesit të vullnetarizmit ose ndaj të tretëve;

e) rimbursim të shpenzimeve personale, përlllogaritur në masën deri në 30% të vlerës neto të pagës minimale në shkallë vendi, të përcaktuar në kontratën e vullnetarizmit;

ë) shpenzime për pjesëmarrjen dhe mbulimin e kostove të tjera, të parashikuara në një program të Bashkimit Evropian apo program tjetër ndërkombëtar në fushën vullnetarizmit.

KREU III

PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE

Neni 15

Kuadri institucional për mbështetjen e vullnetarizmit

Organet përgjegjëse për nxitjen, mbështetjen dhe mbikëqyrjen e vullnetarizmit, sipas këtij ligji, janë:

- ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit;
- institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë;
- ministritë dhe institucionet e tjera publike.



Neni 16

Ministria përgjegjëse për nxitjen dhe mbështetjen e vullnetarizmit

1. Ministria në lidhje me nxitjen dhe mbështetjen e vullnetarizmit ushtron këto kompetenca:

a) harton politika, programe dhe përparësi për mbështetjen dhe zhvillimin e vullnetarizmit dhe të pozitës së vullnetarëve në shoqëri;

b) planifikon buxhetin për financimin e programeve për nxitjen dhe mbështetjen e vullnetarizmit;

c) ndan çmimet kombëtare për vullnetarët e vitit;

ç) harton dhe publikon studime dhe raporte për vullnetarizmin në vend;

d) monitoron zbatimin e këtij ligji.

2. Ministria, në ushtrimin e kompetencave të veta, bashkëpunon me ministritë përgjegjëse për çështjet e arsimit, rinisë, sportit, mjedisit, kulturës, shëndetësisë, mirëqenies sociale, mbrojtjes civile, Këshillin Kombëtar për Shoqërinë Civile, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe organizatat e shoqërisë civile.

Neni 17

Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë

Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë ushtron këto kompetenca:

a) mirëmban dhe administron regjistrin elektronik për vullnetarizmin;

b) ofron shërbimet për ofruesit e vullnetarizmit dhe për vullnetarët sipas parashikimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

c) financon e monitoron zbatimin e programeve për nxitjen dhe mbështetjen e vullnetarizmit, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore të tij;

ç) përpunon dhe analizon informacion për vullnetarizmin bazuar në të dhënat e regjistrit elektronik për vullnetarizmin, nga raportimet periodike të ofruesve të vullnetarizmit dhe nëpërmjet studimeve specifike apo anketimeve.

Neni 18

Ministritë dhe institucionet e tjera publike

1. Ministritë e linjës dhe institucionet e tjera publike të përcaktuara në këtë nen janë përgjegjëse për marrjen e masave për nxitjen dhe mbështetjen e

vullnetarizmit, sipas fushës përkatëse të veprimtarisë.

2. Ministri/ministria përgjegjëse për arsimin, ndër të tjera, merr masa për:

a) rritjen e ndërgjegjësimit për këtë ligj brenda sistemit të institucioneve të arsimit parauniversitar;

b) përfshirjen në programet mësimore të koncepteve dhe vlerave për vullnetarizmin, krijimin e kushteve që nxënësit të kryejnë vullnetarizëm për qëllime edukative dhe të fitojnë kualifikime të përshtatshme për nivelin e zhvillimit dhe aftësive të tyre mbi vullnetarizmin, solidaritetin shoqëror dhe qytetarinë aktive.

3. Ministri/ministria përgjegjëse për rininë, ndër të tjera, merr masa për:

a) rritjen e ndërgjegjësimit për këtë ligj brenda strukturave dhe komunitetit rinor në vend;

b) përfshirjen e koncepteve, vlerave dhe kualifikimeve për vullnetarizmin, solidaritetin shoqëror dhe qytetarinë aktive në programet e edukimit joformal për të rinjtë, të mbështetura përmes fondit shtetëror për të rinjtë;

c) financimin në mënyrë të përshtatshme të veprimtarive vullnetare me të rinjtë përmes fondit shtetëror për të rinjtë.

4. Ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, ndër të tjera, merr masa për rritjen e ndërgjegjësimit për këtë ligj brenda sistemit të institucioneve që ofrojnë arsim dhe formim profesional.

5. Ministria përgjegjëse për çështjet e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, ndër të tjera, merr masa për rritjen e ndërgjegjësimit për këtë ligj brenda sistemit të kujdesit shëndetësor, kujdesit dhe përfshirjes sociale, si dhe në institucionet që ofrojnë shërbime të kujdesit shëndetësor dhe shoqëror.

6. Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, ndër të tjera, merr masa për:

a) rritjen e ndërgjegjësimit për këtë ligj brenda rrjetit të shoqërisë civile;

b) financimin në mënyrë të përshtatshme të veprimtarive vullnetare nëpërmjet fondeve shtetërore për shoqërinë civile.

7. INSTAT-i është institucioni përgjegjës për prodhimin e statistikave zyrtare të vullnetarizmit, në përputhje me legjislacionin për statistikën zyrtare. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë merr masa për furnizimin e INSTAT-it me të dhënat që disponon, në përputhje me legjislacionin në fuqi për statistikën zyrtare.



8. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, ndër të tjera, marrin masa për:

a) rritjen e ndërgjegjësimit për këtë ligj brenda strukturave dhe komunitetit vendor;

b) financimin dhe mbështetjen në mënyrë të përshtatshme të veprimtarive vullnetare brenda njësive të tyre vendore.

KREU IV RREGULLAT PËR KRYERJEN E VULLNETARIZMIT

Neni 19 Vullnetarizmi nga i mituri

1. Një i mitur i moshës deri në 15 vjeç kryen vullnetarizëm me natyrë sociale edukative, që ka qëllim kryesor edukimin, zhvillimin e personalitetit dhe socializimin e të miturit.

2. Një i mitur i moshës mbi 15 vjeç kryen punë ose shërbime vullnetare, që janë të përshtatshme për moshën, nivelin e zhvillimit dhe aftësitë e tij fizike, mendore, shoqërore dhe morale, si dhe nuk paraqesin rrezik për sigurinë, shëndetin, mirëqenien dhe zhvillimin tërësor e nuk cenojnë edukimin e të miturit.

3. Kushtet, kriteret dhe rregullat e parashikuara për punësimin dhe mbrojtjen e punëmarrësit të mitur në legjislacionin në fuqi për marrëdhëniet e punës do të zbatohen edhe në kryerjen e vullnetarizmit nga të miturit dhe mbrojtjen e vullnetarit të mitur.

4. Vullnetari i mitur kryen vullnetarizëm dhe lidh kontratë vullnetarizmi vetëm me pëlqimin me shkrim të prindit ose të kujdestarit ligjor.

5. Vullnetari i mitur e ndërpret vullnetarizmin në çdo kohë pa nevojën e pëlqimit me shkrim, por duke vënë në dijeni prindin ose kujdestarin ligjor.

6. Vullnetari i mitur kryen vullnetarizëm jashtë Republikës së Shqipërisë vetëm me pëlqimin e prindit ose të kujdestarit ligjor dhe i shoqëruar nga prindi, kujdestari ligjor ose personi i caktuar nga ofruesi i vullnetarizmit.

7. Vullnetari i mitur, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk përfshihet në vullnetarizëm afatgjatë.

8. Ofruesi i vullnetarizmit, për vullnetarizmin e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, është:

- a) një institucion arsimor;
- b) një institucion publik;

c) një organizatë jofitimprurëse, që organizon vullnetarizëm për qëllime edukimi, me miratimin ose në bashkëpunim me institucionin shtetëror përgjegjës apo institucionin arsimor.

Neni 20 Vullnetarizmi nga personat që u përkasin grupeve të veçanta

1. Ofruesi i vullnetarizmit duhet t'i kushtojë vëmendje krijimit të kushteve për angazhimin si vullnetarë të personave që u përkasin grupeve të veçanta, me qëllim zhvillimin e personalitetit, fuqizimin dhe riintegrimin e tyre në shoqëri.

2. Ofruesi i vullnetarizmit siguron mbështetje, aksesueshmëri, trajtim të barabartë dhe mbikëqyrje të përshtatshme gjatë vullnetarizmit për vullnetarët që u përkasin grupeve të veçanta.

3. Vullnetari, i cili është me aftësi të kufizuara të shëndetit mendor/intelektual, kryen vullnetarizëm bazuar në parimin e autonomisë, pavarësisë dhe vendimmarrjes së mbështetur, duke gëzuar të drejtën e ndërprerjes së vullnetarizmit në çdo kohë.

Neni 21 Vullnetarizmi me përfitues personat që u përkasin grupeve të veçanta

1. Ofruesi i vullnetarizmit duhet t'i kushtojë vëmendje përzgjedhjes, trajnimit dhe mbikëqyrjes së vullnetarëve që angazhohen në një program vullnetarizmi me përfitues personat që u përkasin grupeve të veçanta.

2. Ndalohej angazhimi si vullnetarë në një program vullnetarizmi me përfitues personat që u përkasin grupeve të veçanta si më poshtë:

a) persona me aftësi të kufizuara të shëndetit mendor ose çrregullime të shëndetit mendor, të cilët janë subjekt i trajtimit dhe/ose shtrimit të pavullnetshëm, personat që kanë detyrimin për ndjekjen e programeve të rehabilitimit psikosocial të varësisë, personat që kanë detyrimin për pjesëmarrje në programet e aftësimin prindëror ose ndaj të cilit është vendosur një nga masat e mbrojtjes ndaj dhunës në familje, sipas legjislacionit në fuqi;

b) personat ndaj të cilëve zbatohet një masë e ndalimit të përkohshëm të ushtrimit të veprimtarive të caktuara profesionale, kur këto lidhen me vullnetarizmin, në përputhje me legjislacionin penal në fuqi;



c) personat që janë në procedim penal ose janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për një vepër penale kundër jetës, shëndetit, krimeve seksuale, lirisë së personit, kundër moralit dhe dinjitetit ose kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, në përputhje me legjislacionin penal në fuqi;

ç) personat, të cilët janë gjetur në shkelje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit me vendim gjykate të formës së prerë apo vendim të organit publik kompetent, që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi.

3. Në rastin e kryerjes së vullnetarizmit, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 26 të ligjit, ofruesi i vullnetarizmit siguron mbikëqyrjen e vazhdueshme profesionale të vullnetarit, si dhe që vullnetari nuk vendoset në kontakt të pambikëqyrrur me përfituesin e vullnetarizmit përgjatë kohëzgjatjes së vullnetarizmit.

4. Në rastin e kryerjes së vullnetarizmit, sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit 26 të ligjit, ofruesi i vullnetarizmit siguron mbikëqyrjen e vazhdueshme profesionale të vullnetarit, si dhe që vullnetari nuk vendoset në kontakt të pambikëqyrrur me përfituesin e vullnetarizmit derisa të sigurojë dokumentacionin që vërteton se nuk ndodhemi në rastet e ndalimit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni.

Neni 22

Vullnetarizmi nga shtetasi i huaj

1. Vullnetari, i cili nuk është shtetas shqiptar, kryen vullnetarizëm në territorin e Republikës së Shqipërisë në përputhje me këtë ligj, legjislacionin kombëtar në fuqi dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

2. Qëndrimi i vullnetarit të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë rregullohet sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për të huajt.

3. Vullnetari i huaj në moshë të mitur gëzon në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat e parashikuara në këtë ligj për vullnetarët e mitur.

Neni 23

Shtetasi shqiptar që kryen vullnetarizëm jashtë vendit

Shtetasi shqiptar kryen vullnetarizëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në përputhje me aktet ndërkombëtare dhe rregullat e përcaktuara në legjislacionin e vendit ku kryhet vullnetarizmi.

Neni 24

Rregullat për organizimin e vullnetarizmit nga personi juridik fitimprurës

1. Ofruesi i vullnetarizmit, sipas përcaktimit të pikës 4 të nenit 7 të këtij ligji, organizon vullnetarizëm me plotësimin e kushteve si vijon:

a) vullnetarizmi organizohet në të mirë dhe në interes të publikut ose personave të tjerë nëpërmjet veprimtarive, që janë të ndryshme nga fusha e aktivitetit të tij;

b) nuk krijohet fitim nga vullnetarizmi;

c) vullnetarizmi nuk zëvendëson punën ose shërbimet që kryhen në mënyrë të zakonshme nga punëmarrësit ose që kontraktohen rregullisht si shërbime të jashtme prej tij.

2. Ofruesi i vullnetarizmit, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij neni, duhet të marrë miratimin nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë përpara zbatimit të një programi vullnetarizmi.

3. Kërkesa drejtuar institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë dhe dokumentacioni shoqërues depozitohen *online* nëpërmjet platformës qeveritare “e-Albania”.

4. Rregullat, dokumentacioni, afatet dhe procedurat e detajuara për plotësimin, dorëzimin dhe shqyrtimin e kërkesës, sipas përcaktimeve të këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit.

KREU V

KONTRATA E VULLNETARIZMIT

Neni 25

Kontrata e vullnetarizmit

1. Kontrata e vullnetarizmit përcakton të drejtat e detyrimet e vullnetarit dhe ofruesit të vullnetarizmit, si dhe kushtet e kriteret e nevojshme për kryerjen e punëve apo të shërbimeve vullnetare.

2. Kontrata e vullnetarizmit lidhet në formë të shkruar ndërmjet vullnetarit dhe ofruesit të vullnetarizmit, në rastet kur:

a) vullnetarizmi është afatgjatë;

b) vullnetari është i mitur, sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 19 të ligjit;

c) vullnetari është person i huaj ose person pa shtetësi;

ç) vullnetari është person me aftësi të kufizuara të shëndetit mendor;



d) vullnetari është shtetas shqiptar, që kryen vullnetarizëm jashtë vendit dhe ofruesi i vullnetarizmit e ka selinë në Republikën e Shqipërisë;

dh) përfituesi i vullnetarizmit u përket grupeve të veçanta, sipas përcaktimit të pikës 1 të nenit 4 të ligjit;

e) kërkohet shprehimisht nga ofruesi i vullnetarizmit ose vullnetari.

Neni 26

Përmbajtja e kontratës

1. Kontrata e vullnetarizmit përmban:

a) identitetin, vendbanimin ose vendqëndrimin e vullnetarit apo të prindit/përfaqësuesit ligjor të vullnetarit të mitur;

b) numrin personal të identifikimit të vullnetarit ose të prindit/përfaqësuesit ligjor të vullnetarit të mitur;

c) identitetin dhe adresën e ofruesit të vullnetarizmit;

ç) numrin personal të identifikimit të ofruesit të vullnetarizmit;

d) identitetin dhe adresën e përfituesit të vullnetarizmit;

dh) datën e fillimit, kohëzgjatjen javore dhe vendin e kryerjes së vullnetarizmit;

e) përshkrimin e vullnetarizmit që do të kryhet;

ë) të drejtat dhe detyrimet e palëve;

f) shkaqet dhe mënyrën e zgjidhjes së kontratës;

g) të dhënat për shpenzimet e nevojshme për kryerjen e vullnetarizmit dhe mënyrën e mbulimit apo kompensimit të tyre.

2. Në rastin e vullnetarizmit afatshkurtër, kur përfituesi i vullnetarizmit u përket grupeve të veçanta, kontratës së vullnetarizmit i bashkëngjitet edhe deklarimi me shkrim i vullnetarit, që nuk ndodhet në rastet e ndalimit, të përcaktuara në pikën 2 të nenit 21 të ligjit.

3. Në rastin e vullnetarizmit afatgjatë, kur përfituesi i vullnetarizmit u përket grupeve të veçanta, kontratës së vullnetarizmit i bashkëngjiten dëshmitë dhe vërtetimet përkatëse nga organet publike kompetente, që vërtetojnë se vullnetari nuk ndodhet në rastet e ndalimit, të përcaktuara në pikën 2 të nenit 21 të ligjit. Vullnetari mbledh dokumentacionin provues për llogari të ofruesit të vullnetarizmit.

4. Përgjashtimisht, për personat e huaj dhe personat pa shtetësi, që nuk janë të pajisur me numër personal identifikimi, nuk zbatohen shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij neni. Në këto raste, në përmbajtjen e kontratës pasqyrohen të dhënat e përcaktuara në dokumentin e lëshuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për të huajt.

5. Kontrata e vullnetarizmit përmban edhe elemente të tjera për të cilat palët bien dakord.

Neni 27

Efektet e kontratës

Me lidhjen e kontratës së vullnetarizmit, të drejtat që kanë lindur nga papunësia dhe nga skemat e sigurimeve shoqërore nuk humbasin.

Neni 28

Përfundimi i kontratës

Kontrata e vullnetarizmit përfundon në rastet kur:

a) mbaron periudha për të cilën është lidhur kontrata;

b) vërtetohet fakti i pamundësisë së vullnetarit për të kryer vullnetarizëm për shkak të arsyeve objektive, si:

i. gjendja shëndetësore, e provuar me dokumentacion përkatës;

ii. rrethana familjare ose personale, që pengojnë realizimin e veprimtarisë vullnetare.

c) vërtetohen ndalimet e përcaktuara në pikën 2 të nenit 21 të ligjit;

ç) palët bien dakord për përfundimin e saj;

d) kontrata zgjidhet në mënyrë të njëanshme;

dh) ndërpritet vullnetarizmi sipas parashikimeve të neneve 19, pika 5, dhe 20, pika 3, të ligjit.

Neni 29

Zgjidhja në mënyrë të njëanshme e kontratës

1. Vullnetari ose ofruesi i vullnetarizmit zgjidhin në çdo kohë, në mënyrë të njëanshme, kontratën e vullnetarizmit për shkaqe të justifikuara.

2. Ofruesi i vullnetarizmit zgjidh kontratën para afatit të mbarimit të saj kur:

a) nuk ka më nevojë për vullnetarizëm;

b) nuk është në gjendje të sigurojë kushtet e nevojshme për kryerjen e vullnetarizmit;



c) vërteton që vullnetari nuk përmbush detyrimet e kontratës.

3. Vullnetari zgjidh kontratën para mbarimit të afatit të saj kur:

a) nuk është më i aftë për të kryer vullnetarizmin, objekt kontrate;

b) nuk ka më vullnet për të kryer vullnetarizmin, objekt kontrate;

c) ofruesi i vullnetarizmit nuk përmbush detyrimet e kontratës.

4. Zgjidhja e njëanshme e kontratës në çdo rast bëhet me shkrim. Pala, e cila kërkon zgjidhjen e kontratës, ia dërgon njoftimin palës tjetër të paktën 5 (pesë) ditë përpara datës së kërkuar për zgjidhjen e kontratës.

Neni 30

Kryerja e vullnetarizmit pa lidhjen e kontratës

1. Vullnetarizmi afatshkurtër, kur kryhet pa lidhjen e kontratës së vullnetarizmit, do të bazohet në rregulloren e brendshme të ofruesit të vullnetarizmit, që përcakton mënyrën e angazhimit dhe të trajtimit të vullnetarëve, dhe në programin e vullnetarizmit. Në këtë rast, vullnetari nënshkruan një deklaratë, ku shpreh vullnetin për të kryer vullnetarizëm, në përputhje me kushtet dhe rregullat e përcaktuara nga ofruesi i vullnetarizmit, me rregulloren e brendshme të tij dhe me programin e vullnetarizmit. Deklarata përmban një detyrim të posaçëm për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave personale, me të cilat vullnetari bie në kontakt gjatë vullnetarizmit.

2. Deklarata e nënshkruar shërben për të provuar ekzistencën e marrëdhënies së vullnetarizmit, në rastin e vullnetarizmit që kryhet pa lidhjen e kontratës.

3. Ofruesi i vullnetarizmit dhe vullnetari, në kryerjen e vullnetarizmit sipas këtij neni, duhet të respektojnë parashikimet e ligjit që janë të zbatueshme për vullnetarizmin afatshkurtër dhe në çdo rast nuk duhet të shkelin parimet bazë të këtij ligji.

KREU VI

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E VULLNETARËVE DHE TË OFRUESIT TË VULLNETARIZMIT

Neni 31

Të drejtat e vullnetarit

1. Vullnetari ka të drejtë:

a) të njihet me përshkrimin e vullnetarizmit që do të kryejë;

b) të informohet për kushtet e punës dhe rreziqet që lidhen me punën që do të kryejë;

c) të kërkojë marrjen e masave të sigurisë teknike gjatë kryerjes së punës;

ç) të informohet nga ofruesi i vullnetarizmit për rregullat e përgjithshme të punës dhe rregullat e etikës së vullnetarit;

d) të trajnohet, nëse është e nevojshme, në përputhje me natyrën e punës që do të kryejë;

dh) të përfitojë pushime ditore në kohëzgjatjen e vullnetarizmit në rast se ka shkaqe të arsyeshme dhe të provueshme, si sëmundje etj.;

e) të përfitojë pushime midis orëve të kryerjes së vullnetarizmit, në varësi të llojit të vullnetarizmit që kryen;

ë) të kërkojë mbrojtjen e të dhënave personale;

f) çdo të drejtë tjetër të përcaktuar në këtë ligj ose në kontratën e vullnetarizmit.

2. Koha e mungesës së justifikuar, e përcaktuar në shkronjën “dh” të pikës 1 të këtij neni, llogaritet në kohëzgjatjen e kontratës së vullnetarizmit dhe nuk përbën arsye për humbjen e të drejtave të vullnetarit të përcaktuara në këtë kontratë.

3. Vullnetari ka të drejtë të mos zbatojë udhëzimet e ofruesit të vullnetarizmit nëse:

a) udhëzimet përbëjnë rrezik real për jetën, shëndetin e integritetin fizik, si dhe i cenojnë moralin përfituesit të vullnetarizmit ose një personi të tretë;

b) udhëzimet janë në shkelje të legjislacionit në fuqi ose të përcaktimeve të kontratës së vullnetarizmit.

Neni 32

Detyrimet e vullnetarit

Vullnetari ka këto detyrime:

a) të kryejë vullnetarizmin në përputhje me kontratën e vullnetarizmit;



b) të ofrojë shërbimin personalisht dhe drejtpërdrejt në përputhje me standardet dhe etikën profesionale, kur ofrimi i shërbimeve kërkon aftësitë profesionale;

c) të marrë pjesë në trajnime për të përmirësuar cilësinë e punës;

ç) të respektojë integritetin, misionin dhe objektivat e ofruesit të vullnetarizmit;

d) të ruajë konfidencialitetin e të dhënave me të cilin njihet për shkak të natyrës së punës që kryen;

dh) të informojë me shkrim ofruesin e vullnetarizmit për çdo rrezik ose dëm real që mund t'i vijë atij vetë, ofruesit apo palëve të treta, të cilin e konstaton gjatë kryerjes së vullnetarizmit;

e) të informojë paraprakisht ofruesin e vullnetarizmit në rast sëmundjeje ose gjendjeje tjetër, që e pengon atë në kryerjen e vullnetarizmit.

Neni 33

Të drejtat e ofruesit të vullnetarizmit

Ofruesi i vullnetarizmit ka të drejtë:

a) të kërkojë kryerjen e vullnetarizmit në përputhje me kontratën e vullnetarizmit dhe rregulloren e brendshme;

b) të kërkojë ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave me të cilat vullnetari njihet gjatë ushtrimit të vullnetarizmit;

c) të informohet në kohë nga vullnetari për çdo rrezik apo dëm real që mund t'i shkaktohet vetë vullnetarit, ofruesit të vullnetarizmit apo palëve të treta, të cilin vullnetari e konstaton gjatë kryerjes së vullnetarizmit;

ç) çdo të drejtë tjetër të përcaktuar në këtë ligj ose në kontratën e vullnetarizmit.

Neni 34

Detyrimet e ofruesit të vullnetarizmit

Ofruesi i vullnetarizmit ka këto detyrime:

a) të ofrojë vullnetarizmin në bazë të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj, në kontratën e vullnetarizmit dhe rregulloren e brendshme;

b) të sigurojë kushtet dhe mjetet e nevojshme për kryerjen e vullnetarizmit;

c) të lëshojë certifikatën për vullnetarizmin e kryer nga vullnetari, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

ç) të ruajë konfidencialitetin e të dhënave personale të vullnetarit dhe përfituesit të vullnetarizmit;

d) t'i sigurojë vullnetarit kompensimin e shpenzimeve të nevojshme për kryerjen e vullnetarizmit, sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 14 të këtij ligji dhe përcaktimeve të kontratës së vullnetarizmit, në rastin kur nuk plotëson detyrimet e përcaktuara në shkronjën “b” të këtij neni;

dh) të mbajë e të plotësojë regjistrin e vullnetarëve dhe të bëjë deklaratimet për vullnetarizmin, sipas përcaktimeve të ligjit;

e) çdo përgjegjësi tjetër të përcaktuar në këtë ligj ose në kontratën e vullnetarizmit.

Neni 35

Sigurimi i shëndetit për vullnetarin

1. Ofruesi i vullnetarizmit detyrohet të sigurojë vullnetarin në rast të aksidenteve apo të sëmundjeve profesionale përgjatë gjithë periudhës së vullnetarizmit, kur:

a) vullnetarizmi është afatgjatë;

b) përcaktohet në kontratën e lidhur për vullnetarizmin, në rastin e vullnetarizmit afatshkurtër.

2. Vullnetari përjashtohet nga detyrimi për pagesën e kontributeve të detyrueshme për sigurimet shoqërore, përveç pagesës së kontributit për sigurimin ndaj aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale, sipas përcaktimeve të këtij neni.

3. Kontributi për sigurimin e vullnetarit ndaj aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale llogaritet mbi pagën minimale të miratuar në shkallë vendi, në masën e përcaktuar për këtë lloj kontributi në legjislacionin në fuqi për sigurimet shoqërore.

4. Deklarimi dhe pagesa e këtij kontributi bëhet nga ofruesi i vullnetarizmit, sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore.

5. Ofruesi i vullnetarizmit ka të drejtë të kompensohet për pagesën e kryer për sigurimin e detyrueshëm ndaj aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale për vullnetarin, në përputhje me rregullat, procedurat dhe afatet e miratuara me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për çështjet e punësimit dhe të ministrit përgjegjës për financat.



6. Ofruesi i vullnetarizmit dhe vullnetari, kur bien dakord, zgjerojnë gamën e sigurimit për vullnetarët nëpërmjet lidhjes nga ofruesi i vullnetarizmit të një kontrate sigurimi me shoqërinë e sigurimit.

Neni 36

Shpërblimi për dëmet

1. Vullnetari përgjigjet ndaj ofruesit të vullnetarizmit nëse shkakton dëm me dashje gjatë kryerjes së vullnetarizmit.

2. Vullnetari përgjigjet ndaj një pale të tretë ose përfituesit të vullnetarizmit nëse shkakton dëm me dashje gjatë kryerjes së vullnetarizmit, përveç rasteve kur vullnetari ka vepruar në mirëbesim, sipas udhëzimeve të ofruesit të vullnetarizmit.

3. Vullnetari shkarkohet nga përgjegjësia për dëmin e shkaktuar gjatë kryerjes së vullnetarizmit në rast se ka informuar ofruesin e vullnetarizmit sipas përcaktimeve të shkronjës “dh” të nenit 32 të këtij ligji.

4. Ofruesi i vullnetarizmit përgjigjet për dëmet e shkaktuara ndaj vullnetarit, gjatë ose në lidhje me kryerjen e vullnetarizmit, kur detyrimet kanë ardhur si rezultat i mospërmbushjes së detyrimeve të tij.

5. Kërkimi i dëmit, në çdo rast, bëhet në bazë të legjislacionit në fuqi për kërkimin e dëmit.

Neni 37

Kodi i Etikës së Vullnetarit

1. Kodi i Etikës së Vullnetarit përcakton rregullat e pranueshme të sjelljes për ofruesin e vullnetarizmit, vullnetarin dhe përfituesin e vullnetarizmit, në përputhje me parimet bazë të vullnetarizmit, të përcaktuara në këtë ligj.

2. Kodi i Etikës së Vullnetarit miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet e punësimit.

Neni 38

Certifikata e vullnetarizmit

1. Ofruesi i vullnetarizmit përgatit dhe pajis vullnetarin me certifikatën e vullnetarizmit në përfundim të programit të vullnetarizmit.

2. Në rastin e vullnetarizmit afatshkurtër, certifikata e vullnetarizmit lëshohet vetëm me kërkesë të vullnetarit.

3. Certifikata e vullnetarizmit përmban të dhënat personale të vullnetarit, periudhën e vullnetarizmit, një përshkrim të shkurtër të punës apo të shërbimeve vullnetare, fushën e vullnetarizmit dhe trajnimet.

4. Certifikata e vullnetarizmit përmban nënshkrimin e personit përgjegjës dhe vulën e ofruesit të vullnetarizmit, e cila garanton vërtetësinë e të dhënave të pasqyruara.

5. Ofruesi i vullnetarizmit, me kërkesë të vullnetarit, në rastin e vullnetarizmit afatgjatë, ose në marrëveshje me vullnetarin, në rastin e vullnetarizmit afatshkurtër, i bashkëngjit certifikatës së vullnetarizmit edhe dëshminë mbi aftësitë dhe kompetencat e fituara nga vullnetari gjatë vullnetarizmit.

6. Format standard i certifikatës së vullnetarizmit miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet e punësimit.

KREU VII

NXITJA DHE MBËSHTETJA E VULLNETARIZMIT

Neni 39

Programet e nxitjes dhe të mbështetjes së vullnetarizmit

1. Nxitja dhe mbështetja e veprimtarive vullnetare dhe pjesëmarrjes së individëve në vullnetarizëm realizohet përmes programeve si më poshtë:

- a) çmimet kombëtare për vullnetarët e vitit;
- b) financimi i programeve të vullnetarizmit;
- c) platforma elektronike e vullnetarizmit.

2. Fondet e buxhetit të shtetit për financimin e programeve të nxitjes dhe të mbështetjes së vullnetarizmit përcaktohen çdo vit në buxhetin vjetor të shtetit për ministrinë përgjegjëse për çështjet e punësimit.

Neni 40

Çmimet kombëtare për vullnetarët e vitit

1. Çmimet kombëtare për vullnetarët e vitit janë vlerësimi më i lartë që bëhet çdo vit për kontributet e dhëna për veprimtarinë vullnetare dhe promovimin e vullnetarizmit në Republikën e Shqipërisë.



2. Procedurat dhe kriteret për ndarjen e çmimeve, kategoritë e çmimeve dhe masa e shpërblimit financiar miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për çështjet e punësimit.

Neni 41

Financimi i programeve të vullnetarizmit

1. Ofruesit e vullnetarizmit, të përcaktuar në pikën 2 të nenit 7 të këtij ligji, mund të mbështeten në kryerjen e veprimtarive vullnetare nëpërmjet subvencionimit shtetëror, në përqindje të caktuar, të shpenzimeve për kryerjen e programit të vullnetarizmit, ku përfshihen:

- a) shpenzimet për trajtimin e vullnetarëve, sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 14 të këtij ligji;
- b) shpenzimet për mbikëqyrjen e vullnetarëve;
- c) shpenzimet për menaxhimin e programit të vullnetarizmit.

2. Procedurat, kriteret dhe rregullat për përzgjedhjen, financimin dhe monitorimin e ofruesve të vullnetarizmit të mbështetur sipas përcaktimeve të këtij neni miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet e punësimit.

3. Fushat e përparësisë për mbështetjen e programeve të vullnetarizmit, bazuar në vlerësimin e objektivave të politikave publike dhe të të dhënave të grumbulluara mbi vullnetarizmin në vend miratohen çdo vit me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet e punësimit.

Neni 42

Platforma elektronike e vullnetarizmit

1. Platforma elektronike e vullnetarizmit ngrihet si një hapësirë e dedikuar interaktive në portalin zyrtar të punësimit dhe të aftësive, me qëllim promovimin e vullnetarizmit dhe të mundësive për vullnetarizëm, duke realizuar, ndër të tjera, ndërlidhjen mes ofrueseve të vullnetarizmit dhe vullnetarëve.

2. Platforma elektronike e vullnetarizmit administrohet e mirëmbahet nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë.

KREU VIII

REGJISTRIMI DHE MONITORIMI I VULLNETARIZMIT

Neni 43

Regjistri Elektronik për Vullnetarizmin dhe Regjistri i Vullnetarizmit

1. Regjistri Elektronik për Vullnetarizmin krijohet dhe integrohet në bazën e të dhënave të sistemit të shërbimeve të punësimit, me qëllim grumbullimin e informacionit të përditësuar për vullnetarizmin në vend dhe për ofrimin e shërbimeve publike për vullnetarët, ofruesit e vullnetarizmit dhe subjektet e tjera, sipas këtij ligji dhe legjislacionit të posaçëm.

2. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë grumbullon e administron të dhënat për vullnetarizmin në përputhje me legjislacionin në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Regjistri i vullnetarizmit mbahet e plotësohet nga ofruesi i vullnetarizmit dhe përmban të dhënat për vullnetarizmin afatgjatë dhe vullnetarizmin afatshkurtër. Regjistri plotësohet nga dita e fillimit deri në ditën e përfundimit të programit të vullnetarizmit.

4. Ofruesi i vullnetarizmit raporton vullnetarizmin e kryer përmes ngarkimit në bazën e të dhënave të shërbimeve të punësimit, si dhe të dhënave të regjistrit të vullnetarizmit, përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.

5. Përmbajtja dhe rregullat e plotësimit të Regjistrit të Vullnetarizmit, si dhe rregullat, afatet e procedurat e raportimit në bazën e të dhënave të shërbimeve të punësimit nga ofruesit e vullnetarizmit miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet e punësimit.

Neni 44

Libreza e vullnetarit

1. Libreza e vullnetarit është dokumenti me vullë elektronike, që lëshohet nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë për vullnetarin dhe përmban të dhënat për vullnetarizmin e kryer.

2. Libreza e vullnetarit lëshohet me numër unik, të papërsëritshëm për çdo vullnetar me shtetësi



shqiptare, vullnetar të huaj ose person pa shtetësi, që kryen vullnetarizëm në Republikën e Shqipërisë.

3. Libreza e vullnetarit plotësohet për vullnetarin:

- a) që merr pjesë në vullnetarizëm afatgjatë;
- b) që merr pjesë në vullnetarizëm afatshkurtër, me kohëzgjatje të paktën 20 orë në javë dhe zbatim të rregullt për të paktën një muaj, dhe përcaktohet në kontratën e vullnetarizmit.

4. Libreza e vullnetarit lëshohet nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë pas raportimit të parë të ofruesit të vullnetarizmit dhe përditësohet në bazë të të dhënave që raportohen në mënyrë periodike në Regjistrin Elektronik për Vullnetarizmin.

5. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, me kërkesë të vullnetarit e pas vlerësimit të dokumentacionit provues, bën plotësimin në Regjistrin Elektronik për Vullnetarizmin me të dhënat për vullnetarizmin e kryer jashtë Shqipërisë, për efekt të përditësimit të librezës së vullnetarit.

6. Libreza e vullnetarit shërben për vërtetimin e përvojës vullnetare, ku koha e shpenzuar në vullnetarizëm përlllogaritet dhe njihet si përvojë pune vetëm për efekt të procedurave të rekrutimit të punëmarrësve nga çdo punëdhënës në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me kriteret e përcaktuara për pozicionin e punës.

7. Forma dhe përmbajtja e librezës së vullnetarit miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet e punësimit.

Neni 45

Informacioni për vullnetarizmin

1. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë përpunon e analizon informacion për vullnetarizmin bazuar në të dhënat periodike të raportuara nga ofruesit e vullnetarizmit në Regjistrin Elektronik për Vullnetarizmin, nëpërmjet kryerjes së hulumtimeve periodike dhe studimeve specifike për matjen e kontributit vullnetar në zhvillimin e mirëqenien e shoqërisë dhe duke u mbështetur në statistikat zyrtare të prodhuara për vullnetarizmin.

2. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë i siguron INSTAT-it të dhënat administrative dhe të dhënat e tjera të mbledhura për vullnetarizmin, bazuar në memorandumun e mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet institucioneve.

Neni 46

Inspektimi

1. Inspektorati që mbulon çështjet e punës siguron kontrollin për zbatimin e detyrimeve të parashikuara në këtë ligj, aktet nënligjore të tij dhe kontratat e vullnetarizmit.

2. Nëse gjatë një procedure inspektimi konstatohen shkelje të kërkesave ligjore, do të zbatohen sanksionet e parashikuara në ligjin për inspektimin e punës.

3. Nëse ofruesi i vullnetarizmit nuk merr masa për zbatimin në mënyrë të plotë të kërkesave ligjore brenda afatit të përcaktuar në aktin e inspektimit, ndaj tij aplikohen gjobat sipas rasteve të parashikuara në nenin 47 të këtij ligji.

4. Të ardhurat e grumbulluara nga gjobat derdhen 100% në buxhetin e shtetit.

5. Inspektorati i punës, kur konstaton shkelje të dispozitave të këtij ligji për shfrytëzimin e vullnetarëve për çështje fitimi, njofton administratën tatimore për të kryer kontrollin e për të vlerësuar masën e përfutimit të paligjshëm, sipas procedurave dhe afateve të parashikuara në legjislacionin për inspektimin.

Neni 47

Kundërvajtjet administrative

1. Shkelja nga ofruesit e vullnetarizmit e dispozitave të parashikuara në nenet 21, pikat 3 dhe 4; 24, pika 2; 25, pika 2; 26, pikat 2 dhe 3; 30, pika 1; 35, pika 1, dhe 43, pika 4, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë deri 20 000 (njëzet mijë) lekë.

2. Shkelja nga ofruesi i vullnetarizmit e dispozitave të parashikuara në nenet 12 dhe 19 të këtij ligji, kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 30 000 (tridhjetë mijë) - 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe, sipas rastit, me konfiskimin e fitimit.



KREU IX
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË
FUNDIT

Neni 48
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 24, pika 4; 37, pika 2; 40, pika 2; 41, pika 2, dhe 43, pika 5.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet e punësimit që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 38, pika 6, 41, pika 3, dhe 44, pika 7.

3. Ngarkohen ministri përgjegjës për çështjet e punësimit dhe ministri përgjegjës për financat që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojnë aktin nënligjor në zbatim të pikës 5 të nenit 35.

Neni 49
Shfuqizime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, ligji nr. 45/2016 “Për vullnetarizmin” shfuqizohet.

Neni 50
Dispozitë kalimtare

Aktet nënligjore të miratuara në zbatim të ligjit nr. 45/2016 “Për vullnetarizmin” mbeten në fuqi dhe do të zbatohen deri në miratimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 51
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 18.12.2025.

Shpallur me dekretin nr. 23, datë 15.1.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 23, datë 15.1.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të kushtetutës

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 94/2025, “Për vullnetarizmin”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

LIGJ
Nr. 96/2025

**PËR SINJALIZIMIN DHE MBROJTJEN
E SINJALIZUESVE¹**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

Ky ligj përcakton rregullat për mbrojtjen e sinjalizuesve në sektorin publik dhe privat, të cilët raportojnë shkelje të mundshme të kuadrit ligjor nëpërmjet mekanizmave të krijuar për raportimin e tyre, procedurat për shqyrtimin e sinjalizimeve, mekanizmat për mbrojtjen e sinjalizuesve, si dhe detyrimet e autoriteteve publike dhe të subjekteve private në lidhje me sinjalizimin.

¹ Ky ligj është përafëruar plotësisht me direktivën nr. 2019/1937/BE, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 13 tetor 2019, “Për mbrojtjen e personave që Faqe | 1420

raportojnë shkelje të ligjit të Unionit.” Numri CELEX 32019L1937, Fletore Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 305, datë 26.11.2019, faqe 17–56.



Neni 2 Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe goditja e çdo veprimi të kundërligjshëm në sektorin publik e privat nëpërmjet krijimit të mekanizmave të përshtatshëm ligjorë dhe institucionalë, si dhe nxitja e sinjalizimit të shkeljeve të mundshme të kuadrit ligjor, duke garantuar mbrojtjen efektive të sinjalizuesve dhe trajtimin e drejtë të sinjalizimeve.

Neni 3 Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për mbrojtjen e sinjalizuesve, që raportojnë ose disponojnë informacion për veprime të kundërligjshme, që cenojnë interesin publik, përfshirë keqpërdorimin e funksionit publik, korrupsionin e keqadministrimit të fondeve ose të burimeve publike, si dhe çdo veprim tjetër që dëmton transparencën, llogaridhënien e integritetin në administratën publike dhe përbën shkelje të dispozitave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, si dhe të normave të nxjerra nga organizata ndërkombëtare, në rastet kur, nëpërmjet një marrëveshjeje të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i këtyre normave në fushat e mëposhtme:

a) përdorimi i fondeve të buxhetit të shtetit, të Bashkimit Evropian apo të organizatave ndërkombëtare, si dhe çdo veprim ose mosveprim që cenon ose mund të cenojë interesat financiarë të Bashkimit Evropian, në kuptim të nenit 325 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian dhe si specifikohet më tej në aktet përkatëse të Bashkimit Evropian;

b) prokurimi publik;

c) shërbimet financiare, produktet e tregjet financiare, parandalimi i pastrimit të parave dhe financimi i terrorizmit;

ç) shkeljet që lidhen me rregullat e tregut të brendshëm, sipas paragrafit 2, të nenit 26 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian, përfshirë shkeljet e rregullave të konkurrencës dhe të ndihmës shtetërore, rregullat për tatimin e shoqërive tregtare ose marrëveshjeve që synojnë përfitimin e një avantazhi tatimor, i cili cenon objektin ose qëllimin e legjislacionit përkatës tatimor për shoqëritë tregtare;

d) siguria dhe përputhshmëria e produkteve;
dh) siguria e transportit;
e) mbrojtja e mjedisit;
ë) mbrojtja nga rrezatimi dhe siguria bërthamore;
f) siguria ushqimore dhe ushqimit për kafshë, shëndeti dhe mirëqenia e kafshëve;
g) shëndeti publik;
gj) mbrojtja e konsumatorit;
h) mbrojtja e të dhënave personale, privatësia e siguria e rrjeteve dhe e sistemeve të teknologjisë së informacionit.

2. Ky ligj zbatohet për çdo person që sinjalizon një shkelje të mundshme ligjore gjatë angazhimit në një kontekst pune, përfshirë:

a) punonjësit në sektorin publik dhe privat;

b) personat që ushtrojnë veprimtari si të vetëpunësuar;

c) personat që janë pjesë e organeve drejtuese, administrative ose mbikëqyrëse të një subjekti, përfshirë edhe anëtarët jodrejtues dhe praktikantët;

ç) personat që punojnë nën mbikëqyrjen dhe drejtimin e kontraktorëve, nënkontraktorëve ose furnitorëve.

Në kuptim të këtij ligji, termit “punonjës” dhe “i vetëpunësuar” interpretohen në përputhje me të drejtën e Bashkimit Evropian dhe me parimet e përgjithshme të së drejtës së Bashkimit Evropian dhe nuk kufizohen nga përkufizimet e parashikuara në legjislacionin shqiptar.

3. Ky ligj zbatohet, gjithashtu, për sinjalizuesit, marrëdhënia e punës e të cilëve nuk ka filluar ende, në rastet kur informacioni për shkeljet është siguruar gjatë procesit të rekrutimit ose në faza të tjera parakontraktuale, si dhe për sinjalizuesit, marrëdhënia e punës e të cilëve është ndërprerë, por që raportojnë përmes mekanizmit të jashtëm ose publik një shkelje të mundshme të kuadrit ligjor në fuqi.

4. Ky ligj zbatohet edhe për sinjalizuesit që raportojnë publikisht, në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë ligj, informacione për shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, si dhe për sinjalizuesit anonimë.

5. Dispozitat e këtij ligji nuk cenojnë përgjegjësinë e shtetit për garantimin e sigurisë kombëtare dhe as të drejtën për mbrojtjen e interesave të tij thelbësorë të sigurisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Ky ligj nuk zbatohet për fushat e rregulluara në mënyrë të posaçme dhe që lidhen me:



a) mbrojtjen e informacionit të klasifikuar sipas ligjit nr. 10/2023, “Për informacionin e klasifikuar”;

b) ruajtjen e sekretit profesional të avokatit sipas ligjit nr. 55/2018, “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”;

c) konfidencialitetin e informacionit mjekësor sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe për kujdesin shëndetësor;

ç) konfidencialitetin e diskutimeve dhe të vendimeve të marra në dhomë këshillimi sipas legjislacionit procedural në fuqi;

d) rregullat e procedurat që rregullojnë ndjekjen penale.

7. Në rastet kur në aktet sektoriale të Bashkimit Evropian parashikohen rregulla të veçanta për raportimin e shkeljeve, zbatohen rregullat e atyre akteve sektoriale. Dispozitat e këtij ligji zbatohen vetëm për pjesët që nuk rregullohen specifikisht nga këto akte.

8. Parashikimet e këtij ligji nuk kufizojnë të drejtën e sinjalizuesit për të paraqitur në çdo kohë kallëzim drejtpërdrejt pranë organeve kompetente për ndjekjen penale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Autoritet publik” ka të njëjtin kuptim me atë të parashikuar në ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”;

2. “Autoritet kompetent” është Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), i caktuar për të pranuar, për të shqyrtuar e për të ndjekur sinjalizimet e jashtme, si dhe për të garantuar mbrojtjen nga veprimet hakmarrëse ndaj sinjalizuesit.

3. “Informacion publik” është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdolloj forme dhe formati gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik.

4. “Informacion për shkeljet” është çdo lloj informacioni që përmban dyshime të arsyeshme dhe lidhet me shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, të kryera ose që ka gjasa të kryhen në një autoritet publik ose subjekt privat, të cilat janë përfutur në një kontekst pune, përfshirë rastet kur informacioni

është marrë nga kontraktorë, nënkontraktorë, furnitorë apo punonjësit e tyre.

5. “Kontekst pune” është çdo marrëdhënie profesionale, aktuale, e mëparshme ose e mundshme, përmes së cilës një person, pavarësisht nga natyra e saj juridike, ka akses në informacione për shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, përfshirë marrëdhëniet e punësimit ose të vetëpunësimit, ofrimin e shërbimeve, kontratat e furnizimit, nënkontraktimin, si dhe aktivitetet vullnetare apo praktikatat profesionale.

6. “Ndihmës” është çdo person që ndihmon një sinjalizues gjatë procesit të sinjalizimit në një kontekst pune dhe ndihma e tij është konfidenciale.

7. “Ndjekje” nënkupton çdo veprim të marrë nga njësi përgjegjëse ose ILDKPKI-ja për të vlerësuar saktësinë e pretendimeve të parashtruara nga sinjalizuesi dhe për të trajtuar shkeljen e sinjalizuar.

8. “Njësi përgjegjëse” është organi i posaçëm, i caktuar brenda autoritetit publik ose subjektit privat, i përbërë nga një ose më shumë punonjës dhe i ngarkuar me detyrën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit, shqyrtimin e kërkesës për mbrojtjen e sinjalizuesit dhe ndjekjen e saj sipas përcaktimeve të këtij ligji.

9. “Masa të përkohshme” janë masa të marra nga ILDKPKI-ja ose të vendosura nga gjykata, me qëllim garantimin e mbrojtjes së sinjalizuesit deri në përfundim të procesit administrativ apo gjyqësor përkatës.

10. “Personat e lidhur me sinjalizuesin” janë bashkëshorti, bashkëjetuesi ose të afërmit, si dhe kolegët e të afërmit, që punojnë për të njëjtin punëdhënës ose që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin kontekst pune.

11. “Person i përfshirë” është çdo person fizik ose juridik, që përmendet në sinjalizim ose publikim si personi të cilit i atribuohet shkelja, ose që ka lidhje me autorin e shkeljes;

12. “Përgjigje” është çdo veprim ose njoftim i dhënë nga autoriteti kompetent sinjalizuesit për të informuar për masat e marra ose të planifikuara pas marrjes së raportimit;

13. “Sinjalizim” është raportimi apo sinjalizimi i informacionit verbal ose me shkrim nga sinjalizuesi tek njësi përgjegjëse, ose tek ILDKPKI-ja për shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, të kryera në një mjedis pune në një autoritet publik ose subjekt privat, nëpërmjet kanaleve të brendshme, të jashtme ose nëpërmjet publikimit, në përputhje me këtë ligj;



14. “Sinjalizim anonim” është sinjalizimi i kryer nga një sinjalizues, identiteti i të cilit nuk është i njohur për autoritetin kompetent ose për njësinë përgjegjëse në momentin e paraqitjes së sinjalizimit, ose kur vetë sinjalizuesi ka kërkuar të mbetet anonim gjatë këtij procesi.

15. “Sinjalizim i brendshëm” është sinjalizimi i kryer nga sinjalizuesi brenda njësisë përgjegjëse të organizatës, sipas këtij ligji.

16. “Sinjalizim i jashtëm” është sinjalizimi i kryer nga sinjalizuesi pranë autoritetit kompetent, sipas ligjit.

17. “Sinjalizim publik” është sinjalizimi, zbulimi ose komunikimi publik i informacionit në lidhje me shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj, nëpërmjet medias së shkruar e audiovizive, medias *online* dhe sociale, takimet publike, njoftimet publike e të gjitha komunikimet verbale, të shkruara dhe të regjistruara.

18. “Sinjalizues” është çdo person fizik që në një kontekst pune sinjalizon ose publikon informacione për shkelje të mundshme.

19. “Subjekt privat” është personi juridik privat, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, përfshirë tregtarin sipas ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.

20. “Shkelje” është çdo veprim ose mosveprim i paligjshëm në fushën e zbatimit të këtij ligji, që ka ndodhur ose ka gjasë të ndodhë dhe për të cilin ka shkaqe të arsyeshme për ta konsideruar në kundërshtim me kuadrin ligjor, duke përfshirë përpjekjet për të fshehur shkeljet e mundshme si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat, si dhe veprimet që cenojnë rregullat, objektin dhe qëllimin e së drejtës së Bashkimit Evropian.

21. “Veprim hakmarrës” është çdo veprim apo mosveprim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë, i ndërmarrë në një kontekst pune, që ndodh pasi një individ ka sinjalizuar ose planifikon të sinjalizojë një shkelje të mundshme të kuadrit ligjor nëpërmjet mekanizmave të brendshëm, të jashtëm ose publikisht, që shkakton ose mund të shkaktojë dëm për sinjalizuesin.

Neni 5

Parime të përgjithshme

Procesi i sinjalizimit udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

1. Parimi i integritetit dhe i konfidencialitetit, sipas të cilit pjesëmarrësit në një procedurë administrative kanë të drejtë të kërkojnë që të dhënat e tyre personale e konfidenciale të trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Parimi i paanshmërisë, sipas të cilit shqyrtimi dhe zgjidhja e sinjalizimeve kryhet në mënyrë objektive, pavarësisht nga bindjet dhe interesat e personave përgjegjës për zgjidhjen e tyre.

KREU II

TË DREJTAT E SINJALIZUESIT, TË NDIHMËSIT DHE TË PERSONAVE TË LIDHUR ME SINJALIZUESIN

Neni 6

E drejta për mbrojtje

1. Mbrojtja e sinjalizuesit nga çdo formë hakmarrjeje sigurohet nëpërmjet mekanizmave të parashikuar në këtë ligj.

2. Sinjalizuesi gëzon të drejtat e mëposhtme:

a) mbrojtje nga të gjitha format e hakmarrjes;

b) mbrojtje të identitetit dhe ruajtje të konfidencialitetit gjatë procesit të sinjalizimit, përfshirë edhe rastet e sinjalizimit anonim;

c) ruajtje të konfidencialitetit të burimit të informacionit të sinjalizuar;

ç) ndihmë juridike falas, në përputhje me ligjin nr. 11/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”;

d) kompensim të dëmit të shkaktuar si rezultat i veprimeve hakmarrëse.

3. Ndihmësit, personat e lidhur me sinjalizuesin, si dhe personat juridikë që sinjalizuesi zotëron, për të cilët punon ose me të cilët është i lidhur në një kontekst të lidhur me punën, gëzojnë të drejtën e mbrojtjes sipas pikës 2 të këtij neni.

4. Të drejtat e sinjalizuesit garantohen sipas këtij ligji:

a) gjatë kohëzgjatjes së procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit;

b) pas përfundimit të procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit, për të siguruar vijimin normal të ushtrimit të detyrës në autoritetin publik ose në subjektin privat;

c) pas përfundimit të marrëdhënies së punës së sinjalizuesit në autoritetin publik ose në subjektin privat, kur sinjalizuesi, mbi bazën e rrethanave të



arsyeshme, ka paraqitur kërkesë për mbrojtje pranë ILDKPKI-së.

5. Çdo rregull ose marrëveshje private, që synon të përjashtojë ose të kufizojë të drejtat e sinjalizuesit, të parashikuara në këtë ligj, është e pavlefshme. Të drejtat e sinjalizuesit kanë epërsi ndaj çdo marrëveshjeje për konfidencialitetin.

6. Sinjalizuesi informohet nga autoriteti publik, subjekti privat ose nga ILDKPKI-ja për të drejtat dhe mbrojtjen e ofruar sipas këtij ligji.

Neni 7

Kushtet për mbrojtjen e sinjalizuesit

1. Sinjalizuesi gëzon të drejtën për mbrojtje sipas këtij ligji, pavarësisht mekanizmit të përdorur, kur plotësohen njëkohësisht këto kushte:

a) ka pasur shkaqe të arsyeshme për të besuar se informacioni i sinjalizuar ose i bërë publik për një shkelje të mundshme të kuadrit ligjor ishte i vërtetë në momentin e sinjalizimit ose të publikimit, pavarësisht nëse më pas rezulton ndryshe;

b) ka pasur shkaqe të arsyeshme për të besuar se informacioni i sinjalizuar përfshihet në fushën e zbatimit të këtij ligji;

c) sinjalizimi është kryer në përputhje me dispozitat e këtij ligji nëpërmjet një mekanizmi të brendshëm, të jashtëm ose nëpërmjet publikimit të informacionit.

2. Në rastet kur sinjalizimi është bërë në mënyrë anonime dhe përmbush kriteret e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, sinjalizuesi gëzon të drejtën për mbrojtje edhe nëse identiteti i tij është zbuluar më vonë pa pëlqimin e tij të shprehur dhe është bërë objekt i veprimeve hakmarrëse.

3. Sinjalizuesi që sinjalizon publikisht një shkelje të mundshme të kuadrit ligjor në fushat e përcaktuara sipas këtij ligji, gëzon të drejtën për mbrojtje në të njëjtat kushte.

4. Personat që sinjalizojnë pranë institucioneve, organeve, zyrave ose agjencive të Bashkimit Evropian shkelje që hyjnë në fushën e këtij ligji, gëzojnë mbrojtjen e parashikuar në këtë ligj në të njëjtat kushte si personat që sinjalizojnë në mënyrë të jashtme.

Neni 8

Mbrojtja kundër veprimeve hakmarrëse

1. Sinjalizuesi që sinjalizon një shkelje të mundshme të kuadrit ligjor gëzon mbrojtje ndaj çdo veprimi hakmarrës të ndërmarrë nga autoriteti publik ose nga subjekti privat kundrejt tij, si:

a) shkarkimi nga puna;

b) pezullimi nga detyra;

c) transferimi brenda ose jashtë institucionit, ose ndryshimi i orarit të punës;

ç) ulja në detyrë;

d) ulja e pagës dhe shpërblimeve financiare;

dh) humbja e statusit profesional, ose e privilegjeve të lidhura me pozicionin;

e) mohimi i mundësisë për ngritje në detyrë;

ë) përjashtimi nga programet e trajnimit;

f) vlerësimi negativ në marrëdhënien e punës;

g) intimidimi, ngacmimi, presioni psikologjik apo përjashtimi nga ambienti i punës;

gj) diskriminimi ose trajtimi i padrejtë;

h) mosrinovimi i kontratës së përkohshme në një kontratë të përhershme, kur punonjësi kishte pritshmëri të ligjshme për punësim të përhershëm;

i) përfundimi ose mosrinovimi i kontratës së përkohshme;

j) dëmtimi i reputacionit, kryesisht në mediat sociale, ose humbja e të ardhurave apo e mundësive të biznesit;

k) përfshirja në “listë të zezë” nëpërmjet marrëveshjeve formale, ose informale, që pengojnë punësimin në sektorin përkatës në të ardhmen;

l) përfundimi ose anulimi i parakohshëm i kontratës për mallra ose shërbime;

ll) anulimi i licencës, ose i lejes së ushtrimit të aktivitetit;

m) referimi i pajustificuar për ekzaminim psikiatrik ose mjekësor;

n) kërcënim, ose përpjekja për të ndërmarrë secilin nga veprimet e mësipërme;

nj) izolimi profesional, përjashtimi nga proceset vendimmarrëse apo marginalizimi i heshtur në ambientin e punës.

2. Sinjalizuesi paraqet kërkesë për mbrojtje pranë autoritetit kompetent, nëse vlerëson se është bërë objekt i veprimeve hakmarrëse për shkak të sinjalizimit.

3. Nëse sinjalizuesi kërkon zhvendosjen në një njësi tjetër, brenda autoritetit publik ose subjektit privat, për shkak të krijimit të një mjedisi pune



armiqësor si pasojë e sinjalizimit, autoriteti publik ose subjekti privat merr masat e nevojshme për realizimin e kësaj zhvendosjeje.

4. Në rast të mosmarrjes së masave, ILDKPKI-ja, me kërkesë të sinjalizuesit, i drejtohet autoritetit publik ose subjektit privat për të urdhëruar marrjen e masave përkatëse.

Nëse autoriteti publik ose subjekti privat nuk zbaton masat e urdhëruara brenda një afati prej 10 ditësh kalendarike nga data e marrjes së kërkesës, sinjalizuesi ose çdo person i interesuar ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës.

Neni 9

Ndalimi për veprimet hakmarrëse

1. Pengimi, ndërhyrja, përpjekja ose kërcënim për të penguar sinjalizimin në çfarëdo formë, janë të ndaluara dhe të dënueshme sipas ligjit.

2. Çdo akt, kontratë apo marrëveshje, individuale ose kolektive, që parashikon ndalimin apo kufizimin e të drejtës për sinjalizim, është e pavlefshme dhe nuk prodhon asnjë efekt juridik.

3. Veprimet hakmarrëse, përpjekjet për veprime hakmarrëse apo kërcënimet për veprime hakmarrëse, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, ndaj sinjalizuesit ose personave të lidhur me të, për shkak të sinjalizimit të brendshëm, të jashtëm, anonim ose publik, janë të ndaluara dhe të pavlefshme.

Neni 10

Konfidencialiteti dhe detyrimi për ruajtjen e identitetit të sinjalizuesit

1. Identiteti i sinjalizuesit dhe të dhënat e tjera të përfshira në sinjalizim ruhen në kushte konfidencialiteti nga njësia përgjegjëse dhe nga ILDKPKI-ja, dhe identiteti i sinjalizuesit mund të zbulohet vetëm me pëlqimin e tij të shprehur.

2. Identiteti i personit të përfshirë, si dhe çdo informacion tjetër që lidhet me të, ruhet dhe mbrohet në kushte konfidencialiteti nga njësia përgjegjëse dhe nga ILDKPKI-ja.

3. Punonjësi i njësise përgjegjëse dhe ILDKPKI-ja kanë detyrimin të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave e të informacionit të marrë nga sinjalizimi, dhe të mos i përdorin apo t'i zbulojnë ato për qëllime të tjera, përveç rasteve kur është e nevojshme për zbatimin e këtij ligji.

4. Zbulimi i identitetit të sinjalizuesit dhe i të dhënave të përpunuara, sipas pikës 1 të këtij neni, mund të kryhet edhe pa pëlqimin e tij, vetëm në rastet kur është i domosdoshëm në mënyrë të arsyetuar e proporcionale për nevoja të hetimit penal ose të procesit gjyqësor.

5. Në çdo rast, ILDKPKI-ja apo njësia përgjegjëse i dërgon sinjalizuesit një njoftim me shkrim, që përmban arsyet e justifikuara për zbulimin e të dhënave konfidenciale, si dhe masat e marra për të kufizuar sa më shumë rrezikun e ekspozimit të panevojshëm.

6. Kryesisht, sinjalizuesi informohet para se të zbulohet identiteti i tij, përveç rasteve kur një informim i tillë do të rrezikonte hetimin ose procedimin gjyqësor.

Neni 11

Përpunimi i të dhënave personale

1. Përpunimi i të dhënave personale të individëve të përfshirë në hetimin administrativ kryhet vetëm për qëllime të zbatimit të këtij ligji e në përputhje me parimet dhe procedurat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Të dhënat personale, që nuk konsiderohen të nevojshme për trajtimin e një sinjalizimi, nuk mblidhen. Nëse këto të dhëna mblidhen rastësisht, ato fshihen pa vonesë.

3. Në rast se gjatë zbatimit të këtij ligji konstatohet shkelje e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, çështja i referohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

4. Të dhënat personale, që nuk i shërbejnë trajtimit të sinjalizimit, nuk përfshihen në hetimin administrativ.

Neni 12

Ruajtja e të dhënave dhe administrimi i dokumentacionit

1. Njësitë përgjegjëse dhe ILDKPKI-ja sigurojnë gjurmueshmërinë e të dhënave e të informacionit, si dhe ruajnë dokumentacionin e krijuar në formë shkresore ose elektronike, në mënyrë që të mundësohet rindërtimi i fazave të ndryshme të procesit të sinjalizimit, duke garantuar njëkohësisht konfidencialitetin e mbrojtjen e të dhënave personale të sinjalizuesit dhe të personit të përfshirë.



2. Dokumentacioni original ruhet për një periudhë 5-vjeçare nga data e komunikimit të rezultatit përfundimtar të procedurës së sinjalizimit, përveç rasteve kur procedura ligjore përkatëse është ende në proces dhe nuk ka përfunduar.

3. Kur sinjalizimi bëhet nëpërmjet një linje telefonike të regjistruar ose një sistemi tjetër të mesazheve zanore të regjistruara, sinjalizuesi informohet paraprakisht për regjistrimin. Sinjalizimi dokumentohet nëpërmjet një regjistrimi zanor në pajisje të përshtatshme për ruajtje dhe dëgjim ose nëpërmjet një transkripti të plotë. Në rast transkriptimi, sinjalizuesi ka të drejtë të verifikojë, të korrigjojë dhe të konfirmojë përmbajtjen, duke nënshkruar dokumentin përkatës.

4. Kur sinjalizimi bëhet nëpërmjet një linje telefonike të paregjistruar ose një sistemi tjetër të mesazheve zanore të paregjistruara, biseda përshkruhet me shkrim në mënyrë të detajuar nga njësisë përgjegjëse ose nga ILDKPKI-ja. Sinjalizuesi ka të drejtë të verifikojë, të korrigjojë dhe të konfirmojë përmbajtjen, duke nënshkruar dokumentin përkatës.

5. Kur sinjalizimi bëhet verbalisht gjatë një takimi me njësinë përgjegjëse ose me autoritetin kompetent, sinjalizimi dokumentohet me pëlqimin e sinjalizuesit nëpërmjet regjistrimit zanor ose nëpërmjet hartimit të një procesverbali të takimit. Sinjalizuesi ka të drejtë të verifikojë, të korrigjojë dhe të konfirmojë përmbajtjen e dokumentuar, duke nënshkruar përkatësisht regjistrimin ose proces-verbalin.

KREU III PROCEDURA E SINJALIZIMIT DHE HETIMIT ADMINISTRATIV

Neni 13

Procedura e kryerjes së sinjalizimit

1. Sinjalizimi bëhet pranë njësisë përgjegjëse, pranë ILDKPKI-së ose nëpërmjet deklaramit publik.

2. Procedura e sinjalizimit fillon me paraqitjen e sinjalizimit pranë njësisë përgjegjëse ose pranë ILDKPKI-së.

3. Sinjalizuesi mund të përdorë mekanizmin e sinjalizimit të brendshëm, të jashtëm ose publik. Sinjalizimi përmban, sipas rastit:

a) të dhënat e identitetit dhe të kontaktit të sinjalizuesit, përveç rasteve kur sinjalizimi bëhet në mënyrë anonime;

b) organin ose personin e përfshirë ndaj të cilit raportohet shkelja;

c) përshkrimin e informacionit për shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, të shoqëruar me fakte, rrethana dhe dokumentacion mbështetës, për aq sa është e mundur;

ç) referimin përkatës të legjislacionit të shkelur, për aq sa është e mundur.

4. Sinjalizimi verbal realizohet nëpërmjet një linje telefonike të dedikuar ose përmes pajisjeve të tjera të regjistrimit zanor, ose nëpërmjet një takimi fizik, brenda një afati të arsyeshëm.

5. Sinjalizimi i jashtëm mund të bëhet në çdo fazë dhe pa u kushtëzuar nga sinjalizimi i brendshëm, përfshirë:

a) drejtpërdrejt pranë autoritetit kompetent;

b) në rast se sinjalizimi është kryer fillimisht pranë njësisë përgjegjëse dhe sinjalizuesi vlerëson se shkelja nuk mund të trajtohet në mënyrë efektive brenda autoritetit publik ose subjektit privat apo kur ekziston rrezik për veprime hakmarrëse ndaj tij, ose personave të lidhur me të;

c) në rast se sinjalizuesi ka paraqitur fillimisht sinjalizimin pranë njësisë përgjegjëse dhe nuk është informuar për ecurinë ose trajtimin e tij.

Neni 14

Krijimi i njësisë përgjegjëse

1. Çdo autoritet publik dhe subjekt privat me më shumë se 50 punonjës, si dhe çdo ent me kapital shtetëror apo që është nën kontrollin e subjekteve shtetërore, kanë detyrimin të krijojnë njësi përgjegjëse për sinjalizimin, duke garantuar funksionimin efektiv të një mekanizmi të dedikuar për raportimin dhe ndjekjen e sinjalizimeve të brendshme.

2. Ky detyrim zbatohet pavarësisht nga numri i punonjësve për personat juridikë që ushtrojnë veprimtari në fushat e shërbimeve financiare, të produkteve dhe të tregjeve financiare, të sigurimeve e të fondeve të pensionit, të parandalimit të pastrimit të parave e të financimit të terrorizmit, si dhe në çdo fushë tjetër të parashikuar nga aktet e Bashkimit Evropian, që kërkojnë ngritjen e kanaleve të brendshme të raportimit.



3. Autoritetet publike e subjektet private miratojnë një rregullore të brendshme për përcaktimin e rregullave të sinjalizimit, në përputhje me këtë ligj dhe me aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

4. Njësia përgjegjëse merr masa për ndërgjegjësimin dhe nxitjen e sinjalizimit nëpërmjet kanaleve e të procedurave të brendshme të sinjalizimit para përdorimit të kanaleve të jashtme në rastet kur shkelja mund të trajtohet në mënyrë efektive brenda institucionit, dhe kur sinjalizuesi vlerëson se nuk ekziston rrezik hakmarrjeje, si dhe siguron informacionin e nevojshëm për përdorimin e këtyre kanaleve dhe për procedurat për raportim të jashtëm pranë ILDKPKI-së ose përdorimin e kanaleve të jashtme dhe, sipas rastit, sinjalizimin pranë institucioneve të Bashkimit Evropian.

5. Njësia përgjegjëse garanton akses në të gjitha format e sinjalizimit, përfshirë ato verbale, me shkrim ose përmes mjeteve të tjera të njohura të komunikimit.

6. Emërimi i punonjësit në njësinë përgjegjëse bëhet pas dhënies së pëlqimit të tij me shkrim.

7. Njësia përgjegjëse përbëhet nga një ose më shumë persona, në varësi të numrit të punonjësve e të strukturës së autoritetit publik, ose subjektit privat, të cilët duhet të jenë të trajnuar posaçërisht në fushën e sinjalizimit dhe mbrojtjes së sinjalizuesve.

8. Mekanizmi i sinjalizimit administrohet nga një person, drejtori ose sektor i veçantë brenda autoritetit publik ose subjektit privat. Në subjektin privat ky shërbim mund të ofrohet edhe nga një palë e tretë e jashtme.

9. Palët e treta, që menaxhojnë mekanizmin e sinjalizimit për subjektet juridike në sektorin privat, duhet të ofrojnë garanci të përshtatshme për respektimin e pavarësisë, konfidencialitetit, mbrojtjes së të dhënave dhe anonimitetit në përputhje me kërkesat e këtij ligji.

10. Subjektet juridike në sektorin privat, që ushtrojnë të njëjtën fushë veprimtarie dhe kanë nga 50 deri në 249 punonjës, mund të krijojnë një njësi të përbashkët përgjegjëse për trajtimin e sinjalizimeve, duke garantuar në çdo rast respektimin e parimit të konfidencialitetit, të së drejtës për informim dhe detyrimin për të trajtuar çdo rast të sinjalizuar.

11. Nga detyrimi për krijimin e njësisë përgjegjëse përjashtohen bashkitë që kanë më pak se 10 000 banorë ose më pak se 50 punonjës.

12. Njësia përgjegjëse paraqet pranë ILDKPKI-së jo më vonë se data 15 janar e vitit pasardhës raportin vjetor të konsoliduar për sinjalizimet e marra dhe trajtimin e tyre, sipas formatit të përcaktuar nga ILDKPKI-ja.

13. ILDKPKI-ja përcakton me udhëzim strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe trajnimin e punonjësve të njësisë përgjegjëse të subjekteve private. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim marrëdhëniet e punës, strukturën dhe kriteret e përzgjedhjes së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike.

Neni 15

Detyrimet e njësisë përgjegjëse

1. Njësia përgjegjëse ka detyrimin:

a) të pranojë, të regjistrojë dhe të konfirmojë marrjen e sinjalizimit, brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes, përveç rasteve kur sinjalizuesi ka kërkuar shprehimisht të mos merret konfirmim ose kur konfirmimi rrezikon mbrojtjen e identitetit të tij;

b) të ndjekë me përgjegjshmëri e të informojë sinjalizuesin për ecurinë e sinjalizimit dhe rezultatin përfundimtar, jo më vonë se 3 muaj nga data e konfirmimit të regjistrimit të sinjalizimit. Ky afat zbatohet edhe në rastet kur konfirmimi nuk është dërguar;

c) të sigurojë që kanalet e sinjalizimit të organizohen e të funksionojnë në mënyrë të sigurt, duke garantuar ruajtjen e konfidencialitetit të identitetit të sinjalizuesit dhe të çdo personi të tretë të përmendur në sinjalizim, si dhe duke parandaluar aksesin e paautorizuar ndaj informacionit të përfshirë në sinjalizim;

ç) të sigurojë informacion të qartë e të nevojshëm për procedurat e raportimit të brendshëm, përfshirë mënyrën e përdorimit të tyre dhe masat e mbrojtjes për sinjalizuesit;

d) njësia përgjegjëse informon automatikisht sinjalizuesin jo vetëm për veprimet e ndërmarra ose të parashikuara si ndjekje të mëtejshme, por edhe për arsyetimin përkatës në çdo rast dhe pa qenë nevoja për kërkesë specifike nga sinjalizuesi.

2. Punonjësi i ngarkuar me trajtimin e sinjalizimeve në njësinë përgjegjëse gëzon pavarësi në ushtrimin e kompetencave të tij, veçanërisht në rastet kur sinjalizimi lidhet me veprimtarinë e punëdhënësit ose përfshin masa për mbrojtjen e sinjalizuesit.



3. Punonjësi i autorizuar për regjistrimin dhe shqyrtimin e sinjalizimeve gëzon të drejtën e mbrojtjes sipas këtij ligji, nëse bëhet objekt i veprimeve hakmarrëse për shkak të ushtrimit të detyrës.

4. Nëse sinjalizimi është marrë nga një person që nuk është i autorizuar për të vepruar sipas ligjit, ky person ka detyrimin ta përcjellë pa vonesë sinjalizimin te punonjësi i njësisë përgjegjëse ose tek autoriteti kompetent, duke ruajtur identitetin e sinjalizuesit dhe të çdo informacioni, që mund ta zbulojë atë.

Neni 16

Autoriteti kompetent

1. Në përputhje me këtë ligj, ILDKPKI-ja:

a) pranon, regjistron dhe konfirmon marrjen e sinjalizimit, brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes, përveç rasteve kur sinjalizuesi ka kërkuar shprehimisht të mos merret konfirmim ose kur konfirmimi rrezikon mbrojtjen e identitetit të tij;

b) brenda 7 ditëve nga marrja e sinjalizimit harton një raport, ku vlerëson nëse të drejtat e sinjalizuesit janë shkelur ose janë vënë në rrezik;

c) vlerëson nevojën për marrjen e masave të përkohshme për mbrojtjen e sinjalizuesit nëse krijohet bindja se ai mund të jetë objekt i veprimeve hakmarrëse;

ç) përcjell raportin për shkeljen e mundshme tek institucioni përgjegjës, ndjek ecurinë e hetimit dhe informon sinjalizuesin për rezultatet;

d) trajton kërkesat për mbrojtje nga veprime hakmarrëse, të paraqitura nga sinjalizuesi;

dh) heton çdo veprim hakmarrës ndaj sinjalizuesit;

e) jep informacion të përgjithshëm për procedurat e sinjalizimit dhe mbrojtjen e të drejtave të sinjalizuesit;

ë) garanton ruajtjen e identitetit të sinjalizuesit dhe të të dhënave të marra nga sinjalizimi ndaj çdo zbulimi të paautorizuar;

f) harton një dokument të plotë dhe lehtësisht të aksesueshëm, që përshkruan procedurat për paraqitjen e një sinjalizimi pranë autoritetit kompetent.

2. ILDKPKI-ja ndjek procedurën e mbrojtjes së sinjalizuesit dhe të personave të lidhur me të, në përputhje me këtë ligj.

3. ILDKPKI-ja siguron e përdor burimet e nevojshme për regjistrimin, ndjekjen dhe komunikimin me sinjalizuesin gjatë trajtimit të sinjalizimit.

4. ILDKPKI-ja krijon mekanizma të jashtëm të pavarur e funksionalë për marrjen dhe trajtimin e sinjalizimeve; i kthen përgjigje sinjalizuesit brenda 3 muajve nga data e konfirmimit të regjistrimit të sinjalizimit ose jo më vonë se 6 muaj në raste të justifikuara me shkrim; njofton sinjalizuesin për rezultatin përfundimtar të hetimit administrativ dhe për përfundimet e raportit të trajtuar nga institucioni përkatës; si dhe mban komunikim të vazhdueshëm me institucionet përkatëse për vijimin e hetimit.

5. ILDKPKI-ja ofron masa mbështetëse për sinjalizuesit, duke përfshirë këshillim dhe orientim për të drejtat e detyrimet që rrjedhin nga ky ligj, si dhe akses në informacion, në çdo rast që vlerësohet i nevojshëm.

6. Pas shqyrtimit të rrethanave dhe fakteve të paraqitura ILDKPKI-ja vendos mbylljen e procedurës kur vlerëson se nuk ekziston shkelje ose kur ka arsye të tjera të objektivë.

7. ILDKPKI-ja mbyll shqyrtimin e sinjalizimeve të përsëritura, që nuk përmbajnë informacione të reja, përveç rasteve kur paraqiten rrethana të reja ose prova të rëndësishme që justifikojnë rihapjen e çështjes.

8. Në rastet kur ka për trajtim një numër të lartë sinjalizimesh, ILDKPKI-ja u jep përparësi atyre që lidhen me çështje me interes të lartë publik.

9. Çdo autoritet që merr një sinjalizim, por nuk është kompetent për trajtimin e tij, është i detyruar ta përcjellë atë tek ILDKPKI-ja dhe të njoftojë sinjalizuesin, duke ruajtur identitetin e sinjalizuesit e çdo informacion që mund ta zbulojë atë.

10. ILDKPKI-ja cakton personel të trajnuar posaçërisht për të informuar personat e interesuar për procedurat e sinjalizimit, për të pranuar e për të ndjekur sinjalizimet, si dhe për të mbajtur kontakt me sinjalizuesin gjatë të gjithë procesit.

Neni 17

Sinjalizimi anonim

1. Sinjalizimet anonime trajtohen nga njësia përgjegjëse ose nga ILDKPKI-ja në të njëjtën mënyrë, si çdo sinjalizim tjetër, pa vendosur kushte shtesë për marrjen, shqyrtimin dhe verifikimin e tyre.



2. Sinjalizimi anonim duhet të bëhet nëpërmjet mekanizmit të brendshëm, të jashtëm ose nëpërmjet publikimit, në përputhje me parashikimet e përcaktuara në këtë ligj.

3. Identiteti i sinjalizuesit, në rastet kur identifikohet, mund të bëhet i njohur vetëm me pëlqimin e tij të shprehur ose me kërkesë të organeve procedurale kompetente, në përputhje me ligjin.

Neni 18

Sinjalizimi publik

Sinjalizuesi, që bën publikisht një sinjalizim për një shkelje të mundshme të kuadrit ligjor, përfiton mbrojtje sipas këtij ligji nëse plotësohet të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

a) personi fillimisht ka bërë më parë sinjalizim të brendshëm dhe të jashtëm ose direkt sinjalizim të jashtëm, në përputhje me këtë ligj, por nuk janë ndërmarrë veprime të nevojshme si përgjigje ndaj tij;

b) sinjalizuesi ka shkaqe të arsyeshme për të besuar, se:

i. shkelja përbën rrezik të menjëhershëm ose të dukshëm për interesin publik, përfshirë situatat e emergjencës, ose rastet kur ka rrezik të dëmit të pariparueshëm; ose

ii. në rast sinjalizimi të jashtëm ekziston mundësi e ulët që shkelja të trajtohet në mënyrë efektive për shkak të rrethanave specifike të çështjes, si rreziku i fshehjes ose shkatërrimit të provave, rreziku i hakmarrjes ndaj sinjalizuesit, ose rastet e përfshirjes apo bashkëpunimit të autoritetit kompetent në shkelje.

Neni 19

Mbikëqyrja dhe informimi nga autoriteti kompetent

1. ILDKPKI-ja është organi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji dhe për ofrimin e informacionit për të.

2. ILDKPKI-ja raporton një herë në vit në Kuvend edhe për zbatimin e këtij ligji dhe veprimtarinë në mbrojtje të sinjalizuesve, përgjatë raportimit vjetor institucional.

3. ILDKPKI-ja publikon në faqen e saj zyrtare të internetit informacion të përgjithshëm për zbatimin e këtij ligji, përfshirë veçanërisht:

a) kushtet për përfitimin e së drejtës për mbrojtje;

b) të dhënat e kontaktit për marrjen e sinjalizimeve, përfshirë adresën postare, adresën elektronike dhe me një sqarim të qartë nëse bisedat telefonike regjistrohen;

c) procedurat e ndjekura për hetimin e sinjalizimeve, duke përfshirë mënyrën se si njësitë përgjegjëse, në bashkëpunim me ILDKPKI-në, mund të kërkojnë nga sinjalizuesi sqarime apo informacion shtesë, afatet për paraqitjen e tyre, si dhe llojin e përmbajtjes të kërkuar të tyre;

ç) mjetet ligjore dhe procedurat për mbrojtjen nga veprimet hakmarrëse;

d) kushtet në të cilat personat që sinjalizojnë pranë autoritetit kompetent përjashtohen nga përgjegjësia për shkelje të konfidencialitetit;

dh) monitorimin dhe nxjerrjen e udhëzimeve për funksionimin e mekanizmit të raportimit të brendshëm e të jashtëm, sipas parashikimeve të këtij ligji;

e) kontrollin për funksionimin e njësive përgjegjëse;

ë) konstatimin e kundërvajtjeve administrative dhe vendosjen e sanksioneve përkatëse, në përputhje me parashikimet e këtij ligji;

f) hartimin e vlerësimeve dhe nxjerrjen e rekomandimeve për zbatimin e këtij ligji, bazuar në raportet vjetore të paraqitura nga njësitë përgjegjëse;

g) ofrimin e këshillimit dhe të mbështetjes për zbatimin e këtij ligji;

gj) ndërmarrjen e veprimtarive ndërgjegjësuere për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve;

h) regjimin e konfidencialitetit të zbatueshëm për sinjalizimet, përfshirë informacionin për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, bazën ligjore e qëllimin e përpunimit, afatet e ruajtjes së tyre, si dhe të drejtat e subjekteve, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. ILDKPKI-ja rishikon periodikisht zbatimin e këtij ligji dhe efektivitetin e procedurave për marrjen, trajtimin e ndjekjen e sinjalizimeve të paktën një herë në tre vjet.

5. Rishikimi bazohet në përvojën e zbatimit të ligjit, në të dhënat e mbledhura nga njësitë përgjegjëse e në bashkëpunimin me autoritetet e tjera publike, si dhe përfshin rekomandime për përmirësimin e sistemit të sinjalizimit e të masave mbrojtëse.



Neni 20

Procedura e hetimit administrativ

1. Sipas rastit, çdo njësi përgjegjëse ose ILDKPKI-ja heton administrativisht sinjalizimin, në përputhje me procedurën e përcaktuar në këtë ligj. Për atë që nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj, njësi përgjegjëse pranë autoritetit publik dhe pranë ILDKPKI-së zbatojnë dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative.

2. Procedura e hetimit administrativ të sinjalizimit përfundon sa më shpejt që të jetë e mundur, por, në çdo rast, jo më vonë se 90 ditë nga data e fillimit të saj.

3. Gjatë hetimit njësi përgjegjëse ose ILDKPKI-ja shqyrton dhe vlerëson pretendimet e sinjalizuesit. Për këtë qëllim mund të kërkojë dokumentacion dhe të dhëna, të urdhërojë inspektime ose analiza, të mbledhë deklarata, të marrë në pyetje persona që kanë dijeni për çështjen, si dhe të angazhojë ekspertë të jashtëm, kur vlerësohet e nevojshme.

4. Në procesin e hetimit administrativ merr pjesë sinjalizuesi dhe çdo palë e tretë, kur dyshohet se posedon dokumente ose ka dijeni për rrethanat e sinjalizuara, përfshirë edhe personin e sinjalizuar, kur kjo çmohet e nevojshme nga drejtuesi i hetimit.

5. Çdo palë pjesëmarrëse në hetimin administrativ i garantohej një proces i rregullt, në përputhje me parashikimet në Kodin e Procedurave Administrative, përfshirë:

a) të drejtën për të paraqitur deklarata me shkrim, argumente ose opinione;

b) të drejtën për t'u njohur me dosjen e hetimit, me përjashtim të çdo informacioni, që mund të çojë në identifikimin e sinjalizuesit; të dhënat e sinjalizuesit paraqiten në mënyrë të anonimizuar;

c) të drejtën për t'u dëgjuar për pretendimet e parashtruara.

6. Çdo institucion publik ose subjekt privat është i detyruar të vërë në dispozicion të hetimit të dhënat, dokumentet dhe provat që disponon.

7. Njësi përgjegjëse ose ILDKPKI-ja njofton sinjalizuesin për çdo masë të marrë në përgjigje të sinjalizimit jo më vonë se 30 ditë nga data e marrjes së masës. Gjithashtu, njësi përgjegjëse ose ILDKPKI-ja është e detyruar të përgjigjet brenda 30 ditëve për çdo kërkesë me shkrim të paraqitur nga sinjalizuesi në lidhje me ecurinë e çështjes.

8. Çdo autoritet publik dhe subjekt privat miraton rregullore të brendshme për procedurat e hetimit administrativ dhe masat për mbrojtjen e konfidencialitetit, sipas këtij ligji dhe në përputhje me udhëzimet e autoritetit kompetent.

9. Për çështjet që bëjnë pjesë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të personave që ushtrojnë funksione publike dhe disa nëpunësve publikë", të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar, autoriteti kompetent për trajtimin e tyre është ILDKPKI-ja.

Neni 21

Mosfillimi dhe përfundimi i hetimit të sinjalizimit

1. Njësi përgjegjëse ose ILDKPKI-ja vendos mosfillimin e hetimit administrativ, kur:

a) sinjalizimi, me përjashtim të rasteve të sinjalizimit anonim, nuk është depozituar sipas formës dhe përmbajtjes së kërkuar nga ky ligj dhe sinjalizuesi nuk i korrigjon këto të meta brenda 7 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për plotësim;

b) sinjalizimi përmban fakte apo rrethana që nuk përfshihen në fushën e zbatimit të këtij ligji;

c) nga përmbajtja e sinjalizimit, si dhe nga verifikimi paraprak, rezulton qartë se nuk ekzistojnë elemente të një kundërvajtjeje administrative ose të një vepre penale.

2. Njësi përgjegjëse ose ILDKPKI-ja përfundon hetimin administrativ, kur:

a) gjatë hetimit administrativ konstatohet se sinjalizimi është i bazuar; ai referohet pranë autoritetit kompetent kur përmban elemente të kundërvajtjes administrative ose në organet e prokurorisë kur dyshohet për vepër penale. Referimi bëhet me të dhëna të anonimizuara ose të depersonalizuara, në lidhje me identitetin e sinjalizuesit;

b) sinjalizimi rezulton i pabazuar në fakte dhe të dhëna;

c) sinjalizuesi ka paraqitur me dashje informacion të rremë ose të pasaktë.

3. Në dosjen e sinjalizimit dokumentohen vendimi për mosfillimin ose përfundimin e hetimit administrativ, arsyet përkatëse që justifikojnë vendimmarrjen dhe çdo masë e marrë në lidhje me



sinjalizimin. Ky vendim i përcillet sinjalizuesit në çdo rast, së bashku me arsyetimin përkatës, pa qenë e nevojshme paraqitja e një kërkesë të veçantë nga ana e tij.

KREU IV TË DREJTAT DHE DETYRIMET E SINJALIZUESIT, NJËSISË PËRGJEGJËSE E TË AUTORITETIT KOMPETENT

Neni 22

Procedura e hetimit të kërkesës për mbrojtje

1. Procedura e hetimit të kërkesës për mbrojtje nga veprimet hakmarrëse fillon me dorëzimin e kërkesës së sinjalizuesit pranë autoritetit kompetent.

2. ILDKPKI-ja regjistron dhe shqyrton kërkesën për të vlerësuar nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për të besuar se një veprim hakmarrës ka ndodhur, është duke ndodhur ose pritet të ndodhë.

3. Brenda 5 ditëve nga marrja e kërkesës, ILDKPKI-ja njofton me shkrim sinjalizuesin për regjistrimin e saj dhe i bën me dije emrin e punonjësit përgjegjës për ndjekjen e çështjes.

4. ILDKPKI-ja merr masa të menjëhershme, jo më vonë se 7 ditë nga paraqitja e kërkesës dhe, kur çmon se ekziston rreziku i një veprimi hakmarrës, vendos me një akt të ndërmjetëm të arsyetuar pezullimin e çdo veprimi hakmarrës ndaj sinjalizuesit deri në përfundimin e hetimit.

5. Vendimi i përkohshëm i njoftohet vetëm sinjalizuesit, përveç rasteve kur zbatimi i tij kërkon ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të institucionit apo të subjektit privat për ndalimin e një veprimi të identifikuar.

6. ILDKPKI-ja njofton me shkrim sinjalizuesin, brenda 7 ditëve nga data e marrjes së kërkesës për mbrojtje, për statusin e hetimit administrativ dhe për çdo veprim procedural të ndërmarrë.

7. Pavarësisht afatit të njoftimit të parashikuar në këtë nen, ILDKPKI-ja është e detyruar t'i përgjigjet çdo kërkesë për informacion, të paraqitur me shkrim nga sinjalizuesi, në çdo kohë, në lidhje me shqyrtimin e kërkesës së tij për mbrojtje.

8. Procedura e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje përfundon sa më shpejt të jetë e mundur, por, në çdo rast, jo më vonë se 60 ditë nga data e regjistrimit të kërkesës.

9. Autoriteti publik ose subjekti privat, me kërkesë të ILDKPKI-së, duhet të provojë se masat e marra në dëm të sinjalizuesit nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me sinjalizimin.

10. ILDKPKI-ja përcakton rregullat për procedurën e shqyrtimit të kërkesës së sinjalizuesit për mbrojtje nga veprimet hakmarrëse.

Neni 23

Mbrojtja nga veprimet hakmarrëse

Gjatë periudhës nëntëmuajore të 2025-s, shkalla e papunësisë vazhdon trajektoren rënës në raport me vitin 2024, duke shënuar 9.3 për qind mesatarisht për këtë hark kohor, dhe duke arritur në 9.0 për qind në fund të tremujorit të tretë. Gjatë nëntëmuajorit të parë të vitit 2025, norma e pjesëmarrjes në forcat e punës arriti në 76.5 për qind, ndërsa shkalla e punësimit u rrit në 69.4 për qind, krahasuar respektivisht me 75.7 për qind dhe 68.6 për qind për të njëjtën periudhë të vitit 2024. Gjithashtu, shkalla e papunësisë për tremujorin e tretë të 2025 është ulur krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të mëparshëm në 8.1 për qind (ose 9.0 për qind për moshën 15 vjeç e lart).

Bazuar në statistikën e bilancit të pagesave të Bankës së Shqipërisë, Bilanci i Pagesave (BP) për vitin 2024 regjistroi një suficit prej rreth 264 milionë eurosh, ndërsa për nëntëmuajorin e vitit 2025 bilanci

i pagesave regjistroi një suficit prej afro 1.1 miliardë euro, kundrejt një deficiti prej 30 milionë eurosh në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Për nëntëmuajorin e parë të vitit 2025, llogaria korrente rezultoi me një suficit prej 51 milionë eurosh krahasuar me një deficit prej 232 milionë eurosh për të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Ndërsa, vetëm për tremujorin e tretë të 2025, llogaria korrente u mbyll me balancë pozitive prej rreth 658 milionë eurosh, përkundrejt 346 milionë eurosh në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, në sfondin e zgjerimit të konsiderueshëm të suficitit tregtar në shërbime. Performanca pozitive e shërbimeve reflekton përmirësimin e ndjeshëm të bilanceve pozitive në: shërbimet e udhëtimit, shërbimet e transportit, shërbimet për përpunim dhe shërbimet e tjera për biznesin. Në të njëjtën kohë, ngushtimi i deficitit të të ardhurave parësore, si pasojë e rënies së flukseve dalëse të të ardhurave nga investimet, si dhe zgjerimi i suficitit të të ardhurave dytësore neto, kontribuan në forcimin e bilancit pozitiv korrent, duke kompensuar plotësisht thellimin e deficitit tregtar në mallra, i cili u zgjerua me rreth 11% në terma vjetorë.




Nga ana tjetër, deficiti tregtar rezultoi me një zgjerim prej rreth 321 milionë eurosh ose 7.9 për qind krahasuar me nëntëmuajorin e 2024-s. Eksporti i mallrave për nëntëmuajorin 2025 u ul me 9.9 për qind krahasuar me të njëjtën periudhë të 2024-s, por në të njëjtën kohë importi i mallrave u zgjerua me rreth 3.6 për qind, në reflektim të rritjes së kërkesës së brendshme stimuluar edhe nga sezoni turistik, duke çuar për rrjedhojë në zgjerimin e deficitit tregtar. Shkëmbimet tregtare në shërbime vijuan në trend pozitiv, duke zgjeruar suficitin tregtar, me

² Këto janë të dhënat më të fundit të disponueshme deri në momentin e hartimit të këtij dokumenti.



rreth 3.5 miliardë euro ose me 16.5 për qind më shumë për nëntëmujorin e parë të 2025 krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ku suficiti ishte rreth 3 miliardë euro. Eksporti i shërbimeve të lidhura përgjithësisht me turizmin u zgjerua në vlerën 4.4 miliardë euro për nëntëmujorin 2025, ose rreth 14.5 për qind më shumë krahasuar me 3.8 miliardë euro në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Remitancat për periudhën nëntëmujore të vitit 2025 shënuan vlerën 817 milionë euro, me një rritje prej rreth 5.7 përqindësh krahasuar me 772 milionë euro në periudhën respektive të një viti më parë. Në nëntëmujorin e parë të vitit 2025, teprica pozitive e llogarisë financiare dhe kapitale rezultoi në 928 milionë euro krahasuar me 125 milionë euro që ishte në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Brenda kësaj llogarie, investimet e huaja direkte hyrëse shënuan nivelin prej 1.2 miliardë eurosh për nëntëmujorin e parë të vitit 2025, ose një rritje prej 4.3 përqindësh në krahasim me nivelin prej 1.1 miliardë eurosh të së njëjtës periudhë të 2024-s.

Inflacioni i çmimeve të konsumit ka shfaqur një ecuri të qëndrueshme gjatë periudhës së fundit, duke u konsoliduar rreth të njëjtës normë mesatare në vitet 2024 dhe 2025. Pas luhatjeve të theksuara të vërejtura në vitet pararendëse, presionet inflacioniste janë zbutur ndjeshëm, ndërsa inflacioni mesatar për vitin 2024 u regjistrua në nivelin 2.2 për qind dhe, sipas të dhënave më të fundit të nëntor 2025, mbetet në nivele të ngjashme edhe gjatë vitit 2025. Kjo ecuri reflekton ndikimin e vazhdueshëm të faktorëve disinflacionistë, përfshirë forcimin e kursit të këmbimit të lekut, uljen e çmimeve të ushqimeve dhe të energjisë, si dhe normalizimin gradual të kushteve të ofertës. Në këtë kontekst, dinamika e inflacionit sinjalizon një mjedis më të stabilizuar të çmimeve dhe një përforcim të tendencës së konsolidimit të inflacionit rreth niveleve të synuara.



Burimi: INSTAT

Ndërsa kursi i këmbimit të lekut kundrejt valutave kryesore ka shënuar një vlerësim të ndjeshëm edhe gjatë vitit 2025, duke theksuar tendencën forcuese të vërejtur në vitet e mëparshme. Kursi mesatar lek/euro për janar–nëntor 2025 ishte 97.94 nga 100.7, që ishte mesatarisht gjatë gjithë vitit 2024. Ndërsa kursi mesatar lek/USD për janar–nëntor 2025 ishte 87.05 nga 93.04, që ishte mesatarisht gjatë gjithë viti 2024. Presionet e vazhdueshme për forcimin e kursit vijuan të burojnë nga rritja e flukseve hyrëse valutore të ushqyera nga rritja e turizmit, remitancave dhe IHD-ve.

2. Politika fiskale

Ekonomia shqiptare ka treguar një qëndrueshmëri të lartë përballë sfidave të tilla, si: pandemia, kriza energjetike dhe presionet inflacioniste, të cilat kanë testuar kuadrin fiskal të vendit. Politikat e kujdesshme makroekonomike dhe fiskale kanë mbështetur rimëkëmbjen graduale të aktivitetit ekonomik, duke garantuar që fondamentet kryesore ekonomike dhe financiare të mbeten solide. Konsolidimi fiskal do të vijojë të jetë objektivi themelor i politikës fiskale për periudhën afatmesme 2027–2029, në funksion të drejtpërdrejtë të sigurimit të stabilitetit makroekonomik të vendit, si një premisë thelbësore për sigurimin e një rritjeje ekonomike të qëndrueshme e gjithëpërfshirëse. Me synimin për të ruajtur të pacenuar kredibilitetin e financave publike në perceptimin e tregjeve, politika fiskale do të targetojë një trajektore rënëse të përvitshme të borxhit publik, ndërsa balanca primare do të jetë së paku neutrale ose në nivel pozitiv në vijimësi, duke përbërë objektivin kryesor operacional që do të ankorojë politikën fiskale në afatin e mesëm dhe të gjatë, në përputhje edhe me rregullat fiskale respektive në LOB.

Kuadrat shpjegues 1: Balanca primare, ankora kryesore e politikës fiskale

Balanca primare është një parametër shumë i rëndësishëm i qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike, për të cilën, në korrik të 2020-s u ndërmor një tjetër iniciativë ligjore, duke përfshirë një rregull të ri fiskal në LOB, në linjë edhe me rekomandimet e KE-së dhe me parimet kryesore të *acquis* të BE-së, i cili bën të detyrueshëm ligjërisht tashmë, që duke filluar që prej vitit buxhetor 2024 e në vijim, balanca primare faktike nuk mund të rezultojë negative, pra duhet të jetë së paku e balancuar ose pozitive (suficit primar). Ky target i




parametrit të balancës primare buxhetore do të përbëjë tashmë dhe në vijimësi objektivin kryesor operativ të politikës fiskale për të materializuar synimin e një trajektore vijimësisht rënësë të borxhit publik, pra duke synuar konsolidim të vijueshëm fiskal me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë së financave publike, si një fundament kyç i stabilitetit makroekonomik dhe mirëfunksionimit e përgjithshëm të ekonomisë së vendit.

Në të njëjtën kohë, krahas konsolidimit fiskal, ky kuadër synon të ruajë një raport të balancuar dhe të qëndrueshëm të shpenzimeve buxhetore korrente dhe kapitale, ku shpenzimet kapitale (pra, investimet publike) për periudhën 2027–2029 do targetohen të jenë mesatarisht rreth 6.0 për qind e PBB-së në çdo vit buxhetor. Kjo përfshin, gjithashtu, investimet e reja publike, të cilat mund të realizohen në kuadër të Planit të Ri të Rritjes të implementuar nga Bashkimi Evropian. Ky nivel i shpenzimeve kapitale tejkalon

qartë deficitin e përgjithshëm fiskal të periudhës, duke targetuar në këtë mënyrë në mënyrë konsistente një balancë fiskale korrente pozitive, në përputhje me “rregullën e artë” të buxhetit. Objektivat e politikës fiskale në KMF 2027–2029 janë në përputhje të plotë me parimet dhe rregullat fiskale të Ligjit Organik të Buxhetit (shih kuadratin shpjegues 2, në faqen 10).

Ky kuadër fiskal synon një deficit fiskal të përgjithshëm prej 1.6 përqindësh të PBB-së për 2027–ën, nga 2.3 për qind i programuar për vitin 2026; nivelin prej 1.3 përqindësh të PBB-së në vitin 2028 dhe 0.9 për qind në 2029–ën. Njëkohësisht, pasi tashmë e targetuar në një nivel neutral prej 0.0 përqindësh e PBB-së për vitin 2026 (sipas ligjit të buxhetit 2026), balanca primare në periudhën afatmesme do të targetohet në vijimësi në vlera pozitive, respektivisht 0.8 për qind e PBB-së për vitin 2027, në 1.0 për qind në vitin 2028 dhe 1.4 për qind në vitin 2029.



Duke marrë të mirëqena supozimet dhe projeksionet e tjera të KMF-së aktuale, respektimi në mënyrë të përvitshme i këtij objekti (rregulle fiskale) të parametrit të balancës primare, pritet të çojë në një reduktim të nivelit të borxhit publik bruto rreth nivelit prej 50.2 përqindësh të PBB-së deri në vitin 2029 nga rreth 54.1 për qind që pritet të rezultojë në 2025.



Kuadrat shpjegues 2: Mbi përputhshmërinë me Rregullat Fiskalë

Në përputhje të plotë me obligimet që rrjedhin prej ligjit organik të buxhetit (LOB) nr. 9936/2008, të ndryshuar, KMF 2027-2029 materializon parimet dhe rregullat fiskale të mëposhtme:

Rregulli i “Qëndrueshmërisë së borxhit”: Në çdo ligj vjetor të buxhetit, fillestar apo të rishikuar, si dhe në planifikimet e buxhetit afatmesëm, raporti i borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) do të planifikohet më i ulët se niveli i vlerësuar për vitin pararendës, deri atëherë kur niveli i borxhit të arrijë dhe të qëndrojë poshtë nivelit 45 për qind të PBB-së.

Në përputhje me këtë rregull fiskal të LOB-së, kuadri fiskal 2027 -2029 **targeton çdo vit një nivel të borxhit publik total në përqindje të PBB-së më të ulët se niveli i vitit pararendës.**

Rregulli i “Balancës primare”: Duke filluar që prej vitit buxhetor 2024 e në vijim, balanca primare buxhetore nuk mund të jetë negative; duhet të jetë së paku zero ose pozitive (tepricë primare).

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull të ri fiskal) të LOB, **kuadri fiskal për periudhën 2027 -2029 targeton një balancë primare pozitive prej 0.8 përqind në vitin 2027, 1.0 përqind në vitin 2028 dhe 1.4 përqind në vitin 2029.**

“Rregulli i artë”: Masa e deficitit buxhetor nuk mund të tejkalojë masën e shpenzimeve kapitale, të miratuara çdo vit në ligjin e buxhetit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal – “rregulli i artë”) të LOB, deficit i targetuar vjetor në këtë kuadër fiskal për periudhën 2027 -2029 është **çdo vit më i ulët se sa shpenzimet kapitale të planifikuara.** Rrjedhimisht, balanca fiskale korrente e targetuar është pozitive çdo vit mesatarisht +4.8 përqind e PBB-së.

Parashikime makroekonomike të kujdesshme: Vlera e Produktit të Brendshëm Bruto, nominale në lekë, e cila do të përdoret për llogaritjen e raportit të borxhit publik ndaj Produktit të Brendshëm Bruto për vitet buxhetore që planifikohen dhe për vitin pararendës, nuk mund të jetë më e lartë se vlera respektive e parashikuar ose vlerësuar në raportin “Perspektiva Ekonomike Botërore” (World Economic Outlook - WEO), të Fondit Monetar Ndërkombëtar, më i fundit i publikuar në kohën kur ligji vjetor i buxhetit dorëzohet për miratim në Kuvend. Kjo dokumentohet qartësisht në relacionin shoqërues të ligjit vjetor të buxhetit;

Në përputhje me rregullin fiskal të përcaktuar në Ligjin Organik të Buxhetit (LOB), Kuadri Makroekonomik e Fiskal 2027 -2029 mbështetet në projeksionet e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) nominal të cilat nuk janë më të mëdha krahasimisht me projeksionet respektive më të fundit të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN) të raportit “Perspektiva Ekonomike Botërore” (World Economic Outlook), të Tetorit 2025.

Parashikimet e PBB nominale të MFE dhe FMN

(në miliardë Lekë)

	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029
			<i>Para.</i>	<i>Para.</i>	<i>Para.</i>	<i>Para.</i>	<i>Para.</i>
MFE	2,364.3	2,517.8	2,642.5	2,781.4	2,925.0	3,081.9	3,241.2
FMN	2,364.3	2,517.8	2,662.0	2,828.7	3,016.5	3,214.7	3,427.4
Diferenca MFE - FMN (Diferenca e vlerave të parashikuara duhet të jetë jo më e madhe se zero)	0.0	0.0	-19.5	-47.2	-91.5	-132.8	-186.1

Planifikim kontigjence: Në çdo vit buxhetor të planifikuar duhet të përfshihet një kontigjencë e veçantë, prej jo më pak se 0.7 përqind e shpenzimeve totale të buxhetit, për të kompensuar rreziqe potenciale nga luhatjet në kurset e këmbimit ose normat e interesit, me ndikim në nivelin e borxhit.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, kuadri fiskal për periudhën 2027-2029 përfshin për çdo vit në një zë të veçantë të tij, emërtuar “Kontigjencë për luhatjet e normave të interesit, etj.” **një kontigjencë prej mbi 0.7 përqind e shpenzimeve totale.**

Të ardhurat nga privatizimi: Të ardhurat nga privatizimi nuk janë pjesë e procesit të programimit buxhetor. Në rast se arkëtohen, ato përdoren jo më pak se 50 për qind për uljen e borxhit publik dhe pjesa e mbetur për investime publike.

Në përputhje me këtë dispozitë (rregull fiskal) të LOB, kuadri fiskal për periudhën 2027 -2029 **nuk përfshin të hyra nga privatizimet e mundshme.**



3. Parashikimet e treguesve makroekonomikë dhe fiskalë

Metodologjia e parashikimeve makroekonomike

Parashikimi i treguesve makroekonomikë afatmesëm dhe i tërësisë së elementeve përbërëse të kuadrit makroekonomik është bazuar kryesisht në metodat modeluese dhe analitike të programimit financiar. Skenari bazë i kuadrit makroekonomik mbështetet në linjën aktuale të politikave makroekonomike, në linjën aktuale të politikave e reformave ekonomiko-strukture qeveritare, në sjelljen dhe në bashkëveprimin racional të agjentëve ekonomikë në kontekstin e ambientit të brendshëm e të jashtëm makroekonomik, i cili vlerësohet si më i mundshmi për periudhën afatmesme në vijim. Në kryerjen e këtyre parashikimeve janë ngritur një set supozimesh bazë, si dhe janë përdorur një set i gjerë të dhënash statistikore makroekonomike të gjeneruara prej institucioneve, si: INSTAT, BSH, MF, FMN, BB, Eurostat etj. Këto statistika janë kryesisht në formën e serive kohore me frekuencë vjetore, tremujore e mujore. Kohëzgjatja e tyre e marrë në konsideratë për ndërtimin e këtij kuadri është përgjithësisht që prej vitit 1996. Pasi janë ndjekur të gjitha etapat metodologjike të parashikimit, skenari bazë i përfutur synon të paraqesë situatën makroekonomike përgjithësisht më të mundshme për të ndodhur, dhe maksimalisht konsistente në aspektin e një ekonomie të plotë e integrale.

Objektivat themelorë të miksit të politikave fiskale e monetare përgjatë tre vjetëve në vijim, nëpërmjet të cilave synohet ruajtja dhe konsolidimi i mëtejshëm i stabilitetit makroekonomik të vendit, krijimi i klimës për një rritje të lartë e të qëndrueshme ekonomike, si dhe konvergimi sa më shpejt drejt nivelit mesatar të mirëqenies të Bashkimit Evropian, janë:

- Synimi i një trajektoreje rënëse të borxhit publik duke targetuar si objektiv operativ vjetor një balancë primare së paku neutrale (ose me suficit) në çdo vit buxhetor në vijimësi. Ky objektiv është ligjërsh i detyrueshëm në LOB.

- Mbajtja e një niveli të investimeve publike mbi nivelin e deficitit të përgjithshëm fiskal në çdo vit dhe mundësisht mbi nivelin 5 për qind të PBB-së, mesatarisht çdo vit.

- Ruajtja e stabilitetit të çmimeve, si objektivi themelor i politikës monetare, e cila targeton një

normë inflacioni në nivelin 3.0 për qind, në një periudhë afatmesme dhe ankorimin e pritshmërive të tij rreth këtij niveli. Harmonizmin e politikës fiskale me këtë objektiv themelor të politikës monetare, me qëllim për të mbështetur një rritje të qëndrueshme dhe afatgjatë ekonomike të vendit.


Zbutja e deficitit të llogarisë korrente dhe përmirësimi i pozicionit të jashtëm të ekonomisë duke tentuar rritjen graduale të nivelit të rezervave valutore, dhe duke ruajtur të paktën një nivel dysheme të tyre, të mjaftueshëm për të financuar jo më pak se 6 muaj import mallrash dhe shërbimesh.

Këta objektiva fundamentale përbëjnë konturet bazë të këtij kuadri makroekonomik e fiskal, brenda të cilave përcaktohen projeksionet dhe programohen të gjithë variablat e tjerë makroekonomikë e fiskalë.

Skenari makroekonomik e fiskal afatmesëm

Pas recesionit të fortë prej -3.3 përqindësh në vitin 2020, ekonomia u rimëkëmb fuqishëm në vitin 2021, duke shënuar rritje reale prej 9.0 përqindësh, dhe duke vijuar trendin pozitiv edhe gjatë viteve 2022–2024, përkatësisht në 4.8 për qind për vitin 2022 dhe 4.0 për qind për vitet 2023 dhe 2024. Për vitin 2025 kjo rritje vlerësohet të jetë rreth 3.9 për qind dhe pritet të vijoje trendin pozitiv edhe në periudhën afatmesme. Rritja ekonomike parashikohet në normën 4.0 për qind për vitin 2026 dhe përgjatë periudhës afatmesme në vijim 2027–2029 parashikohet mesatarisht rreth 3.9 për qind në vit. Më specifikisht, rritja ekonomike parashikohet në 3.9, 4.1 dhe 3.9 për qind respektivisht për vitet 2027, 2028 dhe 2029.

Gjatë periudhës afatmesme, rritja pritet të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi, ashtu edhe investimet. Ndërkohë, kërkesa e huaj neto (eksport-import) pritet të ketë një efekt të lehtë pozitiv. Konsumi privat parashikohet të jetë sërish nxitësi kryesor i rritjes së PBB-së, stimuluar kryesisht nga përmirësimi i besimit të konsumatorit, si dhe nga përmirësimi në tregun e punës. Këto të fundit priten të transmetohen në një rritje graduale të pagave, të cilat më tej pritet të stimulojnë të ardhurat reale të disponueshme të individëve, veçanërisht pas rikthimit në nivelet normale të inflacionit gjatë vitit 2024.



Ndërsa rritja graduale e investimeve pritet të nxitet nga një shfrytëzim më i intensifikuar i kapaciteteve ekzistuese të prodhimit, si dhe nga përsheptimi i aktivitetit ekonomik gjatë periudhës së parashikuar dhe perceptimi i përmirësuar i biznesit mbi perspektivën ekonomike afatmesme e afatgjatë. Njëkohësisht, edhe përmirësimi sërish i kushteve financiare dhe lehtësimi i standardeve të huadhënies gradualisht përgjatë afatit të mesëm priten të jenë faktorë të rëndësishëm incentivues i investimeve private.


Specifikisht, konsumi final total për periudhën afatmesme (2027–2029) parashikohet të rritet në terma realë me mesatarisht rreth 2.9 për qind në vit, duke kontribuar me mesatarisht rreth 2.3 pikë përqindjeje në vit në rritjen e PBB-së. Ndërsa,

investimet totale në ekonomi parashikohen të rriten në terma realë mesatarisht në rreth 4.9 për qind në vitet 2027–2029, me një kontribut mesatar në rritjen totale prej rreth 1.2 pikë përqindjeje në vit.

Kërkesa e huaj neto pritet të ketë një kontribut pozitiv të moderuar në periudhën afatmesme. Eksportet e mallrave, të cilat zakonisht kanë pasur performancë të mirë në vite, priten të vazhdojnë këtë trend pozitiv dhe të ruajnë ritmet e kaluara. Eksportet e shërbimeve, veçanërisht shërbimet turistike, priten, gjithashtu, të kenë performancë pozitive në periudhën afatmesme dhe të jenë elementi kryesor për të kompensuar kontributin negativ të ardhur prej rritjes së importeve.

Sa i takon, më specifikisht, komponentëve të kërkesës së huaj neto, eksportet e mallrave dhe të shërbimeve për periudhën 2027–2029, parashikohen të rriten me mesatarisht rreth 4.6 për qind në vit në terma realë, me një kontribut mesatar pozitiv prej rreth 1.7 pikë përqindjeje në vit në rritjen e PBB-së. Ndërsa importet e mallrave dhe të shërbimeve për këtë periudhë afatmesme parashikohen të zgjerohen me mesatarisht rreth 3.0 për qind në vit, me një kontribut mesatar negativ në rritjen e PBB-së me rreth 1.3 pikë përqindjeje në vit. Rrjedhimisht, në terma neto, kërkesa e huaj parashikohet të ketë një kontribut të moderuar pozitiv në rritjen totale të PBB-së, me mesatarisht rreth 0.4 pikë përqindjeje në vit.

Grafik 3.1: Rritja reale (majtas, në përqindje) dhe kontributet në rritje (djathtas, në p.p.), sipas komponentëve të kërkesës agregate




Burimi: Ministria e Financave

Megjithëse politika fiskale do të vazhdojë të jetë e orientuar drejt konsolidimit në periudhën afatmesme dhe afatgjatë, objektivi tjetër i kësaj politike fiskale për të ruajtur një nivel relativisht të lartë të investimeve publike në mbi 5 për qind të PBB-së në vitet 2027–2029, do të stimulojë formimin e kapitalit fiks bruto në ekonomi, esenciale kjo për të mbështetur nivele relativisht të larta e të qëndrueshme të rritjes ekonomike në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

Konsolidimi fiskal i synuar nga qeveria do të kufizojë kërkesën e përgjithshme të sektorit publik. Si i tillë, nuk pritet të jetë një nxitës i rritjes në periudhën afatmesme. Megjithatë, konsolidimi fiskal do të ulë primin e riskut për financat publike dhe ekonominë në tërësi dhe do të rrisë hapësirat për zgjerimin e aktivitetit në sektorin privat, fundamente mjaft të rëndësishme këto për sigurimin e një rritjeje të lartë e të qëndrueshme në periudhën afatmesme dhe afatgjatë.

Nga pikëpamja e ofertës agregate pritet që të gjithë sektorët kryesorë të vazhdojnë të rriten pak a shumë me të njëjtin trend të mesatares së tyre historike. Specifikisht: bujqësia pritet të rritet mesatarisht me rreth 0.2 për qind në vit në terma realë përgjatë periudhës 2027–2029, duke mos kontribuar pothuajse fare në rritjen ekonomike; industria, me një rritje mesatare vjetore prej rreth 2.6 përqindësh dhe një kontribut mesatar vjetor prej rreth 0.2 pikë përqindjeje; ndërtimi, me rritje mesatare vjetore prej rreth 3.1 përqindësh dhe kontribut mesatar vjetor prej rreth 0.4 pikë përqindjeje; shërbimet, me një rritje mesatare vjetore prej rreth 5.4 përqindësh dhe një kontribut mesatar vjetor prej rreth 2.7 pikë përqindjeje.


Grafik 3.2: Rritja reale (majtas, në përqindje) dhe kontributet në rritje (djathtas, në p.p.), sipas komponentëve të ofertës agregate



Burimi: Ministria e Financave

Në përputhje me parashikimet afatmesme të rritjes, punësimi pritet të rritet me një mesatare prej rreth 0.1 përqindësh në vit gjatë viteve 2027–2029. Shkalla më e lartë e pjesëmarrjes në forcat e punës do të jetë gjeneruesi kryesor i rritjes së ofertës së punës, ndërkohë që trendet negative demografike (të vërejtura prej disa vjetësh tashmë) pritet të vijojnë të kenë efekte shtrënguese, si në ofertën për punë, ashtu edhe në numrat agregatë të punësimit përgjatë periudhës afatmesme në vijim.

Grafik 3.3: Punësimi (në të majtë, rritja vjetore në përqindje) dhe norma e papunësisë (në të djathtë, në përqindje)



Burimi: Ministria e Financave


Ndërsa rritja e kërkesës për punë pritet të reflektojë dinamikën e perspektivës afatmesme të sektorëve kryesorë të aktivitetit ekonomik, të përmendur më sipër. Rrjedhimisht, pritet që shërbimet të kontribuojnë më shumë në rritjen e kërkesës për punë në krahasim me sektorët e tjerë të ekonomisë. Ndërkohë, pritet që punësimi në afatin e mesëm të jetë së paku jo në rritje negative (në nivele mjaft të moderuara, por gjithsesi ende pozitiv), në reflektim të efekteve të kundërta të rritjes së shkallës së pjesëmarrjes në forcat e punës nga njëra anë dhe trendeve negative demografike nga ana tjetër. Në të njëjtën kohë, pritet që produktiviteti i përgjithshëm i punës të vijojë një përmirësim të konsiderueshëm gjatë kësaj periudhe dhe të jetë një faktor i rëndësishëm i gjenerimit të rritjes ekonomike në afatin e mesëm. Kjo, duke reflektuar si vijimin e lëvizjeve të forcave të punës drejt sektorëve me produktivitet relativ më të lartë se të tjerët, ashtu edhe në reflektim të vijimit të përmirësimeve teknologjike ekonomike, përfshirë këtu patjetër edhe vijimësinë e përmirësimeve infrastrukturore dhe vijimësinë e reformave strukturore.

Në skenarin bazë parashikohet (supozohet) se inflacioni do të rikthehet drejt targetit të tij prej 3 përqindësh gjatë vitit 2026 dhe do të qëndrojë rreth këtij niveli për periudhën afatmesme 2027–2029.

Parashikimet për treguesit kryesorë makroekonomikë paraqiten në lidhjen nr.1 bashkëngjitur VKM-së.

Bazuar mbi parashikimet e treguesve kryesorë makroekonomikë, reformave dhe ndryshimeve fiskale (tatimore) të ndërmarra dhe, veçanërisht, ato të pritshme për t'u ndërmarrë në vijim, si dhe të faktorëve të tjerë përcaktues në ecurinë e zërave të ndryshëm të të ardhurave të buxhetit të shtetit, të ardhurat totale të buxhetit për tre vjetët në vijim (2027–2029) parashikohet të rriten mesatarisht me rreth 5.1 për qind në çdo vit. Më specifikisht, 5.8 për qind për vitet 2027 dhe 2028 dhe 3.9 për qind për vitin 2029. Ndërsa të ardhurat tatimore për këtë periudhë parashikohen me një rritje mesatare vjetore prej rreth 5.5 përqindësh.

Grafik 3.4: Të ardhurat (majtas në miliardë lekë, djathtas në përqindje të PBB-së)




Burimi: Ministria e Financave

Duke qëndruar brenda kontureve të parashikimeve të treguesve makroekonomikë dhe të të ardhurave për tre vjetët në vijim, si dhe duke synuar respektimin e objektivave kryesorë të sipërpërmendur të politikës fiskale për këtë periudhë (balanca primare, deficitin fiskal, borxhi publik), burimet totale të qeverisë për t'u shpenzuar gjatë viteve 2027–2029 pritet të jenë mesatarisht në rreth 954.3 miliardë lekë në çdo vit ose mesatarisht rreth 31.0 për qind e PBB-së. Investimet publike janë programuar të mbahen në një nivel mesatarisht prej rreth 6.0 përqindësh të PBB-së në çdo vit (vetëm nga qeveria qendrore, pa përfshirë ato nga qeveria lokale), i cili konsiderohet një nivel i përshtatshëm për mbështetjen e një rritje ekonomike të lartë e të qëndrueshme.



Grafik 3.5: Shpenzimet (majtas në miliardë lekë, djathtas në përqindje të PBB-së)



Burimi: Ministria e Financave

Parashikimet e të ardhurave sipas zërave të buxhetit të konsoliduar, si dhe niveli i shpenzimeve të shpërndara sipas zërave të buxhetit të konsoliduar paraqiten në lidhjet nr. 2/1 dhe nr. 2/2 bashkëngjitur VKM-së, respektivisht në terma nominalë dhe në raport me PBB-në.

Lidhja nr. 1 – Treguesit kryesorë makroekonomikë

Treguesit kryesorë makroekonomikë

Treguesit	Njësia	2022	2023	2024	2025 Vler.	2026 Para.	2027 Para.	2028 Para.	2029 Para.
Popullsia	Milion	2.4	2.4	2.4	2.4	2.4	2.4	2.4	2.3
Inflacioni (mesatar)	%	6.7	4.8	2.2	2.3	3.0	3.0	3.0	3.0
Deflatori i PBB	%	9.9	5.7	2.4	1.1	1.3	1.3	1.3	1.3
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / USD	113.0	100.6	93.1	88.3	88.3	88.3	88.3	88.3
Kursi i këmbimit (mesatar)	Lek / Euro	119.0	108.8	100.7	98.3	98.3	98.3	98.3	98.3
Faktori i Konvertimit sipas Paritetit të Fuqisë Blerese (PPP)	Lek / USD	39.8	40.6	39.7	39.7	39.7	39.7	39.7	39.7
Faktori i Konvertimit sipas Paritetit të Fuqisë Blerese (PPP)	Lek / Euro	64.2	63.2	63.2	63.2	63.2	63.2	63.2	63.2
Rritja reale e PBB	%	4.8	4.0	4.0	3.9	4.0	3.9	4.1	3.9
PBB	Lek miliardë	2,149.7	2,364.3	2,517.8	2,642.5	2,781.4	2,925.0	3,081.9	3,241.2
PBB	USD miliardë	19.0	23.5	27.0	29.9	31.5	33.1	34.9	36.7
PBB	Euro miliard	18.1	21.7	25.0	26.9	28.3	29.7	31.3	33.0
PBB për banor	Lek mijë	879.6	984.2	1,051.5	1,107.4	1,170.3	1,236.2	1,308.2	1,381.7
PBB për banor	USD	7,781.1	9,779.4	11,294.9	12,540.5	13,252.4	13,998.5	14,813.7	15,645.9
PBB për banor	Euro	7,392.7	9,046.4	10,440.2	11,260.5	11,899.7	12,569.6	13,301.6	14,048.8
PBB për banor	USD-PPP	22,101.0	24,249.2	26,498.6	27,909.5	29,493.7	31,154.2	32,968.5	34,820.5
PBB për banor	Euro-PPP (EU=27)	13,708.9	15,581.9	16,625.8	17,511.0	18,505.0	19,546.8	20,685.1	21,847.2
Shkalla e papunësisë (15-64 vjec)	%	11.3	10.1	9.4	9.2	9.0	8.8	8.5	8.3
Shkalla e papunësisë (15+ vjec)	%	10.9	9.5	8.5	7.8	7.6	7.4	7.1	6.9
Të ardhurat totale	% të PBB	26.6	27.2	28.2	29.1	29.6	29.8	29.9	29.5
Shpenzimet totale	% të PBB	30.3	28.5	28.9	31.4	31.9	31.3	31.1	30.4
Bilanci i përgjithshëm	% të PBB	-3.6	-1.3	-0.7	-2.3	-2.3	-1.6	-1.3	-0.9
Bilanci primar fiskal	% të PBB	-1.8	0.7	1.4	0.0	0.0	0.8	1.0	1.4
Bilanci korrent fiskal	% të PBB	1.6	3.7	3.9	3.8	4.2	4.8	5.0	4.6
Borxhi publik NETO nga gjendja e likuiditetit në TSA (Neto)	% të PBB	63.5	55.6	51.9	51.8	51.8	50.9	49.8	48.4
Borxhi Publik (Bruto)	% të PBB	64.1	57.6	54.2	54.1	53.6	52.2	51.0	50.2
Borxhi publik i qeverisë së përgjithshme	% të PBB	61.7	55.9	52.9	52.8	52.1	50.7	49.3	48.5
I Brendshëm	% të PBB	33.2	30.7	30.7	31.2	31.2	30.7	30.0	29.9
I Huaj	% të PBB	28.5	25.2	22.1	21.6	20.9	19.9	19.3	18.6
Borxhi publik jashtë treguesve fiskale	% të PBB	2.4	1.8	1.3	1.3	1.5	1.5	1.7	1.7
Bilanci i llogarisë korrente	% të PBB	-5.9	-1.2	-2.4	-2.2	-3.5	-3.3	-3.2	-3.6
Bilanci tregtar (Mallra & Shërbime)	% të PBB	-10.3	-5.4	-6.9	-6.7	-7.2	-6.8	-6.5	-6.6
Mallra	% të PBB	-23.6	-20.9	-22.4	-21.9	-22.3	-22.0	-21.9	-21.9
Eksporte	% të PBB	10.7	8.4	6.7	7.4	7.5	7.6	7.7	7.7
Importe	% të PBB	-34.3	-29.3	-29.1	-29.4	-29.9	-29.7	-29.6	-29.6
Bilanci i pagesave	% të PBB	-0.4	4.3	1.1	3.1	1.3	0.9	1.4	1.0
Rezervat valutore	Euro milion	4,952.1	5,888.9	6,152.6	6,983.6	7,362.9	7,622.6	8,053.9	8,390.4
Në muaj importi mallrash e shërbimesh	Muaj	6.9	7.4	6.8	7.1	7.1	7.0	7.0	7.0

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave, Banka Botërore, Eurostat



Lidhja nr. 2/1 – Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (në milionë lekë)

Nr.	E M Ë R T I M I	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029
					I Pritshmi	Buxheti	PBA	PBA	PBA
	TOTALI TË ARDHURAVE	572,790	643,678	710,328	769,005	823,057	870,568	920,635	956,308
I.	Ndihmat, nga të cilat:	9,510	22,431	7,797	19,161	20,249	25,297	27,901	18,518
	<i>prej New Growth Plan</i>				561	3,649	8,697	11,251	1,868
II.	Të ardhura tatimore	541,342	598,662	658,847	718,102	773,035	815,149	862,342	907,247
II.1	Nga tatimet dhe doganat	390,893	422,491	456,965	499,621	531,137	560,673	593,844	624,526
II.2	Të ardhura nga pushteti lokal	27,638	31,686	40,331	40,774	43,931	46,344	49,252	52,194
II.3	Të ardhura nga fondet speciale	122,811	144,485	161,551	177,707	197,967	208,132	219,246	230,527
III.	Të ardhura jo-tatimore	21,938	22,585	43,684	31,743	29,773	30,123	30,393	30,543
	TOTALI I SHPENZIMEVE	651,015	674,857	728,572	830,065	886,764	916,394	959,966	986,454
I.	Shpenzime Korrente	499,989	547,039	606,289	662,246	704,441	725,767	763,386	800,672
I.1	Personeli	84,696	100,476	112,699	128,747	140,140	140,379	150,065	153,905
	Paga	72,103	85,945	96,235	109,518	119,463	119,694	120,257	115,707
	Kontributi për sigurime shoqërore	11,784	13,537	15,417	17,829	19,177	19,185	19,384	19,734
	Fondi i veçantë i pagave				400	500	500	500	600
	Indeksimi i pagave							8,924	16,764
	Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta	808	995	1,047	1,000	1,000	1,000	1,000	1,100
I.2	Interesat	39,624	47,591	54,459	61,694	64,206	68,235	71,343	74,627
	Të brendshme	24,210	29,030	33,118	35,600	35,153	37,942	40,151	42,191
	Të huaja	15,414	18,561	21,341	20,244	22,753	23,743	24,442	25,487
	Kontingjencë për risqet e borxhit				5,850	6,300	6,550	6,750	6,950
I.3	Shpenzime operative e mirëmbajtje	68,505	70,489	80,208	80,786	84,605	81,655	82,248	85,735
	Të qeverisjes qendrore (operative & mirëmbajtje)			80,208	77,036	80,705	77,655	78,148	81,485
	Arsimi i lartë				1,000	1,000	1,000	1,000	1,050
	Të tjera jashtë limitit				2,750	2,900	3,000	3,100	3,200
I.4	Subvencionet	1,650	1,906	1,794	1,950	2,450	2,450	2,450	2,580
I.5	Shpenzime për fondet speciale	216,515	226,788	251,791	271,009	286,573	301,394	319,864	340,098
	Sigurime shoqërore	163,037	170,239	188,626	194,038	204,088	214,138	224,438	234,722
	Politika të reja pensionesh				1,140	1,653	1,753	2,673	3,803
	Bonusi i pensionistit				9,700	10,000	15,000	20,500	26,000
	Sigurime shëndetësore	52,244	55,213	58,771	63,132	67,332	67,003	68,253	69,373
	Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve	1,234	1,336	4,394	3,000	3,500	3,500	4,000	6,200
I.6	Buxheti lokal	58,694	68,841	74,407	89,911	97,767	101,934	107,016	111,927
	Transferta nga Buxheti i Shtetit për pushtetin vendor	29,257	33,191	37,058	43,411	47,315	49,040	50,864	52,632
	Transfertë e pakushtëzuar e përgjithshme				26,282	27,814	29,250	30,819	32,412
	Transferte sektoriale për pagat, etj.				13,429	19,501	19,790	20,045	20,220
	Buxheti lokal (të ardhurat e veta tatimore)	28,198	34,905	36,907	40,774	43,931	46,344	49,252	52,194
	Taksa të ndara				1,700	1,820	1,850	2,000	2,100
	Buxheti lokal (të ardhurat e veta jo-tatimore)				3,000	3,200	3,200	3,400	3,500
	Financimi i huaj vendor dhe të tjera të mbartura	676	530	262	1,026	1,500	1,500	1,500	1,500
	Shpenzime nga të ardhura të paplanifikuara (kap6/te m)	563	215	180					
I.7	Transferta të tjera	30,306	30,948	30,931	28,150	28,700	29,720	30,400	31,800
	Pagesa e papunësisë	746	858	832	800	1,000	1,020	1,100	1,100
	Ndihma ekonomike dhe politika e femijeve, etj	25,464	25,686	26,841	23,700	23,900	24,400	24,800	25,200
	Kompensim për të përndjekurit politikë	996	1,098	1,059	1,400	1,500	2,000	2,000	3,000
	Bonusi i lindjeve	3,100	3,306	2,200	2,250	2,300	2,300	2,500	2,500
II.	Fondi rezervë	0	0	0	5,400	2,500	5,500	3,000	6,500
	Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave				2,900	2,500	3,000	3,000	4,000
	Rezerve për zgjedhjet				2,500		2,500		2,500
III.	Shpenzime kapitale	112,119	119,053	115,433	162,419	179,823	185,127	193,580	179,281
	Financimi i brendshëm	63,675	88,489	88,903	117,274	126,811	118,122	120,819	117,504
	Nga e cila: Injektivim/Kthim kapitali nga AIC/BZHS					1,000	2,000	3,000	4,000
	Investime nga të ardhurat e Arsimit të Lartë	892	602	832	1,000	1,000	1,000	1,000	1,000
	Financimi i huaj, nga të cilat:	18,676	13,761	17,427	39,144	47,012	64,505	71,761	60,778
	<i>prej New Growth Plan</i>				1,044	6,800	16,205	20,964	3,481
	Fondi i ri-ndërtimit pas tërmetit:	28,877	16,201	8,271	5,000	5,000	1,500		
	Fondi i ri-ndërtimit pas tërmetit (buxheti i shtetit)	28,877	16,201	8,271	5,000	5,000	1,500		
V.	Të tjera	27,907	3,766	550	0	0	0	0	0
	Hua e dhene për sis. energj. e të tjera nga burimet e br.	7,907			0	0	0	0	0
	Mbështetje buxhetore për sektorin energjistik	20,000			0	0	0	0	0
VI.	Fond shpronësimi	11,000	5,000	0	0	0	0	0	0
VII.	Transferte për Llogarinë e Fondit të Pensioneve në BSH	0	0	6,300	0	0	0	0	0
	DEFICITI	-78,226	-31,180	-18,243	-61,060	-63,707	-45,826	-39,330	-30,146
	FINANCIMI DEFICITIT	78,226	31,180	18,243	61,060	63,707	45,826	39,330	30,146
I.	I brendshëm	87,765	-7,324	33,619	48,189	53,433	42,998	28,581	21,172
	Të ardhura nga privatizimi	191	47	27					
	Hua-marrje e brendshme (neto)	26,156	20,671	49,718	50,000	45,000	30,000	25,000	45,000
	Të tjera, nga të cilat:	61,417	-28,043	-16,126	-1,811	8,433	12,998	3,581	-23,828
	Ndryshimi i gjendjes së likuiditetit në TSA	41,467	-41,046	-24,720	-1,811	8,433	12,998	3,581	-23,828
II.	I huaj	-9,539	38,504	-15,376	12,871	10,274	2,827	10,749	8,973
	Hua afatgjatë (e marrë)	11,140	72,476	12,968	87,936	29,262	90,882	105,419	44,810
	Për projekte, nga të cilat:	11,140	9,703	12,968	23,484	28,262	40,708	45,410	43,810
	<i>prej New Growth Plan</i>				484	3,151	7,508	9,713	1,613
	Eurobond		61,668		63,926		49,174	59,009	
	Nën-hua (Pushteti vendor)	676	530	262	526	1,000	1,000	1,000	1,000
	Ndryshimi i gjendjes së arkës	589	51	-256					
	Ripagesat	-38,386	-53,238	-40,453	-93,753	-36,691	-97,890	-94,670	-35,836
	Eurobond		-13,670		-36,094		-63,926	-59,009	
	Maturim				-36,094		-63,926	-59,009	
	Para-blerje		-13,670						
	Mbështetje buxhetore (hua nga FMN, BB, BE, etj)	17,117	19,215	12,366	18,687	17,703	9,835		
	MEMO:								
	Balancë e përgjithshme (deficiti përgjithshëm)	-78,226	-31,180	-18,243	-61,060	-63,707	-45,826	-39,330	-30,146
	Balancë korente	33,893	87,873	97,190	101,359	116,116	139,301	154,250	149,136
	Balancë primare	-38,602	16,411	36,216	634	499	22,409	32,013	44,482
	Gjendja e likuiditetit në TSA (stok)	14,504	48,419	58,440	60,251	51,818	38,819	35,238	59,066
	Borxhi publik NETO nga gjendja e likuiditetit në TSA	1,364,121	1,314,408	1,306,565	1,369,278	1,440,344	1,488,423	1,536,271	1,569,125
	Borxhi publik BRUTO (stok)	1,378,626	1,362,828	1,365,005	1,429,529	1,492,162	1,527,242	1,571,509	1,628,191
	Borxhi publik nga buxheti (stok)	1,326,201	1,321,390	1,331,395	1,394,266	1,449,540	1,482,367	1,518,117	1,572,090
	I brendshëm (stok)	712,779	725,399	774,197	824,197	869,197	899,197	924,197	969,197
	I huaj (stok)	613,421	595,991	557,198	570,069	580,343	583,170	593,919	602,893
	Borxhi publik jashtë buxhetit (stok)	52,425	41,438	33,609	35,263	42,621	44,875	53,393	56,101
	Pushteti vendor (stok)	204	101	24	900	900	1,000	1,000	1,000
	Borxhi publik i garantuar (stok)	52,221	41,337	33,585	34,363	41,721	43,875	52,393	55,101
	PBB nominal	2,149,742	2,364,276	2,517,820	2,642,509	2,781,433	2,924,988	3,081,927	3,241,224

Burimi: Ministria e Financave



Lidhja nr. 2/2 – Treguesit fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar (në përqindje të PBB-së)

Nr.	E M È R T I M I	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029
					I Pritshmi	Buxheti	PBA	PBA	PBA
	TOTALI TË ARDHURAVE	26.6	27.2	28.2	29.1	29.6	29.8	29.9	29.5
I.	Ndihmat, nga të cilat:	0.4	0.9	0.3	0.7	0.7	0.9	0.9	0.6
	<i>prej New Growth Plan</i>			0.0	0.0	0.1	0.3	0.4	0.1
II.	Të ardhura tatimore	25.2	25.3	26.2	27.2	27.8	27.9	28.0	28.0
II.1	<i>Nga tatimet dhe doganat</i>	18.2	17.9	18.1	18.9	19.1	19.2	19.3	19.3
II.2	<i>Të ardhura nga pushteti lokal</i>	1.3	1.3	1.6	1.5	1.6	1.6	1.6	1.6
II.3	<i>Të ardhura nga fondet speciale</i>	5.7	6.1	6.4	6.7	7.1	7.1	7.1	7.1
III.	Të ardhura jo-tatimore	1.0	1.0	1.7	1.2	1.1	1.0	1.0	0.9
	TOTALI I SHPENZIMEVE	30.3	28.5	28.9	31.4	31.9	31.3	31.1	30.4
I.	Shpenzime Korrente	23.3	23.1	24.1	25.1	25.3	24.8	24.8	24.7
I.1	Personeli	3.9	4.2	4.5	4.9	5.0	4.8	4.9	4.7
	<i>Paga</i>	3.4	3.6	3.8	4.1	4.3	4.1	3.9	3.6
	<i>Kontributi për sigurime shoqërore</i>	0.5	0.6	0.6	0.7	0.7	0.7	0.6	0.6
	<i>Fondi i veçantë i pagave</i>				0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	<i>Indeksi i pagave</i>							0.3	0.5
	<i>Arsimi i lartë nga të ardhurat e veta</i>	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
I.2	Interesat	1.8	2.0	2.2	2.3	2.3	2.3	2.3	2.3
	<i>Të brendshme</i>	1.1	1.2	1.3	1.3	1.3	1.3	1.3	1.3
	<i>Të huaja</i>	0.7	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8	0.8
	<i>Kontingjencë për risqet e borxhit</i>				0.2	0.2	0.2	0.2	0.2
I.3	Shpenzime operative e mirëmbajtje	3.2	3.0	3.2	3.1	3.0	2.8	2.7	2.6
	<i>Të qeverisjes qendrore (operative & mirëmbajtje)</i>	0.0	0.0	3.2	2.9	2.9	2.7	2.5	2.5
	<i>Arsimi i lartë</i>	0.0	0.0		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	<i>Të tjera jashtë limitit</i>	0.0	0.0		0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
I.4	Subvencionet	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
I.5	Shpenzime për fondet speciale	10.1	9.6	10.0	10.3	10.3	10.3	10.4	10.5
	<i>Sigurime shoqërore</i>	7.6	7.2	7.5	7.3	7.3	7.3	7.3	7.2
	<i>Politika të reja pensionesh</i>				0.0	0.1	0.1	0.1	0.1
	<i>Bonusi i pensionistit</i>				0.4	0.4	0.5	0.7	0.8
	<i>Sigurime shëndetësore</i>	2.4	2.3	2.3	2.4	2.4	2.3	2.2	2.1
	<i>Shpenzime për kompensimin në vlerë të pronarëve</i>	0.1	0.1	0.2	0.1	0.1	0.1	0.1	0.2
I.6	Buxheti lokal	2.7	2.9	3.0	3.4	3.5	3.5	3.5	3.5
	<i>Transferta nga Buxheti i Shtetit për pushtetin vendor</i>	1.4	1.4	1.5	1.6	1.7	1.7	1.7	1.6
	<i>Transferte e pakushtëzuar e përgjithshme</i>	0.0	0.0		1.0	1.0	1.0	1.0	1.0
	<i>Transferte e pakushtëzuar sektoriale (Grant Specific)</i>	0.0	0.0		0.5	0.7	0.7	0.7	0.6
	<i>Transferte sektoriale për pagat, etj.</i>	0.0	0.0		0.1				
	<i>Buxheti lokal (të ardhurat e veta tatimore)</i>	1.3	1.5	1.5	1.5	1.6	1.6	1.6	1.6
	<i>Taksa të ndara</i>	0.0	0.0		0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
	<i>Buxheti lokal (të ardhurat e veta jo-tatimore)</i>	0.0	0.0		0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
	<i>Financimi i huaj vendor dhe të tjera të mbartura</i>	0.0	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.0	0.0
I.7	Transferta të tjera	1.4	1.3	1.2	1.1	1.0	1.0	1.0	1.0
	<i>Pagesa e papunësisë</i>	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	<i>Ndihma ekonomike dhe politike e femijeve, etj</i>	1.2	1.1	1.1	0.9	0.9	0.8	0.8	0.8
	<i>Kompensim për të përndjekurit politikë</i>	0.0	0.0	0.0	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
	<i>Bonusi i lindjeve</i>	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
II.	Fondi rezervë	0.0	0.0	0.0	0.2	0.1	0.2	0.1	0.2
	<i>Fondi rezervë i Këshillit të Ministrave</i>				0.1	0.1	0.1	0.1	0.1
	<i>Rezerve për zgjedhjet</i>				0.1		0.1		0.1
III.	Shpenzime kapitale	5.2	5.0	4.6	6.1	6.5	6.3	6.3	5.5
	<i>Financimi i brendshëm</i>	3.0	3.7	3.5	4.4	4.6	4.0	3.9	3.6
	<i>Nga e cila: Injektivim/Kthim kapitali nga AIC/BZSH</i>	0.0	0.0	0.0		0.0	0.1	0.1	0.1
	<i>Investime nga të ardhurat e Arsimit të Lartë</i>	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	<i>Financimi i huaj, nga të cilat:</i>	0.9	0.6	0.7	1.5	1.7	2.2	2.3	1.9
	<i>prej New Growth Plan</i>	0.0	0.0		0.0	0.2	0.6	0.7	0.1
	<i>Fondi i ri-ndërtimit pas tërmetit:</i>	1.3	0.7	0.3	0.2	0.2	0.1		
	<i>Fondi i ri-ndërtimit pas tërmetit (buxheti i shtetit)</i>	1.3	0.7	0.3	0.2	0.2	0.1		
V.	Të tjera	1.3	0.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	<i>Hua e dhene për sis. energj. e të tjera nga burimet e brendshme</i>	0.4	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	<i>Mbështetje buxhetore për sektorin energjistik</i>	0.9	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
VI.	Fond shpronësimi	0.5	0.2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
VII.	Transferte për Llogarinë e Fondit të Pensioneve në BSH								
	DEFIÇITI	-3.6	-1.3	-0.7	-2.3	-2.3	-1.6	-1.3	-0.9
	FINANCIMI DEFIÇITIT	3.6	1.3	0.7	2.3	2.3	1.6	1.3	0.9
I.	I brendshëm	4.1	-0.3	1.3	1.8	1.9	1.5	0.9	0.7
	<i>Të ardhura nga privatizimi</i>	0.0	0.0	0.0					
	<i>Hua-marrje e brendshme (neto)</i>	1.2	0.9	2.0	1.9	1.6	1.0	0.8	1.4
	<i>Të tjera, nga të cilat:</i>	2.9	-1.2	-0.6	-0.1	0.3	0.4	0.1	-0.7
	<i>Ndryshimi i gjendjes së likuiditetit në TSA</i>	1.9	-1.7	-1.0	-0.1	0.3	0.4	0.1	-0.7
II.	I huaj	-0.4	1.6	-0.6	0.5	0.4	0.1	0.3	0.3
	<i>Hua afatgjatë (e marrë)</i>	0.5	3.1	0.5	3.3	1.1	3.1	3.4	1.4
	<i>Per projekte, nga të cilat:</i>	0.5	0.4	0.5	0.9	1.0	1.4	1.5	1.4
	<i>prej New Growth Plan</i>			0.0	0.0	0.1	0.3	0.3	0.0
	<i>Eurobond</i>	0.0	2.6	0.0	2.4		1.7	1.9	
	<i>Nen-hua (Pushteti vendor)</i>	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	<i>Ndryshimi i gjendjes së arkës</i>	0.0	0.0	0.0					
	<i>Ripagesat</i>	-1.8	-2.3	-1.6	-3.5	-1.3	-3.3	-3.1	-1.1
	<i>Eurobond</i>	0.0	-0.6	0.0	-1.4		-2.2	-1.9	
	<i>Maturim</i>	0.0	0.0	0.0	-1.4		-2.2	-1.9	
	<i>Para-blerje</i>	0.0	-0.6	0.0					
	<i>Mbështetje buxhetore (hua nga FMN, BB, BE, etj)</i>	0.8	0.8	0.5	0.7	0.6	0.3		
	MEMO:								
	Balanca e përgjithshme (deficitit përgjithshëm)	-3.6	-1.3	-0.7	-2.3	-2.3	-1.6	-1.3	-0.9
	Balanca korente	1.6	3.7	3.9	3.8	4.2	4.8	5.0	4.6
	Balanca primare	-1.8	0.7	1.4	0.0	0.0	0.8	1.0	1.4
	Gjendja e likuiditetit në TSA (stok)	0.7	2.0	2.3	2.3	1.9	1.3	1.1	1.8
	Borxhi publik NETO nga gjendja e likuiditetit në TSA (s)	63.5	55.6	51.9	51.8	51.8	50.9	49.8	48.4
	Borxhi publik BRUTO (stok)	64.1	57.6	54.2	54.1	53.6	52.2	51.0	50.2
	<i>Borxhi publik nga buxheti (stok)</i>	61.7	55.9	52.9	52.8	52.1	50.7	49.3	48.5
	<i>I brendshëm (stok)</i>	33.2	30.7	30.7	31.2	31.2	30.7	30.0	29.9
	<i>I huaj (stok)</i>	28.5	25.2	22.1	21.6	20.9	19.9	19.3	18.6
	<i>Borxhi publik jashtë buxhetit (stok)</i>	2.4	1.8	1.3	1.3	1.5	1.5	1.7	1.7
	<i>Pushteti vendor (stok)</i>	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
	<i>Borxhi publik i garantuar (stok)</i>	2.4	1.7	1.3	1.3	1.5	1.5	1.7	1.7
	PBB nominal	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

Burimi: Ministria e Financave



VENDIM

Nr. 12, datë 15.1.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 1039, DATË 4.12.2013, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR
FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT
KOMBËTAR TË PUNËS DHE PËR
CAKTIMIN E PËRFAQËSUESVE TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE NË KËTË
KËSHILL”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 200, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1039, datë 4.12.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Punës dhe për caktimin e përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave në këtë këshill”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. KKP-ja kryesohet nga ministri përgjegjës për çështjet e punës dhe ka në përbërje, si përfaqësues të Këshillit të Ministrave, këta anëtarë:

- a) Ministrin e Financave;
- b) Ministrin e Drejtësisë;
- c) Ministrin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;
- ç) Ministrin e Arsimit;
- d) Ministrin e Turizmit, Kulturës dhe Sportit;
- dh) Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë;

Përfaqësues kandidatë të KKP-së, në mungesë të përfaqësuesve, anëtarë të Këshillit të Ministrave, janë zëvendësministrat përkatës.”

2. Në pikën 9 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në shkronjën “b” bëhen këto ndryshime:

i. Fjalja hyrëse ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Komisioni i punësimit, arsimit dhe formimit profesional kryesohet nga drejtori i Drejtorisë së Politikave të Punësimit dhe Migratore në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:”

ii. Nënndarja “i” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“i. Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, përgjegjësi i sektorit të PAP-së;”

b) Në shkronjën “c” bëhen këto ndryshime:

i. Fjalja hyrëse ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Komisioni i pagave, pensione dhe përkrahjes sociale kryesohet nga drejtori i Drejtorisë së Politikave të Sigurimeve Shoqërore në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:”

ii. Nënndarja “i” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“i. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, përgjegjësi i sektorit që mbulon çështjet për mbrojtjen sociale.”

c) Në shkronjën “ç” bëhen këto ndryshime:

i. Fjalja hyrëse ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Komisioni i kushteve të punës, shëndetit dhe sigurimit në punë kryesohet nga drejtori i Drejtorisë së Marrëdhënieve të Punës, Sigurisë dhe Shëndetit në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:”

ii. Nënndarja “i” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“i. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, përgjegjësi i sektorit që mbulon çështjet e shëndetit dhe sigurisë në punë.”

ç) Në shkronjën “d” bëhen këto ndryshime:

i. Fjalja hyrëse ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Komisioni i ekonomisë dhe i financës kryesohet nga drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:”

ii. Nënndarja “i” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“i. Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, përgjegjës i sektorit, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar;”

d) Në shkronjën “dh” bëhen këto ndryshime:

i. Fjalja hyrëse ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Komisioni i shanseve të barabarta, aftësive të kufizuara dhe rinisë kryesohet nga drejtori i Drejtorisë së Politikave të Aftësimit Profesional dhe Inspektimit të AFP-së në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:”

ii. Nënndarja “i” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“i. Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, përgjegjës i sektorit që mbulon çështjet për shanset e barabarta dhe aftësitë e kufizuara;”

3. Kudo në përmbajtjen e vendimit emërtimi “Ministria e Financave dhe Ekonomisë” zëvendësohet me “Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit”.



II. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 15, datë 15.1.2026

**PËR TRANSFERIMIN E KUOTAVE TË
KAPITALIT, QË ZOTËROHEN NGA
SHOQËRIA “ALBCONTROL” SHA, NË
SHOQËRINË “AIR ALBANIA” SHPK, TEK
MINISTRIA E EKONOMISË DHE
INOVACIONIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës: të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar: të ligjit nr. 40/2024, “Për ofruesin e shërbimeve të lundrimit ajror ‘*Albcontrol*’”, dhe të vendimit nr. 309, datë 16.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave të krijimit të shoqërisë ‘*Air Albania*’, sh.p.k.”, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e kapitalit, në masën 10% (dhjetë për qind), që zotërohen nga shoqëria “*Albcontrol*”, sh.a., në shoqërinë “*Air Albania*” sh.p.k., transferohen tek Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit.

2. Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, me transferimin e kuotave, sipas pikës 1, të këtij vendimi, ushtron të gjitha të drejtat dhe detyrimet, që rrjedhin nga cilësia e ortakut në shoqërinë “*Air Albania*” sh.p.k.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe shoqëria “*Albcontrol*” sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 16, datë 15.1.2026

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË
MALLRAVE TË PËRJASHTUARA NGA
TAKSAT DOGANORE, TË CILAT
SHËRBEJNË DREJTPËRDREJT PËR
PRODHIMIN E ARMATIMIT USHTARAK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c”, të pikës 1, të nenit 26, të ligjit nr. 87/2024, “Për rregullimin e prodhimit, tregtimit, kërkimit dhe zhvillimit të armëve, municioneve, pajisjeve dhe teknologjive ushtarake”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së mallrave të përjashtuara nga taksat doganore, të cilat shërbejnë drejtpërdrejt për prodhimin e armatimit ushtarak, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave bashkëpunojnë nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, me qëllim identifikimin dhe verifikimin e mallrave të përcaktuara në shtojcën nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Agjencia e Industrisë së Mbrojtjes dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA NR. 1

Shënim hyrës

a) Komponentët kryesorë dhe mallrat e përcaktuara në listën e mallrave ushtarake dhe mallrave me përdorim të dyfishtë, sipas legjislacionit në fuqi, kur ato importohen me qëllim prodhimin e një produkti përfundimtar ushtarak nga subjektet e licencuara në fushën e prodhimit të industrisë së mbrojtjes;

b) Lënda e parë, makineritë dhe komponentët të cilat shërbejnë drejtpërdrejt për prodhimin e armatimit ushtarak të cilat nuk përfshihen në shkronjën “a”.

**LISTA E MALLRAVE TË PËRJASHTUARA NGA TAKSAT DOGANORE, TË CILAT SHËRBEJNË DREJTPËRDREJT PËR PRODHIMIN E ARMATIMIT USHTARAK**

1. Aditivë kimikë (MEG, butandiol, silikon B8554, glicerina, stabilizant ngjyre, P-650)
2. Katalizator EG
3. Tegoamin AS MEG
4. Aditiv për përcjellshmëri elektrike
5. Aromatizues pinosilvestri
6. DEOA
7. Dylent për ngjyra
8. Niaks silikon sekondar
9. Kristale silice (antilagështi)
10. Distakant BCD10B
11. Distakant PU3740H
12. Distakant GT3
13. Aditiv trajtimi gome (Euroklor K86, SolvekPlus)
14. Aditiv ngjitjeje gome (plastek 37)
15. Çelik balistik, alumin ajror, titan, bronz, nikel, alloys ushtarakë
16. Nitrocelulozë, nitroglicerinë, shtytës të tjerë
17. TNT, RDX, HMX, PETN, oktogjen, komponime të stabilizuara
18. Solventë, oksidues, komponime kimike për ndezës/stabilizatorë
19. Polikarbonat ushtarak, kevlar, aramid, kompozite të fortësisë së lartë
20. Fletë çeliku balistik
21. Fletë çeliku i zakonshëm/galvanizuar
22. Profile çeliku (U, L, tuba, sigma, etalbond)
23. Alumin ekstruduar, fletë alumini, profile alumini
24. Inox (fletë, profile, tuba)
25. Çelik karboni
26. Hardox/strukturë hardox
27. Tuba çeliku, profile kutie, kanale çeliku
28. Pllaka dysHEMEJE alumini kundër rrëshqitjes
29. Panele FRP/GRP, panele kompozite shumështrësore
30. Panele anti-fragmentim/spall liner
31. Xham balistik dhe xhama sigurie/të kalitur
32. Shkumë industriale termo-akustike
33. Guarnicione, vula, profile gome
34. Bojë antibakteriale, primer, shtresa antikorrozion
35. Ngjitës strukturorë, vulosës PU/epoksi
36. Material izolimi
37. Lëkurë, tekstil, materiale për veshje kabine
38. Fletë MDF, dru kompensatë, foamboard
39. Vajra, lubrifikantë, lëngje hidraulike dhe ftohës
40. Zorra hidraulike, lidhje hidraulike
41. Valvula, solenoidë
42. Kushineta, mentesha, bulona, arra, vida, mbërthyes industrialë
43. Koncentrat shkumëzues
44. Kimikate për modet zjarrfikëse/RCV
45. Filtra, materiale izolimi NBC
46. Panele strukturore ambulancë/klinikë/laborator
47. DysHEME fenolike
48. Veshje vinili
49. Bombola oksigjeni
50. Tubacione mjekësore O₂/vakum/ajër
51. Fibër karboni (Prepreg UD, Twill 2x2, Endur, Modul i lartë)
52. Plastika teknike: PA12, PA6-CF, PA12-CF, PC, ABS, ASA, PEEK, PEKK, PETG
53. Pluhur SLS: PA12, PA11, PA12-CF, TPU
54. Filamente 3D (të gjitha llojet, të përfshira të përforcuara)
55. Klasa e inxhinierisë së najlonit
56. Inxhinieri PETG



57. Resina epokside
58. Ngjitës strukturorë aviacioni
59. Tekstil fiberglass (E-glass/S-glass)
60. Alumini avionik 6061-T6/7075-T6 (fletë, shirit, tub)
61. Çelik i lehtë dhe titan
62. Kompozite *sandwich* (honeycomb, Kevlar)
63. Silikon për kablllo avionike
64. PCB boshllëqe dhe nënshtresa
65. Tela bakri, kablllo avionike, kablllo fibra optike
66. Ngjitës Avionik (epoksi, Loctite)
67. Qeliza Li-ion, LiPo, Li-ion HV
68. Pllaka termike, izolim EMI/EMC
69. Lidhëse industriale/ushtarake (DF13, JST-GH, Molex, XT30/60/90, AS150U)
70. Kabllot FPC
71. Kablllo HV dhe komunikimi
72. Shirit/pëlhura mbrojtëse EMI
73. Lente i veshur me IR
74. Strehim metalik për kamera termike
75. Montimet e lenteve, veshjet optike
76. Guarnicione, vula për kamera/avionikë
77. CCTV, GPS, telemetri
78. Armor kit (balistikë, antifragmentim)
79. Porta armësh (*gun ports*)
80. *Night-vision compatible* instrument panel
81. *Weapon mounting systems*
82. Sistem TPMS
83. *Snorkel kit*
84. *Jerry-can holders*
85. Komunikim taktik & *repeaters*
86. Pompë presioni, rezervuarë uji/shkumë
87. *Water cannons* me servo
88. LRAD
89. Dozer blade frontale
90. Sisteme survejimi, kamera termale
91. HVAC i blinduar
92. Sisteme shuarje zjarri
93. *Consola* HMI dhe PLC
94. Sirena dhe emergjencë
95. GPS/telemetri
96. Kupola SIGINT
97. Kupola *jamming*
98. EO/IR sensor
99. Radar 3D
100. SDR bërthamë bllokuese
101. Antena RF, amplifikatorë fuqie
102. Procesor fusional
103. SATCOM, LTE/5G modem
104. Kompjuteri qendror i misionit
105. Konsolë operatori
106. Softuer i kontrollit
107. Portë e sigurt (*secure gateway*)
108. Kamera PTZ, IR, ALPR, radare
109. Sisteme inspektimi nën mjet
110. Ruter, modem LTE/5G, SATCOM
111. Printer, skaner, biometrik
112. Kabina modulare pune
113. Sisteme alarmi, imobilizues, *run-flat*
114. Pajisje ndriçimi dhe sinjalizimi
115. Pajisje mjekësore (autoklava, X-Ray, analizatorë, sterilizues)
116. Mobilie mjekësore, kabinetë, lavamanë



117. HVAC i dedikuar
118. UPS të klinikës
119. CCTV, GPS, IT *medical systems*
120. Krahë (trare krah, nervatura, mbajtëse aileroni)
121. Fuselage (guaskë e sipërme, guaskë e poshtme, kornizë e brendshme)
122. Mbajtëse motorësh (CNC alumini/karbon)
123. Pajisje uljeje (fibër karboni/alumini)
124. Shasi droni
125. Amortizatorë vibrimi
126. Tub për fije
127. Vida prej çeliku inox të shkallës së hapësirës ajrore
128. Telemetri modules
129. Sistem lëshimi i shpejtë
130. Strukturë e montimit për ngarkesë
131. Motorë BLDC
132. ESC industrial/ *military-grade*
133. Helika fibër karboni (2-blade, 3-blade)
134. Mbajtëse helikash të palosshme
135. Kuti ingranazhesh (për dronë heavy-lift)
136. Servo
137. Autopilot
138. Kontrollorët e fluturimit
139. IMU *high-grade*
140. Module GPS/GNSS (*anti-spoofing, anti-jamming*)
141. RTK njësi
142. Magnetometër
143. Barometër i saktësisë së lartë
144. Sensorë pozicioni, presioni, altimetri
145. Telemetri radio e enkriptuar
146. SDR military-grade
147. Antena për UAV (patch, dipole, LHCP/RHCP, Drejtimore me fitim të lartë)
148. Radio mesh network për UAV *swarm*
149. Sistem komunikimi 4G/5G
150. Modem komunikimi
151. BMS (Sistemi i menaxhimit të baterisë)
152. PDB (bordet e shpërndarjes së energjisë)
153. Fan ftohës për avionikë
154. Kabllo silikonike dhe konektorë
155. Qendrat e karikimit dhe karikuesit industrialë
156. Marrësit e monitorimit të spektrit
157. Sistemet SDR për EW
158. Pajisjet e enkriptimit
159. Termike e kamerës
160. Kamera dite/nate (dritë e ulët/drita e yjeve)
161. Kamera multispektrale/RGB
162. Sistemet e gjilpërave EO/IR
163. Stabilizon gjimbalin 2-aks/3-bosht
164. Ndriçues IR
165. Radar/mini-radar urban
166. Lazerët (*rangefinders*)
167. LiDAR
168. Sensorë sonar
169. Montimet dhe shinat e kamerës
170. Modulet telemetrike
171. Njësitë ID të largëta/ADS-B
172. Sistemet e rikuperimit të parashutës
173. Regjistruues fluturimi *blackbox*
174. Marrës/transmetues ADS-B
175. Drum automatik për fibër optike
176. Konektorë FO → *Ethernet*/Radio



177. Jastëk uljeje
178. Modul sigurie për shkëputje emergjente të kabllove
179. Kabllo speciale HV/komunikimi
180. *Software* të dedikuar për dron ushtarak
181. Pajisje CNC për komponentë armësh/struktura metalike
182. Presa për fishekë dhe komponentë metalikë
183. Makineri për formësim tubash balistikë/fletë metalike
184. Përzierje, granulim dhe stabilizim eksplozivësh
185. Tunele balistike, teste presioni, shpejtësie, shpërthimi
186. Saldim elektronik i kontrolluar për përdorime ushtarake
187. Vinça elektrikë dhe hidraulikë
188. Krik hidraulik/mekanik
189. Kompresor ajri
190. Mjete rimorkiator, PTO të mjeteve
191. Pompë hidraulike, motorë pompash, pompë uji
192. Njësi telekomande/komandues hidraulik
193. Pompa zjarrfikëse
194. Bobina automatike tubash
195. Mekanizma miksues dhe kontrolli zjarrfikësi
196. PTO për pompa zjarrfikëse
197. Topa uji (*water cannons*)
198. Pompë presioni të lartë
199. Module dozimi kimik
200. LRAD
201. Radome dhe pajisje montimi
202. Pllaka bazë dhe izolatorë dridhjes
203. Printerë 3D FDM, resin (SLA/DLP/LCD), SLS, MJF, *binder jetting*, metali
204. CNC frezimi aksi 3/4/5
205. CNC torno metali
206. CNC router për karbon/kompozit
207. Makineri prerëse lazer (metal dhe kompozit)
208. Makineri (*waterjet*) prerëse me ujë me presion
209. Makina prerëse me plazmë
210. Makineri për prerje dhe laminim të fibrës së karbonit
211. Makinat e formimit të vakumit
212. Autoklavë për kompozite
213. Furrë industriale për curing/pjekje kompozitesh
214. Stacionet e kurimit, larje, debinder, sisteme sintering
215. Pajisje për rikuperimin e pluhurit
216. Pajisjet e shpërthimit të rërës
217. Makineri zgjedh dhe vendos SMT
218. Furrat ripërtëritëse për PCB
219. Pajisje programimi mikroçipash/autopilotësh
220. Skanera 3D (dritë blu, IR, lazer)
221. Dhomat mjedisore (dhoma klimaterike)
222. Era tuneli
223. Kutitë testimi RF/EMI
224. Pajisje për testim GPS/RTK
225. Testues komunikimi 4G/5G
226. Xhep me kapak për gyp alkooli
227. Xhep për pranga
228. Xhep për spraj lotsjellës
229. Xhep për radio
230. Xhep për teleskop/detektor
231. Këllëf pistolete
232. Mbajtëse çelësash
233. Mekanizëm shtrëngimi rripash acetal
234. Tuba balistikë, bërthama çeliku, elementë fishekësh, kapsolla, trarë
235. Pjesë këmbimi armësh, mekanizma këmbëze, fishkëza, karikatorë
236. Kontrollorë elektronikë për sistemet e armatimit



237. Sensorë, gyroskopë, accelerometra për stabilizim/drejtimit
238. Sisteme ndezëse elektrike, qarkore detonimi, kablllo ushtarake
239. Koka shpërthyese (*warheads*) të paaktivizuara
240. Strehë për municione inteligjente
241. Stabilizatorë aerodinamikë, fenestra balistike, trupa metalikë
242. Motorë (*engine assemblies*)
243. Transmision, *gearbox, transfer case*
244. Aksa, diferenciale
245. Pezullim (torsion bar, amortizatorë)
246. *Driveline components*
247. Sisteme frenimi ABS/EBS
248. Rezervuar karburanti rezistent ndaj shpërthimit
249. Sisteme ftohjeje (radiator, intercooler, ventilatorë)
250. *Steering assemblies*
251. Bateri 12/24 V, sisteme dyfishe baterish
252. Alternatorë, motorë startues
253. ECU/BCU, kontrollorë elektronikë
254. Radio, interkom, GPS
255. Kamera DVR, CCTV
256. Ulëse balistike, rripa 4/5 pikësh
257. Dyer balistike, tureta, xhama balistikë
258. Pllaka antimina dhe *V-shape protection*
259. *Spall liner*, antifragmentim
260. *Run-flat inserts*
261. Parakolpë të blinduar
262. Mbajtëse antenash, sisteme komunikimi
263. Motor, transmision, aksa, frenat, pezullimi
264. Panel komandimi, sirena, drita emergjence
265. Radio dhe GPS
266. Barelë, sedilje mjekësore, dollapë ABS
267. Pajisje (ventilator, defibrilator, monitor, pompë infuzioni, aspirator)
268. Pompa uji, sistem shkumë, rezervuarë uji/shkumë
269. Gryka, rakorderi storz, tubacione
270. Panelet e kontrollit të pompës
271. Drita pune, sirena, kamera
272. Pajisje shpëtimi hidraulike (*spreaders dhe cutters*)
273. Shasi, motor, transmision
274. *Steering*, frenim, pezullim
275. Sistemi dual bateri
276. Makina Lineare
277. Makina Lineare me thikë
278. Makina përgatitje jakë dhe kapak
279. Shpatull me 3 gjilpëra
280. Makinë vrimash azola
281. Makinë kopsash
282. Makinë 2 gjilpërash me ngritje gjilpëre
283. Syzator
284. Makinë për qepje velkrosh të përmasave të ndryshme
285. Makinë vrimash sy
286. Makina palafundi klasike
287. Makinë travete
288. Makinë ylyku automatik
289. Makinë qemeri me veshje
290. Syzator 3-fish
291. Makinë me thikë 2 gjilpërash
292. Makinë për velkro të masës 220*100
293. Makinë për palat e xhepave
294. Makinë termonastro
295. Makinë zig-zag
296. Makinë shtyllë për kapelë



- 297. Makinë cilindrike për kapelë
- 298. Makinë për strehën e kapelës
- 299. Makinë me gjysmë këmbëza për vendosjen e filetit të kapelës
- 300. Makinë për vrimat e kapelës me ajrosje
- 301. Makinë xhepoch me filete me çarje automatike
- 302. Makinë vendosje mënge
- 303. Makinë vendosje shpatulle
- 304. Makinë vendosje e shtesës së mëngës
- 305. Makinë vendosje astar mënge
- 306. Makinë vendosje kanavace
- 307. Makinë për hekurosje xhepoch me përmasa të ndryshme
- 308. Makinë për palafunde sportive
- 309. Makinë për qepjen e zinxhirit + hark
- 310. Makinë për filete të thjeshtë
- 311. Makinë mbyllje anësore
- 312. Makinë mbyllje kavalli me dy gjilpëra
- 313. Makineri për provën e hyrjes në ujë të xhupit
- 314. Makina e qëndisjes me lazer
- 315. Makina që pret nastros me djegie
- 316. Makina e barkodit
- 317. Makinë ylyku klasike me kaldaje
- 318. Makinë invisibile palafundi
- 319. Makinë përgatitje monstre këmishe
- 320. Makinë ngjitje mënge këmishe
- 321. Makinë pale këmishe
- 322. Makinë automatike ngjitje xhepi këmishe
- 323. Makinë palosje këmishe
- 324. Makinë përgatitje mënge të gjatë këmishe
- 325. Makinë për tegelat e zbukurimit të jakës së këmishës
- 326. Makinë për përgatitjen e marshetit të këmishës
- 327. Makinë për hekurosjen e cikës së mëngës së gjatë
- 328. Makinë për kthimin e jakës së marshetit të këmishës
- 329. Makinë palafundi për Polo T-shirt
- 330. Makinë për katrorin e monstres përpara
- 331. Makinë koperture për tegelat e pjesës së brendshme të xhupit
- 332. Makinë për vendosjen e llastikut të mëngës
- 333. Makinë fileti i jakës kolaret
- 334. Makinë vendosje fileti me thurje të poshtme sup+jakë+sup
- 335. Makinë vendosje bandareflex
- 336. Makinë ngjitje për xhaketa
- 337. Makinë ngjitje për kamishat
- 338. Hekura për linjë hekurosje dhe përfundimi
- 339. Makina trikotazhi
- 340. Makina këpucësh
- 341. Lavatriçe për testimin e pulovrave
- 342. Boliere për linjën e hekurosjes
- 343. Ploter
- 344. Tavolina prestatore
- 345. Makineri për stampimin të personalizuar të veshjeve të ndryshme
- 346. Makineri kalimin nga film në telajo (serigrafike)
- 347. Makineri për veshjen e kopsave
- 348. Makineri për çorapet
- 349. Manekinë me dritë të brendshme
- 350. Makineri për bërjen e kompozicioneve dhe përqindje
- 351. Linja mbushjeje, kapsollimi, krimpimi, vulosjeje për municione
- 352. Tekstil 100% lesh i virgjër
- 353. Tekstil 100% lesh merino (shajak)
- 354. Tekstil 100% pambuk
- 355. Tekstil 100% poliestër
- 356. Tekstil 100% najlon



357. Tekstil 100% poliestër me veshje PU membrane
358. Tekstil 100% poliamid
359. Tekstil 100% NOMEX
360. Tekstil 100% Viskoze
361. Tekstil 45% lesh, 55% poliestër
362. Tekstil 50% lesh, 50% akrilik
363. Tekstil 65% poliestër 35% pambuk
364. Tekstil 80% pambuk, 20% poliestër
365. Tekstil 60% pambuk, 40% poliestër
366. Tekstil 90% pambuk, 7% poliamid, 3% elastan
367. Tekstil 60% pambuk, 35% poliamid, 5% elastan
368. Tekstil 92% pambuk, 8% poliamide
369. Tekstil 85–90% pambuk, 10–15% polipropilen
370. Tekstil 50% lesh, 50% poliamid
371. Tekstil 50% lesh, 50% poliestër
372. Tekstil 20% pambuk, 80% poliestër
373. Tekstil 50% pambuk, 50% poliestër
374. Tekstil 70% pambuk, 30% poliestër
375. Tekstil 92% poliestër, 8% spandex
376. Tekstil 96% poliestër, 4% spandex
377. Tekstil 41% lesh, 49% poliester, 10% poliuretan
378. Tekstil 49% pambuk, 49%, poliamid 2%
379. Tekstil 50% lëkurë, 25% najlon, 25% neoprenë
380. Tekstil 93% meta aramid 5%, para aramid, 2% antistatike
381. Tekstil 90% fibra aramidike, 10% najlon
382. Tekstil 70% fibra aramidike, 30% viskozë
383. Tekstil 75% pambuk, 25% poliestër
384. Tekstil 32% viskozë, 65% poliestër, 3% elastan
385. Tekstil 80% lesh “pura lana vergine”, 20% poliestër
386. Tekstil 62% poliester, 35% viskozë, 3% elastan
387. Tekstil 65% poliester, 32%, viskozë 3% elastan
388. Tekstil 90% poliestër, 10% spandex
389. Tekstil 53% modakrilik, 44% pambuk, 3% fibra konduktive
390. Tekstil *cordura nylon*
391. Ripa najloni MOLLE
392. Ripa najloni PALS
393. 100% PA
394. 85% PA – 15% *spandex*
395. 50% nylon – 50% cotton
396. 70% PES – 30% lesh
397. 95% CO – 5% elastan
398. 50% modacryl – 40%, viscose FR – 8%, CO – 2% antistatik
399. 93% meta-aramid – 5% para-aramid – 2% antistatik
400. 100% cotton FR
401. 98% PES/CO – 2% fibra karboni
402. 90% PES – 10% *spandex*
403. 88% nylon – 12% *spandex*
404. Nylon + PU coating
405. 100% nylon 1000D
406. 100% PES 600D
407. Material termoadeziv
408. PVC
409. Material fibre të lidhur
410. Material fibre termoplastike
411. Material llastik
412. Velkro 100% poliamid
413. Buton metalik
414. Kopsa metalike
415. Unaza plastike
416. Unaza metalike



- 417. Kapëse metalike
- 418. Kapëse plastike
- 419. Togëza tunxh
- 420. Togëza plastike
- 421. Togëza metalike
- 422. Fletë bronzi e stampuar
- 423. Fletë bronzi e galvanizuar
- 424. Shirit reflektiv
- 425. Personalizime reflektive
- 426. Fill qepës poliester (lloj të ndryshëm)
- 427. Fill qepës poliamid
- 428. Fill qëndisjeje poliestër
- 429. Fill qëndisjeje najlon
- 430. Fill metalik qëndisjeje
- 431. Kunja me kapëse
- 432. Kapëse plastike acetat
- 433. Kapëse plastike e vogël
- 434. Plastikë për jakë
- 435. Karton për jakë
- 436. Flutura për jakë
- 437. Gjilpëra me kokë
- 438. Gemmelli metalik
- 439. Steka plastike
- 440. Mbulesë kostumesh
- 441. Pllaka mbrojtëse *memory*
- 442. Astar jakë për gyp alkohol
- 443. Astar për pranga
- 444. Astar për spraj
- 445. Astar për radio
- 446. Astar për teleskop
- 447. Këllëf pistolete
- 448. Mekanizëm shtrëngimi rripash acetal
- 449. Lëkurë deleje
- 450. Lëkurë boks viçi
- 451. Lëkurë lope
- 452. Lëkurë e përpunuar
- 453. Lëkurë meshine
- 454. Material kamosh
- 455. Astar meshin derri
- 456. Shkumë *memory*
- 457. Bojëra për stampim
- 458. Prepolimere izocianate
- 459. Poliolo
- 460. TPU + aditiv për përcjellshmëri



UDHËZIM
Nr. 1, datë 9.1.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
TË BRENDSHME MBI EKZEKUTIMIN
E VENDIMEVE GJYQËSORE TË
FORMËS SË PRERË ME DEBITOR
MINISTRINË PËRGJEGJËSE PËR
TURIZMIN, KULTURËN DHE SPORTIN**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të neneve 510, 589, të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 152, datë 30.5.2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; të pikës 2, të nenit 29, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të neneve 43 e 54, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2012, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 512, datë 25.9.2025, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit”,

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i mënyrës së ekzekutimit të detyrimeve monetare që rrjedhin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë, me debitor ministrinë përgjegjëse për turizmin, kulturën dhe sportin.

2. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore realizohet nga struktura përgjegjëse për financat:

a) me fondet buxhetore, të akorduara në ligjin vjetor të buxhetit përkatës, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore;

b) nga të ardhura të tjera, të siguruar nga ministria përgjegjëse për turizmin, kulturën dhe sportin, në bazë të legjislacionit përkatës, të cilat shërbejnë si burime financimi për vetë njësinë (nëse ka).

3. Struktura përgjegjëse për financat, çdo vit, parashikon fondet buxhetore të planifikuara për shpenzimet që do të kryejë institucioni për

ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

4. Struktura përgjegjëse për financat është përgjegjëse për dokumentimin e të gjitha transaksioneve financiare. Ajo, gjithashtu, garanton para miratimit të shkresave/urdhrave me karakter financiar ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, eficiencës dhe efektivitetit.

5. Struktura përgjegjëse për financat, me përparësi në vitet e ardhshme, planifikon fondet e nevojshme për shlyerjen e detyrimeve të mbartura, duke ndjekur procedurat përkatëse të planifikimit të fondeve buxhetore, të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore respektive.

6. Në procesin e shlyerjes së vendimeve gjyqësore, struktura përgjegjëse për financat zbaton parimin e përparësisë së detyrimeve më të hershme dhe/ose atyre të dhëna me ekzekutim të përkohshëm, sipas disponimit të gjykatës.

KREU II
PROCEDURAT DHE AFATET, LIDHUR
ME EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE
GJYQËSORE

7. Për vendimet gjyqësore të formës së prerë ose ato të dhëna me ekzekutim të përkohshëm, struktura përgjegjëse për këshillimin e çështjeve ligjore dhe gjyqësore, pas marrjes së kërkesës për ekzekutim të vendimit gjyqësor, kryen verifikimin e dokumentacionit shoqërues dhe plotësimit të kriterëve ligjore. Nëse kërkesa për ekzekutimin e vendimit, e paraqitur vullnetarisht ose nëpërmjet shërbimit përbarimor, nuk shoqërohet me dokumentacionin e nevojshëm ose nuk plotëson kriteret ligjore, i kërkohet kreditorit/shërbimit përbarimor plotësimi i dokumentacionit dhe/ose kthehet përgjigje mbi shkaqet e refuzimit. Në rastet e pavlefshmërisë së titullit ekzekutiv dhe/ose kundërshtimit të veprimeve përbarimore, veprohet sipas legjislacionit procedural në fuqi.

8. Pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues dhe të plotësimit të kriterëve ligjore, sipas pikës 7, vendimi gjyqësor i formës së prerë dhe dokumentacioni shoqërues i përcillen strukturës përgjegjëse për financat, brenda 5 (pesë) ditëve nga administrimi i kërkesës/praktikës përbarimore



apo dokumentacionit të plotësuar, për parashikimin e fondeve buxhetore për likuidim.

9. Me paraqitjen e kërkesës për ekzekutim nga shërbimi përmbartimor për detyrime monetare me vlera atipike ose të një rëndësie të posaçme, struktura përgjegjëse për këshillimin e çështjeve ligjore dhe gjyqësore paraqet pranë Gjykatës së Lartë, në përputhje me legjislacionin procedural në fuqi, kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, duke njoftuar njëkohësisht edhe përmbartuesin gjyqësor.

10. Në rastet kur struktura përgjegjëse për financat do të kryejë ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë, nga ana e kreditorit/përmbartuesit gjyqësor duhet të jetë depozituar:

a) dokumenti që vërteton njoftimin e njësisë shpenzuese debitore për ekzekutimin vullnetar dhe/ose të detyruar të detyrimit dhe marrjen dijeni nga ana e saj;

b) vendimi gjyqësor, i cili, në kuptim të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile, konsiderohet titull ekzekutiv, sipas rastit, në origjinal ose i noterizuar.

11. Struktura përgjegjëse për financat, pas marrjes së dokumentacionit nga struktura përgjegjëse për këshillimin e çështjeve ligjore dhe gjyqësore, së bashku me kërkesën e miratuar për ekzekutimin e vendimit gjyqësor, sipas pikës 8, brenda 5 (pesë) ditëve nga administrimi i saj, kryen verifikimin e fondeve buxhetore dhe radhës së pagesës, sipas databazës së përcjellë nga struktura përgjegjëse për këshillimin e çështjeve ligjore dhe gjyqësore, dhe i paraqet nëpunësit autorizues propozimin për miratimin e kërkesës së pagesës, të shoqëruar me aktin financiar, në kuadër të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë ose të dhënë me ekzekutim të përkohshëm.

12. Nëse kërkesa për ekzekutim lidhet me një vendim gjyqësor që parashikon rikthimin në punë të një ish-nëpunësi, pjesë e shërbimit civil, praktika i përcillet edhe strukturës përgjegjëse për burimet njerëzore. Kjo e fundit, pas marrjes dijeni, brenda afateve të parashikuara në aktet ligjore/nënligjore për shërbimin civil, njofton Sekretarin e Përgjithshëm dhe merr masat për caktimin e mbledhjes së Komisionit të Posaçëm për Shqyrtimin

e Vendimeve Gjyqësore të Formës së Prerë, me qëllim shqyrtimin e kërkesës për ekzekutim.

13. Përrjashtohen nga rregulli i përcaktuar në pikën 11, lidhur me radhën e kryerjes së pagesës:

a) ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, që urdhërohet nga titullari i institucionit/Sekretari i Përgjithshëm për rrethana lehtësuese të gjyqfutesve;

b) ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë me objekt kthim page apo dëmshpërblim për largim nga puna, për gjyqfutesit që kanë mbushur moshën e daljes në pension pleqërie dhe për ata të cilëve u është ekzekutuar pjesërisht vendimi për rikthim në punë dhe ka mbetur për ekzekutim pjesa e kthimit të pagës;

c) për vendimet me objekt dëmshpërblim për largim nga puna apo kthim page të ish-punonjësve të institucioneve të varësisë (ekzekutimi kryhet nga vetë këto institucione, pas çeljes së fondit sipas parashikimeve ligjore);

d) kur kreditori paraqet kërkesë për shlyerjen e detyrimit deri në momentin e dorëzimit të kërkesës dhe heq dorë nga pjesa tjetër e ekzekutimit të vendimit të formës së prerë.

14. Në rastet kur struktura përgjegjëse për financat, me fondet buxhetore që ka në dispozicion, nuk është në gjendje të shlyejë detyrimin e plotë sipas vendimit gjyqësor, ajo njofton nëpunësin autorizues. Në informacionin e paraqitur, struktura përgjegjëse për financat parashtron mundësitë për ekzekutim, sa i takon vlerës dhe periodicitetit të pagesave.

15. Në çdo rast, pavarësisht parashikimeve të këtij udhëzimi, struktura përgjegjëse për financën zbaton me përparësi modalitetet e Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 4.6.2014, “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisë të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit” dhe publikon grafikun e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në rastet e mungesës së fondeve buxhetore. Në këtë rast, struktura përgjegjëse për financën i kthen përgjigje kërkuarit/përmbartuesit gjyqësor dhe/ose degës së thesarit përkatëse, duke vënë në dijeni edhe strukturën përgjegjëse për ndjekjen e proceseve gjyqësore, brenda afateve të përcaktuara në aktet ligjore/nënligjore.

16. Me kërkesën e strukturës përgjegjëse për financat dhe miratimin e nëpunësit autorizues, në rast të mungesës së fondeve buxhetore apo



detyrimeve monetare me vlera atipike, struktura përgjegjëse për këshillimin e çështjeve ligjore dhe gjyqësore, në bazë të nenit 517 të Kodit të Procedurës Civile, i drejtohet gjykatës me kërkesë për ndarjen/shlyerje pjesore të detyrimit me fondet e vitit/viteve në vijim, duke bërë edhe njoftimin përkatës edhe pranë përmbaruesit gjyqësor.

17. Struktura përgjegjëse për këshillimin e çështjeve ligjore dhe gjyqësore mban dhe i komunikon periodikisht strukturës përgjegjëse për financat databazën e veçantë me të dhënat për vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe ato të dhëna me ekzekutim të përkohshëm që përmbajnë detyrim monetar. Struktura përgjegjëse për financat përditëson databazën me përlogaritjet financiare të detyrimeve monetare, si dhe të dhëna dokumentare pas ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

KREU III DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

17. Ngarkohet Drejtoria e Programimit, Hartimit, Harmonizimit të Kuadrit Rregullator, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij udhëzimi, si dhe Sektori i Arkiv-Protokollit për komunikimin e tij.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS
DHE SPORTIT
Blendi Gonxhja

URDHËR
Nr. 2, datë 7.1.2026

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE TË TITULLARIT TË AUTORITETIT KONTRAKTOR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 22, 25, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të nenit 11, pika 2, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, si dhe të nenit 73, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021,

“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor të znj. Florenca Korbi, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, për të gjitha procedurat e prokurimit publik të Ministrisë së Financave.

2. Kompetencat e deleguara do të ushtrohen nga data 7.1.2026.

3. Urdhri nr. 116, datë 15.8.2024, “Për delegimin e kompetencave”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCIVE
Petrit Malaj

URDHËR
Nr. 12, datë 8.1.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” dhe të udhëzimit nr. 4, datë 29.1.2020, “Për delegimin e të drejtave dhe detyrave në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, për nisjen dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit për blerjet me vlerë të vogël apo direkte, si dhe nënshkrimin e kontratave për ushtrimin e aktiviteteve të AZHT-së të drejtori i Drejtorisë së Monitorimit në Territor, z. Saimir Lita.



2. Kompetenca e deleguar sipas pikës 1 të këtij urdhri, do të ushtrohet nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri deri më datë 30.6.2026.

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri drejtori i Drejtorisë së Monitorimit në Territor, z. Saimir Lita.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Adelajda Roka

URDHËR
Nr. 47, datë 14.1.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Për shkak të angazhimeve zyrtare jashtë vendit dhe për të garantuar vijimësinë e veprimtarisë administrative të Ministrisë, delegoj të drejtën e firmës për të gjitha dokumentet dhe aktet që lidhen me procedurat e importeve në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëvendësministrit, z. Fatmir Guri, për datat 14, 15, 16 janar 2026.

2. Zëvendësministri i përmendur në pikën 1 është i autorizuar të nënshkruajë në emër të ministrit dokumentet që lidhen me importet, si më poshtë:

- kërkesat dhe miratimet për importe sipas kompetencës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

- autorizimet, vërtetimet dhe shkresat zyrtare drejtuar institucioneve shtetërore dhe subjekteve private për çështje që lidhen me importet;

- çdo dokument tjetër administrativ që kërkon firmën e ministrit në fushën e importeve në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Ky delegim është i vlefshëm vetëm për datat 14, 15, 16 janar 2026. Pas kësaj date, e drejta e firmës kthehet te ministri sipas kompetencave të tij të plota ligjore.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike Administrative, drejtoria përgjegjëse për importet

dhe të gjitha strukturat e tjera përkatëse të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

5. Ky urdhër hartohet në 3 (tri) kopje të njëjta, 1 (një) për arkiv-protokollin, 1 (një) për Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe 1 (një) për zëvendësministrin sipas pikës 1.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 213, datë 19.11.2025

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR KUSHTET, KRITERET, AFATET, SI DHE PROCEDURËN PËR KATEGORIZIMIN E STRUKTURAVE AKOMODUESE”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 6, të nenit 43/1, të ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, afatet si dhe procedurën për kategorizimin e strukturave akomoduese, sipas tekstit bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij urdhri.

2. Miratimin e formatit dhe të modelit të certifikatës së kategorizimit të strukturave akomoduese, sipas shtojcës 1 dhe shtojcës 2, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Urdhri nr. 267, datë 24.7.2019, i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, “Për miratimin e rregullores Për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese”, i ndryshuar, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Komisioni i Standardizimit të Veprimtarive Turistike dhe struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e turizmit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS
DHE SPORTIT
Blendi Gonxhja



RREGULLORE
PËR KUSHTET, KRITERET, AFATET SI
DHE PROCEDURËN PËR
KATEGORIZIMIN E STRUKTURAVE
AKOMODUESE

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve, kriterëve, afateve dhe procedurës për kategorizimin e strukturave akomoduese, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar.

Neni 2
Kriteret dhe kushtet

1. Çdo subjekt që do të ushtrojë veprimtarinë si strukturë akomoduese duhet të plotësojë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë rregullore, sipas kategorisë dhe shtojcave më poshtë:

Për kategorinë:

- a) “Bujtinë” – Shtojca 5/a;
- b) “Fjetinë” (hostel) – Shtojca 5/b;
- c) “Kamping” – Shtojca 5/c;
- ç) “Hotel”; – Shtojca 5/ç;
- d) “Motel” – Shtojca 5/d;
- dh) “Qendër kurative” – Shtojca 5/dh;
- e) “Resort” – Shtojca 5/e;
- ë) “Fjetje dhe mëngjes” (B&B) – Shtojca 5/ë;
- f) “Dhomë” – Shtojca 5/f;
- g) “Apartament” – Shtojca 5/g;
- gj) “Bllok apartamentesh” – Shtojca 5/gj;
- h) “Vilë” – Shtojca 5/h;
- i) “Hotel i shpërndarë” – Shtojca 5/i;
- j) “Strukturë akomoduese e trashëgimisë kulturore” – Shtojca 5/j;

2. Çdo subjekt që do të ushtrojë veprimtarinë si strukturë akomoduese, përpara fillimit të aktivitetit është i detyruar të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) për ushtrimin e veprimtarisë si strukturë akomoduese. Përjashtohen nga ky detyrim individët qiradhënës, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e akomodimit në kategoritë “dhomë”, “apartament” dhe “vilë”.

3. Brenda 30 ditëve nga regjistrimi pranë QKB-së për ushtrimin e veprimtarisë si strukturë akomoduese, subjekti është i detyruar të aplikojë në

portalin unik qeveritar “e-Albania” për t’u pajisur me certifikatën e kategorizimit si strukturë akomoduese.

Për individët qiradhënës, të cilët do të ushtrojnë veprimtarinë e akomodimit në kategoritë “dhomë”, “apartament” dhe “vilë”, ky aplikim kryhet përpara fillimit të veprimtarisë.

Neni 3
Kategoritë e strukturave akomoduese të ndara në klasat e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE)

1. Strukturat akomoduese, sikurse përcaktohen në ligjin nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, përfshijnë kategoritë e përcaktuara në pikën 1, të nenit 2, të këtij ligji.

2. Strukturat akomoduese të përcaktuara në pikën 1, referuar vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 552, datë 1.10.2025, “Për miratimin e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike të Revizionuara (Rev. 2.1)”, grupohen në tri klasa të Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike (NVE), sipas tabelës më poshtë:

Klasa	Përshkrimi i klasës	Kategoritë e strukturave akomoduese
5510	Hotele dhe struktura të ngjashme	Hotel, resort, qendër kurative, motel, fjetje dhe mëngjes (B&B), strukturë akomoduese e trashëgimisë kulturore dhomë, hotel i shpërndarë
5520	Akomodime për pushime dhe të tjera akomodime kolektive	Fjetinë (hostel), apartament, bllok apartamentesh, vilë
5530	Hapësirat për kampingje dhe për parqe, për çadra ose rulota argëtimi	Kamping

Neni 4
Procedura e kategorizimit të strukturave akomoduese

1. Kategorizimi i strukturave akomoduese u nënshtrohet tri fazave:

a) faza e parë përfshin procesin e vetëdeklarimit të sipërmarrësit turistik, i cili konsiston në plotësimin e formularit të aplikimit në portalin unik qeveritar “e-Albania” dhe ngarkimit të dokumentacionit



shoqërues, të parashikuar në nenin 6 të kësaj rregulloreje;

b) faza e dytë përfshin procesin e shqyrtimit nga ana e Komisionit të Standardizimit të Veprimtarive Turistike të dokumentacionit të dorëzuar nga sipërmarrësi turistik, sipas përcaktimeve në nenin 7 të kësaj rregulloreje;

c) faza e tretë përfshin verifikimin në terren, rast pas rasti, të të dhënave të vetëdeklarimit nga struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e turizmit, nëse Komisioni i Standardizimit e kërkon këtë proces.

Neni 5

Procesi i vetëdeklarimit për kategorizimin e strukturës akomoduese

1. Sipërmarrësi turistik ose individ i që ushtron veprimtarinë si strukturë akomoduese, aplikon *online* në portalin unik qeveritar “*e-Albania*”, duke plotësuar formularin dhe dokumentacionin përkatës, të përcaktuar në nenin 6 të kësaj rregulloreje.

2. Sipërmarrësi turistik ose individ mban përgjegjësi për vërtetësinë e të dhënave të deklaruara, të cilat janë objekt i verifikimit, sipas rregullave të parashikuara në këtë rregullore.

Neni 6

Dokumentet e aplikimit për pajisje me certifikatë kategorizimi

1. Dokumentacioni që duhet të ngarkohet në portalin unik qeveritar “*e-Albania*” nga aplikuesi është:

a) Certifikata e pronësisë ose një nga dokumentet më poshtë:

- i. kartela e pasurisë;
- ii. certifikata e përdorimit të objektit lëshuar nga organi përgjegjës;
- iii. kontrata e qirasë ose e përdorimit me pronarin e objektit;

b) Planimetria e strukturës akomoduese për çdo kat;

c) Foto aktuale të ambienteve të brendshme me pajisje funksionale dhe foto të jashtme të strukturës.

2. Ministria përgjegjëse për turizmin siguron nëpërmjet portalit unik qeveritar “*e-Albania*” dokumentacionin si vijon:

a) vërtetim për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Biznesit si person fizik/juridik me objekt veprimtarie si strukturë akomoduese;

b) vërtetim i gjendjes gjyqësore të subjektit aplikues/aksionarit kryesor; pronarit/ administratorit;

c) vërtetimi që struktura plotëson kushtet për masat e mbrojtjes nga zjarri lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri;

ç) vërtetim që struktura plotëson kushtet higjieno-sanitare, lëshuar nga Instituti i Shëndetit Publik.

3. Përfashtimisht për strukturat akomoduese “Dhomë”, “Apartament”, “Vilë” dhe “Bllok apartamentesh”, përmbushja e kërkesave të përcaktuara në shkronjat “c” dhe “ç”, të pikës 2, vetëdeklarohen nga individ i dhe ngarkohen në sistem.

Neni 7

Procedura e shqyrtimit të dokumentacionit për kategorizimin e strukturave akomoduese

1. Komisioni i Standardizimit, brenda 10 ditëve nga data e aplikimit për pajisje me certifikatë kategorizimi në portalin “*e-Albania*”, shqyrton dhe vlerëson aplikimin në përmbushjen e kushteve dhe të kriterëve për kategorizimin e strukturave akomoduese.

2. Komisioni i Standardizimit, në rast të konstatimit të mangësive, njofton aplikuesin brenda 2 ditëve nga data e shqyrtimit të aplikimit për plotësimin e dokumentacionit, duke i lënë një afat 10-ditor nga data e njoftimit, për plotësimin e mangësive të konstatuara.

3. Në rast se Komisioni i Standardizimit gjatë shqyrtimit të aplikimit konstaton parregullsi apo lindin dyshime të arsyeshme për të dhënat e deklaruara, i kërkon grupit të punës verifikimin në terren të të dhënave. Komisioni i Standardizimit, nëpërmjet sekretarisë teknike, njofton aplikuesin dhe koordinon vizitën në terren.

4. Grupi i punës i paraqet Komisionit të Standardizimit raportin e gjetjeve të konstatuara në terren, brenda 5 ditëve nga dita e vizitës në terren.

5. Afati i parashikuar në pikën 1 mund të shtyhet, në mënyrë të arsyetuar, por jo më shumë se 30 ditë, duke i dërguar aplikuesit njoftimin në portalin unik qeveritar “*e-Albania*”, sipas afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij neni.



6. Në përfundim të procesit të shqyrtimit dhe të vlerësimit, Komisioni i Standardizimit merr vendim për lëshimin ose jo të certifikatës së kategorizimit të strukturës akomoduese dhe e përcjell për miratim pranë ministrit.

7. Njoftimi i subjektit për tërheqjen e certifikatës apo refuzimi i kërkesës për pajisje me certifikatë bëhet nëpërmjet portalit unik qeveritar “*e-Albania*”, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e lëshimit të certifikatës, apo e vendimit përfundimtar të refuzimit.

8. Në rast se Komisioni refuzon aplikimin për pajisje me certifikatë, vendimi duhet të jetë i arsyetuar dhe i njoftohet subjektit brenda 5 (pesë) ditëve pune nga vendimmarrja e Komisionit.

Neni 8

Certifikata e kategorizimit të strukturës akomoduese

1. Certifikata e kategorizimit të strukturës akomoduese përmban:

- a) emrin e subjektit;
- b) NIPT-in;
- c) emërtesën e strukturës akomoduese
- ç) adresën e strukturës akomoduese;
- d) kategorinë;
- dh) datën e lëshimit të certifikatës së kategorizimit;

e) nënshkrimin e ministrit ose të personit të autorizuar prej tij.

Përfundimisht për kategoritë “Dhomë”, “Apartament” dhe “Vilë” certifikata e kategorizimit nuk përmban të dhënat e parashikuara, sipas shkronjës “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij neni.

2. Certifikata e kategorizimit gjenerohet *online* në portalin unik qeveritar *e-Albania*.

3. Certifikata e kategorizimit, sipas formatit dhe modelit në shtojcën 1 ose në shtojcën 2, bashkëlidhur kësaj rregulloreje, tregon llojin e strukturës akomoduese dhe afishohet në reception/ zonën e pritjes së strukturës akomoduese.

4. Lloji i kategorisë së strukturës akomoduese, sipas certifikatës së kategorizimit, vendoset në hyrjen kryesore/fasadën e strukturës akomoduese.

5. Certifikata e kategorizimit të strukturës akomoduese regjistrohet në Regjistrin Qendror të

Turizmit, i administruar nga ministria përgjegjëse për turizmin.

6. Në rast se subjekti i pajisur me certifikatë kategorizimi të strukturës akomoduese vendos të japë në përdorim/qira ose të shesë strukturën akomoduese, objekt të kësaj certifikate, subjekti posedues/qiramarrës ose blerës duhet të aplikojë për t’u pajisur me certifikatë të re, duke dorëzuar dokumentacionin e parashikuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 6 të kësaj rregulloreje, si dhe dokumentet sipas shkronjës “a” dhe “b”, të pikës 2, do të sigurohen nga ministria.

Neni 9

Ndryshimi i kategorisë së strukturës akomoduese

1. Aplikuesi mund të aplikojë për ndryshimin e kategorisë së një strukture akomoduese në çdo kohë që e çmon se ndërhyrjet dhe ndryshimet në objekt ndikojnë në ndryshimin e kategorisë së strukturës akomoduese.

2. Aplikimi për ndryshimin e kategorisë së strukturës akomoduese kryhet në portalin unik qeveritar “*e-Albania*” nëpërmjet vetëdeklarimit të aplikuesit, së bashku me foto që vërtetojnë ndërhyrjet apo ndryshimet në objekt.

3. Komisioni i Standardizimit rishqyrton statusin e kategorizimit, brenda 10 ditëve nga data e aplikimit për ndryshim të kategorisë së strukturës akomoduese.

Neni 10

Verifikimi

1. Struktura përgjegjëse për inspektimin në turizëm ka përgjegjësi të verifikojë çdo sipërmarrës turistik që ushtron veprimtari si strukturë akomoduese, nëse është apo jo i pajisur me certifikatë kategorizimi.

2. Struktura përgjegjëse për inspektimin në turizëm në rast të konstatimit të ushtrimit të veprimtarisë si strukturë akomoduese, në mungesë të certifikatës së kategorizimit njofton ministrinë përgjegjëse për turizmin dhe merr masa sipas legjislacionit në fuqi për turizmin.



SHTOJCA NR. 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
CERTIFIKATË KATEGORIZIMI
STRUKTURË AKOMODUESE

Kjo certifikatë i lëshohet subjektit:

[Emri i subjektit]

NIPT _____

[Emërtesa e strukturës akomoduese]

Adresa: _____

për ushtrimin e veprimtarisë si strukturë akomoduese

Kategoria: _____

Lëshuar më __/__/20__

Nr. Regj. __/20__

MINISTRI/PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ



SHTOJCA NR. 2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
CERTIFIKATË KATEGORIZIMI
STRUKTURË AKOMODUESE

Kjo certifikatë lëshohet për strukturën akomoduese:

[Emërtesa e strukturës akomoduese]

Adresa: _____

Kategoria: _____

Lëshuar më __/__/20__

Nr. Regj. __/20__

MINISTRI/PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ



SHTOJCA NR. 3

Kërkesë për t'u pajisur me certifikatë kategorizimi të strukturës akomoduese

Aplikim për:

- ☐ Bujtinë ☐ Fjetinë ☐ Kamping ☐ Hotel ☐ Motel
☐ Resort ☐ Qendër Kurative ☐ Fjetje dhe mëngjes (B&B)
☐ Apartament ☐ Bllok apartamentesh ☐ Vilë ☐ Hotel i shpërndarë ☐ Dhomë
☐ SA e trashëgimisë kulturore

Emri i subjektit aplikues: _____

NIPT: _____

Adresa e subjektit: _____

Personi që përfaqëson subjektin: _____

Nr. tel. _____ Email _____

Përmbledhje ekzekutive e subjektit aplikuesit

(Përshkrim të veprimtarisë të cilën subjekti ushtron, eksperiencën konkrete sipas periudhave etj.)

Dokumentacioni shoqërues i aplikimit

(Listë e dokumenteve shoqërues të aplikimit)

- Certifikata e pronësisë ose certifikata e përdorimit të objektit lëshuar nga organi kompetent ose kartela e pasurisë;
- Kontrata e qirasë ose e përdorimit me pronarin e objektit;
- Planimetria e strukturës akomoduese;
- Foto aktuale të ambienteve të brendshme të pajisura dhe funksionale, dhe të jashtme të strukturës;
- Vetëdeklarim që struktura plotëson kushtet për masat e mbrojtjes nga zjarri, për kategoritë “Dhomë”, “Apartament”, “Vilë” dhe “Bllok apartamenti”, që përmban deri në 4 apartamente, të cilat ndodhen në ndërtesa të veçanta;
- Vetëdeklarim që struktura plotëson kushtet higjieno-sanitare, për kategoritë “Dhomë”, “Apartament”, “Vilë” dhe “Bllok apartamenti”, që përmban deri në 3 apartamente, të cilat ndodhen në ndërtesa të veçanta.



SHTOJCA NR. 4

Formular vetëdeklarimi për aplikim për kategorizimin e strukturave akomoduese

	Emri tregtar		
	Përfaqësuesi ligjor F ☐ M ☐		
	Forma e pronësisë		
	Vlera e investimit		
	Viti i operimit		
	Aktiviteti ushtrohet	☐ Gjithë vitin ☐ Sezonal	
	Adresa e plotë e aktivitetit (prefektura, bashkia, qyteti/fshati, lagjja, rruga, nr.)		
	Vendndodhja gjeografike (GIS)		
Kapaciteti i strukturës	Kapaciteti akomodues në dhoma		
	Kapaciteti akomodues në shtretër		
	Kapaciteti në bar-kafe, vende ulje (persona)		
	Kapaciteti në restorante, vende ulje (persona)		
	Nr. i sallave për konferenca		
	Kapaciteti për sallë		
Kategoritë e punësimit	Punonjës me kohë të plotë	Total	
		Femra	
		Meshkuj	
	Punonjës me kohë të pjesshme	Total	
		Femra	
		Meshkuj	
	Punonjës me kontratë	Total	
		Femra	
		Meshkuj	
	Të vetëpunësuar	Total	
		Femra	
		Meshkuj	
Kualifikimi i punonjësve	Me arsim të lartë		
	Me arsim të mesëm të përgjithshëm		
	Me arsim të mesëm profesional		
	Me certifikata/diploma ndërkombëtare		
	Me certifikatë kualifikimi etj.		
Informacione të tjera	Numri i kateve të strukturës akomoduese		
	Ashensor		
	Dhoma pa tualet personal		
	Tualete të përbashkëta		
	Vende parkimi		
	Pishinë	☐ e jashtme ☐ e brendshme	
	Mjedise të tjera argëtuese e sportive		
	Ofrim i vakteve të tjera		
	Ofrim i akomodimit për një kohë të shkurtër (më pak se një natë fjetjeje)		
	Pronari i strukturës fle në të njëjtën strukturë		
	Struktura është në funksion të veprimtarisë “agroturizëm”	☐ Po	☐ Jo
	Mjete kontakti	Email	
Telefon fiks			
Website			
Nr. cel.			



- Unë, i nënshkruari _____, deklaroj se jam njohur me urdhrin e ministrit nr. _____, datë _____, “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurën e kategorizimit të strukturave akomoduese” dhe plotësoj të gjitha kriteret e parashikuara në shtojcën 4, për kategorinë e strukturës akomoduese për të cilën kam aplikuar.

- Në dijeni të përgjegjësive penale që rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale të plotë ligjore deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta, konfirmoj njësinë e kopjes elektronike të dokumenteve shoqëruese të ngarkuara në aplikim me origjinalin dhe në respektim të ligjit nr. 9889, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, autorizoj me vullnetin tim të lirë institucionin, të përpunojë dhe të përdorë të dhënat e mia personale, për qëllime statistikore dhe të shqyrtimit të aplikimit.

SHTOJCA 5/a Kriteret – Bujtina

Fushat	Nr.	Kriteret
I. Të dhëna të përgjithshme mbi bujtinën		
Ndërtesa	1	Bujtina është një godinë që ka kryesisht stil tradicional rajonal, të integruara në mjedisin rrethues – përputhen me traditën dhe arkitekturën lokale të vendit
	2	Dekore sipas stilit lokal (dekorimet janë në stilin tradicional, tipik të rajonit/vendit. Kur dekorimet janë funksionale, ato nuk duhet të paragesin rrezik për shëndetin dhe sigurinë
	3	Sendet personale të pronarëve të shtëpisë pritëse nuk duhet të jenë në ambientet që shfrytëzohen nga klientët
Mirëmbajtja, pastërtia dhe siguria	4	Gjendja e ndërtesës të jetë e qëndrueshme, e sigurt dhe e mirëmbajtur Të gjithë mekanizmat dhe pajisjet që ofrohen të jenë funksionale dhe të padëmtuar
	5	Dhomat, ambientet e përbashkëta, korridoret dhe vendet ku kalohet, të mbajtura pastër në çdo kohë
	6	Të gjitha tualetet dhe dhomat e duzeve pastrohen çdo ditë kontrollohen për të siguruar standardet e përshtatshme të pastërtisë (1)
	7	Gjendje e mirë dhe ndriçim i përshtatshëm i fasadave dhe i ambienteve të mbikëqyruara prej bujtinës
	8	Shërbimi i mirëmbajtjes të ofrohet jo më pak se 12 orë në ditë
Zona e mirëseardhjes	9	Të gjitha pajisjet elektrike ose të gazit duhet të mirëmbahen, të jenë në vend të sigurt dhe në gjendje të mirë pune
	II. Ambienti i përbashkët/për publikun	
	10	Të disponojë një zonë mirëseardhjeje
	11	Pritësi në zonën e mirëseardhjes të jetë i aftë për të komunikuar në anglisht
	12	Bujtina ofron shërbim <i>check-in</i> nga ora 07:00–19:00
	13	Person përgjegjës i arritshëm në telefon, në intervalin kohor 19:00–07:00 (në rastet kur pronari nuk jeton në të njëjtën bujtinë)
	14	Afishim i çmimit dhe çdo shërbim që përfshihet, si dhe taksat apo detyrime të tjera, politikat e rezervimit, ndryshimit dhe anulimit dhe çdo informacion shtesë që kërkon klienti para kryerjes së rezervimit
	15	Informacion për zonën, aktivitetet që kryen, kulturën, traditat ose atraksione të tjera objekte për të vizituar (p.sh., si: muzetë, kështjella, evente, parqe natyrore, aktivitete miqësore) (2)
	16	Klientët informohen saktë në formë elektronike ose me materiale të printuara për shërbimet që ofrohen
	17	Regjistrimi i klientëve të bujtinës në një regjistër të veçantë, përfshirë identitetin e tij, nr. e pasaportës/së kartës së identitetit, nr. e netëqëndrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën
	18	Pronari ose personeli duhet të jenë në krye të detyrës gjatë mbërritjes dhe nisjes së klientëve, si dhe gjatë kohës së vaktit (mëngjes, drekë/darkë)
	19	Klienti njoftohet në kohë për çdo situatë që mund të ndikojë negativisht në qëndrimin e tij në bujtinë
	20	Aksesi në dhomë sigurohet gjatë gjithë qëndrimit të klientit në bujtinë
	21	Shërbim për mbajtjen/ruajtjen e bagazheve
	22	Një tharëse flokësh të jetë në dispozicion të klientëve
	23	Kuti e ndihmës së shpejtë e pajisur siç duhet
	24	Sistem për thirrjen e urgjencës mjekësore
Korridoret, shkallët, kalimet dhe hapësirat e përbashkëta	25	Shenja treguese të vendosura qartë për daljet e emergjencës, dhomat, ashensorët (nëse ka), recepsionin dhe ambiente të tjera
	26	Sistem efektiv i ventilimit: natyral ose mekanik
	27	Duhet të ketë një dhomë ndenjeje dhe zonë ngrënieje



	28	Në rastin kur në dhomat e gjumit nuk ka televizorë, duhet të ketë një të tillë në një dhomë/sallë ndenjeje që ka mobilie të rehatshme
	29	Korridoret dhe shkallët të lira nga çdo pengesë
	30	Niveli i ndriçimit në të gjitha hapësirat publike duhet të jetë i përshtatshëm për siguri dhe rehati. Shkallët dhe sheshpushimet duhet, gjithashtu, të kenë dritë të mjaftueshme gjatë natës
III. Dhomat e gjumit për klientët		
Të përgjithshme	31	Secila dhomë të ketë hyrje të veçantë dhe të pavarur (3) dhe të tregohet me numra ose shenja të tjera
	32	Nuk lejohen shtretër të mbivendosur (tip marinari) dhe shtretër portativë (4)
	33	Numri maksimal i: - shtretërve shtesë: 2 - personave në dhomë: 4
*Standardi i hapësirës së dhomës	34	Sipërfaqja minimale e dhomës akomoduese për një person, duke përfshirë banjën (nëse kjo e fundit ofrohet në dhomë) është 9 m ² dhe ka hapësirë për të siguruar lëvizjen e lehtë nëpër dhomë
	35	Sipërfaqja minimale e zonës së kuzhinës për dhomat për një person, duke përfshirë banjën (nëse kjo e fundit ofrohet në dhomë), kur kemi akomodim me vetëshërbim (5) është 8 m ²
	36	Sipërfaqja minimale e dhomës akomoduese për dy persona, duke përfshirë banjën (nëse kjo e fundit ofrohet në dhomë) është 13 m ²
	37	Sipërfaqja minimale e zonës së kuzhinës për dhomat për dy persona, duke përfshirë banjën (nëse kjo e fundit ofrohet në dhomë), kur kemi akomodim me vetëshërbim (6) është 12 m ²
	38	Sipërfaqja dhomë shtesë prej 3 m ² për çdo person tjetër të shtuar
		*Kriteret dhe sipërfaqet nuk janë të vlefshme për shtëpitë karakteristike tradicionale dhe të shpallura si monument kulture.
Shtrati (Përmasat dhe cilësia)	39	Përmasa minimale e shtratit tek: 80 cm x 190 cm Përmasa minimale e shtratit dopio: 140 cm x 190 cm
	40	Shtrojat: 2 çarçafë, këllëf jastëku, batanije dhe mbulesë
	41	Jastëk shtesë për çdo person sipas kërkesës
	42	Batanije shtesë për çdo person sipas kërkesës
	43	Shtrojat ndërrohen të paktën një herë në javë ose sipas kërkesës së klientit dhe për çdo klient të ri
	44	Të gjithë dyshekët duhet të jetë të rehatshëm, të pastër, pa njolla apo erë, në gjendje të mirë
	45	Të gjithë shtretërit duhet të rregullohen çdo ditë
Mobilimi dhe komoditeti i dhomës	46	Dritare/ballkon që lejon hyrjen e dritës natyrale dhe ajrosjen në dhomë
	47	Perde e errët (ose e ngjashme) që bllokon dritën natyrale/dritat e jashtme
	48	Një karrige ose kolltuk
	49	Së paku një komodinë për çdo dy persona ose dy komodinë për çdo 3 persona
	50	Një kosh mbeturinash
	51	Një pasqyrë vertikale për veshje
	52	Dollap rrobash me 5 varëse rrobash për person
	53	Sistem ngrohjeje dhe ftohjeje efektiv
	54	Dritë leximi individuale
	55	Të paktën një dritë të kontrolluar që nga dera
Shërbime shtesë në dhomë	56	Priza elektrike në dispozicion për përdorim të sigurt të gjitha pajisjeve elektrike individuale dhe atyre që ofrohen nga bujtina
	57	Të sigurojë minimalisht thirrjet telefonike brenda vendit
	58	Të sigurojë shërbimet e mirëmbajtjes
	59	Të disponojë një udhëzues për ndihmën në raste të emergjencës
	60	Plani i evakuimit i vendosur prapa derës së çdo dhomë
	61	Një gotë uji për çdo person
	62	Udhëzime të shkruara se si të kontaktohet pronari/personeli në rast emergjence gjatë 24-orëve
IV. Tualalet, dushet dhe pajisjet sanitare		
Struktura dhe pajisjet sanitare	63	Një tualet në kat dhe së paku një për çdo 6 persona (7)
	64	Ujë të rrjedhshëm të ngrohtë dhe të ftohtë
	65	Letër higjienike
	66	Lavaman
	67	Sapun të paketuar ose sapun të lëngshëm
	68	Kosh për mbetjet higjienike
	69	Dera e tualetit të jetë me mbyllje nga brenda
	70	Të gjitha tualetet duhet të jenë të ndriçuara mirë dhe temperatura e ambientit të jetë e përshtatshme
	71	Faqet anësore dhe dysheja e dushit/vaskës e veshur me material izolues (të papërshkueshëm nga uji)
	72	Mur me material të papërshkueshëm nga uji që pastrohet lehtë (pllaka qeramike etj.) deri në lartësinë 1,20 m
	73	Dy peshqirë për person (fytirë dhe trup) dhe varëset përkatëse
	74	Marrja e masave kundër rrëshqitjes në ambientet sanitare
	75	Aksesorë për mbajtjen e sendeve të tualetit me pasqyrë



	76	Çdo zonë sanitare të ketë një sistem të efektshëm të ventilimit natyral ose mekanik
	77	Një varëse rrobash për dushet e përbashkëta
	78	Priza elektrike për përdorim të sigurt të të gjitha pajisjeve elektrike
Lavamani në dhomë	Kur një lavaman është i vendosur në dhomën e gjumit duhet të ketë:	
	79	Aksesorë për mbajtjen e sendeve të tualetit me pasqyrë
	80	Një mbajtëse peshqiri (8)
	81	Një peshqir duarsh ose pajisje për tharjen e duarve
	82	Sapun të pakeluar ose sapun të lëngshëm në dhomë
V. Zona e ngrënies		
Shërbimi mëngjesit	83	Dhomë/mjedis për ngrënien e mëngjesit me kushte të përshtatshme për akomodimin e një kapaciteti maksimal klientësh
	84	Të ofrohet mëngjes i mjaftueshëm (9) dhe i shërbyer sipas standardeve
	85	Aksesorët për ngrënie të përshtatshëm dhe të mjaftueshme për t'i shërbyer një kapaciteti maksimal klientësh, të ulur në dhomën/mjedisin e ngrënies së mëngjesit. (10)
	86	Aksesorët për ngrënie janë të padëmtuar dhe u përmbahen kushteve optimale higjienike
	87	Një kuzhinë ose ambient, për përgatitjen e ushqimit të mëngjesit
Dreka/darka (nëse ofrohet)	88	Hapësirë/mjedis të pastër, të rregullt dhe të përshtatshëm për magazinim
	89	Ushqimi që shërbehet përpunohet, përgatitet dhe trajtohet sipas rregullave për sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve nga sëmundjet/dëmtimet, si pasojë e konsumimit të produkteve ushqimore me origjinë bimore e shtazore (vërtetuar nga dokumentet e lëshuara nga autoritetet përgjegjëse) (11)
	90	Ofrim i ushqimit vegjetarian sipas kërkesës
VI. Kuzhina (në rastet e akomodimit me vetëshërbim) (12)		
Pajisjet e kuzhinës	91	Frigorifer
	92	Lavapjatë me ujë të rrjedhshëm të ngrohtë dhe të ftohtë
	93	Një furrë dhe sobë me të paktën 2 plitka
	94	Një aspirator
	95	Servis gatimi dhe ngrënie (13) për të paktën 6 persona
	96	Mjete për të siguruar higjienën
	97	Të paktën dy peshqirë kuzhine
	98	Një mbulesë tavoline dhe të paktën 6 peceta
VII. Menaxhimi dhe stafi		
	99	Bujtina duhet të jetë nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të një personi, të aftë për ta drejtuar atë sipas standardeve të vendosura në këtë rregullore
	100	Stafi duhet të jetë i veshur në mënyrën e duhur, pastër dhe të jenë të kujdesshëm në çdo kohë

- (1) Tualetet dhe dhomat e dushave janë të pastra dhe me aromë të freskët.
- (2) Ky informacion mund të jepet në formën e broshurave, revistave ose nëpërmjet komunikimit verbal.
- (3) Dhomat që kanë komunikim me njëra-tjetrën do të quhen si një dhomë e vetme.
- (4) Ky kriter nuk është i vlefshëm për shtëpitë karakteristike tradicionale dhe të shpallura si monument kulture.
- (5) Një akomodim vetëshërbimi mund të përkufizohet si një shtëpi pushimi ose vilë e pastër, e rehatshme, e mobiluar dhe e pajisur me mjetet për të përgatitur dhe për të gatuar vetë ushqimin.
- (6) E vlefshme kjo sipërfaqe minimale e zonës së kuzhinës edhe për zonën e kuzhinës që përdoret nga persona të dhomave të ndryshme.
- (7) Në rastet kur dushi/vaska dhe VC-ja janë në ambiente të ndara, vlen po i njëjti rregull.
- (8) Një radiator nuk është i pranueshëm, por një unazë për mbajtjen e peshqirit ose një raft afër radiatorit është i përshtatshëm.
- (9) Mëngjes i mjaftueshëm ofron të paktën një pije të ngrohtë (kafë ose çaj), një lloj buke, drithëra, gjalpë, reçel/mjaltë/lloj tjetër kremrash të ëmbël, vezë, qumësht.
- (10) Gota, pjata, filxhanë, peceta, servis i ngrënies.
- (11) Preferohet që për vaktin e drekës apo të darkës të ofrohen ushqime tradicionale të zonës.
- (12) Në këtë rast, nuk aplikohen kriteret për shërbimin e mëngjesit, drekës dhe darkës.
- (13) Të tilla, si: tigan, tenxhere, tavë, pjata, servis ngrënie, filxhanë, gota etj.

SHTOJCA 5/b
Kriteret – Fjetinë (Hostel)

Fushat	Nr.	Kriteret
I. Të përgjithshme		
Ndërtesa dhe gjendja e përgjithshme	1	Struktura akomoduese duhet të jetë një godinë e veçantë Godina të ketë një konstruksion të qëndrueshëm, të sigurt dhe të jetë e mirëmbajtur tërësisht
	2	Të jetë e përshtatshme për aktivitetin që zhvillohet dhe e pajisur për qëllime të ofrimit të shërbimeve të fjetinës
	3	Struktura akomoduese duhet të përdoret për akomodim të klientëve që paraqiten me ose pa rezervim, duke i siguruar atyre shërbim në orare të arsyeshme
	4	Ndriçim i mjaftueshëm jashtë dhe brenda godinës, për të siguruar një funksionim normal të aktiviteteve, si p.sh., lexim, ngrënie etj.



	5	Sistem ngrohje/ftohje që siguron një temperaturë të rehatshme në të gjitha ambientet e brendshme, si dhe ventilim natyral ose mekanik
Mirëmbajtja, pastërtia dhe Siguria	6	Të gjitha ambientet pastrohen dhe kontrollohen 3 herë në javë, për të siguruar një standard të lartë pastërtie
	7	Shërbimi i mirëmbajtjes të ofrohet 8 orë në ditë
	8	Hyrje e kontrolluar në portën kryesore për të mundësuar sigurinë e klientëve dhe të sendeve të tyre
	9	Ambient për magazinimin e materialeve dhe të pajisjeve për përdorim të brendshëm, si p.sh., materiale pastrimi, çarçafë dhe jorganë shtesë etj.
II. Ambienti i përbashkët/për publikun		
Zona e pritjes	10	Zona e pritjes e pajisur me tryezë ose banak për t'u shërbyer klientëve
	11	Regjistrimi i klientëve të fjetinës në një regjistrer të veçantë, përfshirë identitetin e tij, nr. e pasaportës/së kartës së identitetit, nr. e netëqëndrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën
	12	Kënd për paraqitjen e materialeve informative të përditësuara, si dhe oferta për aktivitete të ndryshme të organizuara
	13	Person përgjegjës i aftë të komunikojë anglisht dhe të asistojë nevojat e klientëve
	14	Person përgjegjës për të shërbyer të paktën 12 orë në ditë
	15	Procedura të qarta dhe lehta të mënyrës së pagesës Rezervimet duhet të jenë në dispozicion përmes formave të ndryshme (telefon, <i>email</i> , prenotim direkt, <i>online</i> etj.)
	16	Afshim i informacionit për rregullat, oraret dhe shërbimet e funksionimit të fjetinës
	17	Sistem i sigurt për depozitat e sendeve personale
	18	Shërbim për mbajtjen/ruajtjen e bagazheve
	19	Kutia e ndihmës së shpejtë në reception
	20	Telefon publik në zonën e pritjes dhe afshim i numrave të emergjencës. Udhëzime të shkruara se si të kontaktohet personeli në raste emergjence gjatë 24 orëve
	21	Afshim i çmimit dhe çdo shërbim që përfshihet, si dhe taksat apo detyrime të tjera, politikat e rezervimit, ndryshimit dhe anulimit dhe çdo informacion shtesë që kërkon klienti para kryerjes së rezervimit
	22	Zona e pritjes duhet të jetë e ndarë nga zona e kuzhinës/e ngrënies
Dhoma e përbashkët	23	Struktura duhet të ketë të paktën një dhomë të përbashkët
	24	Dhoma e përbashkët duhet të përmbajë mobilie dhe pajisje funksionale.
III. Dhomat e gjumit për klientët		
Të përgjithshme	25	Numri maksimal i personave në dhomë: 12
	26	Të gjitha dhomat kanë hyrje të veçantë dhe të pavarur (1)
	27	Dhomat të kenë numër ose emër, të vendosur në mënyrë të qartë
	28	Fjetoret duhet të ndahen sipas gjinive. Nëse nuk është e mundur, klientët duhet të informohen në kohën e rezervimit
	29	Nuk lejohet akomodimi i të miturve të pashoqëruar në fjetoret me gini të përziera. Në fjetore duhet të afishohet qartë ky shënim
	30	Hapësirë e mjaftueshme në dhomë për të lëvizur lirisht. Dhoma duhet të jetë në madhësinë e duhur dhe të mobiluara për të siguruar nivele normale përdorimi
Standardi i hapësirës së dhomës	31	Nëse shtretërit përbëhen vetëm nga një njësi (tek), hapësira organizohet duke ruajtur raportin 50% sipërfaqe e lirë
	32	Nëse shtretërit përbëhen vetëm nga dy njësi (marinar) ose përzierje e të dyja llojeve, hapësira organizohet duke ruajtur raportin 60% sipërfaqe e lirë
	33	Sipërfaqja minimale e dhomës për një person, duke përfshirë banjën (nëse kjo e fundit ofrohet) 5 m ²
	34	Sipërfaqja minimale e dhomës për dy persona, duke përfshirë banjën (nëse kjo e fundit ofrohet) 7 m ²
	35	Sipërfaqe dhome shtesë e nevojitur për çdo person tjetër të shtuar me shtrat tek/marinar 3 m ² /2 m ²
Shtrati (përmasat dhe cilësia)	36	Përmasa minimale e shtratit tek: 80 cm x 190 cm
	37	Përmasa minimale e shtratit dopio: 140 cm x 190 cm
	38	Shtrojat: 2 çarçafë pambuku të pastër njëngjyrësh, mbulesë/jorgan, këllëf jastëku
	39	Një jastëk për person
	40	Jastëk/batanije shtesë për çdo person sipas kërkesës
	41	Të gjitha shtrojat duhet të jenë të pastra dhe në sasi të mjaftueshme, në bazë të sezonit dhe nevojave të klientit
	42	Shtrojat ndërrohen për çdo klientë të ri dhe të paktën një herë në javë ose sipas kërkesës së klientit (me ose pa pagesë)
Mobilimi dhe komoditeti i dhomës	43	Dritare/ballkon për ndriçim natyral, si dhe ventilim natyral ose mekanik
	44	Perde e errët (ose e ngjashme) që bllokoi dritën natyrale/dritat e jashtme
	45	Priza elektrike në dispozicion për përdorim të sigurt të të gjitha pajisjeve elektrike individuale.
	46	Kosh mbeturinash
	47	Mundësi për akses individual në dhomë (çelës, kartë etj.)
IV. Tualeti, dushet, dhe pajisjet sanitare		
Të përgjithshme	48	Një banjë në kat dhe së paku një për çdo 6 persona
	49	Në rastet kur dushi dhe VC-ja janë në ambiente të ndara, duhet të ketë një VC-ja dhe dush për çdo 8 persona ose nga një në çdo kat



	50	Në rastet kur dushi dhe VC-ja janë në ambiente të ndara, duhet të ketë lavaman në secilën prej tyre
	51	Duhet të ketë privatësi mes gjinive në dushe dhe tualete
	52	Ambientet e dusheve dhe të dhomave të zhveshjes duhet të kenë ndarëse ose dritare opake për të siguruar privatësi
	53	Të gjitha pajisjet sanitare duhet të jenë funksionale dhe të mirëmbajtura
	54	Ujë i rrjedhshëm i ftohtë dhe i ngrohtë
	55	Dysheme me material kundër rrëshqitjes dhe muret me material izolues, që pastrohet dhe mirëmbahet lehtë
Pajisjet sanitare	56	Ambientet sanitare duhet të jenë të pajisura si më poshtë: pasqyrë, varëse peshqiri dhe rrobash, kapak VC-je, mbajtëse sapuni dhe sapun të paketuar ose të lëngshëm, letër higjienike në mbajtësen përkatëse, kosh për mbetjet higjienike
	57	Dera e tualetit të jetë me mbyllje nga brenda
	58	Faqet anësore dhe dyshemeja e dushit e veshur me material izolues (të papërshkueshëm nga uji)
V. Zona e ngrënies		
Shërbimi i mëngjesit, dreka/darka (nëse ofrohet)	59	Përmasat e zonës së ngrënies, si dhe serviset e ngrënies (pjata, gota, lugë, pirunë etj.) të jenë në proporcion me kapacitetin e fjetinës
	60	Tryezat dhe karriget duhet të jenë në numër të mjaftueshëm dhe të vendosura në mënyrë të përshtatshme për të mundësuar kalim pa pengesa të stafit
	61	Serviset e ngrënies (pjatat, gotat, mbulesat etj.) duhet të jenë në gjendje të mirë
	62	Shërbimi nuk duhet të kalojë përmes zonave të përbashkëta që përdoren si zonë pritjeje ose korridore kryesore
	63	Ushqimi mund të jetë i kufizuar në zgjedhje, por duhet të jetë i një cilësie të mirë, që u përmbahet standardeve të përcaktuara nga legjislacioni (2)
	64	Duhet të ketë personel të mjaftueshëm në dispozicion për të shërbyer
	65	Nëse kërkohet në kohën e rezervimit, duhet të ketë të paktën një opsion për ofrimin e një ushqimi vegjetarian
VI. Kuzhina me vetëshërbim (nëse ofrohet)		
Pajisjet e kuzhinës	66	Mjedis përgatitjeje dhe gatimi për klientët, për të mbajtur, për të ruajtur, për të përgatitur dhe për të konsumuar ushqime të ngrohta dhe të ftohta, i cili përmbush kriteret e higjienës
	67	Të ketë përmasa të përshtatshme në proporcion me kapacitetin e fjetinës dhe pajisjet e saj të jenë në gjendje funksionale
	68	Frigorifer ose njësi ftohëse
	69	Tavolinë ose njësi për përgatitjen e ushqimit me sipërfaqe të padëmtuar dhe që pastrohet lehtësisht
	70	Pajisje gatimi
	71	Lavaman me ujë të ftohtë dhe të ngrohtë
	72	Kosh plehrash me kapak në vendndodhje të përshtatshme Nuk lejohet të mbahen plehrat në kuzhinë dhe duhet të hiqen rregullisht
	73	Pjata, gota, pirunë, lugë, thika në sasi të mjaftueshme që të mbulojnë nevojat e klientëve që akomodohen
	74	Kuzhina duhet të jetë e vendosur pranë ose lehtësisht e aksesueshme nga zona e ngrënies
VII. Shërbime shtesë		
	75	Ambient i përshtatshëm për larjen dhe tharjen e rrobave, si dhe mjaftueshëm, makina larëse për të mbuluar nevojat e klientëve
	76	Veprimtari argëtuese (3)
VIII. Menaxhimi dhe stafi		
	77	Fjetina duhet të jetë nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të një personi, të aftë për ta drejtuar atë sipas standardeve të vendosura në këtë rregullore
	78	Stafi duhet të jetë i veshur në mënyrën e duhur, pastër dhe kujdesshëm në çdo kohë

(1) Dhomat që kanë komunikim me njëra-tjetrën do të quhen si një dhomë e vetme.

(2) Menuja duhet të përmbajë të paktën 6 nga lista e mëposhtme, lloje pijesh të ngrohta dhe të ftohta, një lloj buke, një lloj ëmbëlsire, një lloj drithi, reçel/marmelatë/mjaltë, gjalpë, vezë, djathë, kos, sallam, fruta e të tjera.

(3) Tavolinë bilardoje, makinë lojërash, akses në internet, pingpong, bibliotekë, dhomë lojërash, internet kafe etj.



SHTOJCA 5/c
Kriteret – Kamping

Fusha	Nr.	Kriteret
I. Të përgjithshme		
Kapaciteti	1	Të paktën 10 parcela, ku “parcela” nënkupton vend qëndrimi të përkohshëm të karavanëve/tendave (tenda, vend për kamperin)
	2	Të paktën 70% e hapësirës duhet të jetë për parkimin e përkohshëm të <i>camper/caravan</i> , shtëpive të lëvizshme, tendave ose pajisjeve të tjera të marra me qira nga klientët
	3	30% e hapësirës duhet të jenë njësi të ndërtuara ose pajisje të palëvizshme kampingu për shërbimet e tjera ndaj klientit (receptsi/ambientet sanitare/restorant etj.)
Hyrje-dalja	4	Rrethim natyror ose artificial i vendosur rreth kampit
	5	Hyrje-dalje e përshtatshme dhe e ndriçuar për automjetet në kamp
	6	Hyrja kryesore dhe i gjithë kampingu i pajisur me sinjalistikë rrugore për kufizim shpejtësie të lëvizjes së automjeteve në brendësi të kampingut (përfshirë police të shtrirë) dhe sinjalistikë për godinat e shërbimeve të ofruara
Lidhjet dhe lëvizshmëria	7	Ndalim qarkullimi me automjete në brendësi të kampingut në orët e natës
	8	Lidhje me rrugët publike
	9	Rruga kryesore e brendshme me material të fortë (beton, pllaka guri, asfalt, zhavorr etj.)
Hedhja e mbeturinave të ngurta dhe të lëngshme	10	Shtigjet komunikuese me gjerësi të mjaftueshme (jo më pak se 1 m) dhe lehtësisht të përshkueshme
	11	Të gjitha rrugët dhe shtigjet të jenë të ndriçuara dhe të mirëmbajtura
	12	Mbajtja e mbeturinave në konteinorë të mbyllur: largim i mbeturinave rregullisht
Mirëmbajtja	13	Pajisja e të gjithë hapësirës së kampingut me kosha plehrash
	14	Mirëmbajtja e rregullt e pajisjeve, mobileve dhe objekteve që ofrohen nga kampingu, në gjendje funksionale pune
	15	Kampingu duhet të dezinfektohet të paktën një herë në vit
II. Receptsi dhe shërbimi i pritjes		
Receptsi	16	Kampingu përmban një ambient për pritjen (receptsi), përcjelljen e klientëve dhe kontrollin e personave që vizitojnë kampingun, i cili ndodhet pranë hyrjes, i dallueshëm për klientët, i pajisur me një banak/një tavolinë e karrike
	17	Regjistrimi i klientëve të kampingut në një regjistër të veçantë, përfshirë identitetin e tij, nr. e pasaportës/së kartës së identitetit, nr. e netëqendrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën
	18	Receptsi mbahet pastër në çdo kohë
	19	Receptsi është i pajisur me ngrohje, përveç kampeve që operojnë në verë
	20	Receptsi i hapur të paktën 8 orë, me orar të afishuar në ambientet e receptsit
	21	Shërbimi i sigurisë përgjatë natës
	22	Numër telefoni i afishuar për personin përgjegjës, i cili është i arritshëm në telefon 24 orë për pushuesit e kampingut
	23	Receptsi ka njohuri bazë në të paktën një gjuhë të huaj
	24	Sistemi i sigurt për materialet me vlerë në zonën e pritjes
	25	Kuti e ndihmës së shpejtë e pajisur siç duhet
	26	Shërbim telefoni publik në ambientin e pritjes dhe afishim i numrave të emergjencës.
	27	Shërbim interneti (<i>Wi-Fi</i>)
	28	Informacione dhe fletëpalosje për zonën
	29	Për një akses të drejtpërdrejtë, në një vend të dukshëm në ambientin e pritjes, janë të afishuara rregullat e njësisë, të shtypura në gjuhën shqipe dhe angleze
	30	Afishim i planimetrisë së kampingut, ku reflektohet ndarja e parcelave të kampingut dhe i strukturave të shërbimeve
	31	Çmimet e të gjitha shërbimeve dhe të dhënies me qira të pajisjeve, janë të afishuara në vendin më të dukshëm, në ambientin e pritjes (receptsi)
	32	Të paktën 2 vende parkimi në afërsi të receptsit
III. Njësitë bazë të akomodimit		
Parcelat	33	Zona për vendosjen e mjeteve të lëvizshme të ndara zonat për tenda dhe zonat për karavan dhe kamper
	34	Hapësira për kampingun e sistemuar (pastruar nga bimët, gurët etj.)
	35	Kampingu i ndan parcelat sipas përmasave të njësisë së akomodimit duke respektuar të paktën 5 metra hapësirë të lirë në të gjitha anët e tendës/kamperit dhe karavanës
	36	80% e parcelave duhet të ketë mundësi për furnizim me energji elektrike
IV. Nyjat sanitare	37	Nëse kampingu ofron edhe akomodim në shtëpi druri apo struktura të tjera të palëvizshme, këto të fundit nuk mund të jenë më shumë se 20% e sipërfaqes totale të kampingut dhe duhet të respektojnë kushtet e parashikuara për shtëpitë e drurit/vilat në aneksin mbi resortet
	38	Në kampingjet që kanë mbi 50 njësi, nyjat sanitare (VC dhe dushe) duhet të jenë të vendosura në dy hapësira të ndryshme, të shpërndara për të mundësuar aksesin e lehtë nga të gjithë pushuesit e kampingut
Të përgjithshme	39	Për çdo 30 parcela, kampingu ka të paktën:



		- 3 VC për burra dhe 3 për gra
		- 2 dushe për burra dhe 3 për gra
		- 4 lavamanë me pasqyrë
	40	Për çdo 10 parcela shtesë, ka të paktën 1 tualet, dush dhe lavaman shtesë
	41	Ambientet sanitare duhet të kenë një largësi minimale prej 10 m nga parcelat, por gjithsesi në një largësi të përshtatshme dhe lehtësisht të arritshme nga të gjithë
	42	Dyer jotransparente deri në lartësinë 2 m, të pajisura me sistem për mbylljen e derës
	43	Prizë energjie elektrike në afërsi të lavamanëve
	44	Furnizimi me ujë të ftohtë dhe të ngrohtë
	45	Kontenitor mbeturinash
Ambienti i dushit	46	Hapësira e dushit/kabina/ndarja e dushit nuk duhet të jetë me e vogël se 100 x 160 cm
	47	Mbajtëse peshqiri
	48	Mbajtëse rrobash
Higjiena dhe kushtet e përgjithshme	49	Dyshe, tavane dhe mure të pastra
	50	Dysheja dhe muret e nyjave sanitare është e shtruar me material jo të rrëshqitshëm dhe izolues nga uji, që pastrohet lehtësisht
	51	Pajisjet sanitare të pastruara dhe dezinfektuara
	52	Instalime funksionale (elektrike, hidraulike etj.)
	53	Të kenë ndriçim të përshtatshëm
	54	Ventilim natyral ose mekanik
	55	Sistem ngrohje, përveç aktivitetëve që operojnë vetëm në verë
Tualetet kimike (nëse ka)	56	Tualetet kimike lejohen vetëm nëse sigurohet shërbimi për pastrimin dhe për mirëmbajtjen e tyre
	57	Në kabinë vendoset tabelë me emërtimin: “Kabinë kimike”, në gjuhën shqipe dhe atë angleze
	58	Rubinet me ujë të ftohtë me tub fleksibël për pastrim
	59	Lavaman me ujë të rrjedhshëm
	60	Ndriçim i përshtatshëm
	61	Ventilim natyral ose mekanik
V. Ambienti për larjen e enëve dhe veshjeve personale		
Ambienti për larjen e enëve	62	Dy lavapjata inoksi për çdo 50 vende kampimi
	63	Në ambientin për larjen e enëve vendoset tabelë me emërtimin: “Ambient për larjen e enëve”, në gjuhën shqipe dhe angleze
	64	Zonë e mbuluar për larjen e enëve
	65	Deri në 50% të lavapjatarave mund të zëvendësohen me makinë larëse në raportin 1 makinë larëse zëvendëson 3 lavapjata
Ambienti për lavandinë e veshjeve personale	66	Dy vaska për larjen e veshjeve ose një vaskë e pajisur me dy rubinete, me ujë të ftohtë dhe të ngrohtë për 50 parcela
	67	Në ambientin për larjen e veshjeve vendoset tabelë me emërtimin “Ambient për larjen e veshjeve”, në gjuhën shqipe dhe angleze
	68	Zonë e mbuluar për larjen e veshjeve
	69	Deri në 50% të vaskave të larjes mund të zëvendësohen me makinë larëse, në raportin 1 makinë larëse zëvendëson 3 vaska larëse
VI. Elemente të tjera		
Shërbime	70	Mjedise ose struktura për ofrimin e ushqimit dhe pajisjeve bazë të nevojshme për kamping, nëse këto nuk mund të blihen në një dyqan/restorant tjetër, jo më larg se një km nga kampingu
Aktivitete sportive rekreative	71	Kampingjet, me kapacitet deri në 50 njësi, duhet të ofrojnë të paktën një nga aktivitetet e listuara më poshtë
		Kampingjet, me kapacitet mbi 50 deri në 100 njësi, duhet të ofrojnë të paktën dy nga aktivitetet e listuara më poshtë
		Kampingjet, me kapacitet mbi 100 njësi, duhet të ofrojnë të paktën tri nga aktivitetet e listuara më poshtë



SHËTOJCA 5/ç Kriteret – Hotel

Fusha	Nr.	Kriteret
I. Të dhëna të përgjithshme mbi hotelin		
Ndërtesa	1	Ambientet përfshijnë një ose më shumë ndërtesa që ndodhen në të njëjtin shesh/vend (i cili përmban edhe ndërtesën kryesore të hotelit) dhe që janë fizikisht të lidhura me shtigje të ndriçuara dhe ndajnë hyrje dhe dalje të përbashkëta
	2	Në rastin e hotelit të përbërë nga disa ndërtesa, këto ndërtesa duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe fizikisht të lidhura me ndërtesën kryesore me shtigje të ndriçuara mirë. Këto ndërtesa përfshijnë dhomat e klientëve me tualete private, ambiente magazinimi, shkallë dhe korridore që përmbushin kriteret e parashikuara më poshtë
	3	Hoteli i përbërë nga disa ndërtesa operon nën mbikëqyrjen e rregullt dhe mirëmbajtjen e menaxhimit dhe stafit të ndërtesës kryesore të hotelit
Pastërtia/Higjiena	4	Pastërtia dhe higjiena janë parakushte themelore në të gjitha kategoritë - kushte në të gjitha mjediset e brendshme dhe të jashtme të strukturës akomoduese (dyshemetë, muret, tavanet, mobilet, dyert, dritaret dhe çdo pajisje tjetër pa dëmtime, njolla dhe shenja të tjera)
Mirëmbajtja	5	Të gjithë mekanizmat dhe pajisjet janë funksionale dhe në gjendje pune
Përshtypja e përgjithshme	6	Përshtypja e përgjithshme është e mjaftueshme për kërkesa të thjeshta [1]
	7	Sistem për mbrojtjen nga zjarri dhe afishim në korridore i planit të evakuimit dhe i udhëzimeve në rast zjarri
	8	Rregullore e brendshme për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi
	9	Dokumente të përditësuara të lëshuara nga autoritetet përgjegjëse, që konfirmojnë përmbushjen e të gjitha kushteve dhe rregullave për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi për strukturat akomoduese (VKM nr. 699, datë 22.10.2004, “Për miratimin e rregullave teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në konstruksionet dhe ndërtimet, që shërbejnë për veprimtari akomoduese turistike”)
II. Recepsioni dhe shërbimet		
Recepsioni	10	Hapësirë vizualisht e ndarë/tavolinë e dedikuar për shërbimet e recepsionit
	11	Shërbimi i pritjes (recepsionit) dhe person në dispozicion për <i>check-in</i> , sipas një marrëveshjeje
	12	Protokoll i brendshëm i hotelit lidhur me detyrat e stafit sipas profileve të tyre
	13	Regjistrim i klientëve të hotelit [2]
	14	Vendosja e numrave të shërbimeve mjekësore dhe të urgjencës
	15	Kutia e ndihmës së shpejtë në recepsion
	16	Publikimi i listës së çmimeve tavan të dhomave, në gjuhën shqipe dhe të paktën në gjuhën angleze. Afishim i çmimit dhe çdo shërbim që përfshihet, si dhe taksat apo detyrime të tjera, politikat e rezervimit, ndryshimit dhe anulimit dhe çdo informacion shtesë që kërkon klienti para kryerjes së rezervimit, në përputhje me ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorit”
	17	Kasafortë qendrore në recepsion/facilitete të ruajtjes së sendeve me vlerë
	18	Shërbim i ruajtjes së bagazheve
	19	Tualetet të përbashkëta në recepsion [3]
Të ndryshme	20	Material informues për rajonin, të vendosura në ambientet e përbashkëta
III. Dhoma		
Komoditeti i gjumit	21	Sipërfaqja e dhomave dopio (duke përfshirë tualetin, pa përfshirë ballkonin/tarracën) $\geq 14 \text{ m}^2$ [4]
	22	Shtat me dyshek, me teknologji bashkëkohore dhe të mirëmbajtur, me lartësi prej të paktën 13 cm
	23	Shtretër tek, me përmasa minimale 0.80 m x 1.90 m dhe shtretër dopio, me përmasa minimale 1.60 m x 1.90 m [5]
	24	Seti i çarçafëve 100% pambuk ose një cilësi më të lartë
	25	Mbulesë/jorgan me vatinë ose pupla
	26	Jastëk i modelit bashkëkohor dhe i mirëmbajtur
	27	Mundësi për të errësuar dhomën (p.sh., perde)
Pajisjet e dhomës	28	Dollap i përshtatshëm ose zgjidhje alternative për varjen rrobave dhe ndarje për rrobat e palosura
	29	Një numër i përshtatshëm varësesh rrobash
	30	Varëse rrobash/portmanto jashtë dollapit
	31	Një karrige
	32	Tavolinë
	33	Prizë elektrike e aksesueshme në dhomë
	34	Ndriçim i përshtatshëm në dhomë me çelës kryesor në hyrje të dhomës
	35	Plani i evakuimit i vendosur prapa derës së çdo dhome
	36	Alarm zjarri (detektor tymi ose pajisje tjetër e ngjashme)
	37	Kosh për mbeturinat
Kontrolli i zhurmës/ajri i kondicionuar në dhomë	38	Sistem ngrohjeje dhe ftohjeje efektiv



Pajisje elektronike për argëtim	39	Pajisje TV në sallën e recepsionit, për hotelet, të cilat nuk kanë TV në çdo dhomë
Telekomunikacioni	40	Telefon publik të disponueshëm për klientët
Të ndryshme	41	Informacion i hotelit [6]
Informacion i përgjithshëm mbi tualetin	42	100% e dhomave me dush dhe WC ose vaskë dhe WC
	43	Mur me material të papërshkueshëm nga uji që pastrohet lehtë (pllaka qeramike, rezinë etj.) jo më pak se lartësia 1,20 m
	44	Dysheme me material kundër rrëshqitjes dhe të padepërtueshëm nga uji (pllaka qeramike, rezinë e të ngjashme)
	45	Ajrim natyral ose mekanik (aspirim-ventilim)
	46	Kosh për mbeturinat
	47	Mbajtëse letre higjienike dhe letër higjienike rezervë
	48	Mbulesë higjienike për ulësen e WC-së
	49	Faqet anësore dhe dyshemeja e vaskës dhe e dushit duhet të jenë të veshura me materiale izoluese të papërshkueshme nga uji
	50	Dush me perde
	51	Lavaman me ujë të rrjedhshëm, të ngrohtë dhe të ftohtë
	52	Pasqyrë
	53	Mbajtëse peshqiri horizontale ose në formë gripi
	54	Aksesorë për mbajtjen e sendeve të tualetit
	55	Sapun i paketuar ose sapun i lëngshëm në kontenitorë
Pastrimi i përditshëm i dhomës dhe tualeteve në dhomë	56	Xhel për larjen e trupit në dush në shishe të vogla ose në kontenitorë të fiksuar
	57	Shampo [7]
	58	1 peshqir të vogël për person
	59	1 peshqir të madh për person
IV. Gastronomia	60	Pastrimi i përditshëm i dhomës dhe i tualeteve në dhomë
	61	Ndërrim i përditshëm i peshqirëve me kërkesë
	62	Ndërrim i çarçafëve, minimalisht një herë në javë dhe për çdo klient të ri
Shërbimi i mëngjesit	63	Dhomë ngrënie për shërbimin e mëngjesit
	64	Mëngjes bufe [8] ose menu për mëngjesin
Shërbimi i ushqimit	65	Ofrimi i ushqimit në hotel
Siguria ushqimore	66	Ushqimi që shërbehet në hotel, përpunohet, përgatitet dhe trajtohet sipas rregullave për sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve nga sëmundjet/dëmtimet si pasojë e konsumimit të produkteve ushqimore me origjinë bimë ose shtazore dhe sipas sistemit HACCP. Ligji nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, dhe aktet nënligjore përkatëse (vërtetuar nga dokumentet e lëshuara nga autoritetet përgjegjëse)
Pije	67	Ofrimi pijeve në hotel
V. Hotel Apart. [9]		
Pajisjet e kuzhinës personale	68	Frigorifer
	69	Lavapjatë
	70	Një furrë dhe sobë me dy plitka
	71	Një aspirator
	72	Servis gatimi dhe ngrënie[10] për të paktën 6 persona
	73	Mjete pastrimi për të siguruar higjienën
	74	Të paktën dy peshqirë kuzhine
VI. Kualifikimi i stafit	75	Një mbulesë tavoline dhe të paktën 6 peceta
	76	Të gjitha shërbimet të ofrohen nga personel i kualifikuar dhe i identifikueshëm [11]
Personeli	77	Hoteli ka të punësuar një personel të mjaftueshëm në numër dhe të trajnuar për të mbajtur standardet e shërbimit të parashikuara në këto kritere
	78	I gjithë stafi trajnohet me fillimin e punësimit dhe në vazhdim sipas pozicionit
	79	Paraqitja, qëndrimi dhe pastërtia e personelit
Mjedise për personelin	80	Dushe, tualete dhe lavamanë
	81	Dhomë çlodhjeje dhe dhomë ngrënie
	82	Dhomë fjetjeje për personelin
	83	Dhomë ndërrimi

[1] Veçanërisht, mobilimi dhe pajisjet janë të përshtatshme dhe të mirëmbajtura.

[2] Strukturat akomoduese regjistrojnë në një regjister të veçantë për çdo klient identitetin e tij, nr. e pasaportës/kartës së identitetit, numrin e netëqëndrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën.

[3] Tualeti është i pajisur me: pasqyrë, lavaman, kosh për mbeturinat, sapun të lëngshëm, letra për duart ose pajisje për tharje të duarve, letër higjienike, varëse për rrobat, mekanizëm për mbylljen e derës, kosh për mbeturinat në kabinën për femrat.

[4] Sipërfaqja minimale e dhomave teke duhet të jetë 12 m².

[5] Nuk lejohen shtretërit e mbivendosur.



[6] Përfshin të paktën informacion për orarin e mëngjesit, *check out*, dhe orarin e hapjes së shërbimeve të hotelit.

[7] Ky kriter quhet i plotësuar nëse xheli për dush është i përshtatshëm edhe si shampo dhe kjo shënohet mbi etiketën e shishes.

[8] Përfshin të paktën një pije të ngrohtë (kafë ose çaj), një lëng frutash, mundësi zgjedhjeje frutash ose sallatë frutash, mundësi zgjedhjeje buke dhe gjalpë, reçel, proshutë, djathë, vezë dhe drithëra.

[9] Nëse hoteli ofron dhoma që përfshijnë një ambient gatimi.

[10] Të tilla si: tigan, tenxhere, tavë, pjata, servis ngrënie, filxhanë, gota etj.

[11] Për strukturat akomoduese me 4 dhe 5 yje, si dhe për strukturat me 2 dhe 3 yje, të cilat kanë më shumë se 25 dhoma, personeli duhet të jetë i veshur me uniformë.

SHTOJCA 5/d Kriteret – Motel

Fushat	Nr.	Kriteret
Të përgjithshme	1	Moteli duhet të ketë të paktën 6 njësi akomoduese
	2	Ndriçim i përshtatshëm në të gjitha ambientet (dhoma, korridore, shkallë, parkim etj.)
	3	Regjistrer ku mban të dhënat për secilin nga klientët që akomodon (si: emër, mbiemër, adresa, nr. i targës dhe modeli i makinës). Gjithashtu, duhet të shënohet data dhe ora e mbërritjes dhe e largimit nga moteli
	4	Nuk duhet t'u ofrojnë akomodim personave nën 18 vjeç, përveç rasteve kur janë të shoqëruar nga prindërit apo kujdestarët e tyre
Parkimi	5	Garazh individual ose parkim të përbashkët për çdo dhomë
		Vende parkimi 100% sa nr. i dhomave plus stafin
	6	Parkim pa pagesë
	7	Ndriçim në të gjithë sipërfaqen dhe survejim me kamera 24/7
	8	Gjithë zona e parkimit e rrethuar
Pastërtia dhe mirëmbajtja	9	Zona e parkimit e shtuar me asfalt dhe e pajisur me sinjalistikën përkatëse
	10	Kanale për kullimin e ujit në zonat e parkimit
	11	Pastërtia dhe higjiena janë parakushte themelore – kushte në të gjitha mjediset e brendshme dhe të jashtme të strukturës akomoduese
Personeli	12	Të gjithë mekanizmat dhe pajisjet në të gjithë ambientet e strukturës akomoduese janë funksionale dhe të padëmtuara
	13	Të gjitha shërbimet duhet të ofrohen nga personel i kualifikuar dhe i identifikueshëm
Kushtet e sigurisë	14	Sistem për mbrojtjen nga zjarri dhe afishim në korridore i planit të evakuimit dhe i udhëzimeve në rast zjarri
	15	Rregullore e brendshme për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi
	16	Dokumente të përditësuara të lëshuara nga autoritetet përgjegjëse, që konfirmojnë pëmbushjen e të gjitha kushteve dhe rregullave për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi
Receptioni	17	Shërbimi i pritjes (receptionit)
	18	Në hyrje njoftimi i dukshëm mbi kohën e punës
	19	Manuali i brendshëm i procedurave dhe i stafit të hotelit në gjuhën shqipe
	20	Publikimi i listës së çmimeve tavan të dhomave, në gjuhën shqipe dhe të paktën në gjuhën angleze. Afishimi i çmimit dhe çdo shërbim që përfshihet, si dhe taksat apo detyrime të tjera, politikat e rezervimit, ndryshimit dhe anulimit dhe çdo informacion shtesë që kërkon klienti para kryerjes së rezervimit
	21	Regjistrimi i klientëve në një regjistrer të veçantë, përfshirë identitetin e tij, nr. e pasaportës/së kartës së identitetit, nr. e netëqëndrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën
	22	Kutia e ndihmës së shpejtë në reception
	23	Vendosja e numrave të shërbimeve mjekësore dhe të urgjencës
	24	Kasafortë qendrore në reception/facilitete të ruajtjes së sendeve me vlerë (1)
Komunikimi	25	Shkallë kryesore për vizitorët, të cilat lidhin të gjitha katet
	26	Njësitë akomoduese të treguara me numra ose me shenja të tjera
Pastrimi i dhomës	27	Pastrimi i përditshëm i dhomës
	28	Ndërrim i çarçafëve, të paktën dy herë në javë dhe për çdo klient të ri
	29	Ndërrim i përditshëm i peshqirëve sipas kërkesës
Informacion i përgjithshëm mbi dhomat	30	Sipërfaqja e dhomave (duke përfshirë tualetin, pa përfshirë ballkonin/tarracën) $\geq 12,5 \text{ m}^2$
	31	Sipërfaqja e dhomave (duke përfshirë tualetin, pa përfshirë ballkonin/tarracën) $\geq 13,5 \text{ m}^2$
Komoditeti i gjumit	32	Dyshek me teknologji bashkëkohore, i mirëmbajtur, me lartësi prej të paktën 13 cm
	33	Shtretër te, me përmasa minimale 0.80 m x 1.90 dhe shtretër dopio, me përmasa minimale 1.60 m x 1.90 m
	34	Seti i çarçafëve 100% pambuk ose një cilësi më të lartë
	35	Mbulesë/jorgan me vatinë ose me pupla
	36	Jastëk bashkëkohor, i mirëmbajtur



	37	Mundësi për të errësuar dhomën (p.sh., perde)
	38	Rrugicë anës krevatit
Pajisjet e dhomës	39	Dollap i përshtatshëm ose zgjidhje alternative për varjen e rrobave
	40	Të paktën 3 varëse rrobash për person dhe të të njëjtit material dhe model.
	41	Një karrige
	42	Tavolinë
	43	Prizë elektrike e aksesueshme në dhomë
	44	Çelës kryesor për ndriçimin në hyrje të dhomës
	45	Kosh për mbeturinat
	46	Listë me çmimet e shërbimeve të motelit, minibarit (nëse ka)
	47	Televizor
	48	Listë me çmimet e kanaleve me pagesë (nëse ka)
Telekomunikacioni	49	Plani i evakuimit i vendosur mbrapa derës së dhomës
	50	Telefon publik të disponueshëm për klientët
Informacion i përgjithshëm mbi tualetin	51	Akses në internet në ambientet e përbashkëta (me fishë, <i>Wi-Fi</i>) (2)
	52	Banja/pajisjet sanitare $\geq 5\text{m}^2$
	53	100% e dhomave me dush dhe VC ose vaskë dhe VC me mbajtëse sigurie.
	54	Faqet anësore dhe dyshemeja e vaskës dhe dushit duhet të jenë të veshura me materiale izoluese të papërshkueshme nga uji
	55	Dush me perde/kabinë (3)
	56	Lavaman
	57	Peshqir për këmbët në tualet
	58	Ndriçim i përshtatshëm në lavaman
	59	Pasqyrë
	60	Prizë korenti e aksesueshme pranë pasqyrës
	61	Mbajtëse peshqiri horizontale ose në formë grepi
	62	Raft tualeti
	63	Gotë për furçën e dhëmbëve
	64	Sapun njëpërdorimësh ose sapun i lëngshëm në kontenitorë të fiksuar
	65	Xhel për larjen e trupit me shishe të vogla ose në kontenitorë të fiksuar
	66	Shampo për flokë në shishe të vogla ose në kontenitorë të fiksuar Shampoja duhet të ketë etiketë, në mënyrë që të jetë e identifikueshme
	67	Letër higjienike rezervë
	68	1 peshqir duarsh për person
	69	1 peshqir të madh për person
	70	Pantofla njëpërdorimshme (4) sipas kërkesës
	71	Prizë elektrike për makinën e rrojës
	72	Kosh për mbeturina
	73	Ajrim natyral ose mekanik (aspirim-ventilim)
	74	Dysheme me material kundër rrëshqitjes dhe e papërshkueshme nga uji
	75	Mur i veshur në një lartësi deri në 1,2 m, me material të papërshkueshëm nga uji
Mjedise për personelin	76	Dushe, tualete dhe lavamanë
	77	Dhomë çlodhjeje dhe dhomë ngrënie
	78	Dhomë fjetjeje për personelin
	79	Dhomë ndërrimi

(1) Ose një kasafortë në dhomë.

(2) Ose akses në internet në dhomë.

(3) Kabina nuk duhet të ketë përmasa më të vogla se 80 x 80 cm.

(4) Pantoflat plastike nuk janë të lejueshme.



SHTOJCA 5/dh

Kriteret - Qendër kurative

Tabela e mëposhtme është tabelë plotësuese që u bashkëngjitet kriterëve minimale të kategorisë “Hotel dhe resort”		
Fusha	Nr.	Kriteret
Të përgjithshme	1	Sipërfaqja e qendrës kurative të paktën 3 m ² /person, sipas kapacitetit të strukturës akomoduese, duke përfshirë sipërfaqet e jashtme dhe të brendshme.
	2	Sistem alarmi dhe lidhje e recepsionit të qendrës kurative me recepsionin kryesor.
	3	Programe për trajtim shëndetësor, kura.
	4	Kontrolle të vazhdueshme të ujit, higjienës, kujdesit shëndetësor etj.
	5	Ambientet të pastra dhe të mirëmbajtura.
	6	Stafi të jetë miqësor.
	7	Zona e pritjes në recepsion e pastër dhe e rehatshme.
	8	Plotësim i një formulari përshtypsh nga klienti përpara largimit nga qendra kurative.
Hapësira - objektet dhe pajisjet	9	Dhoma e recepsionit në qendrën kurative minimumi 25 m ² .
	10	Duhet të sigurohet një lidhje/kalim midis qendrës kurative dhe hotelit, i cili të ketë një temperaturë të përshtatshme.
	11	Recepsioni i qendrës kurative duhet të jetë i pajisur me informacione dhe listën e çmimeve.
Hapësira të tjera dhe elementët e pritjes	12	Hapësirë për stafin profesional të qendrës kurative, minimumi 10 m ² .
	13	Gardërobë për femrat me çelës, hapësirë për t'u ndërruar dhe dush, në raport me kapacitetin e qendrës kurative, një tharëse flokësh me pasqyrë, stol, karrige, peshqirë për duart dhe fytyrën, mbajtëse rrobash/peshqiri në formë horizontale ose grepi, sapun i lëngshëm.
	14	Gardërobë për meshkuj me çelës, hapësirë për t'u ndërruar dhe dush, në raport me kapacitetin e qendrës kurative, një tharëse flokësh me pasqyrë, stol, karrige, peshqir për duart dhe fytyrën, mbajtëse rrobash/peshqiri në formë horizontale ose grepi, sapun i lëngshëm.
	15	Tualet për femra në bazë të dispozitave të përgjithshme që duhen respektuar dhe në raport me kapacitetin e qendrës kurative.
	16	Tualet për meshkuj në bazë të dispozitave të përgjithshme që duhen respektuar dhe në raport me kapacitetin e qendrës kurative.
	17	Kosh për vendosjen e peshqirëve/rrobëdishanit të përdorur.
	18	Dhomë ndërrimi, dush dhe tualet për stafin e qendrës kurative.
	19	Sistem alarmi në të gjitha ambientet e qendrës kurative (dush, hidromasazh, pishinë etj.) të lidhura me recepsionin e qendrës kurative ose hotelit.
	20	Hapësirë qëndrimi e shoqëruar me muzikë të lehtë relaksi.
	21	Shërbimi të ofrohet të paktën 14 orë.
	22	Ofrimi i shërbimit të telefonit për thirrje të brendshme ose të jashtme.
	23	Personel i kualifikuar në recepsion.
	24	Ofrimi i shërbimeve nga një staf i kualifikuar (si, në fizioterapi, masazhe të ndryshme ose trajtime të tjera të ngjashme).
		Ofrimi i pijeve të ndryshme për klientët me vetëshërbim.
	25	Një person përgjegjës i cili do të monitorojë dhe do të kontrollojë teknologjinë e qendrës kurative dhe do të kujdeset për shërbimet e nevojshme dhe mirëmbajtjen e qendrës kurative.
	26	Një person përgjegjës/drejtues.
	27	Të paktën 1 masazhier.
Zona e trajtimit dhe Estetika	28	Në hapësirën e qendrës kurative deri në 700 m ² , të paktën 3 dhoma për disa trajtime individuale.
	29	Në hapësirën e qendrës kurative nga 700–1500 m ² , të paktën 5 dhoma për disa trajtime individuale.
	30	Në hapësirën e qendrës kurative mbi 1500 m ² të paktën 10 dhoma për disa trajtime individuale.
	31	Të paktën 1 masazh - 3 trajtime mjekësore - 1 masazh ujqor (1).
Pajisjet e dhomës së trajtimit individual	32	Minimumi hapësirës 9 m ² .
	33	Lartësia të paktën 240 cm.
	34	Tavolinë me një lavaman (ujë të ngrohtë dhe të ftohtë), për terapistët, hapësirë për magazinimin e produkteve, p.sh., dezinfektimit, marrja e pëlhurave, bombol kundër zjarrit, kosh me kapak.
	35	Krevat për terapinë.
	36	Pajisje profesionale teknologjike për shërbimet që ofrohen (pishinë e vogël dhe e madhe, therapeutic bath, bed erap, scrub table, vischry shoer, rasul bath etj.)



	37	Dush me hapësirë për t'u ndërruar dhe për t'u vendosur rrobat përpara ose pas përfundimit të trajtimit me ujë të ngrohtë dhe të ftohtë; shampo, likuid ose sapun.
	38	Hapësirë relaksi në pjesën e qendrës kurative.
	39	Set çarçafesh dhe peshqir për çdo trajtim.
	40	Ajër i kondicionuar, ventilim dhe hapësirë e ngrohtë.
	41	Mundësia e errësimit të dhomës nga drita natyrale (perde etj.).
Zona e trajtimit dhe estetika (2)	42	Të paktën 1 trajtim të kujdesit të fytyrës; 1 trajtim të kujdesit të trupit; 1 trajtim të kujdesit të duarve; 1 trajtim të kujdesit të këmbëve;
	43	Temperatura e ujit duhet të jetë 25-32 °C.
Pishinë e brendshme	44	Pishina duhet të ketë mundësi të përdoret edhe për qëllime rekreacioni. Sipërfaqja e pishinës duhet të jetë të paktën 25 m ² , për një sipërfaqe të qendrës kurative deri në 700 m ² .
	a	Të paktën një korsi për not të lirë.
	45	Pishina duhet të ketë mundësi të përdoret edhe për qëllime rekreacioni. Sipërfaqja e pishinës duhet të jetë të paktën 70 m ² , për një sipërfaqe të qendrës kurative mbi 700 m ² .
	a	Të paktën dy korsi për not të lirë.
	46	Në hapësirën e pishinës, ofrimi i dushit me ujë të ngrohtë dhe të ftohtë. Për sipërfaqe të pishinave mbi 100 m ² , të paktën 2 dushe dhe dy vende për të vendosur peshqirë/penjuar së bashku me likuid/sapun.
	47	Person përgjegjës për monitorimin e zonës së pishinës
	48	Nëse në pishinë nuk ka pjesë për fëmijë, atëherë ajo duhet të jetë e ndarë fizikisht dhe vizualisht. Në ambientet e qendrës kurative duhet të ketë edhe një pishinë për fëmijë me lodra të ndryshme, si: rrëshqitëse uji, sauna për fëmijë, të cilat duhet të jenë nën mbikëqyrjen e stafit përgjegjës.
	49	Lartësia, të paktën 280 cm.
	50	Tabelat e rrezikut të jenë të vendosura në mure; rregullore për përdorimin e ambienteve/pajisjeve të paktën në 2 gjuhë.
	51	Pishina duhet të jetë edhe për qëllime rekreacioni. Sipërfaqja e pishinës duhet të jetë të paktën 50 m ² , për një sipërfaqe të qendrës kurative deri në 700 m ² .
Pishinë e jashtme	a	Të paktën 2 ndenjësë për pjesën e hidromasazhit.
	b	Të paktën 1 efekt për masazhin ujor.
	52	Pishina duhet të jetë edhe për qëllime rekreacioni. Sipërfaqja e pishinës duhet të jetë të paktën 100 m ² , për një sipërfaqe të qendrës kurative mbi 700 m ² .
	a	Të paktën 4 ndenjësë për pjesën e hidromasazhit.
	b	Të paktën 2 efekte për masazhin ujor.
	53	Ndriçimi natën i pishinës.
	54	Në hapësirën e pishinës: stola/karrige/shezlonge/ndenjësë lëkundëse (hamaca) etj., për t'u ulur.
	55	Në hapësirën e pishinës ofrimi i dushit, me ujë të ngrohtë dhe të ftohtë. Për sipërfaqe të pishinave mbi 100 m ² , të paktën 2 dushe dhe dy vende për të vendosur peshqirë/penjuar së bashku me likuid/sapun.
	56	Kabinë/dhomë ndërrimi.
	57	Supervizim i detyrueshëm i pishinës gjatë orarit të punës.
Palestër	58	Të paktën 5 pajisje individuale.
	59	Qendrat kurative me sipërfaqe mbi 1000 m ² duhet të kenë të paktën 10 pajisje individuale
	60	Lartësia, të paktën 280 cm.
	61	Për hapësira mbi 1000 m ² , e detyrueshme një dhomë/sallë e vogël për aktivitete/ushtime të ndryshme dhe kapacitet për 12 persona (p.sh., ushtime tradicionale, aerobi, joga, <i>tai chi</i> , <i>reiki</i> , meditim, terapi me muzikë, ushtime relaksuese dhe frymëmarrjeje, ushtime të tjera në grupe të vogla etj.).
	62	Supervizor i palestres kur ofrohen të paktën 10 pajisje individuale.
	63	Ushtime gjimnastikore, aerobi, kërcim sportiv etj.
Shërbime shtesë të ofruara në dhomën e hotelit	64	Udhëzime për shërbimet e ofruara në zonën e qendrës kurative dhe përdorimin e pajisjeve të paktën në 1 gjuhë të huaj.
	65	Lista e shërbimeve dhe tarifat përkatëse të afishuara.
	66	Të paktën 2 programe të qendrës kurative të ofruara nga hoteli.
	67	Në banjë ose në dhomën përkatëse të ofruar nga hoteli, të ketë shampo për dush, likuid për duart, sapunë aromatikë etj.
	68	Planimetria e godinës me daljen e emergjencë e afishuar.

(1) Llojet e masazheve: Masazh klasik, masazh aromatik, masazh limfodrenues, masazh anticelulit, masazh aromaterapi, masazh *reflex*, masazh *shiatsu*, masazh antistres, masazh me gurë të ngrohtë, masazh me gurë vullkanikë, masazh me gurë të ftohtë, masazh me çokollatë dhe vanilje, masazh mineral *peeling*, masazh *royal*, masazh pinda etj. Llojet e masazheve ujore: hidromasazh, *pearl baths*, *balneotherapy baths*, *aromatherapy baths*, *fango therapy*, *cleopatra*, *wrapping the body-packs: herbal, mud, bay* etj.

Trajtime mjekësore dhe programe rehabilitimi: Matja e pulsit, *aromaterapi*, *elektroterapi*, *phytotherapy*, *hidroterapi*, *cryotherapy*, *chiropractic*, *crystal*, *kenépp*, *chromotherapy*, *magnetic*, *naturopath*, *radial*, *dental services*, *thalasotherapy*, *yoga*, *meditation*. Terapi në dhomë: *tepidarium*, *laconium*, *caldarium*, *sudatorium*, *oxygen therapies*, *salt eater inhalation*, *medicine inhalation*, *solar*.

Trajtime elektro-fizike: teknika galvano, ultratinguj, terapi stimulimi, terapi me fushë magnetike

(2) Trajtime estetike do të përfshihen:

Trajtime për kujdesin e fytyrës: *facials*, *regenerating facial*, *deep cleansing*, *anti-aging treatments*, *treatment for rejuvenation*, *crystal faces* etj.

Trajtime për kujdesin e fytyrës: *facials*, *regenerating facial*, *deep cleansing*, *anti-aging treatments*, *treatment for rejuvenation*, *crystal faces* etj. Trajtime për kujdesin e trupit: (maskë për të gjithë trupin, trajtim anticelulit, *preventive and corrective care*, *care and skin firming treatments with healing mud*, *weight loss treatments*, *exfoliating treatments* etj.).

Trajtime për kujdesin e duarve: manikyr, zëjatim thonjsh, arti i thonjve, manikyr francez etj.

Trajtime për kujdesin e këmbëve: manikyr klasik i këmbëve, depilim i këmbëve me dyll, skrab i trupit.



SHTOJCA 5/e
Kriteret – Resort

Tabela e mëposhtme është tabelë plotësuese që u bashkëngjitet kriterëve të kategorisë “Hotel”

Fusha	Nr.	Kriteret
Të përgjithshme	1	Ndërtesat duhet të jenë të shkëputura nga njëra-tjetra.
	2	Vendndodhja e resortit është në një mjedis të qetë, të shkëputur nga qyteti.
	3	Hartë orientuese e resortit në hyrje të tij.
	4	Sinjalistikë orientuese e detajuar dhe e mirëmbajtur për secilën nga godinat e resortit të pajisura me emër ose numër të veçantë.
	5	Sigurimi i hapësirave të mëdha të hapura me gjelbërim.
	6	Ofrimi i jo më pak se i dy vakteve në ambientet e restorantit.
	7	Kënd informacioni për veprimtaritë argëtuese të organizuara nga resorti (p.sh., ekskursione etj.)
Pamja e jashtme	8	Infrastruktura e lëvizjes (rrugët/rrugicat) në resort të jetë lehtësisht e përshkueshme dhe në gjendje të mirë.
	9	Gjendja e ndërtesave të jetë e qëndrueshme, e sigurt dhe e mirëmbajtur. Të gjithë mekanizmat dhe pajisjet që ofrohen të jenë funksionale dhe të padëmtuar.
	10	Ndriçimi i ambientit të jashtëm në gjendje pune dhe në kushte të mira.
Mirëmbajtja dhe sigurimi	11	Pastrim i rregullt dhe mjedis i mirëmbajtur: pa mbeturina, gjethe etj.
	12	Shërbim i mbikëqyrjes së vazhdueshme të resortit turistik në tërësi.
	13	Facilitete të ndihmës së parë (i nevojshëm stafi i trajnuar).
Zona e pishinës	14	Pishinë e hapur, pishinë për fëmijë.
	15	Shezlonge në zonën e pishinës.
	16	Tualet dhe dush në zonën e pishinës.
	17	Ofrimi i shërbimit të barit në zonën e pishinës.
Shërbime të ofruara në resort	18	Ofrimi i 4 programeve të ndryshme argëtimi/animacion/sportive/mjedisore (1).

(1) Programe që mund të ofrohen nga resorti përfshijnë aktivitete tenisi, basketbolli, volejboli, ping-pongu, ski, kanoe, *barbeque*, koncerte, karaoke, diskotekë, bibliotekë, kënd lojërash për fëmijë, lojëra për familjen dhe fëmijët, si: *puzzle*, tavllë, domino etj., aktivitete në pishinë; ofrim i pajisjeve sportive, si biçikletë etj.

SHTOJCA 5/e
Kriteret – Fjetje dhe mëngjes (B&B)

Ambienti	Nr.	Kriteret
I. Të dhëna të përgjithshme mbi B&B		
Pastërtia/higjiena	1	Pastërtia dhe higjiena janë parakushte themelore - kushte në të gjitha mjediset e brendshme dhe të jashtme të strukturës akomoduese
Mirëmbajtja	2	Të gjithë mekanizmat dhe pajisjet janë funksionale dhe në gjendje pune
Përshtypja e përgjithshme	3	Përshtypja e përgjithshme është e mjaftueshme për kërkesa mesatare (1)
Kushtet e sigurisë	4	Sistem sigurie në hyrje të strukturës akomoduese (p.sh., kamera)
	5	Sistem për mbrojtjen nga zjarri dhe afishim në korridore i planit të evakuimit dhe udhëzimeve në rast zjarri
	6	Rregullore e brendshme për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi
	7	Dokumente të përditësuara të lëshuara nga autoritetet përgjegjëse, që konfirmojnë përmbushjen e të gjitha kushteve dhe rregullave për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi për strukturat akomoduese (VKM nr. 699, datë 22.10.2004, “Për miratimin e rregullave teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin në konstruksionet dhe ndërtimet, që shërbejnë për veprimtari akomoduese turistike”)
II. Recepsioni dhe shërbimet		
Zona e pritjes	8	Shërbimi i pritjes (receptionit) dhe personi në dispozicion për <i>check-in</i> , sipas një marrëveshjeje
	9	Publikimi i listës së çmimeve tavan të dhomave, në gjuhën shqipe dhe të paktën në gjuhën angleze. Afishim i çmimit dhe çdo shërbim që përfshihet, si dhe taksat apo detyrime të tjera, politikat e rezervimit, ndryshimit dhe anulimit dhe çdo informacion shtesë që kërkon klienti para kryerjes së rezervimit, në përputhje me ligjin 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorit”
	10	Regjistrim i klientëve në një regjistr të veçantë, përfshirë identitetin e tij, nr. e pasaportës/së kartës së identitetit, nr. e netëqëndrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën
	11	Kutia e ndihmës së shpejtë
	12	Afishimi i numrave të emergjencës në zonën e pritjes
	13	Shenja dalluese në tualete për femra dhe për meshkuj



Tualetet në ambientet e përbashkëta	14	Dyshe me material kundër rrëshqitjes dhe të padepërtueshëm nga uji (pllaka qeramike, rezinë e të ngjashme)
	15	Mur me material të papërshkueshëm nga uji që pastrohet lehtë (pllaka qeramike, rezinë etj.) jo më pak se lartësia 1.20 m
	16	Ajrim natyral ose mekanik (aspirim-ventilim)
	17	Ndriçim i përshtatshëm
	18	Lavaman me ujë të rrjedhshëm të ngrohtë dhe të ftohtë
	19	Sapun i paketuar ose sapun i lëngshëm në kontenitorë të fiksuar
	20	Letra tharëse me mbajtëse ose pajisje për tharjen e duarve
	21	Pasqyrë
	22	Mekanizëm për mbylljen e derës
	23	Kosh për mbeturinat
	24	Letër higjienike dhe mbajtëse letrë
	25	Mbulesë higjienike për ulësen e VC-së
III. Dhoma		
Pastrimi i dhomës	26	Pastrimi i përditshëm i dhomës
	27	Ndërrim i çarçafëve një herë në javë dhe për çdo klient të ri
	28	Ndërrim i përditshëm i peshqirëve sipas kërkesës
Informacion i përgjithshëm mbi dhomat	29	Secila dhomë të tregohet me numra ose me shenja të tjera
	30	Sipërfaqja e dhomave (duke përfshirë tualetin, pa përfshirë ballkonin/tarracën) $\geq 12,5 \text{ m}^2$
	31	
Komoditeti i gjumit	32	Dyshek me teknologji bashkëkohore, i mirëmbajtur, me lartësi prej të paktën 13 cm
	33	Shtretër tek, me përmasa minimale 0.80 m x 1.90 m dhe shtretër dopio, me përmasa minimale 1.40 m x 1.90 m
	34	Shtretër tek, me përmasa minimale 0.90 m x 1.90 m dhe shtretër dopio, me përmasa minimale 1.60 m x 1.90 m
	35	Seti i çarçafëve 100% pambuk, në ngjyrë të bardhë
	36	Mbulesë/jorgan me vatinë ose me pupla
	37	Jastëk i modelit bashkëkohor dhe i mirëmbajtur
	38	Mundësi për të errësuar dhomën (p.sh., perde)
Pajisjet e dhomës	39	Dollap i përshtatshëm ose zgjidhje alternative për varjen e rrobave
	40	Të paktën 5 varëse rrobash për person të të njëjtut material dhe model
	41	Karrige
	42	Tavolinë
	43	Prizë elektrike e aksesueshme në dhomë
	44	Çelës kryesor për ndriçimin në hyrje të dhomës
	45	Kosh për mbeturinat
	46	Plani i evakuimit i vendosur mbrapa derës së çdo dhome
	47	Alarm zjarri (detektor tymi ose pajisje tjetër e ngjashme)
Telekomunikacioni	48	Telefon publik të disponueshëm për klientët
Të ndryshme	49	Informacion i printuar në dhomë, që përfshin të paktën orarin e mëngjesit, <i>check out</i> dhe orarin e hapjes së shërbimeve të hotelit në dy gjuhë
	50	Material informues për rajonin, të vendosura në ambientet e përbashkëta
Tualetet dhe pajisjet sanitare në dhomë	51	Dhomat janë me dush/vaskë dhe VC private ose të përbashkët
	52	Përmbushen të njëjtat kushte si për tualetet e përbashkëta, përveç letrave tharëse me mbajtëse ose pajisjes për tharjen e duarve
	53	Faqet anësore dhe dysheja e vaskës dhe e dushit duhet të jenë të veshura, me materiale izoluese të papërshkueshme nga uji
	54	Dush me perde/kabinë (2)
	55	Peshqir për këmbët në tualet
	56	Prizë korrenti e aksesueshme pranë pasqyrës
	57	Mbajtëse peshqiri horizontale ose në formë grepi
	58	Aksesorë për mbajtjen e sendeve të tualetit
	59	Sapun i paketuar ose sapun i lëngshëm në kontenitorë të fiksuar
	60	Xhel për larjen e trupit në dush në shishe të vogla ose në kontenitorë të fiksuar
	61	Shampo për flokë në shishe të vogla ose në kontenitorë të fiksuar
	62	Shampoja duhet të ketë etiketë, në mënyrë që të jetë e identifikueshme
	62	2 peshqirë për person (1 fytyrë, 1 trup)
Kuzhina/pajisjet	63	Dritare që mund të hapen ose hapësira për ventilimin me rrjeta kundër insekteve
	64	Dyshe me material kundër rrëshqitjes dhe të papërshkueshëm nga uji
	65	Muret e kuzhinës të veshura deri në lartësinë 2.00 m, me material që pastrohet dhe që mirëmbahet lehtësisht, i papërshkueshëm nga uji (pllaka qeramike, ose të ngjashme)
	66	Sipërfaqe pune për parapërgatitjen e ushqimeve, rafte dhe kabine, prej materiali që nuk ndryshket (inoks) dhe jo prej druri



	67	Kosh për mbeturinat pranë çdo sipërfaqeje pune me qese higjienike
IV. Mëngjesi		
Shërbimi i mëngjesit	68	Dhomë ngrënie për shërbimin e mëngjesit (3)
	69	Mëngjesi shërbehet për të paktën 2 orë
V. Teknologjia dhe sistemet e menaxhimit		
Sisteme cilësore	70	Sistem i menaxhimit të ankesave (4)
VI. Stafi		
Personeli	71	Të gjitha shërbimet duhet të ofrohen nga personel i kualifikuar dhe i identifikueshëm.

[1] Veçanërisht, mobilimi dhe pajisjet janë të përshtatshme dhe të mirëmbajtura.

[2] Kabina nuk duhet të ketë përmasa më të vogla se 80 x 80 cm.

[3] Mëngjesi përfshin të paktën një pije të ngrohtë (p.sh., kafe ose çaj), një lëng frutash, mundësi zgjedhjeje frutash, një zgjedhje buke/ëmbëlsire me gjalpë, reçel, proshutë, djathë, vezë dhe drithëra.

[4] Sistemi i menaxhimit të ankesave përfshin një format të plotësimit të ankesës, vlerësimin dhe përgjigjen.

SHTOJCA 5/f

Kriteret – Dhoma

Ambienti	Nr.	Kriteret
I. Të dhëna të përgjithshme mbi dhomën		
Pastërtia/higjiena	1	Dyshemetë, muret, tavanet, mobili, dyert, dritaret dhe çdo pajisje tjetër janë pa dëmtime, njolla dhe shenja të tjera
Mirëmbajtja	2	Të gjithë mekanizmat dhe pajisjet janë funksionale dhe në gjendje pune
II. Pritja e klientëve dhe shërbimi [1]		
Pritja e klientëve	3	Shërbimi i pritjes duhet të jetë i aksesueshëm gjatë regjistrimit dhe largimit të klientëve
	4	Duhet të ketë person të aksesueshëm gjatë 24 orëve
	5	Shërbimet ofrohen nga person i identifikueshëm
	6	Regjistrim i klientëve [2]
	7	Informacion për dhomën [3]
Pastrimi	8	Pastrimi i dhomës sipas kërkesës
	9	Ndërrim i peshqirëve sipas kërkesës
	10	Ndërrim i çarçafëve minimalisht një herë në javë dhe për çdo klient të ri
III. Dhoma		
Komoditeti i gjumit	11	Shtat me dyshek me teknologji bashkëkohore dhe të mirëmbajtur, me lartësi prej të paktën 13 cm
	12	Shtretër tek me përmasa minimale 0.80 m x 1.90 m dhe shtretër dopio me përmasa minimale 1.60 m x 1.90 m
	13	Seti i çarçafëve 100% pambuk ose një cilësi më të lartë, me ngjyrë të bardhë
	14	Mbulesë/jorgan me vatinë ose pupla
	15	Jastëk i modelit bashkëkohor dhe i mirëmbajtur
	16	1 peshqir i vogël për person
	17	1 peshqir i madh për person
	18	Mundësi për të errësuar dhomën (p.sh. perde, grila)
Pajisjet	19	Dollap i përshtatshëm ose zgjidhje alternative për varjen e rrobave dhe ndarje për rrobat e palosura
	20	Një numër i përshtatshëm varësesh rrobash.
	21	Një karrige për çdo person që akomodohet
	22	Tavolinë
	23	Komodinë anës krevatit
	24	Priza elektrike të aksesueshme në dhomë
	25	Ndriçim i përshtatshëm në dhomë me çelës kryesor në hyrje të dhomës
	26	Kosh për mbeturinat
Ajri i kondicionuar në dhomë	27	Sistem ngrohjeje dhe ftohjeje efektiv
Informacion i përgjithshëm mbi tualetin [4]	28	Dush dhe VC ose vaskë dhe VC
	29	Kosh për mbeturinat
	30	Gotë për furçat e dhëmbëve
	31	Mbajtëse letre higjienike dhe letër higjienike rezervë
	32	Dush me perde, kabinë ose xham të temperuar
	33	Lavaman me ujë të rrjedhshëm, të ngrohtë dhe të ftohtë
	34	Pasqyrë
	35	Ndriçues pranë pasqyrës
	36	Prizë elektrike pranë pasqyrës
	37	Mbajtëse peshqiri
	38	Sapun i paketuar ose sapun i lëngshëm në kontenedor



[1] Shërbimi i pritjes mund të realizohet fizikisht ose në rrugë të tjera alternative nëpërmjet mjeteve elektronike (telefon, email, faqe web etj.)

[2] Strukturat akomoduese regjistrojnë në një regjistër të veçantë për çdo klient identitetin e tij, nr. e pasaportës/kartës së identitetit, numrin e netëqëndrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën.

[3] Përfshin të paktën informacion për orarin e regjistrimit, *check out* dhe shërbimet për mirëmbajtjen e dhomës.

[4] Tualeti mund të jetë brenda dhomës ose mund të jetë pjesë e objektit në të cilin ndodhet dhoma.

SHTOJCA 5/g
Kriteret – Apartament

Ambienti	Nr.	Kriteret
I. Të dhëna të përgjithshme mbi apartamentin		
Ambientet përbashkëta	1	Hyrja dhe mjediset e përbashkëta të ndërtesës të jenë të mirëmbajtura (dyshemetë, muret, tavanet, të lyera, pa njolla dhe shenja të tjera) dhe të ndriçuara
	2	Ashensori i ndërtesës (nëse ka) të jetë funksional
Pastërtia/shërbimet	3	Pastërtia dhe higjiena janë parakushte themelore në të gjitha mjediset e brendshme dhe të jashtme (dyshemetë, muret, tavanet, mobilet, dyert, dritaret dhe çdo pajisje tjetër pa dëmtime, njolla dhe shenja të tjera)
	4	Shërbimi i internetit
	5	Të gjithë mekanizmat dhe pajisjet të jenë funksionale dhe në gjendje pune
II. Pritja e klientëve dhe shërbimi [1]		
Pritja e klientëve	4	Shërbimi i pritjes duhet të jetë i aksesueshëm gjatë regjistrimit dhe largimit të klientëve
	5	Informacion mbi apartamentin [2]
	6	Të ketë person të aksesueshëm gjatë 24 orëve
	7	Shërbimet ofrohen nga person i identifikueshëm
	8	Regjistrim i klientëve [3]
Pastrimi i apartamentit	9	Pastrimi i apartamentit sipas kërkesës
	10	Ndërrim i peshqirëve sipas kërkesës
	11	Ndërrim i çarçafëve minimalisht një herë në javë dhe për çdo klient të ri
III. Apartament		
Komoditeti i gjumit	12	Sipërfaqja e apartamentit 1-2 persona: 23 m ² 3 persona: 29 m ² 4 persona: 35 m ² 3 m ² për çdo person shtesë:
	13	Numri i shtretërve dhe ndërresave i barabartë me numrin e personave që do të akomodohen
	14	Shtat me dyshek me teknologji bashkëkohore dhe të mirëmbajtur, me lartësi prej të paktën 13 cm
	15	Shtretër tek me përmasa minimale 0.80 m x 1.90 m dhe shtretër dopio me përmasa minimale 1.60 m x 1.90 m
	16	Seti i çarçafëve 100% pambuk ose një cilësi më të lartë, me ngjyrë të bardhë
	17	Mbulesë/jorgan me vatinë ose pupla
	18	Jastëk i modelit bashkëkohor dhe i mirëmbajtur
	19	Mundësi për të errësuar dhomën (p.sh. perde, grila)
Pajisjet e apartamentit	20	Dollap i përshtatshëm ose zgjidhje alternative për varjen e rrobave dhe ndarje për rrobat e palosura
	21	Një numër i përshtatshëm varësesh rrobash.
	22	Dritë leximi individuale
	23	Komodinë anës krevatit
	24	Priza elektrike të aksesueshme në apartament
	25	Ndriçim i përshtatshëm në dhomë me çelës kryesor në hyrje të dhomës
	26	Kosh për mbeturinat
Ajri i kondicionuar në dhomë	27	Sistem ngrohjeje efektiv
	28	Sistem ftohjeje efektiv
Informacion i përgjithshëm mbi tualetin	29	Apartamenti të ketë të paktën një tualet
	30	Të gjitha tualetet janë të pajisur me VC, dhe të paktën njëri prej tyre me dush ose vaskë
	31	Dush me perde, kabinë plastike ose xham të temperuar për mosdepërtimin e ujit
	32	Faqet anësore dhe dyshemeja e dushit ose vaskës të jetë e veshur me material izolues të papërshkueshëm nga uji
	33	Të ketë sistem ventilimi natyral ose mekanik
	34	Kosh për mbeturinat
	35	1 peshqir i vogël për person
	36	1 peshqir i madh për person
	37	Gotë për furçat e dhëmbëve
	38	Mbajtëse letre higjienike dhe letër higjienike rezervë
	39	Lavaman me ujë të rrjedhshëm, të ngrohtë dhe të ftohtë



Dhoma e ndenjjes	40	Pasqyrë	
	41	Ndriçues pranë pasqyrës	
	42	Prizë elektrike pranë pasqyrës	
	43	Aksesor për mbajtjen e sendeve të tualetit	
	44	Mbajtëse peshqiri	
	45	Sapun i pakeluar ose sapun i lëngshëm në kontenitorë	
	46	Shampo dhe balsam për larjen e flokëve dhe shampo për larjen e trupit	
	47	Divan ose kolltuk për të pushuar	
	48	Pasqyrë vertikale	
	49	Tavolinë për konsumimin e ushqimit	
	50	Karrige, numri i barabartë me numrin e personave që do të akomodohen	
	51	Ambient gatimi/kabineti i kuzhinës	
	52	Frigorifer	
	53	Lavapjatë	
	54	Një furrë dhe sobë me dy plitka	
	55	Aspirator për largimin e erërave dhe avujve të gatimit	
	56	Servis gatimi të paktën sipas listës më poshtë:	
		2 tenxhere, 1 e madhe dhe 1 e vogël	
		2 thika kuzhine	
		1 mbajtëse sheqeri	
		Pajisje për përgatitjen e kafes (ose moka)	
		Kulluese	
		Garuzhde	
		Tas për sallatë	
		Rende	
		Shtrydhëse agrumesh	
		Hapëse për shishet e verës/birrës	
		Xhezve	
		Pjata shërbimi	
		Servis Sallate	
		Tavë	
		Kosh për mbeturinat me qese plastike	
		Servis shërbimi për çdo të ftuar:	
		2 thika	
		2 pirunë	
		2 lugë	
		2 pjata të cekëta	
		1 pjatë e thellë	
		2 gota	
		1 filxhan çaji	
		1 filxhan kafeje	
	57	Mjete pastrimi për të siguruar higjienën	

[1] Shërbimi i pritjes mund të realizohet fizikisht ose në rrugë të tjera alternative nëpërmjet mjeteve elektronike (telefon, *email*, faqe *web* etj.).

[2] Përfshin të paktën informacion për orarin e regjistrimit, *check out* dhe shërbimet në apartamentit.

[3] Strukturat akomoduese regjistrojnë në një regjistër të veçantë për çdo klient identitetin e tij, nr. e pasaportës/kartës së identitetit, numrin e netëqëndrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën.



SHTOJCA 5/gj
Kriteret – Bllok apartamentesh

	Nr.	Kriteret
I. Të dhëna të përgjithshme		
“Bllok apartamentesh” struktura akomoduese që duhet të ketë jo më pak se dy apartamente të vendosura në të njëjtën ndërtesë ose në ndërtesa të veçanta të pozicionuara brenda territorit të së njëjtës njësi të vetëqeverisjes vendore.		
Menaxhimi kryhet nga një subjekt i vetëm për të gjitha apartamentet		
Hapësirat përbashkëta	1	Hyrja dhe mjediset e përbashkëta të ndërtesës të jenë të mirëmbajtura (dyshemetë, muret, tavanet, të lyera, pa njolla dhe shenja të tjera) dhe të ndriçuara
	2	Ashensori i ndërtesës (nëse ka) të jetë funksional
Pastërtia/shërbimet	3	Pastërtia dhe higjiena janë parakushte themelore në të gjitha mjediset e brendshme dhe të jashtme (dyshemetë, muret, tavanet, mobiliet, dyert, dritaret dhe çdo pajisje tjetër pa dëmtime, njolla dhe shenja të tjera)
	4	Shërbimi i internetit
	5	Të gjithë mekanizmat dhe pajisjet janë funksionale dhe në gjendje pune
II. Pritja e klientëve dhe shërbimi [1]		
Pritja e klientëve	6	Shërbimi i pritjes duhet të jetë i aksesueshëm gjatë regjistrimit dhe largimit të klientëve.
	7	Informacion mbi apartamentin [2]
	8	Duhet të ketë person të aksesueshëm gjatë 24 orëve
	9	Shërbimet ofrohen nga person i identifikueshëm
	10	Regjistrim i klientëve [3]
Pastrimi i apartamentit	11	Pastrimi i apartamentit sipas kërkesës
	12	Ndërrim i peshqirëve sipas kërkesës
	13	Ndërrim i çarçafëve minimalisht një herë në javë dhe për çdo klient të ri
III. Apartamenti		
Komoditeti i gjumit	14	Sipërfaqja e 1 apartamenti për 1-2 persona: 23 m ² 3 persona: 29 m ² 4 persona: 35 m ² 3 m ² për çdo person shtesë
	15	Numri i shtretërve dhe ndërresave i barabartë me numrin e personave që do të akomodohen
	16	Shtrat me dyshek me teknologji bashkëkohore dhe të mirëmbajtur, me lartësi prej të paktën 13 cm
	17	Shtretër tek me përmasa minimale 0.80 m x 1.90 m dhe shtretër dopio me përmasa minimale 1.60 m x 1.90 m
	18	Seti i çarçafëve 100% pambuk ose një cilësi më të lartë, me ngjyrë të bardhë
	19	Mbulesë/jorgan me vatinë ose pupla
	20	Jastëk i modelit bashkëkohor dhe i mirëmbajtur
	21	Mundësi për të errësuar dhomën (p.sh. perde, grila)
	22	Dollap i përshtatshëm ose zgjidhje alternative për varjen e rrobave dhe ndarje për rrobat e palosura
Pajisjet e apartamentit	23	Një numër i përshtatshëm varësesh rrobash
	24	Dritë leximi individuale
	25	Komodinë anës krevatit
	26	Priza elektrike të aksesueshme në apartament
	27	Ndriçim i përshtatshëm në dhomë me çelës kryesor në hyrje të dhomës
	28	Kosh për mbeturinat
	29	Sistem ngrohjeje efektiv
Ajri i kondicionuar në dhomë	30	Sistem ftohjeje efektiv
	31	Apartamenti të ketë të paktën një tualet
Informacion i mbi përgjithshëm tualetin	32	Të gjitha tualetet janë të pajisur me VC, dhe të paktën njëri prej tyre me dush ose vaskë
	33	Dush me perde, kabinë plastike ose xham të temperuar për mosdepërtimin e ujit
	34	Faqet anësore dhe dysheja e dushit ose vaskës të jetë e veshur me material izolues të papërshkueshëm nga uji
	35	Të ketë sistem ventilimi natyral ose mekanik
	36	Kosh për mbeturinat
	37	1 peshqir i vogël për person
	38	1 peshqir i madh për person
	39	Gotë për furçat e dhëmbëve
	40	Mbajtëse letre higjienike dhe letër higjienike rezervë
	41	Lavaman me ujë të rrjedhshëm, të ngrohtë dhe të ftohtë
	42	Pasqyrë
	43	Ndriçues pranë pasqyrës
	44	Prizë elektrike pranë pasqyrës



Dhoma e ndenjes dhe mjedisi i gatimit	45	Aksesor për mbajtjen e sendeve të tualetit
	46	Mbajtëse peshqiri
	47	Sapun i paketuar ose sapun i lëngshëm në kontenitorë
	48	Shampo dhe balsam për larjen e flokëve dhe shampo për larjen e trupit
	49	Divan ose kolltuk për të pushuar
	50	Pasqyrë vertikale
	51	Tavolinë për konsumimin e ushqimit
	52	Karrige, numri i barabartë me numrin e personave që do të akomodohen
	53	Ambient gatimi/kabineti i kuzhinës
	54	Frigorifer
	55	Lavapjatë
	56	Një furrë dhe sobë me dy plitka
	57	Aspirator për largimin e erërave dhe avujve të gatimit
	58	Servis gatimi të paktën sipas listës më poshtë
		2 tenxhere, një e madhe dhe një e vogël
		2 thika kuzhine
		1 mbajtëse sheqeri
		Pajisje për përgatitjen e kafes (ose moka)
		Kulluese
		Garuzhde
		Tas për sallatë
		Rende
		Shtrydhëse agrumesh
		Hapëse për shishet e verës/birrës
		Xhezve
		Pjata shërbimi
		Servis Sallate
		Tavë
		Kosh për mbeturinat me qese plastike
		Servis shërbimi për çdo të ftuar:
		2 thika
		2 pirunë
		2 lugë
		2 pjata të cekëta
		1 pjatë e thellë
		2 gota
		1 filxhan çaji
		1 filxhan kafeje
59		Mjete pastrimi për të siguruar higjienën

[1] Shërbimi i pritjes mund të realizohet fizikisht ose në rrugë të tjera alternative nëpërmjet mjeteve elektronike (telefon, email, faqe web etj.)

[2] Përfshin të paktën informacion për orarin e regjistrimit, *check out* dhe shërbimet në apartamente.

[3] Strukturat akomoduese regjistrojnë në një regjistër të veçantë për çdo klient identitetin e tij, nr. e pasaportës/kartës së identitetit, numrin e netëqëndrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën.

SHTOJCA 5/h Kriteret – Vilë

	Nr.	Kriteret
I. Të dhëna të përgjithshme		
Ndërtesë e veçantë deri në 3 kate, me oborr dhe hapësirë kopshti		
Hapësira të jashtme të gjelbëruara dhe të mirëmbajtura		
Menaxhimi kryhet nga një subjekt i vetëm për të gjithë ndërtesën		
Pastërtia/shërbimet	1	Pastërtia dhe higjiena janë parakushte themelore në të gjitha mjediset e brendshme dhe të jashtme (dyshemetë, muret, tavanet, mobiliat, dyert, dritaret dhe çdo pajisje tjetër pa dëmtime, njolla dhe shenja të tjera)
	2	Shërbimi i internetit
	3	Të gjithë mekanizmat dhe pajisjet janë funksionale dhe në gjendje pune
II. Pritja e klientëve dhe shërbimi [1]		
Pritja e klientëve	4	Shërbimi i pritjes duhet të jetë i aksesueshëm gjatë regjistrimit dhe largimit të klientëve
	5	Informacion mbi vilën [2]



	6	Duhet të ketë person të aksesueshëm gjatë 24 orëve
	7	Shërbimet ofrohen nga person i identifikueshëm
	8	Regjistrim i klientëve [3]
	9	Pastrimi i apartamentit sipas kërkesës
Pastrimi	10	Ndërrim i peshqirëve sipas kërkesës
	11	Ndërrim i çarçafëve minimalisht një herë në javë dhe për çdo klient të ri
III. Ambienti		
Komoditeti i gjumit	13	Numri i shtretërve dhe ndërresave i barabartë me numrin e personave që do të akomodohen
	14	Shttrat me dyshek me teknologji bashkëkohore dhe të mirëmbajtur, me lartësi prej të paktën 13 cm
	15	Shtretër tek me përmasa minimale 0.80 m x 1.90 m dhe shtretër dopio me përmasa minimale 1.60 m x 1.90 m
	16	Seti i çarçafëve 100% pambuk ose një cilësi më të lartë, me ngjyrë të bardhë
	17	Mbulesë/jorgan me vatinë ose pupla
	18	Jastëk i modelit bashkëkohor dhe i mirëmbajtur
Pajisjet	19	Mundësi për të errësuar dhomën (p.sh. perde, grila)
	20	Dollap i përshtatshëm ose zgjidhje alternative për varjen e rrobave dhe ndarje për rrobat e palosura
	21	Një numër i përshtatshëm varësesh rrobash
	22	Dritë leximi individuale
	23	Komodinë anës krevatit
	24	Priza elektrike të aksesueshme në apartament
	25	Ndriçim i përshtatshëm në dhomë me çelës kryesor në hyrje të dhomës
Ajri i kondicionuar	26	Kosh për mbeturinat
	27	Sistem ngrohjeje efektiv
	28	Sistem ftohjeje efektiv
Informacion i përgjithshëm i tualetit	29	Apartamenti të ketë të paktën një tualet
	30	Të gjitha tualetet janë të pajisur me VC, dhe të paktën njëri prej tyre me dush ose vaskë
	31	Dush me perde, kabinë plastike ose xham të temperuar për mosdepërtimin e ujit
	32	Faqet anësore dhe dyshemeja e dushit ose vaskës të jetë e veshur me material izolues të papërshtueshëm nga uji
	33	Të ketë sistem ventilimi natyral ose mekanik
	34	Kosh për mbeturinat
	35	1 peshqir i vogël për person
	36	1 peshqir i madh për person
	37	Gotë për furçat e dhëmbëve
	38	Mbajtëse letre higjienike dhe letër higjienike rezervë
	39	Lavaman me ujë të rrjedhshëm, të ngrohtë dhe të ftohtë
	40	Pasqyrë
	41	Ndriçues pranë pasqyrës
	42	Prizë elektrike pranë pasqyrës
	43	Aksesor për mbajtjen e sendeve të tualetit
	44	Mbajtëse peshqiri
	45	Sapun i paketuar ose sapun i lëngshëm në kontenitorë.
	46	Shampo dhe balsam për larjen e flokëve dhe shampo për larjen e trupit
Dhoma e ndenjes dhe mjedisi i gatimit	47	Divan ose kolltuk për të pushuar
	48	Pasqyrë vertikale
	49	Tavolinë për konsumimin e ushqimit
	50	Karrige, numri i barabartë me numrin e personave që do të akomodohen
	51	Ambient gatimi/kabineti i kuzhinës
	52	Frigorifer
	53	Lavapjatë
	54	Një furrë dhe sobë me dy plitka
	55	Aspirator për largimin e erërave dhe avujve të gatimit
	56	Servis gatimi të paktën sipas listës më poshtë
		2 tenxhere, një e madhe dhe një e vogël
		2 thika kuzhine
		1 mbajtëse sheqeri
		Pajisje për përgatitjen e kafes (ose moka)
		Kulluese
		Garuzhde
		Tas për sallatë
		Rende
		Shtrydhëse agrumesh
		Hapëse për shishet e verës/birrës
		Xhezve



		Pjata shërbimi	
		Servis Sallate	
		Tavë	
		Kosh për mbeturinat me qese plastike	
		Servis shërbimi për çdo të ftuar:	
		2 thika	
		2 pirunë	
		2 lugë	
		2 pjata të cekëta	
		1 pjatë e thellë	
		2 gota	
		1 filxhan çaji	
		1 filxhan kafeje	
57		Mjete pastrimi për të siguruar higjienë	

[1] Shërbimi i pritjes mund të realizohet fizikisht ose në rrugë të tjera alternative nëpërmjet mjeteve elektronike (telefon, *email*, faqe *web* etj.)

[2] Përfshin të paktën informacion për orarin e regjistrimit, *check out* dhe shërbimet në vilë.

[3] Strukturat akomoduese regjistrojnë në një regjistër të veçantë për çdo klient identitetin e tij, nr. e pasaportës/kartës së identitetit, numrin e netëqëndrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën.

SHTOJCA 5/i

Kriteret – Hotel i shpërndarë

	Nr.	Kriteret
I. Të dhëna të përgjithshme		
Hotel i shpërndarë duhet të ketë jo më pak se shtatë dhoma gjumi dhe apartamente me të paktën katërmëdhjetë shtretër, të vendosura në të paktën tri ndërtesa autonome dhe të pavarura.		
Njësitë e banimit të destinuara për akomodim duhet të kenë një distancë jo më të madhe se dyqind e pesëdhjetë metra nga ndërtesa qendrore		
Njësitë e banimit përbëhen nga dhoma gjumi ose apartamente të pajisura me mobilie, pajisje dhe shërbime		
Menaxhimi kryhet nga një subjekt i vetëm juridik për të gjitha njësitë akomoduese		
Hoteli i shpërndarë ofron shërbimin e mundshëm të restorantit		
Pastërtia/Higjiena	1	Pastërtia dhe higjiena janë parakushte themelore. Të gjitha mjediset e brendshme dhe të jashtme të strukturës akomoduese dhe njësitë të banimit që janë pjesë e saj (dyshemetë, muret, tavanet, mobilitet, dyert, dritaret dhe çdo pajisje tjetër) të jenë pa dëmtime, njolla dhe shenja të tjera
Mirëmbajtja	2	Të gjithë mekanizmat dhe pajisjet funksionale dhe në gjendje pune.
Përshtypja e përgjithshme	3	Përshtypja e përgjithshme të jetë e mjaftueshme për kërkesa të thjeshta. [1]
	4	Sistem për mbrojtjen nga zjarri dhe afishim në korridore i planit të evakuimit dhe udhëzimeve në rast zjarri.
	5	Rregullore e brendshme për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi
	6	Dokumente të përditësuara të lëshuara nga autoritetet përgjegjëse, që konfirmojnë përmbushjen e të gjitha kushteve dhe rregullave për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi për strukturat akomoduese
III. Recepsioni dhe shërbimet		
Recepsioni	7	Hapësirë vizualisht e ndarë/ tavolinë e dedikuar për shërbimet e recepsionit.
	8	Recepsioni duhet të jetë i hapur të paktën nga ora 07:00 deri në 23:00
	10	Shërbimi i pritjes (recepsionit) dhe person në dispozicion për <i>check-in</i> sipas një marrëveshjeje.
	11	Regjistrim i klientëve të hotelit të shpërndarë [2]
	12	Vendosja e numrave të shërbimeve mjekësore dhe urgjencës
	13	Kutia e ndihmës së shpejtë në recepsion
	14	Tualetë të përbashkëta në recepsion. [3]
	15	Publikimi i listës së çmimeve tavan të dhomave, në gjuhën shqipe dhe të paktën në gjuhën angleze. Afishim i çmimit dhe çdo shërbim që përfshihet, si dhe taksat apo detyrime të tjera, politikat e rezervimit, ndryshimit dhe anulimit dhe çdo informacion shtesë që kërkon klienti para kryerjes së rezervimit, në përputhje me ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorit”.
	16	Kasafortë qendrore në recepsion/Facilitete të ruajtjes së sendeve me vlerë
	17	Shërbim i ruajtjes së bagazheve
	18	Duhet të ketë një portier gjatë natës.
	19	Protokoll i brendshëm i hotelit të shpërndarë lidhur me detyrat e stafit sipas profileve të tyre.
Të ndryshme	20	Material informues për rajonin, të vendosura në ambientet e përbashkëta
Parkimi	21	Mund të ketë një shërbim parkimi ose një garazh të mbikëqyrur, edhe nëse është me marrëveshje me një strukturë tjetër
	22	Ndriçim në të gjithë sipërfaqen e parkimit dhe survejim me kamera
	23	Kanale për kullimin e ujit në zonat e brendshme parkimit



Facilitete për personat me aftësi të kufizuara	24	Një shërbim higjienik në një nga hapësirat e përbashkëta ose afër tyre
	25	Rampa të posaçme ose zgjidhje të tjera ekuivalente për akses në hapësirat e përbashkëta;
	26	Një banjë dhe një dhomë të pajisur posaçërisht dhe të aksesueshme lehtësisht
Dhoma III[4]		
Komoditeti i gjumit	27	Sipërfaqja e dhomës teke: 8 m ²
	28	Sipërfaqja e dhomës dyshe: 14 m ²
	29	Sipërfaqja e dhomës dyshe me shtesë të një krevati*: 14 m ²
	30	Për çdo person shtesë në apartament: 8 m
	31	Shtesë për dhomë me më shumë krevate: +6 m ² për çdo vend shtesë
	32	Shtrat me dyshek me teknologji bashkëkohore dhe të mirëmbajtur, me lartësi prej të paktën 13 cm
	33	Shtretër tek me përmasa minimale (gjerësia 1.40 m) [5]
	34	Seti i çarçafëve 100% pambuk ose një cilësi më të lartë
	35	Mbulesë/jorgan me vatinë ose pupla
	36	Jastëk i modelit bashkëkohor dhe i mirëmbajtur
	37	Mundësi për të errësuar dhomën (p.sh. perde)
	38	Shtimi i një shtrati shtesë për fëmijët ose të rinjtë e familjes, për shoqëruesit e personave me aftësi të kufizuara, ose për shoqëruesit që e kërkojnë këtë shërbim. Ky shtrat mund të hiqet ditën pasi dhoma lirohet
Arredimi i plotë i dhomave	39	Dollap i përshtatshëm ose zgjidhje alternative për varjen e rrobave dhe ndarje për rrobat e palosura
	40	Një numër i përshtatshëm varësesh rrobash
	41	Varëse rrobash/portmanto jashtë dollapit
	42	Një karrige
	43	Tavolinë
	44	Prizë elektrike të aksesueshme në dhomë
	45	Ndriçim i përshtatshëm në dhomë me çelës kryesor në hyrje të dhomës
	46	Llambë ose abazhur mbi tryezë
	47	Plani i evakuimit i vendosur prapa derës së çdo dhome
	48	Alarm zjarri (detektor tymi ose pajisje tjetër e ngjashme)
	49	Kosh për mbeturinat
	50	Lidhje interneti
	51	Lidhje TV satelitore ose digjitale
	52	Banjë private në çdo dhomë
	53	Një poltron për çdo krevat
Ajri i kondicionuar në dhomë	54	Sistem ngrohjeje efektiv
	55	Sistem ftohjeje efektiv
Arredim shtesë për suitat dhe apartamentet	56	Një tavolinë e ulët
	57	Një mobilie me rafte ose një komodinë
	58	Divan
Pajisje elektronike për argëtim	59	Pajisje TV në sallën e receptionit, për hotelet, të cilat nuk kanë TV në çdo dhomë
Telekomunikacioni	60	Telefon publik të disponueshëm për klientët
Të ndryshme	61	Informacion i hotelit [6]
	62	100% e dhomave me dush dhe WC ose vaskë dhe WC
Informacion i përgjithshëm mbi tualetin	63	Faqet anësore dhe dyshemeja e dushit ose vaskës të jetë e veshur me material izolues të papërshkueshëm nga uji
	64	Mur me material të papërshkueshëm nga uji që pastrohet lehtë (pllaka qeramike, rezinë etj.) jo më pak se lartësia 1,20 m
	65	Dysheme me material kundër rrëshqitjes dhe të padepërtueshëm nga uji (pllaka qeramike, rezinë e të ngjashme)
	66	Ajrim natyral ose mekanik (aspirim-ventilim)
	67	Mbajtëse letre higjienike dhe letër higjienike rezervë
	68	Mbulesë higjienike për ulësen e VC (kapak VC)
	69	Dush me perde, kabinë plastike ose xham të temperuar për mosdepërtimin e ujit
	70	Kosh për mbeturinat
	71	1 peshqir i vogël për person
	72	1 peshqir i madh për person
	73	Gotë për furçat e dhëmbëve
	74	Lavaman me ujë të rrjedhshëm, të ngrohtë dhe të ftohtë
	75	Pasqyrë
	76	Ndriçues pranë pasqyrës
	77	Prizë elektrike pranë pasqyrës
	78	Aksesori për mbajtjen e sendeve të tualetit
	79	Mbajtëse peshqiri
	80	Sapun i paketuar ose sapun i lëngshëm në kontenitorë



	81	Shampo dhe balsam për larjen e flokëve dhe shampo për larjen e trupit
	82	Shampo[7]
	83	Divan ose kolltuk për të pushuar
Pastrimi i përditshëm i dhomës dhe tualeteve në dhomë	84	Pastrimi i përditshëm i dhomës dhe tualeteve në dhomë ose sipas kërkesës
	85	Ndërrim i përditshëm i peshqirëve me kërkesë ose sipas kërkesës
	86	Ndërrim i çarçafëve minimalisht një herë në javë dhe për çdo klient të ri ose sipas kërkesës
	87	Ndërrim i çarçafëve minimalisht një herë në javë dhe për çdo klient të ri ose sipas kërkesës
IV. Shërbimi i ushqimit		
Shërbimi i mëngjesit	88	Mëngjesi duhet të ofrohet në një dhomë të caktuar brenda strukturës ose, në mungesë të kësaj, në një bar të afërt me të cilin është bërë marrëveshje
	89	Duhet të jetë i disponueshëm për 3 orë në ditë në një dhomë të caktuar për këtë qëllim
	90	Ofrimi i ushqimit në hotel
	91	Mëngjes bufe [8] ose menu për mëngjesin
Shërbimi i ushqimit (nëse ka)	92	Të ketë një kuzhinë të përshtatshme.
	93	Nëse hoteli nuk ka restorant, duhet të ketë një bar që mund të ofrojë ushqim të shpejtë.
Siguria Ushqimore	94	Ushqimi që shërbehet në hotel, përpunohet, përgatitet dhe trajtohet sipas rregullave për sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve nga sëmundjet/dëmtimet si pasojë e konsumimit të produkteve ushqimore me origjinë bimore ose shtazore dhe sipas sistemit HACCP. Ligji nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", dhe aktet nënligjore përkatëse (vërtetuar nga dokumentet e lëshuara nga autoritetet përgjegjëse)
Pije	95	Ofrimi pijeve në hotel
Pajisjet e kuzhinës personale të njësive të banimit	96	Frigorifer
	97	Lavapjatë
	98	Një furrë dhe sobë me dy plitka
	99	Një aspirator
	100	Servis gatimi dhe ngrënie[9] për të paktën 6 persona
	101	Mjete pastrimi për të siguruar higjienën
	102	Të paktën dy peshqirë kuzhine
	103	Një mbulesë tavoline dhe të paktën 6 peceta
V. Kualifikimi i stafit		
Personeli	104	Të gjitha shërbimet të ofrohen nga personel i kualifikuar dhe i identifikueshëm
	105	Hoteli ka të punësuar një personel të mjaftueshëm në numër dhe të trajnuar për të mbajtur standardet e shërbimit të parashikuara në këto kritere.
	106	I gjithë stafi trajnohet me fillimin e punësimit dhe në vazhdim sipas pozicionit.
	107	Të paktën një gjuhë e huaj duhet të fletet në mënyrë të saktë nga personeli.
Mjedise për personelin	108	Paraqitja, qëndrimi dhe pastërtia e personelit
	109	Dhomë çlodhje dhe dhomë ngrënie
	110	Dushe, tualete dhe lavamanë
	111	Dhomë fjetje për personelin
	112	Dhomë ndërrimi

[1] Veçanërisht mobilimi dhe pajisjet janë të përshtatshme dhe të mirëmbajtura.

[2] Strukturat akomoduese regjistrojnë në një regjistër të veçantë për çdo klient identitetin e tij, nr. e pasaportës/kartës së identitetit, numrin e netëqëndrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën.

[3] Tualeti është i pajisur me: pasqyrë, lavaman, kosh për mbeturinat, sapun të lëngshëm, letra për duart ose pajisje për tharje të duarve, letër higjienike, varëse për rrobat, mekanizëm për mbylljen e derës, kosh për mbeturinat në kabinën për femrat.

[4] Sipërfaqja minimale e dhomave teke duhet të jetë 8 m².

[5] Nuk lejohen shtretërit e mbivendosur.

[6] Përfshin të paktën informacion për orarin e mëngjesit, *check out*, dhe orarin e hapjes së shërbimeve të hotelit.

[7] Ky kriter quhet i plotësuar nëse xheli për dush është i përshtatshëm edhe si shampo dhe kjo shënohet mbi etiketën e shishes.

[8] Përfshin të paktën një pije të ngrohtë (kafë ose çaj), një lëng frutash, mundësi zgjedhjeje frutash ose sallatë frutash, mundësi zgjedhjeje buke dhe gjalpë, reçel, proshutë, djathë, vezë dhe drithëra.

[9] Të tilla si tigan, tenxhere, tavë, pjata, servis ngrënie, filxhanë, gota etj.



SHTOJCA 5/j

Kriteret – Strukturë akomoduese (“Hotel”/“Bujtinë”/“Fjetje dhe mëngjes” (B&B)/ “Hostel”/“Vilë”/“Hotel i shpërndarë” i/e trashëgimisë kulturore

Tabela e mëposhtme është tabelë plotësuese që u bashkëngjitet kriterëve të kategorisë “Hotel”, “Bujtinë”, “Fjetje dhe mëngjes” (B&B), “Hostel”, “Vilë” dhe “Hotel i shpërndarë” [1]

Fusha	Nr.	Kriteret
Të përgjithshme	1	Ndërtesat duhet të jetë shpallur “Monument Kulture”, sipas legjislacionit të Trashëgimisë Kulturore
	2	Përfshihet nga detyrimi për plotësimin e kriterëve të cilat lidhen direkt ose indirekt me strukturën ekzistuese të shpallur monument kulture [2]

[1] Struktura duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në shtojcat përkatëse sipas kategorisë; “Hotel”, “Bujtinë”, “Fjetje dhe mëngjes” (B&B), “Hostel”, “Vilë” dhe “Hotel i shpërndarë”, për të cilën aplikon subjekti.

[2] Struktura plotëson kriteret për kategoritë më sipër, për aq sa është e mundur, duke mos cenuar tërësinë ose elemente të veçanta të saj në mënyrë që pasuria kulturore të mbahet në ato lloj kushtesh e standardesh që japin përdorimin dhe kënaqësinë maksimale, pa dëmтуar vlerat kulturore.

VENDIM

Nr. 44, datë 29.7.2025

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Illir Toska	anëtar;
Marjana Semini	anëtare,

me sekretare Enina Kotoni, në datat 12.6.2025, 9.7.2025 dhe 15.7.2025, mori në shqyrtim në seancë plenare publike, me dyer të mbyllura, çështjen nr. 5 (O) 2024 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Onejda Ymeraj, përfaqësuar fillimisht nga avokatët Eugen Beci dhe Elis Bilali, ndërsa në vijim të gjykimit nga avokatët Flonja Boriçi (Tashko) dhe Florian Hasko, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga prokurorët Altin Dumani dhe Bledar Maksuti.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 93 (87-2024-134), datë 17.5.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-1272, datë 11.7.2024, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të

papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 17, 35, 36, 42, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marjana Semini, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuases Onejda Ymeraj (*kërkuesja*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:**I****Rrethanat e çështjes**

1. Prokuroria e Posaçme në vitin 2022 ka regjistruar një procedim penal, ka kryer dhe po heton, për disa procedura koncesionare të zhvilluara nga ana e një ministrie. Në kuadër të këtij procedimi penal, në regjistrin e njoftimit të veprave penale, përveç veprave penale, janë shënuar edhe emrat e personave të cilëve u atribuohen ato. Ndër ta janë



regjistruar edhe shtetasit A dhe B, bashkëjetues, të cilët janë dyshuar për veprat penale “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose i të zgjedhurve vendorë” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuara nga nenet 257/a, paragrafi i dytë, 260, 287, paragrafi i dytë, e 25 të Kodit Penal (KP).

2. Në lidhje me faktet penale objekt hetimi është ngritur dyshimi se personi nën hetim A, gjatë kohës së ushtrimit të funksioneve të larta shtetërore, ka konsumuar tri vepra penale, konkretisht: “Korrupsioni pasiv i funksionarit të lartë shtetëror”, në disa raste, përmes marrjes drejtpërdrejt ose tërthorazi të përfitimeve të parregullta, për vete ose për persona të tjerë; “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, përmes fshehjes ose mbulimit të origjinës së pasurisë së paligjshme, të përfituar si pasojë e korrupsionit ose nga burimeve të tjera të paligjshme; “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”. Po kështu, është dyshuar se këto vepra penale ai i ka kryer në bashkëpunim, përfshirë edhe bashkëjetuesen e tij, personin nën hetim B. Kjo e fundit, në gusht 2021, ka krijuar shoqërinë tregtare X, e cila, ndonëse nuk ka pasur kapacitete teknike dhe burime njerëzore për ofrimin e shërbimeve përkatëse, ka përfituar pagesa për ofrim shërbimesh nga subjekte të ndryshme tregtare. Është dyshuar për një aktivitet fiktiv të shoqërisë, i kryer me qëllim justifikimin e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të pasurive dhe të shpenzimeve të të dy personave nën hetim në fjalë. Ndër subjektet tregtare që kanë bërë pagesa shërbimesh për shoqërinë X është identifikuar edhe shoqëria Y, përfaqësuesi C i së cilës, i pyetur në datën 14.2.2024, ka deklaruar, ndër të tjera, se kontaktin me personin nën hetim B ia ka rekomanduar kërkuesja. Gjithashtu, gjatë hetimit janë marrë të dhëna se regjistrimi i shoqërisë X pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit është bërë nga një punonjëse e një subjekti privat, ku kërkuesja mban një pozicion të lartë drejtues.

3. Mbi bazën e këtyre të dhënave, në datën 26.2.2024, kërkuesja është pyetur nga Prokuroria e Posaçme në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale. Në deklaratimet e saj ajo ka pohuar njohjen me personin nën hetim B, rekomandimin e kësaj të fundit të shtetasi C dhe mundësimin e kontaktimit mes tyre. Pas vlerësimit edhe të këtyre deklaratimeve, po atë ditë, mbështetur në nenet 188 dhe 198 e vijues të Kodit të Procedurës Penale (KPP), Prokuroria e Posaçme ka marrë vendim “Për këqyrjen e sendeve/dokumenteve”, me të cilin është vendosur këqyrja e të dhënave të telefonit celular “*Iphone 15 Pro Max*” (telefon inteligjent) në përdorim të kërkueses, si dhe bisedave të zhvilluara nga ajo në kanale të ndryshme komunikimi që ishin me interes për hetimin e procedimit penal. Sipas këtij vendimi, këqyrja do të realizohej nëpërmjet administrimit të të dhënave me fotografi dhe përshkrimit të tyre, ndërsa për kryerjen e veprimit janë ngarkuar dy oficerë të Policisë Gjyqësore (OPGJ).

4. Në zbatim të këtij vendimi, po në datën 26.2.2024, ora 15:50, OPGJ-të i kanë kërkuar kërkueses të realizonin këqyrjen e të dhënave në telefonin celular në përdorim të saj. Kërkuesja nuk ka kundërshtuar dhe në prani të saj, OPGJ-të, përmes ekranit të telefonit, kanë këqyruar disa nga komunikimet e ruajtura në të. Ky veprim është dokumentuar me procesverbalin “Për këqyrjen e telefonit celular në posedim të shtetases Onejda Ymeraj”. Sipas këtij procesverbali, nga këqyrja e telefonit është konstatuar se kërkuesja ka pasur disa komunikime me interes për hetimin. Konkretisht, ajo ka komunikuar me një person që, bazuar në të dhënat e kontaktit dhe përmbajtjen e komunikimit, dyshohej të ishte personi nën hetim B; me një person tjetër, i identifikuar nga të dhënat e kontaktit si shtetasi C, përfaqësuesi i shoqërisë Y, që kishte bërë pagesa për shoqërinë e personit nën hetim B; komunikime të tjera ku përmendej personi nën hetim A. Nisur nga këto komunikime, të cilat vijonin edhe gjatë vitit 2021, si dhe nga fakti se këqyrja e tyre për nxjerrjen e të gjitha dokumenteve, komunikimeve me interes për procedimin penal kërkonte kohë të gjatë, OPGJ-të kanë vendosur ndërprerjen e këqyrjes së telefonit dhe sekuestrimin e tij. Më pas, me procesverbalin e datës 26.2.2024, ora 17:08, OPGJ-të, bazuar në nenin 300 të KPP-së, kanë sekuestruar sendin “telefon celular” të kërkueses. Me vendimin e datës 27.2.2024, Prokuroria e Posaçme, duke u mbështetur në nenin



301 të KPP-së, ka vleftësuar të ligjshëm sekuestrimin e provës/sendit “telefon celular” të kërkueses, me arsyetimin se ai është i domosdoshëm për hetimin, pasi në të mund të gjenden të dhëna me rëndësi, duke pasur parasysh rrezikun e ndryshimit ose të humbjes së tyre.

5. Pas sekuestrimit të telefonit të kërkueses, me vendimin e datës 28.2.2024, Prokuroria e Posaçme, bazuar në nenet 178 e vijues dhe 314 të KPP-së, ka vendosur kryerjen e ekspertimit teknik-elektronik të telefonit, me arsyetimin se në të mund të gjenden të dhëna me vlerë për hetimin dhe se për këtë nevojiten njohuri të posaçme teknike në fushën kompjuterike dhe telefonike. Si çështje të ekspertimit janë përcaktuar evidentimi dhe ekstraktimi: i. i të dhënave të rubrikës së thirrjeve hyrëse dhe dalëse, mesazheve SMS dhe MMS, thirrjeve të humbura, numrave të kontaktit, fotove dhe regjistrimeve audio e video e të dhënave të tjera, të fshira ose jo, nëse ekzistojnë dhe mund të rikuperohen; ii. i logimeve dhe i navigimeve në faqe interneti, faqeve të klikuara, komunikimeve me palë të treta, komunikimeve në rrjete sociale (*Facebook, Twitter, Instagram, Skype etj.*), përmes opsioneve të *chat-it online* dhe aplikacioneve të instaluar në objektin e ekspertimit (*Whatsapp, Viber, BBM etj.*) nëse telefoni objekt ekspertimi ka opsione përdorimi të internetit; iii. i çdo të dhënë tjetër me rëndësi për hetimin. Për kryerjen e ekspertimit janë ngarkuar tre ekspertë të sektorit të ekspertizës pranë Prokurorisë së Posaçme. Ky vendim, sipas urdhërimit të tij, i është njoftuar personave nën hetim, por jo kërkueses.

6. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, pohoi në gjykim se ekspertët kanë realizuar ekspertimin teknik-elektronik të telefonit të kërkueses dhe kanë përgatitur aktin e datës 29.3.2024. Sipas tij, dokumenti, akti i ekspertimit, i është nënshtruar këqyrjeve, të cilat janë drejt përfundimit dhe se nga ato janë marrë të dhëna dhe inidicie që kanë vlerën e provës në funksion të objektit të hetimit. Ai ka sqaruar se ekspertimi, si në të gjitha rastet e kësaj natyre, ka konsistuar në ekstraktimin dhe kopjimin e të dhënave të memorizuara në telefonin celular të kërkueses, kurse këqyrja e materialit në vijim konsiston në kërkimin me fjalë kyçe vetëm të atyre të dhënave që lidhen me hetimin, pra me faktin penal, veprën penale dhe personat e përfshirë në të, duke shmangur të dhënat që kanë të bëjnë me jetën private dhe familjare. Ndërkohë, në mbështetje të kërkesës paraprake (*shih*

paragrafin 15 më poshtë), subjekti i interesuar paraqiti si provë një procesverbal të datës 4.7.2025, për këqyrjen e pjesshme të të dhënave të aktit të ekspertimit teknik-elektronik. Sipas këtij procesverbali, OPGJ-të, bazuar në vendimin e prokurorit për këqyrjen e të dhënave, kanë realizuar këqyrjen dhe printimin e të dhënave nga akti i ekspertimit, në të cilin janë ekstraktuar të dhëna si numrat e kontaktit, thirrjet hyrëse dhe dalëse, SMS-të hyrëse dhe dalëse, komunikimet në Whatsapp, Viber, Telegram, fotot dhe dokumentet e shkëmbyera etj., të përfuara nga ekspertimi i telefonit të kërkueses, të cilat janë hedhur në një *hard drive* të jashtëm (pajisje ruajtjeje). Në vijim, në procesverbal përshkruhen veprimet e kryera nga OPGJ-të për realizimin e këqyrjes. Kështu, *hard drive* është vendosur në një kompjuter dhe pasi kanë shkruar te një folder, që në brendësi ka një program që bën të mundur leximin e të dhënave, OPGJ-të kanë bërë kërkim në një rubrikë ku gjendeshin të gjitha komunikimet në formë të shkruar ose zanore, të zhvilluara në aplikacione të ndryshme si: *Whatsapp, Instagram, Facebook, Signal etj.* Sipas procesverbalit, gjatë kërkimit të rastësishëm të komunikimeve të kërkueses në këtë rubrikë janë gjetur biseda në Whatsapp, mes saj dhe bashkëshortit (në një datë të vitit 2018), si dhe me dy persona të tretë (në dy data të vitit 2019), ku përmbajtja e tyre lidhej me një gjyqtar kushtetues, për të cilin është kërkuar përjashtimi nga gjykimi i çështjes. Bashkëlidhur procesverbalit janë edhe ekstraktet e printuara të bisedave.

7. Në datën 29.2.2024, kërkuesja i është drejtuar Prokurorisë së Posaçme me kërkesë për kthimin e telefonit celular të sekuestruar. Me vendimin e datës 8.3.2024, prokurorët e çështjes kanë vendosur mospranimin e kërkesës.

8. Po kështu, në datën 6.3.2024, duke mos qenë dakord me masën e sekuestrimit të telefonit celular, kërkuesja ka paraqitur edhe ankim në gjykatë kundër procesverbalit të datës 26.2.2024, për sekuestrimin e sendit “telefon celular” nga OPGJ-të, si dhe kundër vendimit të datës 27.2.2024, të Prokurorisë së Posaçme për vleftësimin e ligjshëm të sekuestrimit, duke kërkuar edhe kthimin e sendit të sekuestruar. Ajo ka pretenduar se: i. nuk është lejuar të konsultohet me mbrojtësin përpara sekuestrimit të telefonit; ii. sekuestrimi është vendosur në kundërshtim me legjislacionin procedural penal, pasi ajo nuk ishte person nën hetim, nuk kanë ekzistuar



kushtet e urgjencës sipas nenit 300 të KPP-së që OPGJ-të të vepronin me iniciativë, pa urdhër të prokurorit, si dhe se telefoni i saj nuk ka lidhje me procedimin penal; iii. sekuestrimi dhe ekspertimi në vijim i telefonit të saj i kanë cenuar të drejtën për jetë private dhe të drejtën e pronës, përveçse e kanë penguar të kryejë detyrat e punës në institucionin mjekësor privat ku punonte.

9. Me vendimin nr. 161, datë 11.3.2024, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*) ka pranuar ankimin e kërkuësës, duke vendosur shfuqizimin e vendimit të datës 27.2.2024, të Prokurorisë së Posaçme, që kishte vleftësuar të ligjshëm sekuestrimin e telefonit të saj celular nga OPGJ-të, si dhe ka urdhëruar kthimin e tij kërkuësës. Në mënyrë të përmbledhur, ajo gjykatë ka vlerësuar se: i. sekuestrimi i telefonit të kërkuësës nuk është bërë me vendim gjykate, pra nëpërmjet kontrollit personal që përfaqëson mjetin juridik që bën të mundur shkuarjen te sekuestrimi, në kundërshtim me nenet 202, 208/a dhe 209 të KPP-së; ii. sekuestrimi i telefonit të kërkuësës nga OPGJ-të nuk është kryer në kushtet e flagrancës, në kundërshtim me nenet 202, pika 3 dhe 298 të KPP-së dhe vendimin njësuës nr. 1, datë 30.6.2017, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*vendimi njësuës nr. 1/2017*); iii. vendimet e Prokurorisë së Posaçme për vleftësimin e sekuestros dhe për kryerjen e ekspertimit teknik-elektronik të telefonit të kërkuësës nuk përcaktojnë të dhënat që do të përzgjidheshin, të domosdoshme për vërtetimin e faktit penal dhe pa të cilat nuk mund të arrihej në njohimin mbi ekzistencën e faktit, si dhe nuk tregojnë se përse sekuestrimi i të gjitha të dhënave të ruajtura në telefonin e kërkuësës ka qenë i domosdoshëm në aspektin e proporcionalitetit në planin sasior, cilësor dhe kohor, në kundërshtim me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) në lidhje me nenin 8, paragrafi 2, të KEDNJ-së; iv. dorëzimi i telefonit nga kërkuësja, e cila nuk është lejuar të konsultohet paraprakisht me avokatin dhe nuk është informuar për të drejtën për të mos e dorëzuar atë për këqyrje dhe sekuestrim, nuk përbën heqje dorë nga e drejta për jetë private dhe korrespondencë në kuptim të jurisprudencës së GJEDNJ-së. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim Prokuroria e Posaçme.

10. Me vendimin nr. 93 (87-2024-134), datë 17.5.2024, Gjykata e Posaçme e Apelit për

Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Apelit*) ka ndryshuar vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke rrëzuar kërkesën ankimore të kërkuësës. Ajo ka vlerësuar se OPGJ-të kanë vepruar brenda kompetencave për veprimin me iniciativë. Sipas asaj gjykate, pas deklarimeve të kërkuësës dhe këqyrjes të të dhënave në telefonin e saj, është krijuar menjëherë një situatë që kërkonte gjetjen e elementeve të vlefshme për rindërtimin e faktit penal dhe individualizimin e fajtorëve, deri në atë moment të supozuar. Në funksion të fiksimit dhe ruajtjes së gjurmëve, dhe sendeve që i përkasin veprës penale, për të shmangur ndryshimin ose humbjen e tyre, dhe duke qenë se prokurori nuk ishte i pranishëm për të ndërhyrë urgjentisht, OPGJ-të me të drejtë sekuestruan sendin “telefon celular” të kërkuësës. Ky send, si mjet mbajtës i fakteve, përbën provë të llojit “dokument” në kuptim të nenit 191 të KPP-së. Për rrjedhojë, veprimtaria me iniciativë e OPGJ-ve është në përputhje me nenin 294 të KPP-së, që i njeh Policisë Gjyqësore të drejtën të kryejë të gjitha veprimet për sigurimin e burimeve të provës. Po kështu, kjo veprimtari është në përputhje edhe me nenin 300 të KPP-së, për veprimet me iniciativë të Policisë Gjyqësore në rastet e verifikimeve të ngutshme në vend, kur vonesa deri në mbërritjen e prokurorit mund të sjellë ndryshim, humbje ose zhdukje të gjurmëve/sendeve, me pasoja për rezultatin e hetimeve. Ajo gjykatë ka theksuar se veprimi hetimor i sekuestrimit provues, si në rastin konkret, përbën veprim me iniciativë të Policisë Gjyqësore kur plotësohen kushtet e nenit 208 të KPP-së, pra kur provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën penale janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve, pavarësisht natyrës së tyre (të luajtshme/të paluajtshme). Ky sekuestrim i nënshtrohet regjimit të ruajtjes, vulosjes dhe heqjes/vënies së vulave sipas neneve 214–216 të KPP-së, njësoj sikur të ishte ekzekutuar me urdhër të gjykatës ose të prokurorit. Kundër vendimit të GJKKO-së së Apelit kërkuësja ka ushtruar rekurs.

11. Me vendimin nr. 00-2024-1272, datë 11.7.2024, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuësës, me arsyetimin se në të nuk ngrihen shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së dhe se GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar në mënyrë shteruese për pretendimet e saj. Sipas atij kolegji, sekuestrimi i telefonit të kërkuësës nga OPGJ-të është kryer në



kushtet e urgjencës, duke u vleftësuar në vijim nga prokurorët e çështjes, ndërsa sekuestrimi është kryer në përputhje me kërkesat e nenit 208, në lidhje me nenin 187 të KPP-së. Pas këqyrjes, organi procedues me të drejtë dyshoi se veprimtaria kriminale e pretenduar pasqyrohej edhe në të dhënat e ruajtura në telefon, ndërkohë që disponimi i tij nga kërkuesja krijonte rrezik për zhdukjen e dhënave të dobishme për hetimin, duke bërë kështu të domosdoshëm sekuestrimin e tij. Po sipas atij kolegji, ndryshe nga sa është pranuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë, në rastin konkret nuk jemi para një kontrolli të kërkueses, ndërsa ajo e vuri vetë telefonin në dispozicion të OPGJ-ve, pa ndonjë kundërshtim. Ai kolegji ka vlerësuar se këqyrja e telefonit nga OPGJ-të është në përputhje edhe me vendimin njëses nr. 147, datë 23.12.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (*vendimi njëses nr. 147/2021*). Sipas tij, kërkuesja ka qenë e pranishme dhe asaj nuk rezulton t'i jetë cenuar e drejta për jetë private në kuptim të nenit 8 të KEDNJ-së, për sa kohë këqyrja është kufizuar tek të dhënat që lidheshin me faktet objekt hetimi. Edhe sekuestrimi i telefonit, edhe vendimi i ekspertimit teknik-elektronik të tij, vijon ai, nuk i kanë shkelur kërkueses të drejtën për jetë private, pasi ato janë kryer vetëm në funksion të hetimit dhe kërkuesja nuk ka evidentuar fakte konkrete cenimi dhe as se të dhënat në telefon nuk kishin lidhje me objektin e hetimit. Këto veprime janë proporcionale, vetëm për aq sa të dhënat në telefon mund të ndihmonin hetimin. Sekuestrimi, ka vlerësuar ai, është në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës lidhur me kufizimin e së drejtës së pronës, pasi është bërë për një interes publik, siç është hetimi dhe goditja e veprave penale të korrupsionit dhe pastrimit të parave, ka qenë i domosdoshëm, në përputhje me gjendjen që e ka diktuar dhe në proporcion të drejtë me qëllimin dhe rrethanat konkrete. Kthimi i sendit kërkueses, është shprehur kolegji, mund të bëhet vetëm kur mbajta e tij për qëllime prove të mos jetë më i nevojshëm, ndërkohë që në rastin konkret hetimet paraprake vijnë dhe është urdhëruar ekspertimi teknik-elektronik i tij.

12. Në datën 8.11.2024, kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim

kushtetues individual, sipas objektit të tij. Në datën 3.1.2025, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe kjo e fundit në datën 28.1.2025, ka vendosur kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

13. Në datën 5.6.2025, një gjyqtar i Gjykatës ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes. Për këtë kërkesë, Mbledhja e Gjyqtarëve,³ me vendimin e datës 12.6.2025, ka vendosur rrëzimin e saj me arsyetimin se afërsia e lidhjes fisnore mes gjyqtarit dhe bashkëshortit të kërkueses nuk është në shkallën e parashikuar nga ligji dhe, për pasojë, nuk përbën shkak ligjor për papajtueshmëri në ushtrimin e funksionit nga gjyqtari kushtetues. Në seancën plenare të kësaj date Gjykata ka vendosur ndryshimin e formës së gjykimit në seancë plenare publike, duke e vlerësuar këtë si të nevojshme për përcaktimin e fakteve të çështjes. Palët janë njoftuar më pas për këtë vendim.

14. Në datën 24.6.2025, Prokuroria e Posaçme i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për shtyrjen e seancës plenare dhe, bazuar në nenet 5, pika 3 e 33, pika 3, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, ka kërkuar edhe zhvillimin e saj me dyer të mbyllura me qëllim ruajtjen e sekretit hetimor, duke qenë se procedimi penal për çështjen është ende në fazën e hetimit paraprak. Po atë ditë, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur pranimin e kërkesës për shtyrjen e seancës plenare, ndërsa kërkesën për zhvillimin e seancës me dyer të mbyllura ka vendosur ta shqyrtojë në seancën publike të datës 9.7.2025, pasi të dëgjonte palët. Në seancën plenare publike të kësaj date, Gjykata, pasi dëgjoi palët, vendosi zhvillimin e seancës plenare me dyer të mbyllura, vetëm me praninë e palëve, duke vlerësuar se, për sa kohë çështja ndodhet ende në fazën e hetimit paraprak, publiciteti mund të sjellë përhapjen e të dhënave që duhet të mbahen sekret në interes të hetimit.

15. Gjatë vijimit të seancës plenare, në kuadër të kërkesave paraprake, Prokuroria e Posaçme kërkoi përjashtimin nga gjykimi të gjyqtarit kushtetues, dorëheqja e të cilit nuk ishte pranuar më herët. Ajo parashitroi si shkak marrëdhëniet miqësore të

³ Votuan për pranimin e kërkesës për dorëheqje të gjyqtarit kushtetues gjyqtarët Holta Zaçaj, Sonila Bejtja dhe Sandër Beci.



gjyqtarit kushtetues me kërkesen, duke paraqitur si provë disa komunikime të kërkeses me bashkëshortin e saj (në një datë të vitit 2018), si dhe me dy persona të tretë (në dy data të vitit 2019), të nxjerra nga të dhënat e memorizuara nga platforma në *Whatsapp* në telefonin celular të sekuestruar kërkeses. Pas njohjes me shkaqet e kërkesës dhe nisur nga ndjeshmëria e subjektit të interesuar, gjyqtari kushtetues ka paraqitur sërish kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes, e cila është pranuar nga Gjykata me qëllim garantimin e paanësisë së saj edhe në dukje. Në këto rrethana, kërkesa e Prokurorisë së Posaçme për përjashtimin e gjyqtarit kushtetues u konsiderua se nuk është bërë, bazuar në nenin 20 të KPP-së, i zbatueshëm në rastin konkret në kuptim të nenit 1, pika 2, të Ligjit Organik të Gjykatës.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

16. *Kërkesja*, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

16.1 *E drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtëm të *parimit të sigurisë juridike*, pasi vendimet gjyqësore të kundërshtuara bien ndesh me vendimet njësuere nr. 1/2017 dhe nr. 147/2021, të Gjykatës së Lartë, për shkak të mosrespektimit të parimeve të proporcionalitetit dhe të përshtatshmërisë.

16.2 *E drejta për jetë private* në aspektin e *të dhënave personale* dhe *korrespondencës*, të garantuara nga nenet 35 dhe 36 të Kushtetutës, për shkak të mosrespektimit të *parimit të proporcionalitetit*, pasi:

16.2.1 Në përmbajtje të telefonit celular ka komunikime të saj, përveç edhe foto, të dhëna kontakti, faqe interneti të klikuara dhe të dhëna të tjera personale. Për shkak të profesionit që ajo ushtron, një pjesë e mirë e të dhënave kishin të bënin me pacientë, duke përbërë ato të dhëna me natyrë sensitive, të mbrojtura nga ligji nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (*ligji nr. 9887/2008*), në fuqi në kohën e sekuestrimit, nga ligji aktual nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (*ligji nr. 124/2024*), si dhe nga neni 30, i ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, që përcakton detyrimin e profesionistëve të shëndetit, përdoruesve të sistemeve të informacionit shëndetësor dhe

autoriteteve për ruajtjen e të dhënave shëndetësore që përbëjnë informacion konfidencial.

16.2.2 Sekuestrimi i telefonit celular është bërë në kundërshtim me nenin 209 të KPP-së dhe me vendimin njësuere nr. 147/2021, të Gjykatës së Lartë në lidhje me sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, sipas nenit 208/a, të KPP-së, pasi ka dallim thelbësor ndërmjet telefonit si objekt fizik, i cili mund të sekuestrohet sipas nenit 208, të KPP-së, dhe përmbajtjes së tij si të dhëna personale ose korrespondencë. Nisur nga kjo, edhe pse neni 209, i KPP-së i referohet korrespondencës tradicionale, interpretimi i tij duhet të bëhet nën dritën e zhvillimeve të reja teknologjike, të frymës së Kushtetutës dhe të jurisprudencës së GJEDNJ-së, duke u zbatuar kjo dispozitë edhe në rastin e sekuestrimit të telefonit celular në lidhje me leximin dhe përpunimin e përmbajtjes së tij, që përbën korrespondencë elektronike. Në këtë kuptim, ndërhyrja në korrespondencën e kërkeses është bërë pa vendim të gjykatës, si organi i vetëm që mund të vlerësojë proporcionalitetin e saj.

16.2.3 Sekuestrimi i telefonit celular është bërë në kundërshtim edhe me nenin 300 të KPP-së, pasi nuk kanë ekzistuar kushtet e urgjencës dhe flagrancës për veprimin me iniciativë nga OPGJ-të. Ajo nuk është person nën hetim dhe telefonin e ka vënë në dispozicion të OPGJ-ve duke qenë dakord me këqyrjen e tij, ndërkohë që OPGJ-të, ndonëse mund të merrnin kohën e nevojshme, nuk kanë vazhduar këqyrjen dhe dokumentimin e komunikimeve të saj me dy personat që kishin lidhje me hetimin. Kërkesa e saj për praninë e avokatit gjatë sekuestrimit të telefonit nuk është pranuar nga OPGJ-të dhe pretendimi i kërkeses në këtë drejtëm nuk është analizuar nga gjykatat në vendimet e kundërshtuara.

16.2.4 Sekuestrimi i telefonit celular nuk ka qenë i domosdoshëm dhe ka pasur masa të tjera më të lehta, më pak kufizuese për të drejtat e saj, për arritjen e qëllimit të ndjekur, pikërisht sigurimin e komunikimeve me dy personat që kishin lidhje me hetimin, të tilla, si: këqyrja ose kopjimi i atyre të dhënave, madje edhe sekuestrimi i telefonit, por vetëm për një periudhë të kufizuar kohore (deri në një muaj), për atë sa ka qenë e nevojshme për këqyrjen dhe kopjimin e të dhënave në fjalë. Ajo ka pranuar dhe nuk ka penguar këqyrjen e telefonit celular nga OPGJ-të.

16.2.5 Sekuestrimi i telefonit celular dhe ekspertimi i tij nuk kanë qenë masa proporcionale



në kuptimin e ngushtë, përveçse bien në kundërshtim me vendimin njësoes nr. 147/2021. Vendimi i ekspertimit të telefonit është i përgjithshëm, evaziv dhe shumë i gjerë, pa përcaktuar të dhënat elektronike që i shërbenin hetimit e që lidheshin me veprën penale ose masat specifike për mbrojtjen e të dhënave. Media ka informuar se të dhënat për dosjen hetimore në fjalë janë hakeruar, ndonëse sipas njoftimit të Prokurorisë së Posaçme ka pasur tentativë për hakerimin e tyre. Duke sekuestruar dhe ekspertuar telefonin janë aksesuar të gjitha të dhënat e ruajtura në të, ndonëse vetëm një pjesë e kufizuar e tyre lidhej me hetimin, përveçse komunikimet që i adresoheshin kërkueses kanë natyrë periferike dhe pa rëndësi të veçantë për hetimin. Në këtë drejtim, edhe materiali i paraqitur në mbështetje të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit kushtetues tregon qartë se organi i ndjekjes penale ka aksesuar edhe të dhëna që nuk lidhen me hetimin. Po kështu, edhe pse ka kaluar më shumë se 1 vit e 4 muaj nga sekuestrimi, telefoni nuk i është kthyer ende.

16.3 *E drejta e pronës private*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, si rrjedhojë e sekuestrimit të telefonit celular të saj dhe mbajtjes së tij të sekuestruar, masë kjo që e ka vënë në vështirësi serioze për organizimin dhe vijimin e veprimtarisë së saj profesionale.

17. *Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme*, ka prapësuar se:

17.1 Pretendimi i kërkueses për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* është i pabazuar, pasi GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë kanë vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke arsyetuar për proporcionalitetin dhe përshtatshmërinë e ndërhyrjes.

17.2 Pretendimet e kërkueses për cenimin e *së drejtës së pronës private* dhe *së drejtës për jetë private* në aspektin e *të dhënave personale* dhe *të korrespondencës* janë të pabazuara. Këto të drejta nuk janë absolute dhe ndërhyrja në telefonin celular të kërkueses në rastin konkret respekton standardet dhe kriteret e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese dhe ajo e GJEDNJ-së në lidhje me:

17.2.1 Ligjshmërinë e ndërhyrjes, pasi sekuestrimi i telefonit celular të kërkueses është kryer në përputhje me nenin 300 të KPP-së, që u jep OPGJ-ve të drejtën për të sekuestruar, me iniciativë, sende që lidhen me një vepër penale, në kushtet e urgjencës. Sekuestrimi është vleftësuar në vijim nga

prokurori, në përputhje me nenin 301 të KPP-së. Ai është realizuar nga OPGJ-të për shkak se vazhdimi i këqyrjes të të dhënave në telefon kërkonte kohë të gjatë, ndërkohë që ndërhyrja e prokurorit ka qenë e pamundur, pasi kishte kaluar orari zyrtar. Në rast mosveprimi, ka ekzistuar rreziku i fshirjes të të dhënave në telefonin e kërkueses dhe i pamundësisë së rikuperimit të tyre. Dispozitat e KPP-së nuk parashikojnë praninë e mbrojtësit gjatë marrjes në pyetje të shtetasit në cilësinë e personit që ka dënim për rrethanat e hetimit ose gjatë veprimit të sekuestrimit. Edhe jurisprudenca e GJEDNJ-së e ka konsideruar të ligjshme masën e sekuestrimit të pajisjeve elektronike, kur ajo ndihmon për zbulimin e fakteve të rëndësishme për hetimin penal.

17.2.2 Qëllimin legjitim të ndërhyrjes, pasi sekuestrimi i telefonit celular të kërkueses është kryer për mbledhjen e provave në kuadër të një hetimi për vepra të rënda penale si korrupsioni dhe pastrimi i produkteve të veprës penale, krime këto me pasoja të rënda për interesin publik dhe rendin ligjor.

17.2.3 Domosdoshmërinë e ndërhyrjes, pasi sekuestrimi i telefonit celular të kërkueses është bërë për nevojat e hetimit, me qëllim ekzaminimin e tij të mëtejshëm në kushtet kur është verifikuar se në telefon gjendej një numër i konsiderueshëm të dhënash me rëndësi për hetimin dhe ka pasur prova dhe indicie të mjaftueshme për lidhjen e kërkueses me hetimin penal, ndërkohë që nuk ka pasur alternativa të tjera më të lehta për të siguruar të njëjtën rezultat hetimor. Duke pasur parasysh volumin e madh të të dhënave në telefonin celular të kërkueses, për OPGJ-të ka qenë krejt e pamundur të vijonin me këqyrjen në vend të të dhënave, siç pretendon kërkuesja, prandaj është proceduar me sekuestrimin e telefonit, në kushtet kur kemi të bëjmë me prova elektronike që mund të zhduken menjëherë, në çast. Kopjimi i përmbajtjes së telefonit është bërë përmes ekspertimit teknik-elektronik, veprim i cili, ashtu si dhe këqyrja e aktit të ekspertimit në vijim, kërkon kohë për shkak të volumit të madh të të dhënave.

17.2.4 Proporcionalitetin dhe përshtatshmërinë e ndërhyrjes, pasi ndërhyrja në telefonin celular të kërkueses është orientuar vetëm drejt të dhënave që lidhen me faktin penal dhe me personat e përfshirë, duke mos qenë ajo e paarsyeshme ose arbitrare. Për më tepër, kërkuesja e ka dorëzuar me dëshirë telefonin e saj, duke nënshkruar pa vërejtje



procesverbalin e këqyrjes dhe të sekuestrimit të tij. Të dhënat në përmbajtje të telefonit të kërkueses nuk janë bërë publike dhe do të përdoren vetëm për qëllime hetimore. Pretendimet e parashtuara në gjykimin kushtetues për gjyqtarin kushtetues kanë synuar të japin pasqyrim të marrëdhënies së tij me kërkuesen dhe kanë të bëjë me objektin e gjykimit të çështjes, duke mos tejkaluar asnjë normë. Sekuestrimi i telefonit të kërkueses dhe mbajtja e tij i sekuestruar si provë materiale, për aq kohë sa është e domosdoshme për të provuar faktin penal, është në përputhje edhe me vendimin njësoes nr. 147/2021. Nëse telefoni do t'i kthehej kërkueses, ekziston rreziku i dëmtimit ose i zhdukjes së provës dhe në kushtet kur hetimet vazhdojnë, kthimi i tij është i pamundur, pasi mund të lindë nevoja për riekspertim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkueses

18. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

19. Në lidhje me legjitimitimin *ratione personae*, Gjykata ka theksuar se në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, individ mund të bëjë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me të drejtat themelore të tij, duke treguar se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të (*shih vendimet nr. 21, datë 22.4.2025; nr. 17, datë 13.3.2024; nr. 44, datë 26.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese*). Në dritën e kësaj jurisprudence, Gjykata

vëren se, në rastin konkret, kërkuesja ka kundërshtuar masën e sekuestrimit, për qëllime provuese, të telefonit celular të saj të zbatuar nga OPGJ-të dhe vendimin e prokurorëve për vlefhtësimin si të ligjshëm të sekuestrimit, si dhe veprimin hetimor të ekspertimit teknik-elektronik të telefonit të sekuestruar, përveç edhe vendimet gjyqësore të GJKKO-së së Apelit e të Gjykatës së Lartë që kanë rrëzuar ankimin e saj, me pretendimin se masa dhe veprimi hetimor në fjalë, si dhe ligjërimi i tyre nga gjykatat e zakonshme kanë ndërhyrë drejtpërdrejt në të drejtat themelore të saj. Në këto kushte, Gjykata çmon se kërkuesja justifikon interesin në çështjen e parashtuar dhe, për rrjedhojë, legjitimohet *ratione personae*.

20. Për sa i takon kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, duke pasur parasysh se vendimet e ndërmjetme të sekuestros provuese, të zbatuara gjatë hetimeve paraprake, i janë nënshtruar kontrollit kushtetues duke u konsideruar si vendime përfundimtare, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, për sa kohë ndërhyjnë në të drejtat kushtetuese individuale (*shih vendimet nr. 42, datë 1.7.2025; nr. 21, datë 22.4.2025, të Gjykatës Kushtetuese*), si dhe faktin se kërkuesja pretendimet e saj në ankimin kushtetues individual i ka paraqitur më parë, në formë dhe në substancë, përpara gjykatave të zakonshme, Gjykata vlerëson se ajo nuk ka mjete të tjera juridike në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual, ndaj edhe ky kriter plotësohet.

21. Kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 11.7.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 8.11.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

22. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtëm të parimit të sigurisë juridike, së drejtës për jetë private në aspektin e mbrojtjes të të dhënave personale dhe të korrespondencës, si dhe së drejtës së pronës private, të lidhura me parimin e proporcionalitetit, pretendime të cilat përfshihen në juridiksionin kushtetues.

23. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës së pronës private, sipas nenit 41 të Kushtetutës, Gjykata evidenton se kërkuesja nuk ka paraqitur ndonjë argument kushtetues në mbështetje të tij.



Argumenti i saj konsiston në krijimin e vështirësive serioze për organizimin dhe vijimin e veprimtarisë së saj profesionale, duke e lidhur këtë jo me sekuestrimin e telefonit në vetvete, por me përmbajtjen e tij. Edhe gjatë gjykimit kushtetues ajo u përqendrua vetëm tek e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale dhe fshehtësinë e korrespondencës. Për këto arsye, Gjykata çmon se ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

24. Në lidhje me *të drejtën për proces të rregullt ligjor*, Gjykata ka theksuar se, përjashtimisht, në rastin e kontrollit të vendimeve që vendosin masa me karakter të ndërmjetëm ajo i trajton pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues individual në drejtim të të drejtave substanciale, ndërsa pretendimet që kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt ligjor i konsideron si aspekte procedurale të së drejtës substanciale të pretenduar të cenuar, ndaj, në këtë kuptim, ajo ndalet në elemente të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete (*shih vendimet nr. 79, datë 12.11.2024; nr. 29, datë 16.4.2024; nr. 18, datë 19.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në rastin konkret, Gjykata vëren se, në aspektin procedural, kërkuësja ka pretenduar cenimin e *parimit të sigurisë juridike*, për shkak të moszbatimit nga GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë të qëndrimit njësores të kësaj të fundit. Gjykata vlerëson se ky pretendim, pavarësisht se është ngritur në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, në thelb, lidhet me proporcionalitetin e ndërhyrjes, ndaj do të analizohet në drejtim të aspektit substancial të të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara, mbrojtja e të cilave garantohet nga nenet 36 dhe 35 të Kushtetutës. Nga ana tjetër, në këndvështrim të garancive që parashikon neni 36 i Kushtetutës, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuësës në çështjen në shqyrtim nuk lidhen me cenimin e lirisë së korrespondencës, por me fshehtësinë e saj. Në thelb, pretendimet e kërkuësës drejtohen ndaj masës hetimore të sekuestrimit të sendit “telefon celular” dhe aksesimit të përmbajtjes së tij përmes veprimit hetimor të ekspertimit teknik-elektronik, ku sipas kërkuësës ruhen të dhëna personale dhe komunikime elektronike të saj, si dhe me mënyrën sesi Prokuroria e Posaçme, fillimisht, dhe më pas edhe gjykatat e zakonshme kanë

interpretuar dispozitat penale procedurale të zbatueshme në rastin konkret.

26. Për sa u takon neneve 35 dhe 36 të Kushtetutës, Gjykata në jurisprudencën e saj i ka trajtuar ato në këndvështrim të së drejtës për jetë private, duke theksuar se kjo e fundit nuk mbrohet nga një dispozitë e vetme e Kushtetutës, por nga disa prej tyre, ndër të cilat përfshihet edhe neni 35, që bën fjalë për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe neni 36 që bën fjalë për lirinë dhe fshehtësinë e korrespondencës (*shih vendimet nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 52, datë 1.12.2011; nr. 16, datë 11.11.2004, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Nga ana tjetër, sipas nenit 8 të KEDNJ-së, çdokush ka edhe të drejtën e respektimit të jetës private dhe autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji, kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, apo për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Gjykata i referohet KEDNJ-së, për rrjedhojë edhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, jo vetëm për shkak të pretendimeve dhe argumenteve të sjella në një rast konkret, por edhe për shkak të vendit të privilegjuar që marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara zënë në hierarkinë e akteve normative në Republikën e Shqipërisë sipas neneve 116 dhe 122 të Kushtetutës. Për më tepër, për çështje që lidhen me kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, KEDNJ-ja, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës, barazohet në rang me vetë Kushtetutën (*shih vendimin nr. 2, datë 29.1.2024, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, Gjykata merr parasysh edhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila i ka konkretizuar standardet e KEDNJ-së nëpërmjet zbatimit të tyre në çështje të veçanta (*shih vendimin nr. 9, datë 23.3.2010, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Për sa më sipër, duke mbajtur parasysh natyrën dhe thelbin e pretendimeve të kërkuësës, Gjykata vlerëson që t'i shqyrtojë ato në themel në këndvështrim të së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, të garantuar nga neni 35 i Kushtetutës dhe të fshehtësisë së korrespondencës, të garantuar nga neni 36 i saj. Për të vlerësuar nëse ka pasur ose jo cenim të të drejtave substanciale, Gjykata ka pohuar se niset nga arsyetimi i vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, pasi, në zbatim të parimit të subsidiaritetit, u takon atyre gjykatave që, krahas zbatimit të ligjit material dhe procedural



penal, të marrin në konsideratë edhe jurisprudencën e Gjykatës edhe të GJEDNJ-së në lidhje me parimin e proporcionalitetit, duke qenë Gjykata mjeti i fundit për mbrojtjen e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 33, datë 20.5.2025; nr. 79, datë 12.11.2024; nr. 29, datë 16.4.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe fshehtësinë e korrespondencës

29. Kërkuësja pretendon se sekuestrimi i telefonit celular dhe ekspertimi pasues i tij i kanë cenuar të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale dhe fshehtësinë e korrespondencës, pasi telefoni është sekuestruar pa vendim gjykatë, në kundërshtim me nenet 209 dhe 208/a të KPP-së dhe vendimin njësuës nr. 147/2021, si dhe pa qenë të pranishme kushtet e urgjencës e të flagrancës, në kundërshtim me nenin 300 të KPP-së. Po sipas saj, sekuestrimi është kryer megjithëse nuk ishte person nën hetim, përveçse iu mohua prania e avokatit. Ndërhyrja, vijon ajo, nuk ka qenë e domosdoshme dhe kanë ekzistuar masa më pak kufizuese për arritjen e qëllimit të ndjekur, të tilla, si: vijimi i këqyrjes nga OPGJ-të, kopjimi i të dhënave me rëndësi për hetimin ose sekuestrimin, por vetëm për një kohë të kufizuar (deri në një muaj), për aq sa ka qenë e nevojshme për këqyrjen dhe kopjimin e të dhënave në fjalë. Po sipas saj, sekuestrimi i telefonit dhe ekspertimi pasues i tij kanë qenë një masë joproporcionale në kuptimin e ngushtë. Vendimi i ekspertimit, shprehet ajo, është i përgjithshëm, evaziv dhe shumë i gjerë, pa përcaktuar të dhënat elektronike që i shërbenin hetimit dhe as masat specifike për mbrojtjen e të dhënave, duke sjellë aksesim të të gjitha të dhënave edhe pse vetëm një pjesë e vogël lidhej me hetimin, çka, sipas saj, konfirmohet edhe nga materiali i paraqitur në mbështetje të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit kushtetues, ndërkohë që telefoni nuk i është kthyer ende edhe pas më shumë se 1 viti e 4 muaj nga sekuestrimi.

30. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, ka prapësuar se ndërhyrja në telefonin celular të kërkuësës është në përputhje me standardet e jurisprudencës kushtetuese dhe të GJEDNJ-së. Sipas tij, ajo përmbush kriterin e ligjshmërisë, pasi sekuestrimi është kryer nga OPGJ-të në kushtet e urgjencës sipas nenit 300 të KPP-së dhe më pas është vlefësuar nga prokurori sipas nenit 301 të KPP-së, duke qenë i nevojshëm për shkak të kohës

së gjatë që kërkonte vijimi i këqyrjes në vend dhe i rrezikut të fshirjes të të dhënave në telefonin e kërkuësës dhe i pamundësisë së rikuperimit të tyre. Ndërhyrja, vijon ai, ndjek një qëllim legjitim, pikërisht mbledhjen e provave në një hetim për vepra të rënda, si korrupsioni dhe pastrimi i produkteve të veprës penale. Ajo ka qenë e domosdoshme dhe pa alternativa më të lehta, të cilat siguronin të njëjtin rezultat hetimor, edhe për shkak të volumit të madh të të dhënave dhe natyrës së brishtë të provës elektronike, e cila mund të zhduket menjëherë, në çast. Po kështu, vijon ai, ndërhyrja ka qenë proporcionale, e orientuar vetëm drejt të dhënave që lidhen me faktin penal dhe me personat e përfshirë, të cilat nuk janë bërë publike dhe do të përdoren vetëm për qëllime hetimore, duke mos qenë ajo e paarsyeshme ose arbitrare. Për më tepër, kërkuësja e ka dorëzuar vullnetarisht telefonin, duke nënshkruar pa vërejtje procesverbalin e këqyrjes dhe të sekuestrimit të tij. Pretendimet për gjyqtarin kushtetues, shprehet ai, lidhen me objektin e gjykimit të çështjes, duke mos tejkaluar asnjë normë. Mbajtja e telefonit nën sekuestro, si provë materiale, për aq sa është e domosdoshme për provimin e faktit penal dhe për të shmangur rrezikun e dëmtimit/zhdukjes ose nevojën për riekspertim gjatë hetimeve në vijim, është në përputhje edhe me vendimin njësuës nr. 147/2021.

1, Për të drejtën e mbrojtjes të të dhënave personale

31. Neni 35 i Kushtetutës parashikon se askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij dhe se mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale, e garantuar nga neni 35 i Kushtetutës, përshkohet nga fryma se përpunimi i këtyre të dhënave duhet të bëhet duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Qëllimi i kushtetutëbërësit në parashikimin e kësaj dispozite kushtetuese ka qenë garantimi i një hapësire të nevojshme, brenda së cilës individit mund të zhvillojë në mënyrë të pavarur personalitetin e tij. Në këtë kuadër, është e drejtë e individit të vendosë vetë për mënyrën dhe masën e paraqitjes të të dhënave të tij personale përpara të tjerëve dhe publikut në tërësi (*shih vendimet nr. 20, datë 20.4.2021; nr. 16, datë 11.11.2004, të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka pohuar se sanksionimi në këtë



dispozitë i parimit të mosdetyrimit për bërjen publike të të dhënave personale përbën garanci kushtetuese (*shih vendimin nr. 52, datë 1.12.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Nga ana tjetër, GJEDNJ-ja është shprehur se mbrojtja e të dhënave personale garantohet në kuadër të së drejtës për respektimin e jetës private sipas nenit 8 të KEDNJ-së. Sipas saj, mbrojtja e të dhënave personale është me rëndësi themelore për gëzimin e së drejtës për respektimin e jetës private dhe familjare dhe se kjo dispozitë parashikon të drejtën për një formë të vetëvendosjes informative, duke u lejuar individëve të mbështeten në të drejtën e tyre për privatësi, përfshirë edhe për ato të dhëna, të cilat, megjithëse asnjëse, mblidhen, përpunohen dhe shpërndahen në mënyrë kolektive, në një formë ose mënyrë të tillë që mund të aktivizojnë të drejtat e tyre sipas nenit 8 (*shih L. B. kundër Hungarisë, datë 9.3.2023, § 103; Satakunnan Markkinapörssi Oy dhe Satamedia Oy kundër Finlandës, datë 27.6.2017, §137*). Po kështu, GJEDNJ-ja ka theksuar se edhe natyra profesionale e aktiviteteve, të cilave u referohen të dhënat, nuk përjashton ekzistencën e së drejtës për privatësi (*shih Amann kundër Zvicrës [DhM], datë 16.2.2000, § 65; Rotaru kundër Rumanisë [DhM], datë 4.5.2000, § 43*).

33. Në veçanti, në lidhje me nocionin e të dhënave personale, GJEDNJ-ja i është referuar përkufizimit të dhënë nga Konventa nr. 108 e Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale” (CETS No. 108), e datës 28 janar 1981 (*Konventa për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*), sipas së cilës të dhënat personale janë “*çdo informacion që lidhet me një individ të identifikuar ose të identifikueshëm*” (*shih L. B. kundër Hungarisë, datë 9.3.2023, § 42; Bernh Larsen Holding AS dhe të tjerë kundër Norvegjisë, datë 14.3.2013, § 76; Amann kundër Zvicrës, [DhM], datë 16.2.2000, § 65*). Kjo Konventë, bashkë me Protokollin e saj shtesë nr. 181 (ETS No. 181), të datës 8.11.2001, janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 9288, datë 7.10.2004, i ndryshuar, dhe me ligjin nr. 9287, datë 7.10.2004.

34. Në datën 10.10.2018, është hapur për nënshkrim Protokollin nr. 223 (CETS No. 223), i cili gjithashtu është ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 49/2022, datë 12.5.2022. Protokollin nr. 223 integron në një dokument të vetëm Konventën nr. 108 dhe Protokollin Shtesë nr. 181, me qëllim modernizimin dhe forcimin e

zbatimit të tyre, për t’iu përgjigjur sfidave të reja dhe nevojës për të ruajtur rolin e rëndësishëm të Konventës në mbrojtjen e individëve nga përpunimi i të dhënave personale dhe, më gjerë, në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore. Gjykata i mban në konsideratë këto zhvillime legjislative, të cilat, edhe pse ende nuk kanë hyrë në fuqi, diktojnë nevojën për interpretim më rigoroz të garancive mbrojtëse për të dhënat personale dhe përpunimin e tyre.

35. Sipas ligjit nr. 9887/2008, në fuqi në kohën e ndodhjes së fakteve në çështjen në shqyrtim, “*të dhëna personale*” është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor ose social (neni 3, pika 1). Edhe sipas ligjit të ri nr. 124/2024, i cili ka hyrë në fuqi pas sekuestrimit të telefonit celular të kërkuësës, konkretisht më 1.2.2025, “*e dhënë personale*” është çdo informacion në lidhje me një subjekt të dhënash (neni 5, pika 3), ndërsa “*subjekt i të dhënave*” është çdo person fizik i identifikuar ose i identifikueshëm dhe se një person është i identifikueshëm nëse mund të arrihet në identifikimin e tij, duke iu referuar drejtpërdrejt ose tërthorazi një ose disa faktorëve identifikues të veçantë, si: emri, numri i identifikimit, të dhënat për vendndodhjen, një identifikues në internet, ose një apo më shumë faktorëve specifikë lidhur me identitetin e tij fizik, fiziologjik, identitetin gjenetik, mendor, ekonomik, kulturor ose shoqëror (neni 5, pika 23).

36. Nga sa më lart, Gjykata vëren se neni 35 i Kushtetutës, në thelb, garanton të drejtën e individit për të vendosur në mënyrë autonome për mbledhjen, përdorimin dhe bërjen publike të informacionit që lidhet me personin e tij. *E drejta për të vendosur vetë për informacionin personal* ka të bëjë me mënyrën dhe masën e paraqitjes, përpara të tjerëve dhe publikut në tërësi, të atij informacioni, përfshirë të dhënat personale, që ekspozon aspekte të jetës private të individit, si formë e shpalosjes së lirë të personalitetit njerëzor, e sanksionuar si vlerë kushtetuese edhe në Preambulën e Kushtetutës. Thënë ndryshe, kjo dispozitë garanton mbrojtjen e individit nga përpunimi i të dhënave në mënyrë të pakufizuar, duke i siguruar atij mundësinë për të vendosur vetë mbi përdorimin e të dhënave



personale. Një mbrojtje e tillë nuk kushtëzohet nga forma e regjistrimit/dokumentimit dhe e ruajtjes të të dhënave personale, mjafton që ato të jenë të regjistruara dhe të ruajtura në një formë të atillë që mundëson mbledhjen, përpunimin, përdorimin ose publikimin e tyre. Në këtë kuptim, ajo garanton mbrojtjen e fshehtësisë të të dhënave personale, përfshirë edhe të atyre të regjistruara në formë elektronike në një pajisje inteligjente si telefoni celular. Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se edhe të dhënat personale që përmban një telefon celular në përdorim të një individi përfshihen në fushën e mbrojtjes të garantuar nga neni 35 i Kushtetutës.

2. *Për të drejtën e fshehtësisë së korrespondencës*

37. Neni 36 i Kushtetutës parashikon se edhe fshehtësia e korrespondencës ose e çdo mjeti tjetër të komunikimit janë të garantuara. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se kjo dispozitë kushtetuese mbron hapësirën brenda së cilës individi zhvillon personalitetin e tij dhe marrëdhëniet me individët e tjerë. Gjykata është shprehur se pjesë e korrespondencës janë edhe komunikimet e individit në ambiente publike me individë të tjerë në distancë që ai i bën me mesazhe të shkruara, zanore ose vizuale, duke përdorur pajisje kompjuterike, komunikime, të cilat mund të regjistrohen, filmohen ose fotografohen rastësisht gjatë zbatimit të masave të veçanta, veçanërisht të mbikëqyrjes vizuale (*shih vendimet nr. 30, datë 5.7.2021; nr. 52, datë 1.12.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për respektimin e korrespondencës sipas nenit 8 të Konventës synon të mbrojë konfidencialitetin e komunikimeve të një rangu të gjerë, përfshirë padyshim letrat me natyrë private ose profesionale (*shih Niemetz kundër Gjermanisë, datë 16.12.1992, § 32; Mehmet Nuri Özgen dhe të tjerë kundër Turqisë, datë 11.11.2011, § 41; Nuh Uzun dhe të tjerë kundër Turqisë, datë 29.3.2022, § 80*) ose dhe pakot (*shih X kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i Komisionit, datë 12.10.1978*). Po kështu, ajo mbulon edhe forma të tjera komunikimi, si bisedat telefonike midis anëtarëve të familjes (*shih Margareta dhe Roger Andersson kundër Suedisë, datë 20.1.1992, § 72*), ose me të tjerë (*shih Lüdi kundër Zvicrës, datë 15.6.1992, §§ 38–39; Azer Ahmadov kundër Azerbajxhanit, datë 22.7.2021, § 62*), pavarësisht nëse kanë ndodhur vetëm në një rast ose gjatë një periudhe të caktuar kohore. Ajo mbulon gjithashtu edhe komunikimet elektronike në format më të vjetra si telekset (*shih Christie kundër Mbretërisë së*

Bashkuar, vendimi i Komisionit, datë 27.6.1994), mesazhet me pager (*shih Taylor-Sabori kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 22.10.2002*) ose transmetimet private radiofonike (*shih X dhe Y kundër Belgjikës, vendimi i Komisionit, datë 13.5.1982*), ashtu edhe ato në format më të reja. Lidhur me këto të fundit, GJEDNJ-ja ka pranuar se edhe teknologjitë e reja hyjnë në fushëveprimin e nenit 8 të KEDNJ-së, në veçanti të dhënat nga një telefon inteligjent/laptop dhe/ose kopja e tij pasqyrë (*shih Sargava kundër Estonisë, datë 16.11.2021*), mesazhet elektronike (email-et) (*shih Copland kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 3.4.2007, §§ 41, 44*), SMS-të (*shih Saber kundër Norvegjisë, datë 17.12.2020, § 48*) mesazhet e çastit të dërguara dhe të marra nëpërmjet internetit (*shih Bărbulescu kundër Rumanisë [DhM], datë 5.9.2017, § 74*), si dhe të dhënat e ruajtura në serverët e kompjuterëve (*shih Grande Oriente d'Italia kundër Italisë, datë 19.12.2024, § 89*), duke përfshirë disqet e forta (*shih Petri Sallinen dhe të tjerë kundër Finlandës, datë 27.9.2005, § 71*) dhe disketat (*shih Iliya Stefanov kundër Bullgarisë, datë 22.5.2008, § 42*).

39. Legjislacioni në fuqi në kohën e ndodhjes së fakteve në çështjen në shqyrtim ka rregulluar edhe nocionet e mjetit, të komunikimit dhe të dokumentit elektronik, duke iu përshtatur zhvillimeve të teknologjisë së informacionit. Sipas ligjit nr. 9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, “*mjet elektronik*” është çdo mjet, me anë të të cilit mundësohet dërgimi fillestar i informacionit e marrja e tij nga marrësi i përcaktuar me anë të pajisjeve elektronike për përpunimin (duke përfshirë ngjeshjen shifrore) dhe ruajtja e të dhënave, tërësisht të transmetuara, të përcjella ose të marra përmes kablllove, valëve radio, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, përfshirë edhe internetin (neni 4, pika 18). Ndërsa sipas ligjit nr. 9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike”, të ndryshuar, “*komunikim*” (elektronik) është shkëmbimi ose transmetimi i informacionit ndërmjet një numri të kufizuar përdoruesish të shërbimeve të komunikimeve elektronike (neni 3, pika 13). Po sipas tij, “*postë elektronike*” është çdo mesazh në formën e tekstit, tingullit ose imazhit, të dërguar nëpërmjet rrjetit publik të komunikimeve, i cili mund të ruhet në rrjet ose në pajisjen fundore të marrësit derisa marrësi ta marrë atë (neni 3, pika 34), kurse “*pajisje fundore*” është pajisja e lidhur në pikën fundore të rrjetit, e cila shërben për transmetimin, marrjen dhe përpunimin e komunikimeve (neni 3,



pika 26), ndërsa “*rrjeti i komunikimeve publike*” është rrjeti i komunikimeve elektronike, që përdoret, tërësisht ose pjesërisht, për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun (*neni 3, pika 37*).

40. Në vijim, sipas ligjit nr. 10273, datë 29.4.2010, “Për dokumentin elektronik”, të ndryshuar, “*dokument elektronik*” është çdo informacion i krijuar me “cilësi dokumentare”, i dërguar, i marrë ose i ruajtur në formë elektronike nga një sistem kompjuterik ose nga një mekanizëm i ngjashëm dhe që plotëson kushtet për vlefshmërinë, ndërsa përmbajtja e tij përfshin të gjitha format e të dhënave, e pasqyruar me shkronja, numra, simbole, zë dhe imazh (*neni 3, pika 1*). Po sipas tij, “*sistem kompjuterik*” është ai sistem, i cili përbëhet prej pajisjeve, grupi pajisjesh ose pajisje të lidhura, ku njëra ose më shumë prej tyre janë vazhduese dhe që kryejnë një proces automatik të transmetimit të të dhënave (*neni 3, pika 4*), kurse “*formë numerike*” është paraqitja e dokumentit elektronik në gjuhën shifrore të sistemit kompjuterik (*neni 3, pika 5*). Neni 8 i ligjit përcakton se dokumenti elektronik ka formën e paraqitjes së tij të brendshme, që është forma numerike, e përfutur nga përpunimi, dërgimi, marrja dhe ruajtja e dokumentit elektronik me një sistem programesh dhe pajisjesh kompjuterike, si dhe formën e paraqitjes së jashtme, që është paraqitja vizuale dhe e kuptueshme e përmbajtjes së tij në ekranin e kompjuterit ose në pajisje të tjera të ngjashme ose në letër, apo në mjete të tjera të materializuara, prodhuar nga forma e brendshme e paraqitjes së tij, ndërkohë që çdo dokument elektronik është unik (*neni 9, pika 1*).

41. Nga sa më lart, Gjykata vëren se koncepti kushtetues “*korrespondencë*” në nenin 36 të Kushtetutës mbulon çdo komunikim të individit në distancë, përmes çdo mjeti dhe mënyre që mundëson shkëmbimin ose transmetimin konfidencial të informacionit midis një numri të caktuar personash. Në mënyrën sesi është formuluar kjo dispozitë, ky koncept paraqitet i gjerë dhe gjithëpërfshirës, në kuptimin që përfshin çdo formë komunikimi të mendimit njerëzor (ide, qëllime, ndjenja, të dhëna, lajme) midis dy ose më shumë personave të përcaktuar, që kryhet në mënyrë të ndryshme nga biseda e personave të pranishëm. Fshehtësia e korrespondencës, sipas kësaj dispozite, nuk kushtëzohet nga përmbajtja dhe forma e pasqyrimin të saj dhe as nga mënyra dhe mjetet me

të cilat korrespondenca kryhet. Ajo garanton mbrojtje gjithëpërfshirëse të çdo komunikimi njerëzor në distancë. Prandaj, si rregull, shkëmbimi i mesazheve elektronike, qoftë përmes postës elektronike (*email*), ashtu edhe ato tekst (SMS, MMS) përmes rrjeteve telefonike të lëvizshme ose përmes aplikacioneve në internet (të tilla si *Whatsapp* dhe të tjera të ngjashme), të ashtuquajtura sisteme të mesazheve të çastit, është në vetvete një formë korrespondence dhe përfshihet në sferën e mbrojtjes së nenit 36 të Kushtetutës, për sa kohë ky shkëmbim synon komunikimin e mendimit njerëzor në mënyrë ekuivalente me korrespondencën tradicionale dhe telegrafike përmes letrave, zarfeve dhe pakove të vulosura ose telegrameve postare.

42. Gjykata çmon të theksojë se e drejta kushtetuese për fshehtësinë e korrespondencës përfshin mbrojtjen e interesit të individit që shteti ose një palë e tretë e paautorizuar të mos mësojë përmbajtjen e komunikimit dhe të çdo informacioni tjetër për të, sikundër edhe interesin e tij (individit) për të pasur kontroll dhe liri për të vendosur se kujt, në çfarë mase, në çfarë mënyre dhe në çfarë kushtesh do t’ia transmetojë një informacion të caktuar. Në këtë kuptim, mbrojtja e ofruar nga neni 36 i Kushtetutës ka në qendër komunikimin në distancë të individit dhe është e pavarur nga karakteristikat e mjeteve teknike të përdorura për transmetimin e mendimeve njerëzore. Garancia, sipas saj, shtrihet në çdo mjet që zhvillimet teknologjike e bëjnë të disponueshëm për qëllime komunikimi, përfshirë edhe ato mjete elektronike, të cilat kanë qenë të panjohura në kohën e miratimit të Kushtetutës.

43. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se edhe komunikimi ose korrespondenca elektronike përmes teknologjive të reja të informacionit, përfshirë edhe atë nëpërmjet një telefoni inteligjent (telefoni celular), bie plotësisht në fushën e mbrojtjes së nenit 36 të Kushtetutës, duke u shfaqur ajo tërësisht e krahasueshme me korrespondencën fizike përmes letrave ose shënimeve të vulosura.

44. Gjykata, pasi më lart vlerësoi se të dhënat personale të regjistruara në formë elektronike dhe komunikimi ose korrespondenca elektronike, përmes një pajisjeje inteligjente, si telefoni celular, përfshihen në fushën e mbrojtjes sipas neneve 35 dhe 36 të Kushtetutës, do ta analizojë çështjen në drejtim të së drejtës për të vendosur vetë për informacionin personal të lidhur me të dhënat



personale dhe të fshehtësisë së korrespondencës, në këndvështrim të këtyre dispozitave të Kushtetutës dhe të nenit 8 të KEDNJ-së.

45. Për t'u dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuësës për cenimin e të drejtave kushtetuese të garantuara nga nenet 35 dhe 36 të Kushtetutës, si dhe nga neni 8 i KEDNJ-së, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë edhe jurisprudencën e GJEDNJ-së, do të shqyrtojë fillimisht nëse ka pasur ndërhyrje në të drejtën e kërkuësës për të vendosur vetë për informacionin personal të lidhur me të dhënat personale dhe për fshehtësinë e korrespondencës, si dhe ku konsiston ajo. Në vijim, nëse konstaton se ka pasur ndërhyrje, ajo do të shqyrtojë nëse ndërhyrja në këndvështrim të nenit 17 të Kushtetutës, ka qenë e justifikuar, që do të thotë nëse ajo ka qenë në përputhje me ligjin, nëse ka ndjekur një qëllim të ligjshëm dhe nëse ka qenë proporcionale, domethënë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

a) Nëse ka pasur ndërhyrje

46. Gjykata vëren se kërkuësja pretendon se telefoni i saj celular është sekuestruar nga OPGJ-të dhe organi procedues, në vijim, përmes veprimit hetimor të ekspertimit teknik-elektronik, ka aksesuar përmbajtjen e tij. Sipas saj, në telefon gjenden komunikime, por edhe foto, të dhëna kontakti, informacion për faqe interneti të klikuara dhe të dhëna të tjera personale, përfshirë edhe të dhëna shëndetësore të pacientëve të trajtuar në institucionin mjekësor privat ku ajo punonte, të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, përbëjnë të dhëna sensitive.

47. Nga ana tjetër, subjekti i interesuar pranon se OPGJ-të kanë ndërmarrë masën hetimore të sekuestrimit provues të sendit “telefon celular” të kërkuësës dhe se, në vijim, është kryer edhe veprimi hetimor i ekspertimit teknik-elektronik të tij, përmes të cilit janë ekstraktuar dhe kopjuar në një pajisje të jashtme të dhënat e memorizuara në telefon. Materiali më tej po u nënshtrohet këqyrjeve vetëm për ato të dhëna që lidhen me objektin e hetimit penal dhe ato do të dokumentohen me procesverbal. Ai nuk kundërshton pretendimet e kërkuësës për llojin dhe natyrën e të dhënave të memorizuara në telefonin e sekuestruar asaj.

48. Gjykata vëren se neni 35, pika 2, i Kushtetutës në lidhje me të dhënat personale ka identifikuar si ndërhyrje në të drejtën e individit për të vendosur vetë për informacionin personal lidhur

me mbledhjen, përdorimin dhe bërjen publike të tyre. Ndërkohë, GJEDNJ-ja, në këtë drejtim, i është referuar Konventës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në lidhje me nocionin e “përpunimit automatik”, që përfshin operacionet, e kryera plotësisht ose pjesërisht më anë të mjeteve automatike, për: ruajtjen e të dhënave, kryerjen e veprimeve logjike dhe/ose aritmetike mbi to, ndryshimin, fshirjen, marrjen ose shpërndarjen e tyre (neni 2, shkronja “c”). Sipas ligjit kuadër për mbrojtjen e të dhënave personale (ligjit nr. 9887/2008, në fuqi në kohën e ndodhjes së fakteve në çështjen në shqyrtim), “përpunim i të dhënave personale” është çdo veprim ose grup veprimesh, të cilat janë kryer mbi të dhënat personale, me mjete automatike ose jo, të tilla, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, shfrytëzimi, transmetimi, shpërndarja ose ndryshe duke vënë në dispozicion, shtrirja ose kombinimi, fotografimi, pasqyrimi, hedhja, plotësimi, seleksionimi, bllokimi, asgjësimi ose shkatërrimi, edhe në qoftë se nuk janë të regjistruara në një bankë të dhënash (neni 3, pika 12). Ndërsa sipas ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale (ligji nr. 124/2024) “përpunim” është çdo veprim ose një grup veprimesh që kryhet mbi të dhënat personale ose grupe të dhënash personale, pavarësisht nëse kryhen me mjete të automatizuara ose jo, të tilla, si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, strukturimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, përdorimi, përhapja me anë të transmetimit, shpërndarjes ose vënies në dispozicion në ndonjë mënyrë tjetër, lidhja ose kombinimi, kufizimi, fshirja ose shkatërrimi (neni 5, pika 16).

49. Në lidhje me fshehtësinë e korrespondencës, sipas GJEDNJ-së, si shembuj të “ndërhyrjes” së mundshme janë edhe shqyrtimi i korrespondencës (*shih Campbell kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 25.3.1992, § 33*), bërja e kopjeve (*shih Foxley kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 20.6.2000, § 30*), sekuestrimi i një telefoni inteligjent dhe laptopit të aplikantit, kopjimi i përmbajtjes së plotë të tyre në një *hard disk* të jashtëm dhe kontrolli i kopjes së tij pasqyrë (*shih Saber kundër Norvegjisë, datë 17.12.2020, § 48; Särgava kundër Estonisë, datë 16.11.2021*), ruajtja e të dhënave në lidhje me përdorimin e telefonit, email-it dhe internetit (*shih Copland kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 3.4.2007, § 44*), pa pasur rëndësi nëse të dhëna të tilla janë marrë në mënyrë të ligjshme ose



nëse informacioni nuk u është zbuluar palëve të treta, ose nuk është përdorur në procedura të tjera kundër personit në fjalë (*shih po aty, § 43*), kopjimi i skedarëve elektronikë, përfshirë edhe ato që u përkasin kompanive (*shih Bernb Larsen Holding AS dhe të tjerë kundër Norvegjisë, datë 14.3.2013, § 106*), si dhe sekuestrimi i dokumenteve në letër dhe digjitale, përfshirë edhe ato të një shoqate (*shih Grande Oriente d'Italia kundër Italisë, datë 19.12.2024, § 91*).

50. Nga sa më lart, Gjykata vëren se në rastin konkret, subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, në kuadër të hetimit të një procedimi penal, ka zbatuar një masë hetimore, sikurse është sekuestrimi i telefonit celular të kërkueses dhe, më pas, e ka aksesuar atë duke ekstraktuar (nxjerrë), kopjuar dhe ruajtur të dhënat që ai përmbante, me qëllim kërkimin e mëvonshëm dhe marrjen e atyre të dhënave që paraqesin rëndësi për hetimin.

51. Në këtë pikë, Gjykata çmon të theksojë se masa e sekuestrimit të telefonit celular të kërkueses, e zbatuar me qëllim zbulimin dhe marrjen e të dhënave të memorizuara që paraqesin rëndësi për hetimin, pra për sigurimin e provave për vërtetimin e fakteve të hetimit penal, nuk është thjesht një sekuestrim i një objekti (sendi) në vetvete. Duke pasur parasysh se telefoni celular shërben edhe për ruajtjen, përpunimin dhe shpërndarjen e informacioneve në distancë, se përdorimi i gjerë i formave të reja të komunikimit ka ndryshuar mënyrën sesi individët i perceptojnë dhe ruajnë të dhënat e tyre personale dhe se telefonat inteligjentë praktikisht janë shndërruar në “një arkiv”, ku individët ruajnë informacionin personal që u përket jo vetëm atyre, por edhe palëve të treta, sekuestrimi i telefonit në rastin konkret përbën, po ashtu, edhe sekuestrim të të dhënave të ruajtura në të, përfshirë të dhënat personale dhe korrespondencën e kërkueses.

52. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ka pasur ndërhyrje në të drejtën e kërkueses për të vendosur vetë për informacionin personal të lidhur me të dhënat personale dhe në fshehtësinë e korrespondencës në kuptim të neneve 35 dhe 36 të Kushtetutës, si dhe të nenit 8 të KEDNJ-së. Kjo ndërhyrje ka konsistuar në sekuestrimin e telefonit të saj celular dhe të të dhënave (elektronike) personale dhe të korrespondencës, si dhe aksesimin e telefonit në vijim përmes kopjimit dhe ruajtjes të të dhënave që ai përmbante.

b) Nëse ndërhyrja ka qenë e justifikuar

53. Gjykata, në vijim të analizës së parashtruar në paragrafin 45 të këtij vendimi, do të ndalet në analizën nëse ndërhyrja në të drejtën e kërkueses për të vendosur vetë për informacionin personal të lidhur me të dhënat personale dhe fshehtësinë e korrespondencës është e justifikuar, pra respekton kriteret kushtetuese të kufizimit, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës dhe ato të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së.

i. Nëse ndërhyrja ka qenë në përputhje me ligjin

54. Gjykata vëren se kërkuesja pretendon se sekuestrimi i telefonit të saj celular është kryer pa vendim të gjykatës, në kundërshtim me ligjin, konkretisht me nenin 209 të lidhur me nenin 208/a të KPP-së, si dhe me vendimin njësoj nr. 147/2021. Po kështu, vijon ajo, sekuestrimi i telefonit me iniciativë nga OPGJ-të është kryer pa ekzistuar kushtet e urgjencës dhe të flagrancës, në kundërshtim me nenin 300 të KPP-së. Po sipas saj, ky sekuestrim është kryer megjithëse ajo nuk ishte as person nën hetim.

55. Nga ana tjetër, subjekti i interesuar ka prapësuar se sekuestrimi i telefonit celular të kërkueses është kryer në përputhje me ligjin, në bazë të nenit 300 të KPP-së, që u jep OPGJ-ve të drejtën për të sekuestruar, me iniciativë, në kushtet e urgjencës, sende që lidhen me veprën penale. Ky sekuestrim, vijon ai, është vleftësuar më pas nga prokurori në përputhje me nenin 301 të KPP-së. Sipas subjektit të interesuar, sekuestrimi nga OPGJ-të është realizuar për shkak se vazhdimi i këqyrjes të të dhënave në telefon kërkonte kohë të gjatë, ndërkohë që ndërhyrja e prokurorit ka qenë e pamundur, sepse kishte kaluar orari zyrtar. Në rast mosveprimit nga OPGJ-të, shprehet subjekti i interesuar, ka ekzistuar rreziku i fshirjes të të dhënave në telefonin e kërkueses dhe i pamundësisë së rikuperimit të tyre. Për më tepër, kërkuesja ka dorëzuar me dëshirën e saj telefonin celular dhe në vijim ka nënshkruar pa vërejtje procesverbalin e sekuestrimit të tij. Edhe jurisprudenca e GJEDNJ-së e ka konsideruar të ligjshme masën e sekuestrimit të pajisjeve elektronike, kur ajo ndihmon për zbulimin e fakteve të rëndësishme për hetimin penal.

56. Gjykata vëren se neni 35 i Kushtetutës, që garanton mbrojtjen nga përpunimi i të dhënave personale, parashikon se ndërhyrja në këtë të drejtë kushtetuese bëhet me pëlqimin e individit, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj. Ndërsa neni 36 i Kushtetutës, që garanton fshehtësinë e



korrespondencës, nuk përmban rregullime procedurale në rastet e ndërhyrjeve në këtë të drejtë kushtetuese.

57. Çështja në shqyrtim, siç u parashtua më lart, lidhet me masën hetimore të sekuestrimit të telefonit të celular të kërkueses, që ka synuar zbulimin dhe marrjen e të dhënave të memorizuara në të dhe me rëndësi për hetimin. Nisur nga kjo, masa ka të bëjë me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale e të korrespondencës dhe mbrojtjen e privatësisë në fushën penale. Në këtë fushë, kërkimi dhe marrja e provave u nënshtrohen rregullimeve të KPP-së. Po kështu, për përpunimin e të dhënave personale edhe në kuadër të veprimtarive të parandalimit dhe ndjekjes penale, zbatohet edhe ligji kuadër për mbrojtjen e të dhënave personale, referuar për këtë nenit 4, pika 3/1, në lidhje me nenin 6, pika 2, të ligjit nr. 9887/2008, në fuqi në kohën e ndodhjes së fakteve në çështjen në shqyrtim apo Pjesës III, nenet 47–74, të ligjit nr. 124/2024, në fuqi aktualisht.

58. Përpara se të shqyrtojë nëse ndërhyrja në të drejtat e kërkueses ka qenë në përputhje me ligjin, Gjykata e shih të nevojshme të ndalet fillimisht në prapësimin e subjektit të interesuar, sipas të cilit ajo ka dorëzuar vullnetarisht telefonin dhe ka nënshkruar pa vërejtje procesverbalin e sekuestrimit. Këtë sjellje të kërkueses subjekti i interesuar duket se e paraqet për të treguar se ndërhyrja në të drejtat kushtetuese është kryer me pëlqimin e saj, duke qenë kështu përpara një ndërhyrjeje të lejueshme dhe në përputhje me Kushtetutën.

i.1. Nëse ndërhyrja është kryer me pëlqimin e kërkueses

59. Në lidhje me këtë, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka arritur në përfundimin se dorëzimi i telefonit celular nga kërkuesja, e cila nuk është lejuar të konsultohet paraprakisht me avokatin dhe nuk është vënë në dijeni për të drejtën për të mos e dorëzuar telefonin për këqyrje dhe sekuestrim, referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, nuk përbën heqje dorë nga e drejta për jetë private dhe fshehtësia e korrespondencës. Ky përfundim është gjetur i gabuar nga Gjykata e Lartë, e cila ka arsyetuar se, në rastin konkret, nuk kemi të bëjmë me kontroll të kërkueses, por me vënien në dispozicion, nga vetë ajo, të telefonit celular, pa ndonjë kundërshtim. Megjithatë, të dyja gjykatat më të larta, në vendimet e kundërshtuara, nuk e kanë bazuar refuzimin e ankimit të kërkueses në arsyetimin se ndërhyrja në të drejtat e saj është kryer me pëlqimin e saj.

60. Lidhur me faktin se kërkuesja ka dorëzuar vullnetarisht telefonin celular dhe ka nënshkruar pa vërejtje procesverbalin e sekuestrimit, Gjykata vlerëson të shqyrtojë nëse ky veprim përbën heqje dorë nga të drejtat kushtetuese, pra nëse përbën dhënie pëlqimi për marrjen dhe përpunimin e të dhënave personale dhe të korrespondencës të memorizuara në telefon. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se heqja dorë nga një e drejtë themelore mund të bëhet vetëm në bazë të pëlqimit të informuar, pra kur subjekti ka njohuri të plota për faktet relevante. Heqja dorë jo vetëm që duhet të jetë vullnetare, por edhe e vetëdijshme dhe inteligjente, përveçse duhet të shoqërohet dhe me garanci minimale në përpjesëtim me rëndësinë e së drejtës (*shih vendimin nr. 42, datë 1.7.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

61. Në rastin konkret, referuar akteve, sikurse pranohet edhe nga palët, kërkuesja është pyetur si person që ka dijeni për veprën penale për fakte që lidheshin me persona të caktuar. Pas përfundimit të pyetjes, prokurorët kanë urdhëruar këqyrjen e telefonit të saj celular. Ky vendim i është njoftuar kërkueses dhe OPGJ-të në vijim kanë kryer këqyrjen e komunikimeve të memorizuara në telefon. Ndonëse nuk ekziston ndonjë akt i veçantë për dorëzimin e telefonit nga kërkuesja me qëllim këqyrjen e tij dhe as dokumentimi i dhënies nga ajo të pëlqimit për kryerjen e këtij veprimi, kërkuesja pranon se nuk e ka kundërshtuar këqyrjen e telefonit për komunikimet e saj me persona që lidheshin me hetimin dhe as ka pretendime në lidhje me këtë. Ajo, po ashtu, ka nënshkruar pa vërejtje edhe procesverbalin e këqyrjes. Pas 1 ore e 18 minutash OPGJ-të kanë ndërprerë këqyrjen e telefonit dhe kanë vendosur sekuestrimin e tij, ndërkohë që pajisja në atë moment posedohej nga ata. Më pas, prokurorët kanë vendosur kryerjen e ekspertimit teknik-elektronik të telefonit dhe ekspertët e kanë realizuar atë. Megjithatë, kërkuesja është njohur me vendimin e ekspertimit vetëm gjatë procesit gjyqësor në gjykatat e zakonshme.

62. Në rrethanat si më lart, Gjykata vëren se nuk ka ndonjë të dhënë që të tregojë se në rastin konkret janë respektuar kushtet për një heqje dorë të vlefshme nga të drejtat kushtetuese. Nuk rezulton e dokumentuar që kërkuesja është informuar paraprakisht dhe plotësisht për të drejtën e saj për të refuzuar, qoftë edhe pjesërisht, marrjen dhe aksesimin, me qëllim përpunimin e mëtejshëm të të



dhënave personale dhe të korrespondencës të memorizuara në telefon, dhe as për pasojat që do të sillte dhënia e një pëlqimi të tillë. Për më tepër, edhe pse kërkesja ka kërkuar praninë e avokatit për t'u këshilluar për masat dhe veprimet hetimore që po ndërmerreshin ndaj saj, një kërkesë e tillë nuk është pranuar. Po kështu, nuk del qartë nëse ndonjë heqje dorë e mundshme nga e drejta për të vendosur vetë për informacionin personal të lidhur me të dhënat personale dhe nga fshehtësia e korrespondencës ka qenë e ndërjegjeshme dhe e arsyeshme, në drejtim të shprehjes së vullnetit të lirë, pas kuptimit të plotë të rëndësisë së veprimit dhe të pasojave të tij. Në këtë këndvështrim, prapësimi i subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme, se kërkesja ka dorëzuar me dëshirë telefonin dhe ka nënshkruar pa vërejtje procesverbalin e sekuestrimit të tij, nuk mjafton për të arritur në përfundimin se kemi një shfaqje të qartë dhe të padyshimtë të vullnetit të saj për dhënien e pëlqimit për marrjen dhe aksesimin, me qëllim përpunimin e mëtejshëm të të dhënave personale dhe të korrespondencës, të memorizuara në telefonin e saj.

63. Në këtë drejtim, Gjykata çmon të analizojë nocionin “pëlqim” në nenin 35, pika 2, të Kushtetutës, që është detajuar në ligjin kuadër për mbrojtjen e të dhënave personale (*shih paragrafin 35 të vendimit*). Kështu, ligji nr. 9887/2008, në fuqi në kohën e ndodhjes së fakteve në çështjen në shqyrtim, parashikonte se “pëlqim i subjekteve të të dhënave” është çdo deklaratë me shkrim, e dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të përpunohen të dhënat e tij. Ndërsa sipas ligjit nr. 124/2024, aktualisht në fuqi, “pëlqim” përkufizohet si çdo element tregues i vullnetit të subjektit të të dhënave, i dhënë lirisht, i informuar dhe i qartë, nëpërmjet të cilit ai, me anë të një deklarate ose me çdo lloj shfaqjeje tjetër të padyshimtë pohuese të vullnetit, shpreh dakordësinë për përpunimin e të dhënave personale që lidhen me të për një ose më shumë qëllime specifike. Ky ligj është përafëruar plotësisht me rregulloren (BE) nr. 679/2016 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 27 prill 2016, për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe shfuqizimin e direktivës 95/46/EC, si dhe me direktivën nr. 680/2016 të Parlamentit Evropian

dhe të Këshillit të datës 27 prill 2016, për mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga autoritetet kompetente, me qëllim parandalimin, hetimin, zbulimin, ndjekjen penale të veprave penale ose ekzekutimin e dënimeve penale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe shfuqizimin e vendimit kornizë të Këshillit 2008/977/JHA.

64. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se ndërhyrja në të drejtat e kërkuases në rastin konkret nuk mund të konsiderohet e kryer me pëlqimin e saj. Për këtë arsye, për të nxjerrë përfundimin nëse ndërhyrja është bërë në përputhje me ligjin, Gjykata çmon se duhet analizuar nëse ndërhyrja pa pëlqimin e individit autorizohet nga ligji.

i.2. Nëse ndërhyrja autorizohet nga ligji

65. Sikurse u theksua më lart, nenet 35 dhe 36 të Kushtetutës nuk përmbajnë rregullime procedurale për rastet dhe garancitë e ndërhyrjeve në të drejtat e mbrojtura nga ato. Në nenin 35 të Kushtetutës, ato i janë deleguar ligjvënësit të zakonshëm. Ndërkohë, neni 17 i Kushtetutës, parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtave dhe lirive kushtetuese vetëm me ligj. Edhe GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj mbi nenin 8 të KEDNJ-së, që mbulon të drejtën për jetë private, përfshirë të dhënat personale dhe korrespondencën, ka vlerësuar se kjo e drejtë nuk është absolute, por mund të kufizohet në funksion të imperativave të tjera legjitime. Sipas saj, kjo dispozitë mbron, në thelb, individin nga ndërhyrjet arbitrare nga autoritetet publike dhe çdo ndërhyrje duhet të jetë në përputhje me ligjin (*shih Vavrčka dhe të tjerë kundër Republikës Çeke [DhM], datë 8.4.2021, §§ 266–269*).

66. Nën dritën e sa më sipër, Gjykata vlerëson se të drejtat kushtetuese të mbrojtura nga nenet 35 dhe 36 të Kushtetutës nuk janë absolute, por duhet të merren në konsideratë në lidhje me funksionin e tyre në shoqëri dhe të balancohen kundrejt të drejtave të tjera themelore. Ato mund t'iu nënshtrohen kufizimeve në rastet e parashikuara me ligj, duke respektuar thelbin e këtyre të drejtave themelore dhe parimin e proporcionalitetit.

67. Në çështjen në shqyrtim, siç u parashtrua më lart, ndërhyrja në të drejtat kushtetuese të kërkuases ka konsistuar në zbatimin e masës hetimore të sekuestrimit të telefonit të celular, me synimin e zbulimit dhe marrjes të të dhënave të memorizuara me rëndësi për hetimin. Sipas procesverbalit të sekuestrimit, OPGJ-të, në zbatimin e kësaj mase,



janë mbështetur në nenin 300 të KPP-së, që rregullon veprimet e ngutshme me iniciativë të Policisë Gjyqësore. Sekuestrimi në këtë rast është vleftësuar më pas si i ligjshëm nga prokurorët, mbështetur në nenin 301 të KPP-së. Subjekti i interesuar pranon se në rastin konkret është zbatuar masa e sekuestrimit provues, që rregullohet nga nenet 208–220 të KPP-së.

68. Gjithashtu, ndërhyrja ka konsistuar edhe në aksesimin e telefonit, përmes ekstraktimit, kopjimit dhe ruajtjes në një pajisje të jashtme të të dhënave që ai përmbante, me qëllim kërkimin e mëvonshëm dhe marrjen e atyre të dhënave që paraqesin rëndësi për hetimin. Kjo është realizuar nëpërmjet vendimit të prokurorëve për kryerjen e ekspertimit teknik-elektronik të telefonit dhe përmes vetë ekspertimit të realizuar, që ka konsistuar në ekstraktimin, kopjimin dhe ruajtjen e të dhënave që ai përmbante. Vendimi i ekspertimit është bazuar në nenet 178 e vijues dhe 314 të KPP-së.

69. Për t'u dhënë zgjidhje çështjeve të ngritura në gjykimin kushtetues, Gjykata vlerëson të analizojë fillimisht dispozitat ligjore dhe praktikën gjyqësore të lidhur me to.

70. Për sa i përket sekuestrimit provues, Gjykata ka theksuar më parë se ai rregullohet në nenet 208–220 të KPP-së dhe mund të vendoset nga gjyqtari ose prokurori, me vendim të arsyetuar, për sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve. Sekuestrimi provues është mjet për kërkimin e provës dhe paraqitet si një masë hetimore procedurale autonome, por në praktikë shpesh shoqëron ose pason një masë kontrolli ose këqyrjeje, pasi përmes këtyre të fundit mund të gjenden sende, dokumente ose diçka tjetër që duhen sekuestruar (*shih vendimin nr. 42, datë 1.7.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

71. Gjykata konstaton se KPP-ja parashikon në mënyrë të veçantë sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, sekuestrimin e korrespondencës, sekuestrimin pranë bankave dhe sekuestrimin në zyrat e shërbimeve informative.

72. Në lidhje me masën e *sekuestrimit të të dhënave kompjuterike*, ajo është përfshirë në kuadër të transpozimit të Konventës së Këshillit të Evropës për Krimet Kibernetike, ratifikuar me ligjin nr. 8888, datë 25.4.2002. Kështu, neni 208/a i KPP-së (shtuar në vitin 2008), në rastin e procedimeve për krime që lidhen me teknologjinë e informacionit, parashikon

sekuestrimin e të dhënave ose sistemeve kompjuterike me vendim të gjykatës, ku përcaktohet e drejta për të hyrë, kërkuar dhe marrë të dhënat kompjuterike në sistemin kompjuterik, si dhe ndalimi për kryerjen e veprimeve të mëtejshme ose sigurimi i të dhënave apo i sistemit kompjuterik (*pika 1*). Kur ka shkaqe të arsyeshme për të menduar se të dhënat e kërkuara janë memorizuar në një sistem tjetër kompjuterik ose në një pjesë të tij dhe këto të dhëna janë në mënyrë të ligjshme të kapshme prej ose janë të disponueshme nga sistemi kompjuterik fillestar, që kontrollohet, gjykata, me kërkesë të prokurorit, urdhëron menjëherë kërkimin ose hyrjen edhe në këtë sistem kompjuterik (*pika 2*). Në zbatim të vendimit të gjykatës, prokuroria ose OPGJ-ja, i deleguar nga prokurori, merr masa për: a) ndalimin e veprimeve të mëtejshme ose sigurimin e sistemit kompjuterik, vetëm të një pjesë të tij ose të një mjeti tjetër memorizimi të dhënash; b) nxjerrjen dhe marrjen e kopjeve të të dhënave kompjuterike; c) pengimin e hyrjes në të dhënat kompjuterike ose heqjen e tyre nga sistemet kompjuterike me të drejtë hyrjeje; ç) sigurimin e paprekshmërisë të të dhënave përkatëse, të memorizuara (*pika 3*). Për zbatimin e këtyre veprimeve, prokurori mund të thërrasë ekspert me njohuri për sistemet kompjuterike apo për masat mbrojtëse të të dhënave kompjuterike (*pika 4*).

73. Në lidhje me *sekuestrimin e korrespondencës*, Gjykata konstaton se neni 209 i KPP-së përcakton se, kur ka arsye të bazuara për të menduar se në zyrat postare ose telegrafike gjenden letra, letra me vlerë, zarfe, pako, telegrame dhe objekte të tjera të korrespondencës, të dërguara nga i pandehuri ose që i drejtohen atij, qoftë edhe me emër tjetër ose nëpërmjet një personi tjetër, gjykata vendos sekuestrimin e tyre (*pika 1*). Kur sekuestrimin e kryen OPGJ-ja, ai duhet t'i dorëzojë objektet e sekuestruara të korrespondencës organit gjyqësor, pa i hapur dhe pa u njohur me ndonjë mënyrë tjetër me përmbajtjen e tyre (*pika 2*). Kur objektet e sekuestruara nuk hyjnë në korrespondencën e sekuestrueshme, ato i kthehen personit që i përkasin dhe nuk mund të përdoren (*pika 3*).

74. Ndërsa neni 210 i KPP-së, për *sekuestrimin pranë bankave*, parashikon se gjykata mund të vendosë sekuestrimin, ndër të tjera, të dokumenteve, letrave me vlerë dhe çdo gjëje tjetër, përfshirë edhe ato në kaseta sigurie, kur ka arsye të bazuara për të menduar se lidhen me veprën penale, edhe nëse nuk



i përkasin të pandehurit ose nuk janë në emër të tij, ndërkohë që në raste të ngutshme ky vendim mund të merret nga prokurori.

75. Për sa i përket ekspertimit, Gjykata, po ashtu, konstaton se ai, si provë, rregullohet nga nenet 178–186 të KPP-së. Sipas nenit 178, ekspertimi lejohet kur është i nevojshëm zhvillimi i kërkimeve, marrja e të dhënave ose i vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, shkencore ose kulturore (*pika 1*). Eksperti caktohet me vendim të organit procedues, i cili i njoftohet të pandehurit ose mbrojtësit të tij (*neni 179, pika 2*). Vendimi i ekspertimit duhet të jetë i motivuar (*neni 182, pika 1*) dhe të përmbajë edhe kërkesat e ekspertimit (*neni 183, pika 1*). Eksperti mund të autorizohet të shohë aktet, dokumentet dhe gjithçka që përfshihet në fashikullin e prokurorit ose të gjykatës (*neni 184, pika 1*) dhe harton aktin e ekspertimit me shkrim, i cili përmban mendimin e tij (*neni 185, pika 1*). Ndërkohë neni 314 i KPP-së rregullon një nga veprimet e prokurorit, pikërisht caktimin e ekspertit, duke përcaktuar se prokurori, për veprime të cilat kërkojnë njohuri teknike, mund të caktojë ekspert sipas nenit 179 të kodit.

76. Për sa i përket veprimtarisë me iniciativë të Policisë Gjyqësore në fazën e hetimeve paraprake, Gjykata ka pasur rastin të evidentojë se ajo rregullohet nga nenet 293–303 të KPP-së. Neni 294 përcakton se policia gjyqësore vazhdon të kryejë funksionet e saj edhe pas referimit të veprës penale për sigurimin e burimeve të provave, duke grumbulluar e fiksuar çdo element të vlefshëm për rindërtimin e faktit dhe për individualizimin e fajtorit dhe duke proceduar sidomos për kërkimin dhe fiksimin e sendeve dhe të gjurmëve të veprës penale, si dhe për ruajtjen e tyre dhe të vendit të ngjarjes për aq kohë sa kjo gjë është e domosdoshme ose dhe për kryerjen e veprimeve të caktuara në nenet vijuese (*pika 1*). Edhe pas ndërhyrjes së prokurorit, krahas çdo veprimi të urdhëruar ose të deleguar posaçërisht nga prokurori, policia gjyqësore kryen me iniciativë edhe çdo veprim hetimor të nevojshëm dhe siguron burime të reja të provës (*pika 2*). Ndërkohë, neni 300 i KPP-së rregullon “*verifikimet e ngutshme në vend*”, duke parashikuar se OPGJ-të dhe agjentët e policisë gjyqësore marrin masa që gjurmët dhe sendet që i përkasin veprës penale të fiksohen e të ruhen dhe që gjendja e vendngjarjes dhe e sendeve të mos ndryshojnë dhe kur ka rrezik që ato të ndryshojnë ose të humbasin dhe prokurori nuk mund të

ndërhyjë urgjentisht, OPGJ-të kryejnë veprimet hetimore të domosdoshme dhe, kur është rasti, sekuestrojnë provat materiale dhe sendet që lidhen me veprën penale, sekuestrim i cili kontrollohet nga prokurori, ndaj vendimit të të cilit mund të bëhet ankim në gjykatë (*neni 301*) (*shih vendimin nr. 42, datë 1.7.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

77. Në kuadër të veprimeve me iniciativë të Policisë Gjyqësore, neni 299 i KPP-së rregullon marrjen e plikove dhe të korrespondencës. Ai parashikon se kur është e nevojshme për qëllimet e procedimit, OPGJ-ja merr plikot e vulosura ose të mbyllura me ndonjë mënyrë tjetër dhe ia dërgon prokurorit të paprekura për sekuestro eventuale (të mundshme) dhe nëse ka shkaqe të bazuara për të menduar se plikot përmbajnë të dhëna që mund të humbasin për shkak të vonesës, OPGJ-ja njofton menjëherë prokurorin, i cili mund të autorizojë hapjen e tyre (*pika 1*). Për sa u takon letrave, zarfeve, pakove, vlerave monetare e pasurore, telegrameve ose mjeteve të tjera të korrespondencës, për të cilat lejohet sekuestroja, OPGJ-ja, në raste të ngutshme, urdhëron pezullimin e dërgimit dhe nëse prokurori nuk vendos sekuestron brenda dyzet e tetë orëve, objektet e korrespondencës dërgohen në destinacion (*pika 2*).

78. Në kushtet kur çështja në shqyrtim lidhet me një telefon inteligjent dhe me të dhënat personale dhe korrespondencën e memorizuar në të, Gjykata konstaton se KPP-ja nuk përmban ndonjë rregullim nën termin “provë elektronike”. Megjithatë, neni 191/a i KPP-së (shtuar po në vitin 2008), është përfshirë në seksionin e provave “dokument” dhe parashikon “*detyrimin për paraqitjen e të dhënave kompjuterike*”. Sipas këtij neni, në procedimet për vepra penale në fushën e teknologjisë së informacionit, gjykata, me kërkesë të prokurorit ose viktimës akuzuese, urdhëron mbajtësin ose kontrolluesin të dorëzojnë të dhënat kompjuterike të memorizuara në një sistem kompjuterik ose në një mjet tjetër memorizimi (*pika 1*). Kur ka arsye të bazuara për të menduar se vonesa mund të sjellë dëm të rëndë për hetimet, prokurori, me akt të motivuar, vendos detyrimin për paraqitjen e të dhënave kompjuterike dhe njofton menjëherë gjykatën, e cila vlerëson vendimin e tij (*pika 3*).

79. Po kështu, Gjykata konstaton se në seksionin e kontroleve, neni 202/a (i shtuar me ligjin nr. 35/2017), që rregullon vendimin për lejimin e kontrollit, parashikon se edhe kur ka arsye të bazuara



se të dhënat, informacionet, programet informatike ose gjurmë të tyre, gjenden në një sistem informatik ose telematik, edhe kur ky është i mbrojtur me masa sigurie, gjykata merr vendim për kontrollin, duke urdhëruar masa teknike të përshtatshme që sigurojnë ruajtjen e të dhënave origjinale dhe nuk lejojnë ndryshimin e tyre, ndërkohë që vendimi duhet të përcaktojë llojin e informacionit që kërkohet dhe mënyrën e marrjes së tij (*pika 2*). Në lidhje me kontrollet me iniciativë të OPGJ-së, neni 298 i KPP-së, parashikon se edhe në rastet e flagrancës ose ndjekjes së personit në ikje, ose kur duhet të kryhet një ndalim apo të ekzekutohet një vendim arresti, ose një vendim dënimi me burgim, policia gjyqësore merr të gjitha masat teknike për sigurimin dhe ruajtjen e të dhënave origjinale kompjuterike, mbrojtjen e tyre nga humbja, dëmtimi dhe tjetërsimi, si dhe kryen kontrole të mëtejshme të të dhënave kompjuterike, kur ka shkaqe të arsyeshme se ato përmbajnë informacion, programe ose gjurmë të veprës penale (*pika 3*).

80. Gjithashtu, Gjykata konstaton se neni 299/a (shtuar në vitin 2008) parashikon që prokurori mund të urdhërojë ruajtjen e përsheptuar të të dhënave kompjuterike të caktuara, përfshirë të dhënat e trafikut, kur ka shkaqe të mjaftueshme për të besuar se ato mund të humbasin, dëmtohen ose ndryshohen (*pika 1*). Kur të dhënat janë në zotërim/kontroll të një personi, prokurori mund ta urdhërojë atë t'i ruajë dhe mirëmbajë për një periudhë deri në 90 ditë, me qëllim zbulimin dhe nxjerrjen e tyre, afat ky që mund të zgjatet vetëm një herë për shkaqe të arsyeshme (*pika 2*). Personi i ngarkuar ka detyrim të mbajë sekret procedurat dhe veprimet e kryera deri në përfundim të hetimeve (*pika 3*). Kurse neni 299/b (shtuar edhe ai në vitin 2008) parashikon se personi i ngarkuar me ruajtjen e përsheptuar të të dhënave të trafikut duhet të marrë masa për të garantuar që të dhënat e ruajtura janë të vlefshme, edhe kur në transmetim kanë qenë të përfshirë një ose më shumë dhënës shërbimesh, dhe se ai duhet t'i sigurojë prokurorisë ose OPGJ-së së autorizuar zbulim të pjesshëm të një sasive të mjaftueshme të të dhënave të trafikut, për të mundësuar identifikimin e dhënësit të shërbimit dhe shtegut të transmetimit të komunikimit.

81. Në lidhje me praktikën gjyqësore, duke iu referuar për këtë vendimeve unifikuese ose njësuere të Gjykatës së Lartë për interpretimin e dispozitave ligjore të zbatueshme edhe në këtë çështje, Gjykata

çmon të evidentojë vendimet e referuara nga kërkuesja dhe nga gjykatat e zakonshme, konkretisht vendimin nr. 1/2017 dhe vendimin njësuere nr. 147/2021.

82. Gjykata konstaton se vendimi nr. 1/2017, i dhënë më 30.6.2017, nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk i plotëson kriteret për t'u konsideruar **vendim njësuere** në kuptim të nenit 141 të Kushtetutës. Pas ndryshimeve kushtetuese me ligjin nr. 76/2016 (miratuar më 22.7.2016) Kolegjet e Bashkuara nuk kishin më kompetencë të unifikonin praktikën përmes krijimit të precedentëve fillestarë, por vetëm të ndryshonin praktikën gjyqësore, ndërsa funksioni i unifikimit (nomofilatisë ose të uniformitetit) u kalonte kolegjeve përkatëse të Gjykatës së Lartë. Në vetë vendimin, ndonëse shprehen se ai nuk është unifikues, por njësuere dhe shërben për trajtimin ligjor të çështjeve të argumentuara në pjesën arsyetuese (paragrafi 43), Kolegjet e Bashkuara pranojnë se, për shkak të ndryshimit të situatës ligjore, çështjet e ngritura për njësimin e praktikës nuk paraqisnin më nevojën për adresimin e tyre (paragrafi 3). Po kështu, vendimi nuk evidenton çështje për njësim, nuk jep një sentencë njësuere dhe as dispozitivi nuk e kualifikon si të tillë. Për më tepër, ai nuk është publikuar në Fletoren Zyrtare, siç kërkon neni 35, pika 4, i ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë". Pavarësisht kësaj, objekti kryesor i analizës në atë vendim lidhet kryesisht me nenet 202, pika 3 dhe 298 të KPP-së, për veprimet me iniciativë të OPGJ-ve në rastin e kontrollit të vendeve.

83. Lidhur me vendimin njësuere penal nr. 147/2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykata konstaton se themeli i tij ka konsistuar në marrjen nga gjykata të masës së sekuestrimit të të dhënave kompjuterike. Në këtë vendim është shtruar për njësim, ndër të tjera, edhe se cilat janë kriteret që gjykata duhet të ndjekë për lejimin e sekuestrimit të të dhënave ose sistemeve kompjuterike sipas nenit 208/a të KPP-së. Për sa u takon kriteret, Gjykata e Lartë ka nxjerrë sentencën njësuere, sipas së cilës sekuestrimi i **të dhënave** ose i **sistemeve kompjuterike** lejohet vetëm kur plotësohen kushtet e përgjithshme të **nenit 208 të KPP-së. Ajo sekuestro vendoset për prova materiale** në kuptim të nenit 187 të KPP-së ose për **sende që lidhen me veprën penale**, duke argumentuar në çdo rast se ato janë **të**



domosdoshme për vërtetimin e fakteve. Në vendimin e saj gjykata duhet të përcaktojë qartë veprën penale të dyshuar, të arsyetojë pse sekuestrimi është i nevojshëm për zgjidhjen e çështjes, të specifikojë të dhënat/sistemet kompjuterike që sekuestrohen, **çfarë synohet të provohet dhe modalitetet e sekuestrimit, në mënyrë që të preken vetëm të dhënat/sistemet kompjuterike të specifikuar.** Sekuestrimi duhet të respektojë **proporcionalitetin dhe përshtatshmërinë,** vetëm sa është e nevojshme, për aq sa është e nevojshme dhe për aq kohë sa është e nevojshme. Për nxjerrjen e të dhënave, pajisjet mund të sekuestrohen nëse kjo është e domosdoshme dhe për aq kohë sa është e nevojshme për marrjen e të dhënave ose krijimin e kopjeve (*shih paragrafin 77 të vendimit njëses*).

84. Gjykata e Lartë ka vënë në dukje edhe rolin e teknologjisë së informacionit në procesin penal, duke nënvizuar se të dhënat dokumentare (përfshirë ato fotografike e filmike) mund të jenë në format “hard copy” ose “format kompjuterik”. Jo rrallë provat e domosdoshme për vërtetimin e fakteve penale gjenden në formën e të dhënave kompjuterike. Për këtë arsye, në vitin 2008 në KPP është shtuar neni 208/a për sekuestrimin provues të të dhënave kompjuterike. Ky nen parashikon rregulla të posaçme për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, por rregullat e përgjithshme të nenit 208 të KPP-së mbeten të zbatueshme, përveç rasteve kur neni 208/a parashikon ndryshe. Për rrjedhojë, garancia e arsyetimit të domosdoshmërisë së sekuestrimit të të dhënave zbatohet edhe në rastin e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike (*shih paragrafët 55–56 të vendimit njëses*).

85. Gjykata e Lartë ka vërejtur se sekuestrimi i të dhënave kompjuterike, në rastin e krimeve në fushën e teknologjisë së informacionit, sipas nenit 208/a të KPP-së, bëhet vetëm me vendim gjykate, që pasqyron vullnetin e ligjvënësit për të ofruar garanci të shtuar. Kjo lidhet me vështirësinë e individualizimit të të dhënave kompjuterike dhe me rrezikun që, bashkë me të dhënat relevante, të ekspozohen dhe të dhëna të tjera që nuk kanë lidhje me veprën penale, marrja e të cilave mund të cenojë liri dhe të drejta që gëzojnë mbrojtje kushtetuese dhe konventore, të tilla, si: liria dhe fshehtësia e korrespondencës ose e çdo mjeti tjetër të komunikimit sipas nenit 36 të Kushtetutës, e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare sipas

nenit 8 të KEDNJ-së, liria e shprehjes sipas neni 22 të Kushtetutës, e drejta e informimit sipas nenit 23 të Kushtetutës, të mbrojtura gjithashtu dhe nga neni 10 i KEDNJ-së, kufizimi i të cilave mund të bëhet vetëm në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës (*shih paragrafin 57 të vendimit njëses*). Po sipas Gjykatës së Lartë, nenet 208 dhe 208/a të KPP-së përbëjnë bazën ligjore për sekuestrimin provues të të dhënave kompjuterike, sekuestrim i cili bëhet me vendim gjykate, në vijim të kërkesës së prokurorit (*shih paragrafin 60 të vendimit njëses*).

86. Në vendimin njëses, Gjykata e Lartë ka sqaruar se edhe sekuestrimi provues është mjet tipik i kërimit të provës në procesin penal, me të cilin ndalohet përkohësisht disponimi dhe/ose tjetërsimi i provës materiale ose i dokumentit, që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me veprën penale dhe është i domosdoshëm për vërtetimin e faktit. Ai nuk lidhet me raportin e pronësisë, por me nevojat e të provuarit, ndaj mund të vendoset mbi çdo send, pavarësisht se kujt i përket (*shih paragrafin 31 të vendimit njëses*). Sipas Gjykatës së Lartë, gjatë hetimeve paraprake sekuestrimi mund të vendoset nga: a) prokurori; b) gjykata me kërkesë të prokurorit; c) Policia Gjyqësore në rastin e “verifikimeve të ngutshme” (*shih paragrafin 42 të vendimit njëses*).

87. Nga sa më lart, Gjykata vëren se KPP-ja, për sa i përket sekuestrimit të provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale, kur kjo është e domosdoshme për vërtetimin e fakteve, parashikon mundësinë që sekuestrimi të vendoset me vendim të gjykatës ose të prokurorit, por edhe nga OPGJ-ja, në kushte të përcaktuara. Praktika gjyqësore (vendimi njëses nr. 147/2021) ka pranuar se neni 300 i KPP-së lejon sekuestrimin provues me iniciativë të OPGJ-së, në rastet e “verifikimeve të ngutshme në vend”, kur ka rrezik që gjurmët dhe sendet që lidhen me veprën penale të ndryshojnë ose të humbasin dhe prokurori nuk mund të ndërhyjë urgjentisht. Në këtë pikë, sikurse edhe më parë, Gjykata vëren se nocioni “vendngjarje” në përmbajtje të kësaj dispozite duket se ka kuptimin e një hapësire fizike ose edhe virtuale ku është përgatitur vepra penale, ku është realizuar ajo, ku janë lënë pasojat materiale të saj, ose ku ndodhen provat materiale ose gjurmët e lidhura me të (*shih vendimin nr. 42, datë 1.7.2025, të Gjykatës Kushtetuese*).

88. Gjykata vëren më tej se ndonëse KPP-ja nuk përmban një përkufizim të përgjithshëm të nocionit



“provë elektronike”, përmbajtja e disa dispozitave të tij tregon se të dhënat kompjuterike mund të jenë objekt administrimi dhe përdorimi si provë në procesin penal. Në këtë drejtim, vendosja e rregullimit mbi detyrimin për dorëzimin/paraqitjen e të dhënave kompjuterike në seksionin e provave me dokument tregon se ligjvënësi i ka trajtuar këto të dhëna, në rrethana të caktuara, si provë dokumentare. Në këtë kuadër, duke mbajtur parasysh edhe nocionin ligjor të dokumentit elektronik, i cili paraqitet në formë të brendshme numerike dhe në formë të jashtme të kuptueshme (vizualisht ose të materializuar), mund të pranohet se nocioni i provave dokumentare, i parashikuar në KPP, përfshin edhe dokumentet elektronike, si një formë e të dhënave kompjuterike, të cilat, njësoj si dokumentet në letër, mund të pasqyrojnë dhe të përfaqësojnë fakte, persona ose sende me rëndësi për procesin penal.

89. Megjithatë, vlen të përmendet se nocioni i “*të dhënave kompjuterike*” duket se është më i gjerë se ai i “*dokumentit elektronik*”, pasi përfshin edhe të dhëna të natyrës teknike e funksionale, të cilat krijohen, regjistrohen ose ruhen automatikisht nga sistemet informatike dhe pajisjet elektronike gjatë funksionimit të tyre, të cilat, edhe kur mund të nxirren dhe të paraqiten në një formë të lexueshme, nuk përbëjnë domosdoshmërisht “dokument elektronik” në kuptimin klasik, për sa kohë që ato, në vetvete, nuk artikulojnë një përmbajtje të individualizuar si dokument, por pasqyrojnë kryesisht rrethana, parametra teknike dhe gjurmë funksionimi të sistemeve dhe proceseve digjitale.

90. Po kështu, vlen të përmendet se fakti që dokumentet elektronike, njësoj si dokumentet në letër, mund të përfaqësojnë fakte, persona ose sende, nuk nënkupton se përmbajtja e tyre është e një natyre asnjë nga këndvështrimi kushtetues, ose që ajo përjashtohet nga kategoritë e mbrojtura, si të dhënat personale dhe korrespondenca. Përkundrazi, në varësi të përmbajtjes konkrete, një dokument elektronik mund të përmbajë informacion për një person të identifikuar ose të identifikueshëm në lidhje me jetën private, marrëdhëniet, vendndodhjen, shprehitë dhe preferencat e tij, si dhe komunikime private të tij në kuptimin e korrespondencës. Për rrjedhojë, klasifikimi i një materiali si “*provë dokumentare*” nuk mjafton, në vetvete, për të përcaktuar regjimin e plotë të mbrojtjes së përmbajtjes së tij dhe garancitë

procedurale që duhet të shoqërojnë marrjen, aksesimin, përpunimin dhe përdorimin e tij në procesin penal. Në çdo rast vendimtare mbeten natyra e informacionit që materiali përmban dhe konteksti në të cilin ai është krijuar dhe ruajtur.

91. Në këtë pikë, Gjykata çmon të evidentojë se, duke mbajtur në konsideratë jurisprudencën e GJEDNJ-së (*shih Copland kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 3.4.2007, § 44; Bărbulescu kundër Rumanisë, datë 5.9.2017, § 74*), por edhe praktikën e gjykatave kushtetuese homologe (*shih vendimin nr. 170/2023, të Gjykatës Kushtetuese të Italisë*), në kuadër të mbrojtjes së fshehtësisë së korrespondencës, krahas komunikimeve elektronike *in itinere*, përfshihen edhe ato *statike*. Kjo për shkak se kufizimi vetëm në komunikimet në zhvillim dhe jo të përfunduara (*in itinere*) do të nënkuptonte që t'i jepej një interpretim kufizues konceptit të korrespondencës, duke u dhënë mundësi organeve të hetimit që t'i shmangen detyrimit kushtetues, të cilat, në vend që të marrin komunikimet në momentin që ndodhin, do të mjaftonte të prisnin përfundimin e tyre dhe sekuestrimin e sendit në të cilën ka gjurmë të përmbajtjes së tyre. Në këtë kuptim, përcaktimi i “*komunikimit*” si një “*dokument i thjeshtë*” kur ai nuk është më *in itinere* është një zgjidhje që çon deri në eliminimin e mbrojtjes kushtetuese për komunikimet e kryera nëpërmjet postës elektronike dhe sistemeve të tjera të mesazheve të çastit, në të cilat dërgimi kryhet menjëherë ose, në çdo rast, pa një ndërprerje të dukshme kohore (*pritjeje*). Për rrjedhojë, komunikimet elektronike *statike* të memorizuara në një pajisje elektronike vijnë të ruajnë karakterin e korrespondencës edhe pas marrjes nga marrësi, deri atëherë kur interesi për konfidencialitetin e tyre humb çdo rëndësi, qoftë për shkak të kalimit të kohës, ashtu dhe për arsye të tjera, duke u shndërruar ato thjesht në një dokument “historik”.

92. Gjykata vëren gjithashtu se praktika gjyqësore (vendimi njësoj nr. 147/2021) ka pranuar se rregullat e përgjithshme të sekuestrimit provues zbatohen edhe për sekuestrimin e të dhënave ose të sistemeve kompjuterike. Po sipas praktikës gjyqësore, referuar KPP-së, sekuestrimi provues i të dhënave ose i sistemeve kompjuterike bëhet me vendim të gjykatës, por vetëm në procedimet për krime që lidhen me teknologjinë e informacionit. Në raste të tilla, ndërsa krime të kësaj natyre kryhen duke përdorur pajisje kompjuterike, këto të fundit



mund të përkufizohen si *corpus delicti*, pra si mjeti përmes të cilit është kryer krimi.

93. Megjithatë, Gjykata vëren se KPP-ja nuk ndalon sekuestrimin provues të të dhënave ose sistemeve kompjuterike në procedime për krime të tjera, të ndryshme nga ato që lidhen me teknologjinë e informacionit, kur ato shërbejnë ose përmbajnë të dhëna të dobishme për përcaktimin e krimit. Në këtë kuptim, konsiderata se vetëm luftimi i krimeve që lidhen me teknologjinë e informacionit justifikon sekuestrimin dhe aksesin në të dhënat kompjuterike kufizon në mënyrë të papërligjur kompetencat hetimore të autoriteteve publike, duke rritur rrezikun e pandëshkueshmërisë, në veçanti për veprat e rënda penale, duke pasur parasysh rëndësinë që të dhëna të tilla mund të kenë për hetimet penale. Nën këtë qasje, në praktikë, sekuestrimi i pajisjeve elektronike dhe i sistemeve kompjuterike, me qëllim nxjerrjen e konsultimin e të dhënave që ato përmbajnë dhe marrjen e atyre që kanë rëndësi për hetimin, është një masë që zbatohet shpesh edhe në hetime për vepra të tjera penale, duke pasur parasysh përdorimin e gjerë të tyre në jetën e përditshme dhe rëndësinë e të dhënave që ato përmbajnë për drejtësinë penale. Megjithatë, ndonëse nuk ka një praktikë gjyqësore të njësuar për mënyrën e zbatimit të sekuestrimit të të dhënave ose të sistemeve kompjuterike edhe në raste të tilla, është e kuptueshme që edhe në këto raste janë të zbatueshme standardet kushtetuese dhe ato të KEDNJ-së, sikurse edhe kërkesat ligjore specifike.

94. Gjykata vëren gjithashtu se KPP-ja rregullon edhe ekspertimin si provë në procesin penal, duke parashikuar se ai lejohet kur është i nevojshëm zhvillimi i kërkimeve, marrja e të dhënave ose e vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike. Vendimi për ekspertimin dhe caktimi i ekspertit merret nga organi procedues, i cili në fazën e hetimeve paraprake është, në parim, prokurori, ndërsa ligji kërkon që vendimi të jetë i motivuar dhe të përcaktojë qartë edhe çështjet që i parashtrohen ekspertit, duke pranuar mundësinë e lejimit të tij për t'u njohur me aktet e nevojshme të fashikullit (*shih paragrafin 75 më sipër*). Ndërsa për sa u takon të dhënave ose sistemeve kompjuterike, në kuadrin e masave të sigurimit të provës elektronike, KPP-ja parashikon mundësinë e prokurorit për të thirrur ekspert me njohuri për sistemet kompjuterike dhe masat mbrojtëse të të dhënave, me qëllim zbatimin e masës së ndalimit të veprimeve të mëtejshme ose

sigurimit të sistemit kompjuterik, nxjerrjen dhe marrjen e kopjeve të të dhënave kompjuterike, pengimin e hyrjes në të dhënat kompjuterike, ose heqjes së këtyre të dhënave nga sistemet kompjuterike me të drejtë hyrjeje, si dhe sigurimin e paprekshmërisë të të dhënave përkatëse, të memorizuara. Në këtë kuptim, kur ekspertimi teknik konsiston në ekstraktimin, kopjimin dhe ruajtjen e të dhënave të memorizuara në një pajisje elektronike, me qëllim kërkimin e mëvonshëm dhe marrjen e atyre të dhënave që paraqesin rëndësi për hetimin, ai duket se shërben, përpara së gjithash, si veprim teknik për sigurimin e provës dhe ruajtjen e integritetit, vërtetësinë dhe pandryshueshmërinë e saj, duke shmangur manipulimin e mundshëm të bartësit të të dhënave. Për rrjedhojë, në aspektin funksional, ekstraktimi, kopjimi dhe ruajtja e të dhënave të memorizuara në një pajisje elektronike përmes ekspertimit mund të kuptohen si veprime teknike të lidhura me zbatimin e masës së sekuestrimit, në masën që ato synojnë ruajtjen e provës në gjendjen që është dhe krijojnë kushtet që, në një fazë të mëpasshme, të mundësohet identifikimi dhe përzgjedhja e atyre të dhënave që paraqesin rëndësi për hetimin.

95. Në këtë pikë, Gjykata çmon të evidentojë se sekuestrimi i pajisjes elektronike dhe i të dhënave në tërësi që ajo përmban është një masë që dallon nga kërkimi i mëvonshëm i atyre të dhënave që paraqesin rëndësi për hetimin. Kjo pranohet edhe nga subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, sipas të cilit, kërkimi i të dhënave kompjuterike me rëndësi për hetimin realizohet përmes masës së këqyrjes së dokumentit/kopjes pasqyrë të përfutur nga ekspertimi, sipas nenit 198 të KPP-së. Megjithatë, siç edhe më lart u konstatua, neni 202/a i KPP-së (pika 2), bën fjalë për kontroll të sistemeve informatike ose telematike, kurse neni 298 (pika 3) për kontroll të të dhënave kompjuterike (*shih paragrafin 79 më sipër*). Vlen të përmendet se këto masa, pra këqyrja dhe kontrolli, pa marrë përsipër përcaktimin se ku ato konsistojnë, duket se janë të dallueshme mes tyre, nisur edhe vetëm nga fakti se rregullohen nga dispozita të ndryshme ligjore. Po kështu, KPP-ja, zbatimin e masës së sekuestrimit e parashikon shprehimisht vetëm për rastin e kontrollit. Gjithsesi, edhe në këtë drejtim nuk duket se ka një praktikë gjyqësore të qëndrueshme dhe aq më tepër njësuare të Gjykatës së Lartë.



96. Po kështu, Gjykata çmon të evidentojë se në hetimet penale tradicionale autoritetet zakonisht procedojnë me kontrollin dhe, nëse gjenden prova, kalojnë te sekuestrimi i tyre. Ndërsa në fushën digjitale duket se ndodh e kundërta. Fillimisht zbatohet masa e sekuestrimit të pajisjes elektronike, përfshirë krijimin e kopjes pasqyrë (forenzike) dhe më pas kalohet në kërkimin e të dhënave me rëndësi për hetimin. Duket se ky *modus operandi* lidhet me nevojën për ruajtjen e integritetit të të dhënave kompjuterike.

97. Për sa më lart, Gjykata, fillimisht, vëren se sekuestrimi i një pajisjeje elektronike, edhe kur shoqërohet me veprime teknike për sigurimin e provës, si: nxjerrja, kopjimi dhe ruajtja e të dhënave, me qëllim garantimin e integritetit dhe parandalimin e humbjes, dëmtimit ose ndryshimit, është veprim i dallueshëm dhe **nuk barazohet** me veprimtarinë hetimore që konsiston në kërkimin, analizën, përzgjedhjen dhe marrjen e të dhënave me rëndësi për hetimin. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se KPP-ja, në kuadrin e përgjithshëm të sekuestrimit provues, parashikon sekuestrimin e provave materiale dhe të sendeve që lidhen me veprën penale me vendim të gjyqtarit ose të prokurorit dhe në raste përjashtimore edhe nga OPGJ-ja. Ndërkohë, **kur ndërhyrja shtrihet** në veprime që paraqesin cenim më intensiv të privatësisë, të tilla, si: kërkimi, analiza, përzgjedhja dhe marrja e të dhënave në një sistem informatik/telematik ose përcaktimi i modaliteteve të marrjes së tyre, ligjvënësi ka parashikuar garanci të shtuara, përfshirë kontrollin gjyqësor paraprak dhe detyrimin që vendimi të përcaktojë objektin dhe mënyrën e zbatimit të masës. Megjithatë, në këtë drejtim, sërish nuk duket se ka një praktikë gjyqësore të qëndrueshme dhe, aq më tepër, njësuere të Gjykatës së Lartë, që të ketë përcaktuar qartë kufijtë midis veprimeve teknike për sigurimin e provës elektronike dhe veprimeve të **aksesimit/kërkimit dhe përpunimit** të të dhënave në përmbajtjen e pajisjes, të cilat përbëjnë ndërhyrje më intensive në sferën e privatësisë.

98. Duke pasur parasysh të drejtat kushtetuese që potencialisht cenohen nga **aksesimi dhe përpunimi** i të dhënave, veçanërisht ajo e jetës private në aspektet e të dhënave personale dhe të fshehtësisë së korrespondencës, si dhe standardet që ligji procedural penal përcakton për masat hetimore që ndërhyjnë në elemente të tjera të së drejtës për jetë private, Gjykata çmon se kërkimi i të dhënave

kompjuterike që përfaqësojnë të dhëna personale ose korrespondencë private duhet, në parim, të autorizohet me vendim paraprak të gjykatës. Ky vendim duhet të jetë i arsyetuar mjaftueshëm, në mënyrë që ndërhyrja të kufizohet vetëm në atë që është rreptësisht e nevojshme për hetimin, duke shmangur arbitraritetin. Vendimi duhet të përcaktojë, së paku, garancitë procedurale për minimizimin e ndërhyrjes, veçanërisht në drejtim të: a) kufizimit të fushës së kërkimit, duke identifikuar pajisjen elektronike dhe, kur është rasti, sistemin ose sistemet e lidhura me të, si dhe duke përcaktuar objektin e kërkimit, llojin e të dhënave, fjalët kyçe ose kriteret e filtrimit dhe shtrirjen kohore, me synim shmangien e të dhënave të parëndësishme dhe, kur është rasti, të atyre që gëzojnë mbrojtje të posaçme nga ligji; b) kufizimit të kohës së ruajtjes dhe të rrethit të ekspozimit të të dhënave, duke përcaktuar afate për ruajtjen dhe analizimin, si edhe personat e autorizuar për akses, në mënyrë që ndërhyrja të mos shndërrohet në një mbledhje të përgjithshme dhe të pakontrolluar të informacionit; c) si dhe dokumentimit të detajuar të të gjitha veprimeve të kryera për kërkimin dhe analizimin e të dhënave, duke përfshirë mënyrën e aksesimit, kriteret e përdorura për kërkimin, të dhënat e përzgjedhura, si dhe masat e marra për garantimin e integritetit, me qëllim që të mundësohet një kontroll gjyqësor real dhe efektiv, në rast pretendimesh për arbitraritet, tejkalim të autorizimit ose shkelje të garancive procedurale.

99. Gjykata vëren se, në kontekstin e telefonave inteligjentë, aksesimi i të dhënave të memorizuara mund të shtrihet potencialisht në një spektër shumë të gjerë informacioni dhe të lejojë nxjerrjen e përfundimeve tejet të hollësishme mbi jetën private, profesionale dhe shoqërore të individit. Për këtë arsye, ndërhyrja shtetërore mbi të nuk mund të trajtohet si ndërhyrje mbi një send të zakonshëm provues, por si ndërhyrje në një hapësirë të zgjeruar të jetës private, me intensitet të lartë kushtetues. Për rrjedhojë, ndërhyrja në nenet 35 e 36 të Kushtetutës dhe në nenin 8 të KEDNJ-së duhet konsideruar në parim si “e rëndë” e në rrethana të caktuara edhe si “veçanërisht e rëndë”, kur ajo prek të dhëna me natyrë sensitive. Në këto kushte, për të shmangur arbitraritetin, kërkimi, analiza, përzgjedhja e të dhënave duhet, si rregull, t’i nënshtrohet një verifikimi paraprak nga gjykata, i aftë të refuzojë ose



të kufizojë masën kur ndërhyrja është joproporcionale.

100. Gjykata, po ashtu, vëren se në rastet e ngutshme/të urgjencës, si përjashtim, interesi publik mund të justifikojë sekuestrimin e pajisjes elektronike dhe përkohësisht edhe të të dhënave të memorizuara në të, në tërësi, me iniciativë të OPGJ-së, pa vendim paraprak të gjykatës, referuar nenit 300 të KPP-së. Megjithatë, në këto raste masa i nënshtrohet kontrollit automatik të prokurorit dhe kontrollit gjyqësor *ex post* mbi ankimin e individit, ku ligjshmëria vlerësohet: *së pari*, në aspektin e urgjencës, nëse kanë ekzistuar arsye të bazuara për të menduar se pajisja ose të dhënat mund të humbin, ndryshonin ose cenoheshin. Lidhur me këtë, Gjykata çmon të theksojë se urgjenca, në kuptimin kushtetues, duhet të jetë reale, konkrete dhe e argumentuar në rrethanat specifike të rastit. Rreziku i fshirjes të të dhënave digjitale nuk mund të prezumohet për çdo pajisje elektronike, pasi një qasje e tillë rrezikon të zhvendosë qendrën e kontrollit nga gjykata tek organi hetimor, në kundërshtim me parimin kushtetues të kontrollit gjyqësor; *së dyti*, në aspektin e nevojës për qëllimet e procedimit penal, pra nëse kanë ekzistuar arsye të bazuara për të menduar se pajisja përmban informacion, programe ose gjurmë të veprës penale, domethënë të dhëna me rëndësi për hetimin.

101. Në këtë pikë, Gjykata thekson se sekuestrimi në kushtet e urgjencës nuk nënkupton se OPGJ-të fitojnë edhe të drejtën për të kërkuar, analizuar, përzgjedhur dhe marrë të dhëna të memorizuara në përmbajtjen e pajisjes elektronike dhe që kanë rëndësi për hetimin. Për këtë ndërhyrje kërkohet vendim gjykate, i cili përcakton edhe modalitetet konkrete të kërkimit dhe të administrimit të të dhënave, në mënyrë që ndërhyrja të kufizohet vetëm në atë që është rreptësisht e nevojshme. Përjashtimi në rastet e urgjencës nuk duhet të kuptohet si zëvendësim i kontrollit gjyqësor *ex ante*, por vetëm si devijim i arsyetuar nga rregulli i autorizimit paraprak gjyqësor. Prandaj, në rastet e urgjencës, kërkohet që arsyeja e ngutshmërisë të jetë e motivuar në mënyrë të veçantë dhe kontrolli gjyqësor *ex post* të realizohet në një afat të shkurtër, në mënyrë që ndërhyrja të mos konsumohet faktikisht pa verifikim real të domosdoshmërisë dhe kufijve të saj.

102. Gjykata vëren gjithashtu se qoftë kur masa autorizohet paraprakisht nga gjykata, ashtu dhe kur

autorizohet pas sekuestrimit në kushtet e urgjencës, mënyra e kërkimit dhe e përzgjedhjes të të dhënave i nënshtrohet sërish kontrollit gjyqësor me kërkesë të prokurorit dhe është gjykata ajo që vendos përfundimisht për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike me rëndësi për hetimin dhe, kur është rasti, urdhëron asgjësimin e të dhënave të parëndësishme ose të atyre që gëzojnë mbrojtje të veçantë nga ligji. Në këtë pikë, Gjykata çmon të theksojë se efektiviteti i mjetit juridik dhe realiteti i kontrollit gjyqësor për ndërhyrje të kësaj natyre presupozon gjithashtu që personi i prekur të vihet në dijeni për bazën, arsyet thelbësore që kanë shërbyer për lejimin e aksesit në përmbajtjen e telefonit, sapo komunikimi i këtij informacioni të mos rrezikojë më detyrat e autoriteteve hetimore dhe interesat legjitimë të hetimit. Ky informim, i bërë në kohën e duhur, shërben si garanci kundër arbitraritetit dhe si parakusht për ushtrimin real të së drejtës për ankim të individit.

103. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren se sekuestrimi i telefonit të kërkueses është kryer në kuadër të hetimit penal që zhvillohet ndaj disa personave, të dyshuar për kryerjen e disa veprave penale specifike. Ky sekuestrim është kryer me iniciativë nga OPGJ-të, ndërsa më herët, përmes këqyrjes së telefonit nëpërmjet ekranit, kanë konstatuar se ai përmbante komunikime të kërkueses me persona të lidhur me hetimin, jo vetëm me personat nën hetim A dhe B, por edhe me përfaqësuesin e një prej subjekteve tregtare që ka realizuar pagesa për shoqërinë e personit nën hetim B, për shërbime që dyshohen të jenë fiktive, të kryera vetëm me qëllim justifikimin e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të pasurive dhe të shpenzimeve të të dy personave nën hetim në fjalë. Sekuestrimi i telefonit nga OPGJ-të është justifikuar me rrezikun e humbjes ose zhdukjes së tij dhe i të dhënave që ai përmbante, ndërsa ndërhyrja e prokurorit ka qenë e pamundur. Në vijim, prokurorët kanë urdhëruar ekspertimin e telefonit, i cili ka konsistuar në ekstraktimin, kopjimin dhe ruajtjen e të dhënave në përmbajtjen e tij.

104. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, e vënë në lëvizje me ankimin e kërkueses, ka pranuar këtë ankim, duke arsyetuar se sekuestrimi i telefonit të kërkueses nga OPGJ-të nuk është kryer në kushtet e flagrancës, në kundërshtim me nenet 202, pika 3 dhe 298 të KPP-së dhe vendimin nr. 1/2017 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë



(referuar prej saj si njësuës). Ndryshe nga ajo, GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë kanë pranuar se sekuestrimi i telefonit të kërkueses nga OPGJ-të është kryer me iniciativë në kushtet e urgjencës, në përputhje me nenin 300 të KPP-së, menjëherë pas marrjes së deklarimeve të kërkueses dhe pas këqyrjes përmes ekranit të telefonit të disa komunikimeve të ruajtura në të, me qëllim për të shmangur ndryshimin ose humbjen e tyre, ndërsa prokurori nuk mund të ndërhynte urgjentisht, ndërkohë që ekzistonin kushtet e përgjithshme sipas nenit 208 të KPP-së, pasi marrja e të dhënave ishte e domosdoshme për vërtetimin e fakteve të hetimit penal. Gjykata e Lartë ka theksuar se sekuestrimi nuk është kryer gjatë një kontrolli të kërkueses, siç kishte pranuar GJKKO-ja e Shkallës së Parë.

105. Gjykata vëren se sekuestrimi me iniciativë i telefonit të kërkueses nga OPGJ-të është një masë hetimore e marrë në fazën e hetimeve paraprake të një procedimi penal dhe është mbështetur në nenin 300 të KPP-së, si “*verifikim i ngutshëm në vend*”, pra në kushte urgjence. Masa është justifikuar me vlerësimin se ekzistonte rreziku i afërt i humbjes, zhdukjes ose tjetërsimit të sendit, për pasojë edhe i të dhënave kompjuterike të memorizuara në të, të cilat, nisur edhe nga rezultatet e këqyrjes paraprake të telefonit, sipas OPGJ-ve, konsideroheshin se përmbanin njoftime me rëndësi për hetimin. Gjykata vëren se KPP-ja, në kushte të përcaktuara rreptësisht, lejon që sekuestrimi provues i provave materiale ose i sendeve që lidhen me veprën penale të kryhet përjashtimisht nga OPGJ-të edhe pa vendim paraprak të gjykatës, përfshirë rastet kur sendi përmban të dhëna personale ose korrespondencë. Megjithatë, në këto raste, për të garantuar mbrojtjen nga arbitrariteti, masa i nënshtrohet kontrollit të prokurorit dhe, nëse ka ankim, edhe kontrollit gjyqësor *ex post*.

106. Në lidhje me ekzistencën e kushteve të urgjencës në rastin konkret, Gjykata vëren se subjekti i interesuar, si dhe gjykatat e zakonshme në vendimet e kundërshtuara nga kërkuesja, kanë parashtruar argumentet e tyre në këtë drejtim. Në thelb, është pranuar se telefoni celular u sekuestrova në momentin në të cilin u verifikua se në të gjendeshin të dhëna me rëndësi dhe të domosdoshme për hetimin, të cilat, për shkak të natyrës së tyre digjitale dhe mënyrës së ruajtjes/përpunimit përmes teknologjisë së informacionit, mund të ndryshonin, fshiheshin ose

humbnin, pra se ekzistonte rreziku i vonësës (*periculum in mora*). Ky rrezik ka qenë real në kushtet kur pajisja/telefoni kishte akses në rrjet (internet), çka e rriste mundësinë e ndërhyrjeve që mund të ndiknin mbi gjendjen e të dhënave, përfshirë përmes mekanizmave të sinkronizimit ose fshirjes në distancë. Në këto rrethana, OPGJ-të, në pamundësi të ndërhyrjes së menjëhershme të prokurorit, sekuestrova telefonin, i cili më pas iu nënshtrua veprimeve të ekspertimit me qëllim ruajtjen e integritetit të të dhënave. Kërkuesja, në këtë drejtim, pretendon vetëm se sekuestrimi nuk është bërë në kushtet e flagrancës. Megjithatë, kjo është një situatë faktike dhe ligjore e ndryshme nga ajo në rastin konkret, që ka të bëjë me sekuestrimin në kushtet e urgjencës. Po kështu, ndonëse kërkuesja pretendon se nuk është person nën hetim, ajo nuk ka treguar ndonjë dispozitë ligjore që pengon sekuestrimin për një arsye të tillë, dhe as Gjykata nuk konstaton ekzistencën e një ndalimi të tillë ligjor.

107. Për sa më sipër, dhe në mungesë të ndonjë të dhëne konkrete që mund të vënë në dyshim arsyetimin e gjykatave të zakonshme në vendimet e kundërshtuara, Gjykata vlerëson se marrja, sekuestrimi i telefonit të kërkueses nga OPGJ-të, si dhe veprimet teknike të domosdoshme për sigurimin dhe ruajtjen e integritetit të të dhënave kompjuterike të memorizuara në të, përfshirë edhe krijimin e një kopjeje të të dhënave për qëllime ruajtjeje, kanë bazë ligjore dhe, për pasojë, ato përmbushin kërkesën që ndërhyrja të jetë në përputhje me ligjin. Kjo masë iu nënshtrua kontrollit të prokurorit dhe, mbi ankimin e kërkueses, edhe kontrollit gjyqësor *ex post*, nga i cili u verifikua ligjshmëria e saj në kushtet e urgjencës. **Megjithatë, ky përfundim nuk shtrihet automatikisht te faza pasuese e përpunimit të përmbajtjes të të dhënave, kërkimi dhe përzgjedhja e tyre, sidomos kur ato përbëjnë të dhëna personale ose korrespondencë, gjë e cila kërkon garanci të posaçme dhe vlerësim të veçantë.**

108. Gjatë gjykimit kushtetues, kërkuesja ngriti pretendimin se organi procedues (prokuroria, Policia Gjyqësore dhe ekspertët) kishin kërkuar dhe marrë në kopjen e përmbajtjes së telefonit të saj celular komunikime elektronike që nuk kishin rëndësi për hetimin penal, të cilat i përdorën për të mbështetur kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit kushtetues (*shih paragrafin 6 më sipër*). Sipas saj, kjo



përbënte një ndërhyrje tjetër në të drejtat kushtetuese të fshehtësisë së korrespondencës dhe të jetës private, ndërhyrje e cila nuk ishte bërë në përputhje me ligjin, pra me vendim të gjykatës.

109. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata vëren se ai nuk është ngritur në gjykatat e zakonshme dhe nuk lidhet drejtpërdrejt me veprimet fillestare të organit procedues, për të cilat janë dhënë vendimet gjyqësore, objekt i ankimit kushtetues individual. Për këtë arsye, në pamje të parë duket se pretendimi nuk duhet marrë në shqyrtim për të respektuar parimin e subsidiaritetit dhe natyrën përfundimtare të gjykimit kushtetues. Megjithatë, duke mbajtur në konsideratë faktin se pretendimi bazohet në aktet e paraqitura prej subjektit të interesuar në gjykimin kushtetues për të mbështetur kërkesat procedurale për efekte të vet gjykimit kushtetues, Gjykata çmon se, përjashtimisht, ky pretendim, në dukje i ri, duhet të merret në shqyrtim prej saj. Në vijim të këtij arsyetimi, por edhe për shkak të analizës së mësipërme të kuadrit kushtetues dhe ligjor, në raport me praktikën gjyqësore, me të cilën janë nxjerrë përfundime të reja dhe të rëndësishme për të përshtatur metodat hetimore në funksion të mbrojtjes të të drejtave themelore, Gjykata çmon ta shqyrtojë këtë pretendim në kuadër të parimit të proporcionalitetit (*shih paragrafët 120–128 më poshtë*).

ii. Nëse ndërhyrja ka ndjekur një qëllim të ligjshëm

110. Për sa i përket qëllimit të ndërhyrjes, Gjykata vëren se sekuestrimi i telefonit dhe i të dhënave kompjuterike të ruajtura në të ka synuar gjetjen e të dhënave për kryerjen e veprave penale të korrupsionit dhe pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale. Nisur nga kjo, ndërsa as kërkesja nuk ka ndonjë kundërshtim në këtë drejtim, është e qartë se masa e sekuestrimit ka pasur për qëllim parandalimin dhe ndjekjen penale të veprave penale në fjalë, domethënë ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike nga veprimtaria kriminale, çka përbën një qëllim të ligjshëm në aspekt të interesit publik, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës. Në këtë pikë, vlen të evidentohet se Kushtetuta, në nenet 135, pika 2 dhe 148/dh, i ka dhënë rëndësi të veçantë luftës kundër korrupsionit, duke parashikuar ngritjen e organeve të posaçme të drejtësisë.

iii. Nëse ndërhyrja ka qenë proporcionale, në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë

111. Gjykata vëren se kërkesja pretendon se sekuestrimi i telefonit të saj celular nuk ka qenë i domosdoshëm, pasi qëllimi i ndjekur, konkretisht sigurimi i komunikimeve me dy persona të lidhur me hetimin, mund të arrihej me masa më të lehta dhe më pak kufizuese për të drejtat e saj. Masa të tilla, shprehet ajo, do të ishin vijimi i këqyrjes së telefonit nga OPGJ-të, kopjimi i atyre të dhënave me interes për hetimin, ose sekuestrimi i telefonit, por vetëm për një periudhë të kufizuar kohore (deri në një muaj), për atë sa ka qenë e nevojshme për këqyrjen dhe kopjimin e të dhënave në fjalë. Po sipas saj, sekuestrimi i telefonit dhe ekspertimi pasues nuk kanë qenë proporcionalë dhe bien ndesh me vendimin njëses nr. 147/2021. Vendimi i ekspertimit të telefonit, shprehet ajo, është i përgjithshëm, evaziv dhe shumë i gjerë, pa përcaktuar të dhënat elektronike që i shërbenin hetimit dhe pa parashikuar masa specifike për mbrojtjen e tyre. Sipas saj, sekuestrimi dhe ekspertimi kanë çuar në aksesimin e të gjitha të dhënave të ruajtura në telefon, ndonëse vetëm një pjesë e tyre lidhej me hetimin. Në këtë drejtim, vijon kërkesja, edhe materiali i paraqitur në mbështetje të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit kushtetues tregon qartë se organi i ndjekjes penale ka aksesuar edhe të dhëna që nuk lidhen me hetimin. Për më tepër, shprehet kërkesja, komunikimet e saj kanë natyrë periferike dhe pa rëndësi të veçantë për hetimin ku edhe pse ka kaluar më shumë se 1 vit e 4 muaj nga sekuestrimi, telefoni ende nuk i është kthyer.

112. Nga ana tjetër, subjekti i interesuar ka prapësuar se sekuestrimi i telefonit celular të kërkeses është kryer për nevojat e hetimit, me qëllim ekzaminimin e mëtejshëm, pasi është verifikuar se në të gjendej një numër i konsiderueshëm të dhënash me rëndësi për hetimin dhe se ekzistonin prova e indicie të mjaftueshme për lidhjen e kërkeses me hetimin penal. Sipas tij, ndërhyrja ka qenë e domosdoshme dhe nuk kanë ekzistuar alternativa të tjera më të lehta, të cilat të siguronin të njëjtin rezultat hetimor. Nisur nga volumi i madh i të dhënave, shprehet ai, vijimi i këqyrjes në vend të telefonit nga OPGJ-të, sikundër edhe ekstraktimi dhe kopjimi i të dhënave, për shkak të kohës që nevojitet për realizimin e tyre, ka qenë objektivisht e pamundur, ndaj është proceduar me sekuestrimin e telefonit, çka ka qenë e domosdoshme edhe për shkak të natyrës së brishtë



të provës elektronike, e cila mund të zhduket menjëherë, në çast. Po sipas tij, ndërhyrja ka qenë proporcionale, e orientuar vetëm drejt të dhënave që lidhen me faktin penal dhe me personat e përfshirë, të cilat nuk janë bërë publike dhe do të përdoren vetëm për qëllime hetimore, duke mos qenë ajo e paarsyeshme ose arbitrare. Pretendimet për gjyqtarin kushtetues, shprehet ai, kanë pasur për qëllim të pasqyrojnë marrëdhënien e tij me kërkuesen dhe lidhen me objektin e gjykimit të çështjes, duke mos tejkaluar asnjë normë. Sekuestrimi i telefonit dhe mbajtja e tij si provë materiale, vijon ai, për atë kohë sa është e domosdoshme për të provuar faktin penal, është në përputhje edhe me vendimin njësuës nr. 147/2021. Nëse telefoni do të kthehej, ekziston rreziku i dëmtimit ose i zhdukjes së provës dhe në kushtet kur hetimet vazhdojnë, kthimi i tij është i pamundur edhe për shkak se mund të lindë nevoja për ricksptim.

113. Gjykata, për sa i përket kriterit të proporcionalitetit të ndërhyrjes, është shprehur se ai nënkupton që marrëdhënia midis ndërhyrjes (kufizimit) dhe qëllimit të ndjekur duhet të jetë e arsyeshme. Ajo e ka analizuar këtë kriter në drejtim: i. të nevojës, pra të aftësisë së masës për të arritur qëllimin e ndjekur; ii. të përshtatshmërisë, në kuptimin që masa të mos shkojë përtej asaj që është e pashmangshme; iii. si dhe të ashpërsisë, në kuptim të shtrirjes së masës, përfshirë edhe kohëzgjatjen e saj (*shih vendimet nr. 42, datë 1.7.2025; nr. 79, datë 12.11.2024; nr. 29, datë 16.4.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

114. Gjykata, mbështetur edhe në standardet e GJEDNJ-së, ka pohuar se, edhe pse autoritetet publike, në funksion të parandalimit dhe ndjekjes penale, mund të përdorin masa për sigurimin e provave, ajo kontrollon nëse arsyet përkatëse janë relevante dhe të mjaftueshme dhe nëse janë respektuar garancitë kundër abuzimit, duke kërkuar që ligji dhe praktika të ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme dhe efektive, si dhe që proporcionaliteti të vlerësohet mbi bazën e rrethanave konkrete. Në këtë drejtim, për të përcaktuar nëse ndërhyrja është proporcionale me qëllimin e ndjekur, mbahen në konsideratë, ndër të tjera, rrethanat e lëshimit të urdhrit të kërkimit, përmbajtja e fushëveprimit i tij, mënyra e zbatimit dhe pasojat e mundshme për personin e prekur. Në kontekstin e kontroleve dhe të sekuestreimeve, Gjykata ka theksuar se ligji duhet të ofrojë **garanci**

të mjaftueshme dhe të përshtatshme kundër arbitraritetit, përfshirë edhe mundësinë e një **shqyrtimi efektiv** të masave që cenojnë të drejtën për jetë private. Po kështu, në kontekstin e urdhrave për kërkim dhe sekuestrim, Gjykata ka theksuar se ato duhet të përmbajnë **kufizime të qarta**, në mënyrë që ndërhyrja të mos jetë potencialisht e pakufizuar dhe, për këtë arsye, joproporcionale. Urdhri duhet të specifikojë fushëveprimin dhe kriteret e zbatimit, si dhe një minimum informacioni që mundëson mbikëqyrjen e ekzekutimit dhe verifikimin e respektimit të kufijve. Urdhrat e formuluar gjerësisht, pa të dhëna të mjaftueshme mbi hetimin ose objektin e sekuestrit, nuk garantojnë ekuilibrin e drejtë ndërmjet interesit publik dhe të drejtave të individit, duke iu dhënë organeve hetimore kompetenca tepër të gjera, ndërsa individit të prekur i kufizojnë mundësinë për të zbuluar, parandaluar dhe raportuar abuzimet. Mungesa e një urdhri gjyqësor paraprak mund të kompensohet vetëm nga një shqyrtim gjyqësor **ex post** për ligjshmërinë dhe domosdoshmërinë e masës, i cili duhet të jetë real dhe efektiv në rrethanat konkrete (*shih vendimet nr. 42, datë 1.7.2025; nr. 79, datë 12.11.2024; nr. 29, datë 16.4.2024, të Gjykatës Kushtetuese*).

115. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se sekuestrimi i telefonit celular përbën në vetvete edhe sekuestrim të të dhënave në përmbajtjen e tij (*shih paragrafin 51 më sipër*), thekson se, në këto raste, organi procedues duhet të garantojë mbrojtjen efektive të të drejtave themelore mbi të dhënat personale dhe fshehtësinë e korrespondencës, përmes disa standardeve bazë, të tilla, si: i. kufizimi objektiv dhe material i ndërhyrjes, që nënkupton ndalimin e çdo veprimi të paautorizuar nga gjykata në drejtim të hapjes/hyrjes në pajisje, kërkimit, nxjerrjes, përpunimit dhe përdorimit të të dhënave personale dhe/ose korrespondencës; ruajtjen e pajisjes së sekuestruar, kur ajo përmban të dhëna personale dhe/ose korrespondencë, në gjendje të mbyllur, të vulosur, veprim ky që, kur është e mundur, duhet të kryhet në prani të individit dhe/ose avokatit dhe të dokumentohet me procesverbal; si dhe ndalimin e bërjes së kopjeve të përmbajtjes së pajisjes pa autorizim gjyqësor, me përjashtim të rastit kur një kopje teknike e plotë kryhet vetëm si masë paraprake ruajtjeje në kushtet e urgjencës, për të parandaluar humbjen ose ndryshimin e provës, kur ekziston realisht mundësia



e ndërhyrjes mbi gjendjen e të dhënave dhe fshirjen e tyre në distancë, duke garantuar integritetin e provës dhe zinxhirin e ruajtjes; **ii.** ndarja e qartë ndërmjet të dhënave me rëndësi për hetimin dhe atyre të parëndësishme, si dhe atyre që gëzojnë mbrojtje të posaçme nga ligji; **iii.** ushtrimi i një kontrolli gjyqësor real dhe efektiv për çdo fazë të ndërhyrjes; **iv.** respektimi i parimit të minimizimit, në kuptimin që, edhe kur lejohet ruajtja paraprake e përmbajtjes së pajisjes në kushtet e urgjencës, çdo veprim i mëtejshëm i kërkimit, analizës, përzgjedhjes dhe marrjes të të dhënave me rëndësi për hetimin kërkon autorizim të posaçëm nga gjykata dhe duhet të kufizohet në minimumin e domosdoshëm.

116. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar edhe se qëllimi i ndjekur nga organi procedues mund të arrihej me masa më të lehta dhe më pak kufizuese për të drejtat e saj, të realizueshme përmes alternativave, të tilla, si: i. vijimi i këqyrjes në vend të telefonit nga OPGJ-të; ii. kopjimi vetëm i atyre të dhënave që paraqisnin interes për hetimin; iii. sekuestrimi i telefonit vetëm për një periudhë të kufizuar kohore, sa ishte e nevojshme për këqyrjen dhe kopjimin e të dhënave me interes për hetimin.

117. Në lidhje me alternativën e parë, *vijimin e këqyrjes së telefonit*, Gjykata vëren se këqyrja e telefonit përmes ekranit, në kushtet e një situatë urgjence dhe përballë një vëllimi potencialisht të lartë të të dhënave, nuk duket se ofron domosdoshmëri garanci të barasvlershme me ato që kërkohen për sigurimin e provës në formë të plotë, të verifikueshme dhe të qëndrueshme. Në veçanti, vijimi i këqyrjes në vend nuk siguron, në vetvete, ruajtjen e integritetit të të dhënave dhe gjurmueshmërinë e veprimeve për dokumentimin e plotë të asaj që është kërkuar, parë dhe përzgjedhur, elemente këto të cilat janë thelbësore, si për vlefshmërinë provuese të materialit, ashtu edhe për mundësinë e kontrollit gjyqësor efektiv për respektimin e kufijve të ndërhyrjes. Për më tepër, një këqyrje e tillë do të kërkonte një shfletim të gjerë të përmbajtjes së telefonit, çka do të rrezikonte të rriste shkallën e ndërhyrjes në sferën private pa garanci të mjaftueshme.

118. Për sa i takon alternativës së dytë, *kopjimin e të dhënave*, Gjykata çmon se kopjimi selektiv i të dhënave mund të përbëjë, në parim, një mjet më pak kufizues, por zbatueshmëria e tij varet nga ekzistenca e kriterëve paraprake të qarta që kufizojnë

fushëveprimin e kërkimit, të tilla, si: kontakte të caktuara, periudhë kohore specifike, aplikacione, fjalë kyçe ose kriteret filtrimi të caktuara, në mënyrë që përzgjedhja të mos bëhet në mënyrë rastësore ose e pavërtetueshme në një kontroll *ex post*. Në mungesë të një autorizimi me kufij të përcaktuar, seleksionimi “në vend” i të dhënave do të rrezikonte të ishte ose i paqëndrueshëm e potencialisht arbitrar ose të presupozonte një ekspozim të gjerë ndaj të dhënave të parëndësishme për hetimin. Nga ana tjetër, duket se vetëm pas sigurimit të burimit të provës, parimi i minimizimit të ndërhyrjes merr peshë të posaçme, pikërisht në fazën e kërkimit, analizës, përzgjedhjes dhe marrjes të të dhënave me rëndësi për hetimin, duke u orientuar vetëm drejt kategorive të lidhura me objektin e hetimit dhe duke përjashtuar ekspozimin e të dhënave të parëndësishme ose të atyre që gëzojnë mbrojtje të posaçme nga ligji.

119. Lidhur me alternativën e tretë, *sekuestrimin e telefonit brenda një periudhe të kufizuar kohore*, Gjykata vëren se kufizimi kohor i mbajtjes në sekuestro i pajisjes/telefonit nuk mund të përcaktohet në mënyrë të përgjithshme dhe abstrakte, sikurse kërkuesja pretendon “deri në një muaj”, pasi një gjë e tillë varet nga rrethanat konkrete të hetimit dhe nga veprimet procedurale që duhen kryer për sigurimin dhe administrimin e provës. Megjithatë, Gjykata çmon të theksojë se vijimi i mbajtjes në sekuestro i pajisjes dhe/ose i të dhënave të nxjerra prej saj nuk mund të mbështetet vetëm në një referim të përgjithshëm të interesit të hetimit, por kërkon arsyetim të posaçëm dhe kontroll gjyqësor efektiv për domosdoshmërinë e vijimit, si në shtrirje, ashtu edhe në kohë, veçanërisht kur bëhet fjalë për një person që nuk është subjekt nën hetim.

120. Në vijim, Gjykata thekson se vlerësimi i këtyre alternativave në fazën fillestare të sigurimit të provës nuk legjitimon, në mënyrë automatike, kërkimin dhe përpunimin potencialisht të pakufizuar të të gjithë përmbajtjes së pajisjes. Për rrjedhojë, Gjykata do të shqyrtojë nëse mënyra e autorizimit dhe e zbatimit të ekspertimit teknik-elektronik të telefonit, si dhe ushtrimi i mbikëqyrjes gjyqësore *ex post*, përveç edhe kërkimi, edhe përpunimi i të dhënave në vijim, kanë ofruar garanci të mjaftueshme që ndërhyrja të kufizohet në minimumin e pashmangshëm dhe të mos shndërrohet në një aksesim dhe përpunim të pakufizuar të të dhënave.



121. Në këtë kuadër, për të vlerësuar nëse ndërhyrja është kufizuar në minimumin e pashmangshëm dhe është shoqëruar me garanci të mjaftueshme kundër arbitraritetit, Gjykata u kthehet rrethanave konkrete të rastit. Në veçanti, duke pasur parasysh se, sipas akteve të procedimit penal, interesi faktik i hetimit lidhej, në thelb, me komunikimet e kërkuësës me persona të lidhur me hetimin, Gjykata do të shqyrtojë nëse vendimi i prokurorit për ekspertimin teknik-elektronik të telefonit, sikundër edhe ai për kërkimin dhe përzgjedhjen, në kopjen teknike të plotë, të të dhënave me rëndësi për hetimin, referuar nga subjekti i interesuar si këqyrje e aktit të ekspertimit, kanë përmbajtur kufizime të mjaftueshme që ndërhyrja të orientohej vetëm drejt këtyre të dhënave dhe të mos shndërrohej në një aksesim të përgjithshëm të të gjithë përmbajtjes së telefonit.

122. Gjykata vëren se, në kushtet kur sekuestrimi i telefonit, ekspertimi pasues i tij dhe kërkimi e përzgjedhja e të dhënave janë kryer pa vendim paraprak të gjykatës, kërkohej garanci të shtuara që masa të mos shndërrohet në një përpunim potencialisht të pakufizuar të të dhënave personale dhe të korrespondencës. Për këtë arsye, Gjykata do të shqyrtojë nëse organi procedues ka përcaktuar garanci të mjaftueshme procedurale për të siguruar që ndërhyrja të mos tejkalonte objektivin e parandalimit dhe të ndjekjes penale të veprës, për të cilën është zbatuar. Një vendim që, në thelb, autorizon kërkim të dhënash, pa shkelur kufijtë e sekretit hetimor, duhet të përmbajë kufizime të qarta dhe tregues minimalë orientues në drejtim të **objektit konkret të kërkimit, rrethit të personave/komunikimeve** që kërkohej, **shtrirjen kohore** të kërkimit, **aplikacionet** relevante dhe, kur është e mundur, kritere filtrimi (kontakte, fjalë-kyçe etj.). Këto kufizime dhe tregues minimalë orientues duhet të jenë të përshtatshëm për të drejtuar si veprimtarinë e ekspertit, ashtu edhe të OPGJ-së, në mënyrë që ndërhyrja, veçanërisht në të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale dhe fshehtësinë e korrespondencës, të mos jetë potencialisht e pakufizuar dhe, si pasojë, joproporcionale. Po kështu, ato duhet t'i mundësojnë individit të prekur të dallojë, të parandalojë dhe të ankohet për abuzim, përveçse duhet të mundësojnë një kontroll të mëvonshëm efektiv nëse ekspertët ose OPGJ-të kanë përmbushur fushëveprimin e autorizuar të hetimit.

123. Në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi për kryerjen e ekspertimit teknik-elektronik të telefonit të kërkuësës duket se është hartuar në terma të gjerë, duke mos kufizuar në mënyrë të arsyeshme fushëveprimin e masës. Ndonëse, sipas akteve të procedimit penal, interesi i parashtruar i hetimit lidhej me komunikime të kërkuësës me persona të lidhur me hetimin, ekspertët janë autorizuar për evidentimin dhe ekstraktimin e një spektri të gjerë të kategorive të të dhënave, përfshirë thirrje, mesazhe, kontakte, materiale fotografike dhe filmike, regjistrime audio/video, të dhëna të logimeve dhe navigimeve, komunikime në rrjete sociale dhe në aplikacione të ndryshme, përfshirë edhe të dhëna të fshira ose të rikuperueshme, si dhe “çdo të dhënë tjetër” me rëndësi për hetimin. Në mungesë të lidhjes së qartë të kësaj shtrirjeje me objektin konkret të hetimit dhe në mungesë të kufizimeve të përcaktuara për objektin e kërkimit, për nga vetë formulimi i vendimit, prokurorët e çështjes praktikisht kanë disponuar për ekstraktimin e kopjimin dhe, në këtë mënyrë, për sekuestrimin në bllok të përmbajtjes së telefonit, pavarësisht nëse të dhënat e memorizuara në të kishin ose jo rëndësi për hetimin. Në këto kushte, Gjykata do të vlerësojë në vijim nëse kjo mungesë kufizimesh është kompensuar nga garanci procedurale të mjaftueshme gjatë zbatimit dhe, veçanërisht, nga një mbikëqyrje gjyqësore *ex post* reale dhe efektive mbi fushëveprimin real të përpunimit të të dhënave.

124. Gjykata konstaton se, në rastin konkret, këqyrja e disa komunikimeve përmes ekranit dhe sekuestrimi i telefonit celular në vijim, janë kryer në prani të kërkuësës. Megjithatë, ndërsa ekstraktimi i të dhënave në përmbajtjen e telefonit dhe kopjimi tyre u krye më pas, kërkuësja nuk u njoftua paraprakisht për një masë të tillë dhe as për mënyrën e zbatimit të saj, pra për përmbajtjen e kopjes. Gjykata, po ashtu, konstaton se ndonëse masa nuk është urdhëruar paraprakisht nga gjykata, kërkuësja ka pasur një mjet juridik për kundërshtimin e sekuestrimin të telefonit dhe të të dhënave kompjuterike në përmbajtjen e tij, të cilin ajo e ka shfrytëzuar. Në këto rrethana, u takonte gjykatave të zakonshme të vendosnin se për cilat të dhëna sekuestrimi do të duhet të mbahej. Gjykata ka vërejtur më lart se sekuestrimi i telefonit celular përbën në vetvete edhe sekuestrim të të dhënave në përmbajtjen e tij, si dhe se vendimi për ekspertimin e tij, ekstraktimin e të dhënave dhe krijimin e kopjes,



është formuluar në terma të gjerë, duke mos kufizuar në mënyrë të arsyeshme fushëveprimin e tij vetëm drejt komunikimeve të kërkuësës me persona të lidhur me hetimin, të cilat, sipas subjektit të interesuar, paraqisnin rëndësi për hetimin. Megjithatë, rezulton se të gjitha të dhënat kompjuterike në telefonin e kërkuësës janë kopjuar dhe sekuestruar në tërësi.

125. Në këto rrethana, mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë ushtruar funksionin e tyre mbikëqyrës *ex post* merr rëndësi të veçantë, duke qenë se ndërhyrja në rastin konkret, që buron nga aksesimi i të dhënave në telefonin celular të kërkuësës, paraqet një intensitet shumë më të lartë kushtetues dhe një kontroll i tillë nuk duhet të reduktohet në verifikimin formal të sekuestrimit të pajisjes si send, por duhet të shtrihet në mënyrë të posaçme mbi fushëveprimin real të përpunimit të të dhënave, me mundësinë për ta kufizuar ose përjashtuar atë pjesë të ndërhyrjes që nuk justifikohet nga nevojat konkrete të hetimit.

126. Gjykata vëren se, ndonëse GJKKO-ja e Shkallës së Parë vuri në diskutim proporcionalitetin e masës së sekuestrimit të të gjitha të dhënave në përmbytjen e telefonit të kërkuësës dhe arriti në përfundimin se ky kriter ishte shkelur, gjykatat më të larta, në vendimet e kundërshtuara, u kufizuan vetëm në kontrollin e masës së sekuestrimit të telefonit si send, pa shqyrtuar proporcionalitetin e sekuestrimit të të dhënave kompjuterike në përmbytjen e tij. Veçanërisht, ato nuk trajtuan nëse do të ishte e mjaftueshme që kopjimi dhe sekuestrimi të mbahej vetëm për ato të dhëna që përmbanin komunikime të kërkuësës me persona të lidhur me hetimin. Po kështu, ato nuk dhanë as ndonjë arsye specifike se përse kopjimi dhe sekuestrimi i të gjitha të dhënave në telefonin e kërkuësës ka qenë i nevojshëm për hetimin. Për rrjedhojë, mënyra e ushtrimit të mbikëqyrjes *ex post* nga gjykatat e zakonshme më të larta nuk i mundëson Gjykatës të përcaktojë se kopjimi dhe sekuestrimi i të gjitha të dhënave elektronike në telefonin e kërkuësës është proporcional në rrethanat e rastit.

127. Megjithatë, faktet e çështjes tregojnë se veprimtaria e dyshuar kriminale, për të cilën nevojitej ekstraktimi, kopjimi dhe sekuestrimi i të dhënave në përmbytjen e telefonit të kërkuësës, lidhet, në thelb, me komunikimet midis saj dhe personave të lidhur me hetimin. Nisur nga kjo,

Gjykata vëren se duhet të ekzistojnë arsye të veçanta që të justifikojnë sekuestrimin e të gjitha të dhënave në përmbytjen e telefonit. Megjithatë, në rastin konkret, arsye të tilla nuk janë paraqitur as në vendimin e sekuestrimit të telefonit, as në vendimin e ekspertimit, dhe as në ndonjë dokument tjetër. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se sekuestrimi i të gjitha të dhënave në përmbytjen e telefonit, si dhe shqyrtimi edhe i të dhënave që nuk kanë rëndësi për hetimin, referuar për këtë materialit mbështetës të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit kushtetues, ka shkuar përtej asaj që ka qenë e nevojshme për arritjen e qëllimit legjitim.

128. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se ekstraktimi, kopjimi dhe sekuestrimi i të gjitha të dhënave kompjuterike në përmbytjen e telefonit celular të kërkuësës, si dhe kërkimi e përpunimi i mëvonshëm i tyre, nuk duket se ka qenë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë dhe, rrjedhimisht, ndërhyrja nuk ka qenë proporcionale, pasi nuk provohet të jetë gjetur një ekuilibër i drejtë midis interesave të ndryshëm të përfshirë në këtë rast. Duke pasur parasysh interesin e një shoqërie demokratike për të siguruar respektimin e së drejtës për të vendosur vetë për informacionin personal të lidhur me të dhënat personale dhe fshehtësinë e korrespondencës së individit, pretendimi i kërkuësës për cenimin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe fshehtësinë e korrespondencës, të garantuara nga nenet 35 dhe 36 të Kushtetutës, është i bazuar, për aq kohë sa ndërhyrja është drejtuar përtej të dhënave me rëndësi për hetimin.

129. Gjykata vëren se, në rastin konkret, cenimi i së drejtës së ankueses buron jo vetëm nga vendimmarrja e gjykatave të zakonshme, por nga vetë ndërhyrja vazhduese e shkaktuar nga ekstraktimi, kopjimi, ruajtja dhe kërkimi i të dhënave të nxjerra nga telefoni celular, në kushtet e mungesës së kufizimeve të qarta të fushëveprimit dhe të një mbikëqyrjeje gjyqësore *ex post* reale dhe efektive. Për rrjedhojë, duke mbajtur në konsideratë se kopja e të dhënave mbahet aktualisht vetëm nga organi i ndjekjes penale dhe nuk i është vënë në dispozicion as Gjykatës dhe as gjykatave të zakonshme në procesin objekt kontrolli kushtetues, Gjykata çmon se rikthimi i çështjes për rishqyrtim, edhe nëse do të shoqërohej me shfuqizimin e vendimeve të kundërshtuara të gjykatave të zakonshme, nuk do të garantonte në vetvete rivendosjen praktike të së drejtës së shkelur, pasi masa riparuese vendimtare



duhet të konsistojë në ndarjen/filtrimin material të të dhënave me rëndësi dhe atyre pa rëndësi për hetimin, asgjësimin e menjëhershëm të këtyre të fundit dhe vendosjen e garancive procedurale e kontrollin gjyqësor për vijimin e mbajtjes në sekuestro të të dhënave me rëndësi për hetimin. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se konstatimi i cenimit të së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe fshehtësinë e korrespondencës, i shoqëruar me urdhërime konkrete riparuese dhe me përcaktimin e organit përgjegjës, mënyrën dhe afatet e ekzekutimit, përmbush kërkesat e efektivitetit të ankimit kushtetues individual dhe e bën të panevojshëm dërgimin e çështjes për rishqyrtim në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

130. Gjykata, duke iu referuar përfundimeve të mësipërme, vëren se ndërhyrja e konstatuar në të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale dhe fshehtësinë e korrespondencës nuk lidhet vetëm me sekuestrimin e telefonit celular si send, por edhe me ekstraktimin, kopjimin, kërkimin dhe përpunimin në vijim të të dhënave të nxjerra nga ai. Për rrjedhojë, riparimi kushtetues nuk mund të mbetet vetëm deklarativ, por duhet të jetë i aftë të ndalojë vazhdimin e ndërhyrjes së pajustificuar, të kufizojë ndërhyrjen e justifikueshme në minimumin e pashmangshëm, si dhe të vendosë garanci procedurale të mjaftueshme dhe efektive kundër arbitraritetit.

131. Gjykata rithekson se proporcionaliteti, në kuptimin e ngushtë, kërkon gjetjen e një ekuilibri të drejtë ndërmjet interesit publik për parandalimin dhe ndjekjen penale dhe interesit të individit për respektimin e së drejtës për të vendosur vetë për informacionin personal të lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe fshehtësinë e korrespondencës. Ky ekuilibër nuk mund të konsiderohet i arritur kur masa hetimore është formuluar dhe zbatuar në terma potencialisht të pakufizuar, pa kufizime të qarta të fushëveprimit dhe pa një kontroll real e të plotë të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit të saj.

132. Gjykata vëren se, në çështjet që lidhen me prova digjitale, identifikimi i të dhënave me rëndësi për hetimin dhe i atyre që duhet të asgjësohen presupozon jo vetëm vlerësimi teknik, por edhe njohjen konkrete të përmbajtjes së kopjes dhe të elementeve faktike të hetimit. Në rastin konkret, pamundësia e Gjykatës për të bërë një identifikim të tillë nuk buron vetëm nga volumni dhe natyra e të

dhënave, por, mbi të gjitha, nga fakti se kopja e të dhënave të nxjerra nga telefoni nuk i është vënë në dispozicion Gjykatës dhe ajo nuk ka qenë objekt i një shqyrtimi real e të plotë as në gjykatat e zakonshme në procesin gjyqësor, që përbën objekt kontrolli kushtetues. Kopja e përmbajtjes së telefonit të kërkuësës edhe aktualisht vijon të mbahet vetëm nga organi i ndjekjes penale, subjekti i interesuar. Megjithatë, kjo pamundësi faktike nuk e pengon Gjykatën të përcaktojë pasojat kushtetuese të cenimit dhe të urdhërojë një mekanizëm zbatimi që vendos kufij të qartë dhe mundëson verifikimin e respektimit të tyre. Në këto rrethana, Gjykata çmon se ekzekutimi i vendimit të saj duhet të konsiderohet si proces i detyruar në kuptimin se organi që disponon kopjen duhet të kryejë veprimet teknike të ndarjes/filtrimit dhe asgjësimit të të dhënave që nuk kanë lidhje me objektin e hetimit, ndërsa gjykata e zakonshme duhet të ushtrojë kontrollin gjyqësor efektiv për vijimin e mbajtjes në sekuestro të të dhënave me rëndësi për hetimin dhe për sa i përket respektimit të kufijve të ndërhyrjes, në mënyrë që të garantohet mbrojtje e mjaftueshme dhe efektive kundër arbitraritetit.

133. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se masat riparuese konsistojnë në ndarjen materiale të të dhënave në përmbajtjen e telefonit të kërkuësës dhe, konkretisht: i) korrespondenca dhe të dhënat personale që nuk lidhen me objektin e hetimit penal e që duhet të asgjësohen; ii) korrespondenca dhe të dhënat personale që lidhen me objektin e hetimit penal, të cilat mund të mbahen përkohësisht, por vetëm nën kontroll gjyqësor, duke zbatuar garancitë procedurale të përcaktuara në arsyetimin e këtij vendimi, në mënyrë që ndërhyrja të mos mbetet potencialisht e pakufizuar.

134. Për sa më lart, Gjykata vëren se kërkesa nuk mund të pranohet në tërësinë e saj, pasi autoritetet publike, në funksion të parandalimit dhe ndjekjes penale, mund të përdorin masa për sigurimin e provave, për aq kohë sa ndërhyrja është e parashikuar nga ligji, ndjek një qëllim legjitim dhe është e domosdoshme në rrethanat konkrete, duke u shoqëruar me garanci kundër abuzimit. Megjithatë, Gjykata ka arritur në përfundimin se kopjimi dhe sekuestrimi i të gjitha të dhënave kompjuterike në përmbajtjen e telefonit të kërkuësës, si dhe kërkimi e përpunimi i tyre, pa kufizime të arsyeshme të fushëveprimit dhe pa arsye të veçanta që ta justifikojnë këtë shtrirje, ka shkuar



përtej asaj që ka qenë e nevojshme për të arritur qëllimin legjitim. Për rrjedhojë, kërkesa pranohet vetëm në masën që lidhet me pjesën e ndërhyrjes joproporcionale dhe me pasojat e saj, si dhe me urdhërimin e masave riparuese që sigurojnë respektimin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe fshehtësinë e korrespondencës në kuptim të neneve 35 dhe 36 të Kushtetutës ose të së drejtës për jetë private dhe të korrespondencës në kuptim të nenit 8 të KEDNJ-së. Në vlerësim të Gjykatës, pranimi i pjesshëm pasqyron ekuilibrin që duhet ruajtur ndërmjet interesit publik për mbarëvajtjen e hetimit penal dhe nevojës për mbrojtje efektive të të drejtave kushtetuese të kërkuarës.

135. Gjykata vlerëson se, *së pari*, është rasti të konstatojë cenimin e të drejtave kushtetuese të kërkuarës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe fshehtësinë e korrespondencës për të dhënat kompjuterike që nuk lidhet me objektin e hetimit penal. Siç u parashtrua, nga faktet e çështjes, rezulton se interesi real i hetimit lidhet, në thelb, me komunikimet e kërkuarës me persona të lidhur me hetimin, ndaj është e justifikueshme që ndërhyrja të mund të shtrihet vetëm në atë pjesë të korrespondencës dhe të dhënave personale që lidhen me objektin konkret të hetimit penal. Nga ana tjetër, për të legjitimuar kopjimin dhe sekuestrimin e të gjitha të dhënave të tjera në përmbajtjen e telefonit të kërkuarës, si dhe për kërkimin e përpunimin në tërësi të tyre, kërkohen arsye të veçanta dhe të mjaftueshme, çka në rastin konkret nuk janë parashtruar as në vendimin e sekuestrimit, as në vendimin e ekspertimit teknik-elektronik të telefonit, dhe as në ndonjë dokument tjetër. Për pasojë, ekstraktimi, kopjimi, sekuestrimi dhe shqyrtimi i korrespondencës dhe i të dhënave personale që nuk lidhen me objektin e hetimit cenojnë fshehtësinë e korrespondencës dhe të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale të kërkuarës. Për rrjedhojë, Gjykata konstaton cenimin e fshehtësisë së korrespondencës dhe së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, për pjesën që nuk lidhet me objektin e hetimit penal, pasi nuk provohet të jetë gjetur ekuilibri i drejtë ndërmjet interesave të përfshirë.

136. *Së dyti*, Gjykata vlerëson se është rasti të urdhërojë asgjësimin e kopjes të të dhënave që nuk lidhen me objektin e hetimit. Ajo vëren se konstatimi i cenimit të të drejtave kushtetuese të

kërkuarës do të ishte i pamjaftueshëm, nëse nuk do të shoqërohej me masa riparuese konkrete. Në këtë kuptim, për sa kohë që kopjet e korrespondencës dhe të dhënave personale që nuk lidhen me objektin e hetimit penal vazhdojnë të mbahen nga organi i ndjekjes penale, ndërhyrja në të drejtat e kërkuarës vazhdon në kohë dhe rreziku i aksesimit ose përdorimit të mëtejshëm mbetet aktual. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se asgjësimi i kopjeve të korrespondencës dhe i të dhënave personale të nxjerra nga telefoni celular i kërkuarës, për pjesën që nuk lidhet me objektin e hetimit penal, është një masë riparuese e domosdoshme për të ndaluar ndërhyrjen e pajustificuar dhe për të rivendosur, sa të jetë e mundur, respektimin e të drejtave të saj. Kjo masë buron nga detyrimi i autoriteteve publike për të mos mbajtur nën kontroll të dhëna që nuk justifikohen nga qëllimi legjitim i hetimit. Në këtë drejtim, Gjykata mban parasysh se realizimi i këtij asgjësimi presupozon identifikimin teknik të të dhënave që duhet të zhduken. Në rrethanat kur kopja mbahet vetëm nga organi i ndjekjes penale, subjekti i interesuar, është ky organ që ka mundësi për të kryer identifikimin dhe asgjësimin material të të dhënave përkatëse. Megjithatë, duke qenë se cenimi i konstatuar lidhet pikërisht me shtrirjen e pakufizuar dhe mungesën e mbikëqyrjes reale, identifikimi dhe asgjësimi nuk mund të mbeten diskrecionale, por duhet të realizohen në mënyrë të verifikueshme, sipas garancive procedurale të përcaktuara në arsyetimin e këtij vendimi dhe nën mbikëqyrjen e gjykatës së zakonshme.

137. Nga ana tjetër, Gjykata, *së treti*, vlerëson se është rasti të shprehet për vijimin e mbajtjes në sekuestro të të dhënave kompjuterike që kanë lidhje me objektin e hetimit, por duke ia nënshtuar këtë kontrollit gjyqësor. Në masën që ekzistojnë të dhëna që lidhen me objektin e hetimit penal, Gjykata çmon se ruajtja e tyre mund të jetë e domosdoshme për sigurimin e provës dhe mbarëvajtjen e procedimit penal. Megjithatë, vijimi i mbajtjes së këtyre të dhënave nuk mund të konsiderohet i ligjshëm dhe proporcional vetëm mbi bazën e interesit të hetimit, pa u vendosur nën kufij të qartë dhe mbikëqyrje gjyqësore të efektshme, sidomos kur ndërhyrja fillestare është konstatuar si e shtrirë në mënyrë të pakufizuar dhe pa kontroll gjyqësor *ex post* real e të plotë. Mbikëqyrja gjyqësore në rastin konkret duhet të përfshijë verifikimin e lidhjes së kategorive të të dhënave me objektin e hetimit, domosdoshmërinë e



ruajtjes së tyre, si dhe kufijtë në shtrirje dhe në kohë të kësaj mbajtjeje, në mënyrë që ruajtja të kufizohet vetëm në të dhënat që lidhen me objektin e hetimit penal dhe të mos tejkalojë masën e pashmangshme. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, në parim, kontrolli gjyqësor duhet të bëhet me kontradiktoritet, me pjesëmarrjen e palëve. Megjithatë, në rrethanat kur hetimi në rastin konkret është ende në vijim dhe ekziston rrezik real që zbulimi i materialit të cenojë sekretin hetimor, duke mbajtur parasysh edhe faktin se kërkuesja nuk është subjekt nën hetim, gjykata e zakonshme e shkallës së parë mund të kufizojë kontradiktoritetin vetëm për atë që është e domosdoshme dhe në mënyrë proporcionale, duke kompensuar çdo kufizim me garanci procedurale që ruajnë karakterin real dhe efektiv të kontrollit, të tilla, si: shqyrtim të plotë, vendimarrje të arsyetuar dhe dokumentim të kufijve të masës. Duke mbajtur në konsideratë që Gjykata nuk është në pozicionin e duhur për të vlerësuar rrezikun që mund t'i vijë integritetit të hetimit penal, ajo vëren se kufizimi i kontradiktoritetit mund të shtrihet tek e drejta e njohjes me aktet e çështjes nëse verifikohet rreziku i cenimit të integritetit të hetimit penal, por gjithsesi kjo mbetet çështje për t'u zbatuar nga prokuroria dhe gjykata e zakonshme, sipas standardeve të këtij vendimi. Në këtë kuptim, kontrolli gjyqësor nuk duhet të mbetet formal, **por duhet të ushtrohet realisht mbi ndërhyrjen që prek nenet 35 dhe 36 të Kushtetutës dhe nenin 8 të KEDNJ-së, pra mbi përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave.**

138. Gjykata, po ashtu, *së katërti*, vlerëson se është rasti të urdhërojë zbatimin e garancive procedurale për vijimin e mbajtjes në sekuestro të telefonit celular të kërkueses, si send që mbart korrespondencë dhe të dhëna personale. Duke ritheksuar se telefoni celular është send që mbart të dhëna personale dhe të korrespondencë dhe, për rrjedhojë, mbajtja e tij në sekuestro dhe çdo veprim i mëtejshëm për përmbytjen e tij përbëjnë ndërhyrje në nenet 35 dhe 36 të Kushtetutës dhe nenin 8 të KEDNJ-së, Gjykata çmon se vijimi i mbajtjes në sekuestro i telefonit duhet të shoqërohet me garancitë procedurale të evidentuara në arsyetimin e këtij vendimi, të afta për të parandaluar arbitraritetin dhe për të kufizuar ndërhyrjen brenda kuadrit të hetimit penal. Këto garanci synojnë që ndërhyrja të mos jetë potencialisht e pakufizuar, që çdo akses dhe kërkim të jetë i justifikuar dhe i kufizuar vetëm në të

dhënat që lidhen me hetimin penal dhe të mos tejkalojë masën e pashmangshme, si dhe që të mundësohet kontroll gjyqësor efektiv për respektimin e kufijve të masës. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se, duke qenë se kërkuesja nuk është subjekt nën hetim, por person që ka dijeni për rrethanat të tij, zbatimi rigoroz i garancive procedurale merr peshë të shtuar, pasi ndërhyrja mbi të drejtat e saj nuk mund të shtrihet përtej minimumit të domosdoshëm që justifikohet nga hetimi penal.

139. Gjykata gjithashtu, *së fundmi*, vlerëson se është rasti për të ngarkuar Prokurorinë e Posaçme për ekzekutimin e vendimit dhe përcaktimin e një afati deri në 3 muaj për ekzekutimin. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se ekzekutimi i vendimit të saj kërkon kryerjen e veprimeve konkrete mbi kopjen e të dhënave të nxjerra nga telefoni, kopje e cila, siç u përmend, mbahet aktualisht nga Prokuroria e Posaçme. Për pasojë, vetëm ky organ ka mundësi faktike të kryejë ndarjen/filtrimin dhe asgjësimin material të të dhënave që nuk kanë lidhje me hetimin si dhe të administrojë në vijim atë pjesë të të dhënave kompjuterike që pretendohet se kanë lidhje me të. Megjithatë, Gjykata çmon se ngarkimi i Prokurorisë së Posaçme me ekzekutimin nuk nënkupton lënien e vlerësimit përfundimtar në diskrecionin e saj. Përkundrazi, ekzekutimi duhet të kuptohet si realizim teknik i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim dhe si detyrim për të vënë në lëvizje kontrollin gjyqësor për vijimin e mbajtjes në sekuestro të të dhënave kompjuterike që kanë lidhje me hetimin. Për këtë qëllim, Prokuroria e Posaçme duhet t'i paraqesë gjykatës së zakonshme të shkallës së parë kërkesën për miratimin e vijimit të sekuestrimit të të dhënave që pretendon se kanë lidhje me hetimin, duke arsyetuar në mënyrë konkrete këtë lidhje dhe domosdoshmërinë e ruajtjes të të dhënave, si dhe duke siguruar zbatimin e garancive procedurale të përcaktuara në arsyetimin e këtij vendimi. Gjykata çmon se afati 3-mujor është i domosdoshëm për të garantuar efektivitetin e vendimit dhe për të shmangur zgjatjen në kohë të një ndërhyrjeje të konstatuar si joproporcionale. Ky afat detyron subjektin e interesuar për të kryer, brenda një kohe të arsyeshme, veprimet e nevojshme për ndarjen/filtrimin dhe asgjësimin e atyre të dhënave kompjuterike që nuk kanë lidhje me hetimin, si dhe për të paraqitur kërkesën për kontroll gjyqësor për vijimin e mbajtjes në sekuestro të të



dhënave të tjera (atyre që kanë lidhje me hetimin), duke respektuar garancitë procedurale të përcaktuara në arsyetimin e këtij vendimi.

140. Në përfundim, Gjykata, bazuar në rrethanat e çështjes dhe arsyetimin e mësipërm, vlerëson se urdhërimet si më lart në dispozitivin e vendimit janë të përshtatshme dhe të domosdoshme për të bërë efektive mbrojtjen kushtetuese të të drejtave të kërkuases, duke garantuar njëkohësisht interesin publik për mbarëvajtjen e hetimit penal dhe duke vendosur mekanizma të verifikueshëm që parandalojnë arbitraritetin, në përputhje me kërkesën për gjetjen e një ekuilibri të drejtë ndërmjet interesave të përfshirë.

141. Gjykata, duke ritheksuar detyrimin kushtetues që rrjedh nga neni 132 i Kushtetutës për zbatimin e vendimeve të saj, të cilat janë përfundimtare dhe të detyrueshme për organet publike, çmon se, duke pasur parasysh natyrën e çështjes, duhet të shprehet edhe për efektet e këtij vendimi, në kuptim të nenit 76, pika 3, të Ligjit Organik të saj. Në këtë kuadër, duke iu referuar dhe rregullimit ligjor për fuqinë prapavepruese të vendimeve të saj në rastet përjashtimore (pika 7), Gjykata thekson se ky vendim nuk ka efekte prapavepruese në çështje të ngjashme të sekuestrit të të dhënave kompjuterike, në të cilat nuk është paraqitur ankim kushtetues individual ose për të cilat është paraqitur ankim dhe kontrolli gjyqësor ka përfunduar. Ky vendim prodhon efektet e tij në kuadër të këtij rasti konkret dhe brenda kufijve të urdhërimeve të dispozitivit, por edhe në çdo rast tjetër në të ardhmen, duke orientuar organet përgjegjëse për zbatimin e masave hetimore të kësaj natyre, në përputhje me garancitë procedurale të përcaktuara në arsyetimin e tij.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.

2. Konstatimin e cenimit të fshehtësisë së korrespondencës, si dhe së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, për pjesën që ato nuk lidhen me objektin e hetimit penal.

3. Asgjësimin e kopjeve të korrespondencës dhe të dhënave personale të nxjerra nga telefoni celular i kërkuases që nuk lidhen me objektin e hetimit penal.

4. Vijimin e mbajtjes në sekuestro të kopjeve të korrespondencës dhe të dhënave personale që lidhen me objektin e hetimit penal, duke ia nënshtruar kontrollit gjyqësor.

5. Urdhërimin e zbatimit të garancive procedurale të parashikuara në arsyetimin e këtij vendimi në vijimin e mbajtjes në sekuestro të telefonit celular, si send që mbart korrespondencë dhe të dhëna personale.

6. Ngarkimin e Prokurorisë së Posaçme për ekzekutimin e vendimit brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e tij, duke respektuar garancitë procedurale, sipas arsyetimit të këtij vendimi.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 29.7.2025.

Shpallur më 13.1.2026.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marjana Semini, Ilir Toska

VENDIM

Nr. 345, datë 29.12.2025

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “VOLTON” SHPK PËR ZGJIDHJEN E MOSMARRËVESHJES ME SHOQËRINË OSSH SHA, LIDHUR ME PIKËN E MATJES “TONA ALB/6390”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, germat “a” dhe “ë”, nenit 24, pikat 1, 2, 3, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 15 dhe 23, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 96, datë 3.9.2016; të nenit 11, të “Rregullores për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve, në sektorin e energjisë elektrike



dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.12.2025, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve me nr. 2489/5 prot., datë 24.12.2025, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Volton’ sh.p.k. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqëritë ‘OSSH’ sh.a., lidhur me pikën e matjes ‘Tona Alb/6390’”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Volton” sh.p.k., me shkresën e datës 19.9.2025, të protokolluar pranë Entit Rregullator të Energjisë (ERE) me nr. 2489 prot., datë 19.9.2025, ka paraqitur kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së lindur me shoqërinë “OSSH” sh.a., lidhur me konfigurimin e gabuar të parametrave të matjes së energjisë elektrike në pikën e matjes “Tona ALB/6390”, si dhe me efektet financiare të pretenduara nga ky gabim.

- Sipas parashtrësive të “Volton” sh.p.k., konfigurimi i pasaktë i transformatorëve të rrymës ka sjellë matje të fryra të konsumit të energjisë elektrike për periudhën 20.2.2025–30.3.2025, duke ndikuar në planifikimin dhe blerjen e energjisë elektrike në tregun “Day Ahead” dhe duke krijuar, sipas shoqërisë, një dëm ekonomik të konsiderueshëm.

- Shoqëria “OSSH” sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 10701/1 prot., datë 15.10.2025, të protokolluar në ERE me nr. 2489/2 prot., datë 17.10.2025, ka bërë me dije se: gabimi në konfigurimin e parametrave të matjes ka qenë i natyrës njerëzore, është konstatuar dhe korrigjuar, janë kryer rilogaritjet përkatëse dhe se matjet finale janë vënë në dispozicion të furnizuesit brenda afateve të parashikuara, duke vlerësuar se detyrimet e operatorit të shpërndarjes janë përmbushur.

- Nga dokumentacioni i administruar rezulton se palët mbajnë qëndrime të ndryshme lidhur me pasojat financiare të gabimit të konstatuar në matje dhe me ekzistencën ose jo të një detyrimi për kompensim ekonomik. Në kuadër të shqyrtimit të kësaj kërkesë rezulton se:

- Shoqëria “Volton” sh.p.k. është e licencuar nga ERE për veprimtarinë e furnizimit me energji elektrike me vendimin nr. 268, datë 10.12.2024, ndërsa shoqëria “OSSH” sh.a. është operator i licencuar i sistemit të shpërndarjes me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014, i ndryshuar

me vendimet nr. 216, datë 11.10.2018 dhe nr. 224, datë 9.11.2021.

- Në nenin 24, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, përcaktohet se ERE vepron si autoriteti kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura ndërmjet të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, në përputhje me rregulloren përkatëse.

- Në këto rrethana, vlerësohet se çështja e paraqitur përbën një mosmarrëveshje ndërmjet dy subjekteve të licencuara dhe se palët legjitimohen për t’iu drejtuar ERE-s për zgjidhjen e saj, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

- Shqyrtimi i mosmarrëveshjeve ndërmjet të licencuarve trajtohet nga ERE në përputhje me “Rregulloren për trajtimin e ankesave të paraqitura nga klientët dhe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 114, datë 8.7.2016.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës së paraqitur nga shoqëria “Volton” sh.p.k. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë “OSSH” sh.a., lidhur me pikën e matjes “Tona ALB/6390”, dhe fillimin e procedurës për shqyrtimin e kësaj mosmarrëveshjeje.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqërinë “Volton” sh.p.k. dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM**Nr. 346, datë 29.12.2025****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
DISA NDRYSHIME NË TREGUESIT E
KRITEREVE STANDARDE TË CILËSISË
SË SHËRBIMIT NË SISTEMIN E
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 7, pika 1; 16; 19, germa “h” dhe “j”, dhe nenit 20, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 19, germa “f” dhe 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimit dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.12.2025, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Çështjeve Konsumatore dhe Drejtoria e Monitorimit të Tregut dhe Mbikëqyrjes së të Licencuarve, me nr. 3147 prot., datë 24.12.2025, “Mbi fillimin e procedurës për disa ndryshime në treguesit e kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Kuvendi i Shqipërisë në Rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2024, miratuar në datën 9.10.2025, ka rekomanduar marrjen e masave për rishikimin e rregullave dhe standardeve të cilësisë së shërbimit të ofruar nga operatorët e rrjetit, në kuadër të rritjes dhe përmirësimit të cilësisë për konsumatorët e energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 181, datë 10.11.2017, ka miratuar “Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, e cila përcakton ndër të tjera treguesit e cilësisë së furnizimit me energji elektrike dhe performancën, në lidhje me sigurinë e rrjetit për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike (OSSH) sh.a.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 97, datë 7.4.2021, ka miratuar treguesit për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2021.

- Në zbatim të detyrimit për raportim, “OSSH” sh.a. ka përcjellë periodikisht raportimet mbi standardet e arritura të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes, ndërsa nga të dhënat e raportuara për 9-mujorin (janar–shtator) 2025 rezultojnë tendenca për përmirësim të treguesve kryesorë të cilësisë së shërbimit, përfshirë energjinë e pafurnizuar (ENS) dhe treguesit SAIDI dhe SAIFI.

- Në vijim të komunikimit, “OSSH” sh.a., me shkresën nr. 2717/2 prot., datë 12.11.2025, ka bërë me dije arsyet që lidhen me përmirësimin e treguesve të cilësisë së shërbimit, si dhe pritshmëritë për vijimin e trendit përmirësues për vitin 2025 dhe vitet pasardhëse, ndërkohë që ka bërë me dije edhe procesin e hartimit të Kodit të Shpërndarjes.

- Duke pasur parasysh realizimet e deritanishme dhe pritshmëritë afatmesme pozitive, si dhe faktin se miratimi i një Kodi të ri Shpërndarjeje mund të kërkojë kohë, ERE, bazuar në nenin 13 të rregullores së miratuar me vendimin nr. 181, datë 10.11.2017, me iniciativën e saj, vlerëson se është në rrethanat që mund të procedojë me fillimin e procedurës për ndryshimin e treguesve të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, si dhe rishikimin e disa dispozitave të kësaj rregulloreje që, për shkak të implementimit ndër vite apo humbjes së aktualitetit, rezultojnë të nevojshme për t'u rivlerësuar.

- Në vijim të rishikimit të “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit”, konstatohet se kompensimi i klientëve fundor, në rast të mosrespektimit të këtyre kriterëve, realizohet përmes marrëdhënies kontraktuale ndërmjet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe furnizuesit, e rregulluar nga “Marrëveshja për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, e miratuar nga Bordi i ERE-s; për këtë arsye, pika 10.2, e nenit 10 të kësaj rregulloreje harmonizohet me këtë akt kontraktual, me qëllim garantimin e qartësisë juridike dhe koherencës rregullatore në zbatimin e mekanizmit të kompensimit ndaj klientëve fundor.

- Treguesit aktualë të standardeve teknike (p.sh. koha mesatare e ndërprerjes, energjia e pafurnizuar – ENS, indekset SAIDI/ SAIFI), të përcaktuar në vendimet e mëparshme të Bordit, kanë treguar ndryshime në performancë dhe tregojnë nevojën për përshtatje të vlerave objektive të standardeve për



të reflektuar realitetin e tregut dhe performancën e operatorëve.

- Rregullorja aktuale përmban dispozita që kanë humbur aktualitetin ose janë bërë të papërshtatshme për situatën operacionale, përfshirë dispozita të caktuara që parashikojnë afate, raporte ose kërkesa që nuk korrespondojnë me zhvillimet e sektorit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për disa ndryshime në “Rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181, datë 10.11.2017, të ndryshuar.

2. Fillimi i procedurës përfshin shqyrtimin dhe vlerësimin e propozimeve për rishikimin e rregullores dhe aneksit të “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, në lidhje me parametrat e treguesve të cilësisë së shërbimit, sipas tabelës së standardeve të cilësisë, si më poshtë:

A- Drafttreguesit e cilësisë së shërbimit për vitet 2026, 2027, 2028:

Treguesit	Njesia	Propozim					
		Vitet					
		2026		2027		2028	
a. Energjia e pafurnizuar (ENS)	MWh	33,318		32,651		31,998	
f. SAIDI	Ore	38.20		36.29		34.48	
g. SAIFI	numer	23.52		22.56		21.65	
h. Koha e nevojshme për riparimin e shërbimit pas një difekti në sistemin e shpërndarjes (TM+TU)	Ore	1.79		1.77		1.75	
		Urbane	Rurale	Urbane	Rurale	Urbane	Rurale
TM 35kV	ore	1.58	1.97	1.57	1.93	1.56	1.89
20 kV	ore	1.23	1.64	1.22	1.62	1.21	1.60
6-10 kV	ore	2.35	2.88	2.33	2.85	2.31	2.82
0.4 kV	ore	1.00	1.14	0.99	1.12	0.98	1.10

- B- Në rregulloren për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, miratuar në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181, datë 10.11.2017, të ndryshuar fillojnë procedurat për ndryshimet, si vijon:

- B-1 Neni 6 të shfuqizohet;

- B-2 Paragrafi i fundit, i pikës 7.1, të nenit 7 të ndryshojë dhe të bëhet: “Nivelet e pritshme të performancës, siç miratuar nga ERE, do të vihen në zbatim menjëherë dhe do të mbeten në fuqi, deri në rivlerësimin e këtyre standardeve nga ERE në funksion të performancës së matur dhe të raportuar.”;

Faqe | 1566

- B-3 Pika 7.2, e nenit 7 të shfuqizohet;

- B-4 Pika 7.3, e nenit 7, të ndryshojë dhe të bëhet: ““OSSH” sh.a. ose ERE, me iniciativën e saj, do të propozojë dhe ERE do të miratojë nivelin e lejuar të rishikuar të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit në funksion të performancës së matur dhe të raportuar.”;

- B-5 Pika 7.4, e nenit 7, të ndryshojë dhe të bëhet: “Jo më vonë se njëherë në 3 vjet ERE do të rishqyrtojë performancën e arritur gjatë kësaj periudhe, do të rivlerësojë nivelet e pritshme të performancës dhe do të miratojë nivelin e lejuar të kriterëve standarde të cilësisë së furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit në sistemin e shpërndarjes.”;

- Pika 10.2, e nenit 10, të ndryshojë dhe të bëhet: “Kompensimi i klientëve fundor të lidhur në rrjetin e shpërndarjes, në rast të mosrespektimit të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit të energjisë elektrike, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje, do të bëhet bazuar në përcaktimet e “Marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit”, të miratuar nga Bordi i ERE-s.”.

3. Drejtoria e Çështjeve Konsumatore të njoftojë shoqërinë “OSSH” sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM
Nr. 1, datë 8.1.2026

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “TIRANA
INTERNATIONAL DEVELOPMENT”
SHPK PËR RINOVIMIN E LICENCËS
NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, 10, pikat 1 dhe 3, si dhe 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.1.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2983/1 prot., datë 29.12.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Tirana International Development’ sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Tirana International Development” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 146, datë 24.6.2021, deri më 24.6.2026.

- Shoqëria ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 2983/1 prot., datë 24.12.2025.

- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 490, seria T21, është 24.6.2026) dhe shoqëria duhet të aplikonte brenda datës 24.12.2025.

- Sa konstatohet, shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1, të rregullores.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

- Shoqëria ka bërë me dije se nuk ka pasur ndryshime thelbësore të dokumentacionit dhe të dhënave teknike të dokumentacionit të depozituar në aplikimin fillestar për pajisje me licencë.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar rezulton se shoqëria “Tirana International Development” sh.p.k. ka paraqitur ekstraktin historik të QKB-së, vërtetimet e gjendjes gjyqësore për administratorin dhe shoqërinë, si dhe vërtetimin tatimor, nga të cilat konstatohet përmbushja e kriterëve përkatëse. Shoqëria ka depozituar strukturën administrative dhe pasqyrat financiare të audituara për vitet 2022–2024, nga të cilat rezulton se ka qenë me fitim për të tre vitet kontabël.

- Nga vlerësimi i dokumentacionit rezulton se shoqëria ka depozituar pjesërisht dokumentacionin e kërkuar sipas rregullores, ndërkohë që mbetet për t’u depozituar dhe/ose plotësuar dokumentacioni përkatës.

- Për sa depozituar nga shoqëria dhe në referencë të përcaktimeve të rregullores, vlerësohet se nga ana e saj duhet të sqarohet/plotësohet dhe sa vijon:

- deklaratën e kërkuar në germën “c”, të shtojcës 1 të rregullores;

- vërtetimin se shoqëria nuk ka detyrime tatimore të papaguara;

- parashikimin e sasisë së energjisë që do të tregtojë 5 vitet e ardhshme të ushtrimit të aktivitetit, mënyrën se si parashikon ta financojë këtë veprimtari në të ardhmen e po ashtu dedikimin e mbështetjes financiare përkatëse.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 490, seria T21, të shoqërisë “Tirana International Development” sh.p.k., për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.



2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Tirana International Development” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 2, datë 8.1.2026

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “FAVINA.1.” SHPK, PËR
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e”, dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 8.1.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 3099/1 prot., datë 29.12.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë

‘Favina.1.’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Favina.1.” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 3099 prot., datë 19.12.2025, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, të rregullores për pikën 1.1, germat: “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat: “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat: “a”, “b” dhe “c”; si dhe pikën 2.5.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e nevojshëm për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Favina.1.” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Favina.1.” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 672 lekë

